

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

Konferenca e Përgjithshme Vjetore e 182-të

31 mars – 1 prill 2012

Botuar nga
Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
Solt-Lejk-Siti, Juta

© 2012 Intellectual Reserve, Inc.
I rezervohen të gjitha të drejtat

Miratuar për anglisht: 12/11
Miratuar për përkthim: 12/11
Përkthim i *182nd Annual General Conference*
Albanian
PD50038655 101

Përmbajtja

SESIONI I PARADITES TË SË SHTUNËS

Ndërsa Mblidhemi Përsëri <i>Tomas S. Monson</i>	1
Dhe do të Udhëhiqen nga një Fëmijë <i>Bojd K. Paker</i> ,	4
Të Mësojmë Fëmijët Tanë të Kuptojnë <i>Sheril A. Esplin</i> ,	11
Të Kthyer në Besim tek Ungjilli i Tij përmes Kishës së Tij <i>Donald L. Hallstrom</i> ,	16
Ai me të Vërtetë na Do <i>Pol E. Kolliker</i> ,	21
Sakrifica <i>Dallin H. Ouks</i> ,	26
Male për t'i Ngjitur <i>Henri B. Ajring</i> ,	33

SESIONI I PASDITES TË SË SHTUNËS

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës <i>Diter F. Uhtdorf</i> ,	41
Raporti i Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2011 <i>Robert W. Kentuell</i>	45
Raporti Statistikor, 2011 <i>Bruk P. Hejls</i> ,	47
Punëtorët në Vresht <i>Xhefri R. Holland</i> ,	49
Të Vijnë në Vete: Sakramenti, Tempulli dhe Sakrifica e Shërbimit <i>Robert D. Hejls</i> ,	55
Besim, Qëndrueshmëri, Përbushje: Një Mesazh Drejtuar Prindërve të Vetëm <i>Dejvid S. Bakster</i> ,	61
Qëndroni në Territorin e Zotit! <i>Ulises Soaresh</i> ,	66
Në Akordim me Muzikën e Besimit <i>Kuentin L. Kuk</i> ,	70
Si të Merrni Zbulësë dhe Frymëzim për Jetën Tuaj Personale <i>Riçard G. Skot</i> ,	78

SESIONI I PRIFTËRISË

Fuqitë e Qiellit <i>Dejvid A. Bednar</i> ,	84
Kritja e Vërtetë përmes Riaktivizimit të Anëtarëve më pak Aktivë <i>Riçard C. Exhli</i>	91
Priftëri Aarone: Ngrihu dhe Përdore Fuqinë e Perëndisë <i>Adrián Oçoa</i> ,	97
Arsyet dhe Qëllimet e Shërbimit të Priftërisë <i>Diter F. Uhtdorf</i> ,	102
Familje që Kanë Bërë Besëlidhje <i>Henri B. Ajring</i> ,	110
Të Gatshëm dhe të Denjë për të Shërbyer <i>Tomas S. Monson</i>	118

SESIONI I PARADITES TË SË DIELËS

Të Mëshirshmit Gjejnë Mëshirë <i>Diter F. Uhtdorf</i> ,	125
Falë i Oqftë Perëndisë <i>Rasëll M. Nelson</i> ,	132
Mësime të Veçanta <i>Ronald A. Rasband</i> ,	139
Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndihmës: Besim, Familje, Ndihmë <i>Xhuli B. Bek</i> ,	144
Doktrina e Krishtit <i>D. Tod Kristoferson</i> ,	150
Vrapimi i Jetës <i>Tomas S. Monson</i>	159

SESIONI I PASDITES TË SË DIELËS

Fuqia e Çlirimit <i>L. Tom Peri</i> ,	167
Që të Humburit të Mund të Gjenden <i>M. Rasëll Ballard</i> ,	173
Të Pasurit e Vizionit për të Vepruar <i>O. Vinsent Halek</i> ,	179
“Vetëm mbi Parimet e Drejtësisë” <i>Leri Y. Uilson</i> ,	184
A ia Vlente? <i>Dejvid F. Evans</i> ,	189
Ta Mbajmë të Shenjtë <i>Pol B. Pajper</i> ,	195
Ç’Mendon Krishti për Mua? <i>Nil L. Andersen</i> ,	200
Ndërsa e Mbyllim Këtë Konferencë <i>Tomas S. Monson</i>	206

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E TË REJAVE

Ngrihuni e Shkëlqeni <i>En M. Dib</i> ,	209
Kërkoni të Mësoni: Ju Keni një Punë për të Bërë <i>Meri N. Kuk</i> ,	215
Tani Është Koha për t’u Ngritur e Shkëlqyer! <i>Elen S. Dalton</i> ,	221

Besoni, Binduni, Duroni | *Tomas S. Monson*228

Ndërsa Mblidhemi Përsëri

Nga Presidenti Tomas S. Monson

Ati ynë Qiellor e do secilin prej nesh dhe i di nevojat tona. U mbushëshim me Shpirtin e Tij ndërsa marrim pjesë në punimet e kësaj konference.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, ndërsa mblidhemi përsëri në konferencën e përgjithshme të Kishës, unë ju uroj mirëseardhjen dhe ju shpreh dashurinë time. Ne takohemi çdo gjashtë muaj për të forcuar njëri-tjetrin, për të dhënë inkurajim, për të ofruar ngushëllim, për të forcuar besimin tonë. Ne jemi këtu për të mësuar. Disa prej jush mund të jenë duke kërkuar përgjigje për pyetjet dhe sfidat që po përjetojnë në jetën e tyre. Disa po luftojnë me zhgënjimet apo humbjet. Secili mund të ndriçohet, të lartësohet dhe të ngushëllohet ndërsa ndihet Shpirti i Zotit.

Nëse ka ndryshime që duhen bërë në jetën tuaj, e gjetshit nxitjen dhe kurajën për t'i bërë ato ndërsa dëgjoni fjalët e frymëzuara që do të thuhën. E përtëritë secili prej nesh vendosmërinë për të jetuar në mënyrë të tillë që të jemi bij e bija të denja të Atit tonë Qiellor. Le të vazhdojmë ta kundërshtojmë të keqen kudo që të gjendet.

Ne jemi shumë të bekuar që kemi ardhur në tokë në një kohë të tillë si kjo – një kohë e mrekullueshme në historinë e gjatë të botës. Ne nuk mund të qëndrojmë të gjithë nën të njëjtën çati, por tani kemi aftësinë për të marrë pjesë në zhvillimet e kësaj konference nëpërmjet mrekullive të televizionit, radios, televizionit me kabëll, transmetimit satelitor dhe internetit – madje në telefonat celularë. Ne bashkohemi si një, duke folur

gjuhë të ndryshme, duke jetuar në vende të ndryshme, por të gjithë të një besimi dhe një doktrine, dhe një qëllimi.

Nga një fillim i vogël 182 vjet më parë, prania jonë tani ndihet anembanë botës. Kjo kauzë e madhe në të cilën jemi përfshirë, do të vazhdojë të shkojë përpara, duke ndryshuar dhe bekuar jetë ndërsa ndodh kështu. Asnjë shkak, asnjë forcë në të gjithë botën nuk mund ta ndalojë punën e Perëndisë. Pavarësisht se çfarë ndodh, kjo kauzë e madhe do të shkojë përpara. Ju i mbani mend fjalët profetike të Profetit Jozef Smith: “Asnjë dorë mëkatore nuk mund ta ndalojë punën të përparojë; përndjekjet mund të egërsohen, turmat mund të bashkohen, armiqtë mund të mblidhen, shpifja mund të përgojë, por e vërteta e Perëndisë do të shkojë përpara me guxim, me fisnikëri dhe e pavarur derisa ajo të ketë përshkuar çdo kontinent, të ketë vizituar çdo rajon, të futet në çdo vend dhe të jetë dëgjuar nga çdo vesh, derisa qëllimet e Perëndisë të përmbushen dhe Jehova i Madh të thotë se puna u krye”¹.

Ka shumë gjëra të vështira dhe sfiduese në botë sot, vëllezër e motra të mia, por ka gjithashtu shumë gjëra që janë të mira dhe lartësuese. Ashtu siç shpallim në nenin tonë të trembëdhjetë të besimit: “Në qoftë se ka diçka të virtytshme, të dashur ose me famë të mirë apo të denjë për t’u lavdëruar, ne i kërkojmë këto gjëra”. Vazhdojmë përherë të bëjmë kështu.

Ju falënderoj për besimin dhe përkushtimin tuaj ndaj ungjillit. Unë ju falënderoj për dashurinë dhe kujdesin që i shfaqni njëritjetrit. Ju falënderoj për shërbimin që sillni në lagjet e degët tuaja dhe në kunjet e distriktet tuaja. Është një shërbim i tillë që i mundëson Zotit të përmbushë shumë nga qëllimet e Tij këtu në tokë.

Unë ju shpreh falënderimet e mia për dashamirësinë tuaj ndaj meje kudo që shkoj. Ju falënderoj për lutjet tuaja në emrin tim. Unë i kam ndier ato lutje dhe jam mirënjohës së tepërmi për to.

Tani, vëllezërit dhe motrat e mia, kemi ardhur këtu që të udhëzohemi dhe të frymëzohemi. Shumë mesazhe do të ndahen gjatë këtyre dy ditëve. Unë mund t’ju siguroj se ata burra e gra që do t’ju flasin, kanë kërkuar ndihmë dhe drejtim nga qielli, kur kanë përgatitur mesazhet e tyre. Ata kanë marrë mbresa në lidhje me atë që do të ndajnë me ne.

Ati ynë Qiellor e do secilin prej nesh dhe i di nevojat tona. U mbushëshim me Shpirtin e Tij ndërsa marrim pjesë në punimet e kësaj konference. Kjo është lutja ime e sinqertë, në emrin e shenjtë të Zotit e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 147.

Dhe do të Udhëhiqen nga një Fëmijë

Nga Presidenti Bojd K. Paker,

President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të kuptojnë se thirrja e tyre e parë – prej së cilës nuk do të lirohen kurrë – është ndaj njëri-tjetrit dhe më pas ndaj fëmijëve të tyre.

Vite më parë, në një natë të acartë në një stacion treni në Japoni, dëgjova një trokitje të lehtë në dritaren e vagonit tim të fjetjes. Atje qëndronte një djalë që po ngrinte, i veshur me një këmishë të rreckosur, me një leckë të ndotur të lidhur rreth nofullës së fryrë. Koka e tij ishte e mbuluar me dregëza. Ai mbante një kanaçe të ndryshkur dhe një lugë, simbol i një lypësi jetim. Ndërsa luftova ta hapja derën për t'i dhënë pará, treni u nis.

Unë nuk do ta harroj kurrë atë djalë të vogël, të pangrënë që mbeti duke qëndruar në të ftohtë, duke mbajtur një kanaçe të zbrazët. As nuk mund ta harroj se sa i paaftë u ndieva ndërkohë që treni u largua ngadalë dhe e la atë duke qëndruar në platformë.

Disa vite më vonë në Kusko, një qytet lart në Andet e Perusë, Plaku A. Teodor Tatël dhe unë, mbajtëm një mbledhje sakramenti në një dhomë të gjatë e të ngushtë që kishte daljen në rrugë. Ishte natë dhe, teksa foli Plaku Tatël, një djalë i vogël, ndoshta gjashtë vjeç, u shfaq në hapësirën e derës. Ai kishte veshur vetëm një këmishë të rreckosur që i shkonte deri te gjunjët.

Në të majtën tonë ishte një tavolinë e vogël me pjatën e bukës për sakramentin. Ky jetim i pangrënë rruge pa bukën dhe u afrua ngadalë përgjatë murit drejt saj. Ai ishte thujse te tavolina kur

një grua në udhëzën mes ndenjësve e pa atë. Me një shkundje të vrazhdë të kokës, ajo e dëboi jashtë në natë. Unë rënkova brenda vetes.

Më vonë djali i vogël u kthye sërish. Ai u fut fshehtas përgjatë murit, duke hedhur shikimin nga buka tek unë. Kur ishte afër pikës ku gruaja do ta shihte sërish, unë shtriva krahët dhe ai erdhi duke vrapuar drejt meje. E mbajta në prehrin tim.

Më pas, si diçka simbolike, e ula atë te karrigia e Plakut Tatël. Pas lutjes së mbylljes, djali i vogël e i uritur u turr si shigjetë nëpër natë.

Kur u ktheva në shtëpi, i tregova Presidentit Spenser W. Kimball rreth përvojës sime. Ai u mallëngjye thellësisht dhe më tha: "Ju po mbanit një komb në prehër". Ai ma tha më shumë se një herë: "Ajo përvojë ka kuptim shumë më të madh sesa ju tashmë keni arritur të dini".

Ndërsa kam vizituar afro 100 herë vende të Amerikës Latine, e kam kërkuar atë djalë të vogël në fytyrat e njerëzve. Tani e di vërtet se çfarë donte të thoshte Presidenti Kimball.

Takova një tjetër djalë duke u dridhur në rrugët e Solt-Lejk-Sitit. Ishte vonë në një natë tjetër të ftohtë dimri. Ne po largoheshim nga një darkë Krishtlindjeje te një hotel. Nëpër rrugë zbritën gjashtë ose tetë fëmijë të zhurmshëm. Të gjithë ata duhet të kenë qenë në shtëpi, jo në të ftohtë.

Njëri djalë nuk kishte pallto. Ai kërcente shumë shpejt që të largonte të dridhurat. Ai u zhduk poshtë një rrugice, pa dyshim drejt një apartamenti të vogël e të vjetër dhe një shtrati që nuk kishte mbulesa mjaftueshëm për ta mbajtur ngrohtë.

Natën, kur tërhoqa lart vetes mbulesat, ofrova një lutje për ata që nuk kanë shtretër të ngrohtë ku të shtrihen.

Kur përfundoi Lufta II Botërore, unë isha vendosur në Osaka të Japonisë. Qyteti ishte i rrënuar dhe rrugët ishin mbushur me blloqe, copëra materialesh dhe gropa prej bombave. Edhe pse pjesa më e madhe e pemëve ishte hedhur në erë, pak prej tyre ende qëndronin me degë dhe trungje të thyera dhe kishin kurajën të lëshonin pak degë me gjethe.

Një vajzë e vocërr, e veshur me një kimono të rreckosur me ngjyra, po mblidhte me vrull gjethe fiku egjipti të verdha për një buqetë. Vajza e vogël dukej e pavetëdijshme për shkatërrimin që

e rrethonte atë, ndërsa kacavirrej mbi rrënoja për t'i shtuar gjethe të tjera koleksionit të saj. Ajo kishte gjetur bukurinë e vetme të mbetur në botën e saj. Ndoshta duhet të them se *ajo* ishte pjesa e bukur e botës së saj. Në një farë mënyre, mendimi për të e rrit besimin tim. Te vajza ishte e mishëruar shpresa.

Mormoni na mësoi se “fëmijët e vegjël janë gjallë në Krisht”¹ dhe nuk kanë nevojë të pendohen.

Rreth vitit 1900, dy misionarë po bënë punë misionare në malet në jug të Shteteve të Bashkuara. Një ditë, nga një kodër, ata panë njerëz që po mblidheshin në një çeltirë shumë më poshtë. Misionarët nuk kishin shpesh shumë njerëz të cilëve mund t'u predikonin, kështu që nisën të zbrisnin te çeltira.

Një djalë i vogël ishte mbytur dhe do të kishte një funeral. Prindërit e tij kishin dërguar që të thërrisnin meshtarin për të folur në funeralin e të birit. Misionarët qëndruan prapa ndërsa meshtari shëtitës u kthye nga babai dhe nëna e vrerosur dhe filloi predikimin e tij. Nëse prindërit do të prisnin të merrnin ngushëllim nga ky meshtar, ata do të zhgënjeshin.

Ai i qortoi ashpër që nuk e kishin pagëzuar djalin e vogël. Ata e kishin vonuar pagëzimin për shkak të një gjëje apo një tjetre dhe tani ishte tepër vonë. Ai u tha atyre shumë hapur se djali i tyre i vogël kishte shkuar në ferr. Ishte faji i tyre. Ata duhej të fajësoheshin për vuajtjen e tij të pafund.

Pasi predikimi përfundoi dhe varri u mbulua, misionarët iu afruan prindërve të vrerosur. “Ne jemi shërbëtorë të Zotit”, i thanë ata të ëmës, “dhe ne kemi ardhur me një mesazh për ju.” Ndërkohë që prindërit e ngashëryer dëgjuan, të dy misionarët lexuan nga zbulesat dhe ndanë dëshminë e tyre për rivendosjen e çelësave për shëlbimin edhe të të gjallëve edhe të të vdekurve.

Kam ca simpati për atë predikues. Ai po bënte më të mirën që mundte me atë dritë dhe njohuri që kishte. Por ka më shumë se sa ai duhej të kishte qenë në gjendje të jepte. Ka një plotësi të ungjillit.

Misionarët erdhën si ngushëllues, si mësues, si shërbëtorë të Zotit, si shërbëtarë të autorizuar të ungjillit të Jezu Krishtit.

Këta fëmijë, për të cilët fola, përfaqësojnë të gjithë fëmijët e Atit tonë Qiellor. “Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga Zoti; . . . Lum ai njeri që ka kukurën e tij plot.”²

Krijimi i jetës është një përgjegjësi e madhe për një çift të martuar. Një nga sfidat më të mëdha të kësaj jete të vdekshme është të jesh një prind i denjë dhe i përgjegjshëm. As burri as gruaja nuk mund t'i rrisë fëmijët i vetëm. Është paracaktuar që fëmijët të kenë dy prindër – edhe babanë edhe nënën. Asnjë model ose proces tjetër nuk mund ta zëvendësojë këtë.

Shumë kohë më parë, një grua e përlotur më tha se, kur ishte studente kolegji, kishte bërë një mëkat serioz me të dashurin e saj. Ai kishte planifikuar një abort. Në kohën e duhur ata u diplomuan e u martuan dhe patën disa fëmijë të tjerë. Ajo më tha se sa vuante tani që shikonte familjen e saj, fëmijët e saj të bukur dhe që shihte në mendjen e saj vendin, bosh tashmë, ku ajo foshnjë po mungonte.

Nëse ky çift do ta kuptonte dhe zbatonte Shlyerjen, ata do ta dinin se ato përvoja dhe dhembja e lidhur me to mund të fshihen. Asnjë dhembje nuk do të zgjasë përgjithmonë. Nuk është e lehtë, por jeta kurrë nuk është menduar të jetë e lehtë apo e drejtë. Gjithmonë do t'ia vlejë mundimi për pendimin dhe shpresën e përhershme që sjell falja.

Një tjetër çift i ri i përlotur më tha se sapo kishin ardhur nga një mjek, ku u qe thënë se nuk do ishin në gjendje të kishin fëmijët e tyre. Ata ishin zemërthyer nga lajmi. Ata u habitën kur unë u thashë se në të vërtetë ishin mjaft fatlumë. Ata pyetën veten se përse do ta thoja diçka të tillë. U thashë atyre se gjendja e tyre ishte pafundësisht më e mirë se sa ajo e disa çifteve të tjera, që qenë në gjendje të ishin prindër, por që e refuzuan dhe e shmangën me egoizëm atë përgjegjësi.

U thashë atyre: “Të paktën ju dëshironi fëmijë dhe ajo dëshirë do të peshojë shumë në favorin tuaj në jetën tuaj tokësore dhe përtej, sepse do të japë qëndrueshmëri shpirtërore dhe emocionale. Së fundi, do të jeni shumë më fatlumë, sepse ju dëshironit fëmijë dhe nuk mund t'i kishit ata, në krahasim me ata që mundeshin, por që nuk do të kenë fëmijë.”

Ende të tjerë qëndrojnë të pamartuar dhe si pasojë pa fëmijë. Disa, për shkak të rrethanave përtej kontrollit të tyre, janë duke rritur fëmijë si nëna ose baballarë të vetëm. Këto janë gjendje të përkohshme. Si pjesë e planit të përjetësisë – jo gjithmonë në vdekshmëri – dëshirat e zjarrta dhe të drejta do të përmbushen.

“Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve.”³

Qëllimi përfundimtar i të gjithë aktivitetit në Kishë është të shohësh burrin e gruan e tij dhe fëmijët e tyre të lumtur në shtëpi, të mbrojtur nga parimet dhe ligjet e ungjillit, të vulosur me siguri në besëlidhjet e priftërisë së përjetshme. Bashkëshortët dhe bashkëshortet duhet të kuptojnë se thirrja e tyre e parë – prej së cilës nuk do të lirohen kurrë – është ndaj njëri-tjetrit dhe më pas ndaj fëmijëve të tyre.

Një nga zbulimet më të mëdha të prindërimit është se ne mësojmë shumë më tepër për atë që ka vërtet rëndësi nga fëmijët tanë sesa mësoam ndonjëherë nga prindërit tanë. Ne arrijmë të njohim të vërtetën në profecinë e Isaias se “do të udhëhiqen nga një fëmijë”⁴.

Në Jerusalem, “Jezusi, pasi thirri një fëmijë të vogël pranë vetes, e vuri në mes tyre

dhe tha: ‘Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve.

Kush, pra, do të përulet si ky fëmijë i vogël, do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve.’”⁵

“Jezusi tha: ‘I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë, sepse atyre u përket mbretëria e qiejve.’

Dhe, mbasi vuri duart mbi ata, u nis që andej.”⁶

Ne lexojmë në Librin e Mormonit për vizitën e Jezu Krishtit në Botën e Re. Ai i shëroi dhe i bekoi njerëzit dhe urdhëroi se fëmijët e tyre të vegjël duhet të silleshin tek Ai.

Mormoni shënoi: “Ata i sollën fëmijët e tyre të vegjël dhe i ulën përdhe rreth e përçark tij dhe Jezusi qëndroi në mes; dhe turma u hapi rrugë, derisa të gjithë u sollën pranë tij”⁷.

Ai më pas i urdhëroi njerëzit të gjunjëzoheshin. Me fëmijët përreth Tij, Shpëtimtari u gjunjëzua dhe i ofroi një lutje Atit tonë në Qiell. Pas lutjes, Shpëtimtari qau “dhe ai i mori fëmijët e tyre të vegjël, një nga një, dhe i bekoi dhe iu lut Atit për ta.

Dhe pasi e bëri këtë gjë, ai qau përsëri.”⁸

Unë mund t’i kuptoj ndjenjat e shprehura nga Shpëtimtari ndaj fëmijëve. Ka shumë për t’u mësuar nga ndjekja e shembullit

të Tij në kërkimin për t'u lutur për ta, për t'i bekuar dhe për t'u dhënë mësim "të vegj[ëlve]"⁹.

Unë isha fëmija i 10-të në familjen prej 11 fëmijësh. Me aq sa di unë, as babai, as nëna ime nuk shërbeu në ndonjë thirrje me rëndësi në Kishë.

Prindërit tanë shërbyen besnikërisht në thirrjen e tyre më të rëndësishme – si prindër. Babai ynë e udhëhoqi familjen në drejtësi, kurrë me inat ose frikë. Dhe shembulli i fuqishëm i babait u lartësua nga këshilla e ëmbël e nënës. Ungjilli është një ndikim i fuqishëm në jetën e secilit prej nesh në familjen Paker dhe në brezin tjetër, dhe tjetrin, dhe tjetrin, me aq sa kemi parë.

Shpresoj të gjykohej si një burrë po aq i mirë sa babai im. Përpara se të dëgjoj ato fjalë "të lumtë" nga Ati im Qiellor, shpresoj që fillimisht t'i dëgjoj ato nga babai im i vdekshëm.

Shumë herë kam vrarë mendjen se përse duhej të thirresha si Apostull dhe më pas si President i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, pavarësisht se vij nga një shtëpi ku babai mund të konsiderohet si pak aktiv. Nuk jam i vetmi anëtar i Të Dymbëdhjetëve që i përshtatem atij përskrimi.

Përfundimisht, mund ta shihja e ta kuptoja se mund të ketë qenë për shkak të asaj rrethane që u thirra. Dhe mund ta kuptoja se përse në gjithçka që bëjmë në Kishë, na duhet të sigurojmë rrugën si udhëheqës për prindërit dhe fëmijët që të kenë kohë së bashku si familje. Udhëheqësit e priftërisë duhet të jenë të kujdesshëm për ta bërë Kishën një bekim për familjen.

Ka shumë gjëra rreth të jetuarit të ungjillit të Jezu Krishtit që nuk mund të maten përmes asaj që llogaritet ose shënohet në dokumentet e frekuentimit. Ne e ngarkojmë veten me ndërtesa e buxhete dhe programe e procedura. Duke bërë kështu, është e mundur të mos vihet re vetë qëllimi i ungjillit të Jezu Krishtit.

Shumë shpesh dikush vjen tek unë dhe thotë: "Presidenti Paker, a nuk do të ishte mirë nëse . . . ?"

Unë zakonisht i ndaloj ata dhe them jo, sepse dyshoj se ajo që vijon do të jetë një aktivitet ose program i ri që do të shtojë një barrë për kohën dhe detyrimet financiare në familje.

Koha për familjen është kohë e shenjtë dhe duhet të mbrohet e respektohet. Ne i nxisim anëtarët tanë të tregojnë besnikëri ndaj familjeve të tyre.

Kur u martuam në fillim, bashkëshortja ime dhe unë vendosëm se do t'i prananim fëmijët që do të na lindnin, bashkë me përgjegjësinë që vjen nga lindja dhe rritja e tyre. Në kohën e duhur, ata kanë krijuar familjet e tyre.

Dy herë në martesën tonë, në kohën e lindjes së dy prej djemve tanë të vegjël, një doktor na tha: “Nuk mendoj se ky fëmijë do të mbijetojë”.

Të dyja herët kjo solli përgjigjen nga ana jonë se do të jepnim jetën tonë nëse djali ynë i vocërr do të mund ta mbante të tijën. Gjatë atij ofrimi, ne kuptuam se po e njëjta besnikëri është e ngjashme me atë që Ati Qiellor ndien për secilin prej nesh. Çfarë mendimi hyjnor!

Tani në përfundim të jetës sonë, motra Paker dhe unë e kuptojmë dhe kemi dëshmi se familjet mund të jenë përgjithmonë. Kur u bindemi urdhërimeve dhe e jetojmë plotësisht ungjillin, do të jemi të mbrojtur dhe të bekuar. Për fëmijët dhe nipërit e mbesat tona dhe stërnipërit e stërmbesat, lutja ime është që secili prej familjes sonë të rritur do të ketë të njëjtën besnikëri kundrejt atyre të vegjëlve të çmuar.

Baballarë dhe nëna, herën tjetër që do të mbani një të porsalindur në krahët tuaj, ju mund të keni një përfytyrim të brendshëm të mistereve dhe qëllimeve të jetës. Ju do ta kuptoni më mirë përse Kisha është ashtu siç është dhe përse familja është organizimi themelor në kohë dhe në përjetësi. Unë jap dëshminë se ungjilli i Jezu Krishtit është i vërtetë dhe se plani i shëlbimit, që është quajtur plani i lumturisë, është plan për familjet. I lutem Zotit që familjet e Kishës do të bekohen, prindërit dhe fëmijët, që kjo punë do të ecë me radhë siç Ati dëshiron. E ndaj këtë dëshmi, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

- | | |
|------------------------|---------------------|
| 1. Moroni 8:12. | 6. Mateu 19:14–15. |
| 2. Psalmeve 127:3, 5. | 7. 3 Nefi 17:12. |
| 3. 1 Korintasve 15:19. | 8. 3 Nefi 17:21–22. |
| 4. Isaia 11:6. | 9. 3 Nefi 17:24. |
| 5. Mateu 18:2–4. | |

Të Mësojmë Fëmijët Tanë të Kuptojnë

Nga Sheril A. Esplin,

Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Fillores

Të mësojmë fëmijët tanë të kuptojnë është më shumë sesa thjesht të ndajmë informacion. Ka të bëjë me të ndihmuarin e fëmijëve që të fusin doktrinën në zemrat e tyre.

Ndërsa vitet kalojnë, shumë hollësira në jetën time po bëhen gjithnjë e më shumë të turbullta, por disa prej kujtimeve të mia që qëndrojnë më të kthjellta, janë lindjet e secilit prej fëmijëve tanë. Kujtimet dukeshin aq afër dhe, nëse përpiqem, unë mund të ndiej pothuaj po ato ndjenja të nderimit dhe mrekullisë që përjetova çdo herë që një nga ato foshnja të çmuara u vendos në krahët e mi.

“Bijtë [tanë] janë një trashëgimi që vjen nga Zoti” (Psalmeve 127:3). Ai e njeh dhe e do çdonjërin me dashuri të përkryer (shih Moroni 8:17). Çfarë përgjegjësie të shenjtë vendos mbi ne Ati Qiellor si prindër, që të bashkëpunojmë me Të për të ndihmuar shpirtrat e Tij të zgjedhur të bëhen ajo çka Ai e di se ata mund të bëhen.

Ky privilegj hyjnor i rritjes së fëmijëve tanë është një përgjegjësi tepër e madhe që të mund ta bëjmë të vetëm, pa ndihmën e Zotit. Ai e di me përpikëri se çfarë kanë nevojë të dinë fëmijët tanë, se çfarë kanë nevojë të bëjnë dhe se çfarë duhet të bëhen që të kthehen në praninë e Tij. Ai u jep nënave dhe baballarëve udhëzim dhe drejtim të veçantë përmes shkrimeve të shenjta, profetëve të Tij dhe Frymës së Shenjtë.

Në një zbulësë të ditëve të mëvonshme, përmes Profetit Jozef Smith, Zoti i udhëzon prindërit t’u mësojnë fëmijëve të tyre *të*

kuptojnë doktrinën e pendimit, të besimit në Krisht, të pagëzimit dhe të dhuratës së Frymës së Shenjtë. Vini re se Zoti nuk thotë vetëm se ne duhet t'ua "mësojmë doktrinën"; udhëzimet e Tij janë për t'i mësuar fëmijët tanë të "*kuptojnë* doktrinën". (Shih DeB 68:25, 28; theksimi i shtuar.)

Te Psalmet lexojmë: "Më jep mënçuri dhe unë do ta ruaj ligjin tënd; po, do ta respektoj me gjithë zemër" (Psalmeve 119:34).

Të mësojmë fëmijët tanë të *kuptojnë* është më shumë sesa thjesht të ndajmë informacion. Ka të bëjë me të ndihmuarin e fëmijëve që të fusin doktrinën në zemrat e tyre në një mënyrë që bëhet pjesë e vetë qenies së tyre dhe kjo pasqyrohet në qëndrimet e sjelljen e tyre gjatë gjithë jetës.

Nefi dha mësim se roli i Frymës së Shenjtë është ta çojë të vërtetën "në zemrat e fëmijëve të njerëzve" (2 Nefi 33:1). Roli ynë si prindër është të bëjmë gjithçka mundemi për të krijuar një mjedis ku fëmijët tanë të mund të ndiejnë ndikimin e Shpirtit dhe më pas t'i ndihmojmë ata të dallojnë atë që po ndiejnë.

M'u kujtua një telefonatë që mora disa vite më parë nga vajza jonë Mishel. Me një ndjenjë të ëmbël ajo tha: "Mama, sapo pata përvojën më të habitshme me Eshlin". Eshli është vajza e saj, e cila ishte pesë vjeçe në atë kohë. Mishela e përshkroi mëngjesin si një grindje të vazhdueshme midis Eshlit dhe Endrjus tre vjeçar – njëri nuk donte t'i ndante gjërat dhe tjetri do të qëllonte. Pasi i ndihmoi ata t'i zgjidhnin gjërat, Mishela shkoi për të parë të voglin.

Shpejt, Eshli hyri duke vrapuar, e inatosur që Endrju nuk po i ndante gjërat me të. Mishela e rikujtoi Eshlin për zotimin që kishin bërë në mbrëmjen familjare për të qenë më të sjellshëm me njëri-tjetrin.

Ajo e pyeti Eshlin nëse dëshironte të lutej dhe të kërkonte ndihmën e Atit Qiellor por Eshli, ende shumë e inatosur, iu përgjigj "Jo". Kur e pyeti nëse ajo besonte se Ati Qiellor do t'i përgjigjej lutjes së saj, Eshli tha se nuk e dinte. E ëma i kërkoi asaj të përpiqej dhe me butësi e kapi nga duart dhe u gjunjësua me të.

Mishela sugjeroi se Eshli mund t'i kërkonte Atit Qiellor ta ndihmonte Endrjun të ndante gjërat – dhe ta ndihmonte atë të ishte e sjellshme. Mendimi se Ati Qiellor do ta ndihmonte të vëllanë e saj të vogël që t'i ndante gjërat mund të ketë zgjuar

interesin e Eshlit dhe ajo nisi të lutej, së pari duke i kërkuar Atit Qiellor ta ndihmonte Endrjun t'i ndante gjërat. Ndërsa i kërkoi Atij ta ndihmonte të ishte e sjellshme, ajo nisi të qajë. Eshli e mbylli lutjen e saj dhe e mbështeti kokën mbi supin e mamasë. Mishela e shtrëngoi atë dhe e pyeti se përse po qante. Eshli tha se nuk e dinte.

Mamaja i tha: "Mendoj se e di përse po qan. A ndihesh mirë brenda vetes?" Eshli tundi kokën dhe mamaja vazhdoi: "Ky është Shpirti që të ndihmon të ndihesh në këtë mënyrë. Është mënyra e Atit Qiellor për të të thënë se Ai të do dhe se do të të ndihmojë."

Ajo e pyeti Eshlin nëse e besoi këtë, nëse ajo besoi se Ati Qiellor mund ta ndihmojë. Me sytë e saj të vegjël të përplotur, Eshli tha se ajo e besonte.

Ndonjëherë mënyra më e shkëlqyer për t'u mësuar fëmijëve tanë të kuptojnë një doktrinë është t'i mësojmë sipas rrethanës që po përjetojnë pikërisht në atë moment. Këto momente janë spontane e të paplanifikuara dhe ndodhin në aktivitetet e zakonshme të jetës familjare. Ato vijnë dhe shkojnë shpejt, kështu që ne duhet të jemi vigjilentë dhe ta dallojmë një çast mësimdhënieje kur fëmijët tanë vijnë te ne me një pyetje ose shqetësim, kur ata kanë probleme për t'u marrë vesh me vëllezërit e motrat apo miqtë, kur kanë nevojë të kontrollojnë zemërimin e tyre, kur bëjnë një gabim ose kur kanë nevojë të marrin një vendim. (Shih *Teaching, No Greater Call: A Resource Guide for Gospel Teaching* [1999], f. 140–141; *Marriage and Family Relations Instructor's Manual* [2000], f. 61.)

Nëse jemi gati dhe do ta lejojmë Shpirtin të na drejtojë në këto situata, fëmijët tanë do të marrin mësim me efektshmëri dhe kuptueshmëri më të madhe.

Po aq të rëndësishme janë çastet e mësimdhënies që vijnë ndërsa planifikojmë me maturi aktivitete të rregullta si lutja familjare, studimi familjar i shkrimeve të shenjta, mbrëmja familjare në shtëpi dhe aktivitete të tjera familjare.

Në çdo situatë mësimdhënieje i gjithë mësimi dhe i gjithë kuptimi ushqehen më mirë në një atmosferë ngrohtësie dhe dashurie, ku Shpirti është i pranishëm.

Rreth dy muaj përpara se fëmijët e tij të mbushnin nga tetë vjeç, babai do të gjente kohë çdo javë për t'i përgatitur ata për

pagëzimin. Vajza e tij tha se kur ishte radha e saj [për t'u pagëzuar], ai i dha asaj një ditar dhe u ulën së bashku, vetëm ata të dy, dhe folën e ndanë ndjenjat rreth parimeve të ungjillit. Ai i vizatoi asaj një skicë ndihmëse ndërsa bënë përpara. Ajo tregonte ekzistencën para lindjes, këtë jetë tokësore dhe secilin hap që ajo duhej të merrte që të kthehej për të jetuar me Atin Qiellor. Ndërsa ia dha atë mësim asaj, ai ndau dëshminë për secilin hap të planit të shpëtimit.

Kur bija e tij solli ndërmend këtë përvojë pasi ishte rritur, ajo tha: “Nuk do ta harroj kurrë dashurinë që ndieva nga babai im kur ai kaloi atë kohë me mua. . . . Unë besoj se kjo përvojë ishte një arsye kryesore që unë kisha një dëshmi për ungjillin kur u pagëzoza.” (Shih *Teaching, No Greater Call*, f. 129.)

Dhënia mësim për të kuptuar kërkon përpjekje të vendosur e të qëndrueshme. Kërkohet mësimdhënie përmes porosisë morale e përmes shembullit dhe veçanërisht përmes të ndihmuarit të fëmijëve tanë që të jetojnë atë çka mësojnë.

Presidenti Harold B. Li dha mësim: “Pa përjetuar një parim të ungjillit në veprim, është . . . më e vështirë të besosh në atë parim” (*Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* [2000], f. 121).

Unë fillimisht mësova të lutem duke u gjunjëzuar me familjen time në lutjen familjare. M'u dhanë mësim fjalët që përdoren kur lutesh, ndërsa dëgjova prindërit e mi të luten dhe ndërsa më ndihmuan të thoshja lutjet e mia të para. Mësova se unë mund të flisja me Atin Qiellor dhe të kërkoja drejtim.

Çdo mëngjes pa harruar, nëna dhe babai im mblidheshin së bashku rreth tavolinës së kuzhinës përpara mëngjesit dhe gjunjëzoheshin në lutjen familjare. Ne luteshim në çdo vakt. Në mbrëmje përpara se të shkonim në shtrat, gjunjëzoheshim në dhomën e ndjenjës dhe e mbyllnim ditën me lutje familjare.

Edhe pse kishte shumë gjëra që nuk i kuptova rreth lutjes kur qeshë fëmijë, ajo u bë një pjesë e tillë e jetës sime, që qëndroi me mua. Unë akoma vazhdoj të mësoj dhe kuptimi im për fuqinë e lutjes ende vazhdon të rritet.

Plaku Xhefri R. Holland tha: “Ne të gjithë e kuptojmë se suksesi i mesazhit të ungjillit varet nga mësimdhënia e tij dhe më pas kuptimi, dhe më pas të jetuarit, në një mënyrë të tillë që

premtimi i tij për lumturinë dhe shpëtimin të mund të përmbushet” (“Teaching and Learning in the Church” [worldwide leadership training meeting, 10 shkurt 2007], *Liahona*, qershor 2007, f. 57).

Të mësosh t’i kuptosh plotësisht doktrinat e ungjillit është një proces gjatë tërë jetës dhe vjen “rresht pas rreshti, parim pas parimi, pak këtu dhe pak atje” (2 Nefi 28:30). Ndërsa fëmijët mësojnë dhe veprojnë sipas asaj që mësojnë, kuptimi i tyre zgjerohet, që çon në një nxënie më të madhe, në më shumë veprim dhe madje në një kuptim më të madh e më të qëndrueshëm.

Ne mund ta dimë se fëmijët tanë po fillojnë ta kuptojnë doktrinën kur e shohim atë të shfaqet në qëndrimet dhe veprimet e tyre pa kërcënime apo shpërblime të sipërfaqshme. Ndërsa fëmijët tanë mësojnë të kuptojnë doktrinën e ungjillit, ata bëhen më të mbështetur te vetja dhe më të përgjegjshëm. Ata bëhen pjesë e zgjidhjes së sfidave tona familjare dhe japin një kontribut pozitiv në mjedisin e shtëpisë sonë dhe në suksesin e familjes sonë.

Ne do t’i mësojmë fëmijët tanë të kuptojnë ndërsa shfrytëzojmë çdo situatë mësimdhënieje, ftojme Shpirtin, japim shembullin dhe i ndihmojmë ata të jetojnë atë që mësojnë.

Kur shohim në sytë e një foshnjeje të vocërr, na kujtohet kënga:

*Fëmi i Per’ndis’ jam,
nevoj’ kam un’ gjithmon’;
ndihmom’ që fjal’t e tij t’kuptoj
gjersa nuk është von’.*

*Tregom’, drejtom’, pran’ ti më rri,
rrugën që ta gjej.
Çfar’ të bëj ti më mëso
të rroj me të në qiej.*

(“Fëmi i Per’ndis’ Jam”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58; theksimi i shtuar)

Veprofshim kështu. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Të Kthyer në Besim tek Ungjilli i Tij përmes Kishës së Tij

Nga Plaku Donald L. Hallstrom,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

*Qëllimi i Kishës është të na ndihmojë që të jetojmë
ungjillin.*

Unë e dua ungjillin e Jezu Krishtit dhe Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ndonjëherë ne i përdorim termat *ungjill* dhe *Kishë* si zëvendësuese për njëra-tjetrën, por ato nuk janë njësoj. Sidoqoftë, ato janë të ndërlidhura bukur dhe neve na duhen të dyja.

Ungjilli është plani i lavdishëm i Perëndisë në të cilin neve, si fëmijët e Tij, na jepet mundësia për të marrë gjithçka që Ati ka (shih DeB 84:38). Kjo quhet jetë e përjetshme dhe përshkruhet si “më e madhja e të gjitha dhuratave të Perëndisë” (DeB 14:7). Një pjesë jetike e planit është përvoja jonë tokësore – një kohë për të zhvilluar besim (shih Moroni 7:26), për t’u penduar (shih Mosia 3:12) dhe për t’u pajtuar me Perëndinë (shih Jakobi [LiM] 4:11).

Për shkak se dobësitë tona tokësore dhe “një kundërshtim në të gjitha gjërat” (2 Nefi 2:11) do ta bënë këtë jetë thellësisht të vështirë dhe për shkak se ne nuk do të mundeshim t’i pastronim vetë mëkatet tona, nevojitej një Shpëtimtar. Kur Elohimi, Perëndia i Përjetshëm dhe Ati i të gjithë shpirtrave tanë, paraqiti planin e Tij të shpëtimit, që dikush mes nesh që tha: “Ja ku jam, dërgomë mua” (Abraham 3:27). Emri i tij që Jehova.

Lindur nga një Atë Qiellor, si shpirtërisht dhe fizikisht, Ai zotëronte plotfuqishmërinë për ta mposhtur botën. Lindur nga një nënë tokësore, Ai iu nënshtrua dhembjes dhe vuajtjes në

vdekshmëri. Jehova i madh u quajt gjithashtu Jezus dhe përveç kësaj iu dha dhe titulli Krisht, që do të thotë Mesia ose I Vajosuri. Arritja e tij kurorëzuese qe Shlyerja, ku Jezusi, Krishti, “zbriti nën gjithçka” (DeB 88:6), duke e bërë të mundur që Ai të paguante një shpërblësë për secilin prej nesh.

Kisha u krijua nga Jezu Krishti gjatë shërbesës së Tij tokësore “ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe të profetëve” (Efesianëve 2:20). Në këtë “periudhë ungjillore [të] plotësisë së kohëve” (DeB 128:18), Zoti rivendosi atë që qe dikur, duke i thënë në mënyrë specifike Profetit Jozef Smith: “Unë do të ngre një kishë prej dorës tënde” (DeB 31:7). Jezu Krishti ishte dhe është kreu i Kishës së Tij, i përfaqësuar në tokë nga profetët që mbajnë autoritetin e Apostullit.

Kjo është një Kishë madhështore. Organizimi, efektshmëria dhe mirësia e saj e plotë respektohen nga të gjithë ata që kërkojnë ta kuptojnë atë sinqerisht. Kisha ka programe për fëmijët, rininë, burrat dhe gratë. Ajo ka shtëpi të bukura mbledhjeje që janë më shumë se 18.000 në numër. Tempujt madhështorë – 136 në total tani – gjenden anembanë botës, me 30 të tjerë në ndërtim ose të njoftuar. Një trupë misionarësh me kohë të plotë prej më shumë se 56.000 vetësh, përfshirë të rinjtë dhe më pak të rinjtë, po shërbejnë në 150 shtete. Puna humanitare mbarëbotërore e Kishës është një shembull i mrekullueshëm i bujarisë së anëtarëve tanë. Sistemi ynë i mirëqenies kujdeset për anëtarët tanë dhe përkrah mbështetjen te vetja në një mënyrë që nuk ka të dytë askund. Në këtë Kishë, ne kemi udhëheqës pa pagesë dhe një komunitet shenjtorësh që janë të gatshëm t’i shërbejnë njëri-tjetrit në një mënyrë të mahnitshme. Nuk ka asgjë të ngjashme me këtë Kishë në të gjithë botën.

Kur linda unë, familja jonë jetonte në një vilë të vockël në tokat e një prej shtëpive të mëdha dhe historike të mbledhjes së Kishës në Tabernakullin e Honolulus. Unë u kërkoj ndjesë tani miqve të mi të dashur në Peshkopatën Kryesuese, që mbikëqyrin godinat e Kishës, por kur isha i vogël, unë kacavirresha sipër, poshtë dhe përmes çdo centimetri të asaj prone, nga fundi i pishinës së mbushur me ujë që reflektonte, deri në majën e kullës së madhe e të ndriçuar. Ne madje lëkundeshim (si Tarzani) në

degët e gjata e të varura të pemëve gjigante të bananes që ndodhen në atë vend.

Kisha që gjithçka për ne. Ne shkonim në shumë mbledhje, madje në më shumë sesa kemi sot. Ne merrnim pjesë në Fillore pasditeve të së enjtes. Mbledhjet e Shoqatës së Ndihmës qenë të martave në mëngjes. Aktiviteti i Përbashkët për të rinjtë që të mërkurën mbrëma. E shtuna që për aktivitetet e lagjes. Të dielën, burrat dhe të rinjtë shkonin në mbledhjen e priftërisë në mëngjes. Në mesditë ne merrnim pjesë në shkollën e së dielës. Pastaj në mbrëmje, ne ktheheshim për mbledhjen e sakramentit. Me vajtje-ardhjet dhe mbledhjet, dukej sikur koha jonë shpenzohej me aktivitetet e Kishës gjatë gjithë ditës së diel dhe shumicës së ditëve të javës.

Sado që e doja Kishën, që gjatë atyre ditëve të fëmijërisë që, për herë të parë, pata një ndjesi se kishte diçka më tepër se aq. Kur qeshë pesë vjeç, u mbajt një konferencë e madhe në tabernakull. Ne ecëm përgjatë rrugicës në të cilën jetonim e mbi një urë të vogël që të çonte te shtëpia kryesore e mbledhjes dhe u ulëm për afërsisht në rreshtin e 10-të në godinën e madhe kishtarë. Kryesues dhe folës në mbledhje që Dejvid O. Mek-Kei, Presidenti i Kishës. Në të vërtetë, nuk më kujtohet asgjë nga ato që tha ai, por kam një kujtim të gjallë të asaj që pashë dhe asaj që ndieva. Presidenti Mek-Kei që veshur me një kostum ngjyrë kremi dhe, me flokët e tij të bardhë e me onde, dukej shumë fisnik. Ai mbajti një varëse të bërë me lule të kuqe të freskëta sipas traditës së ishujve. Ndërsa fliste, unë ndieva diçka shumë të fortë dhe shumë vetjake. Më vonë e kuptova se po ndieja ndikimin e Shpirtit të Shenjtë. Ne kënduam himnin e mbylljes.

Kush është në anën e Zotit? Kush?

Tani është koha për ta treguar.

Ne pyesim pa frikë:

Kush është në anën e Zotit? Kush?

(“Who’s on the Lord’s Side?” [“Kush është në anën e Zotit?”] *Hymns*, nr. 260)

Me ato fjalë të kënduara nga pothuaj 2.000 njerëz, por që mua më dukej se ishte një pyetje që më drejtohej vetëm mua, dëshiroja të ngrihesha në këmbë dhe të thoja: “Jam unë!”

Disa kanë arritur të mendojnë se të qenit aktiv në Kishë është qëllimi kryesor. Këtu ka një rrezik. Ka mundësi që të jesh aktiv në Kishë dhe më pak aktiv në ungjill. Më lini ta theksoj: të qenit aktiv në Kishë është një synim shumë i dëshirueshëm; megjithatë është i pamjaftueshëm. Të qenit aktiv në Kishë është një tregues i jashtëm i dëshirës sonë shpirtërore. Nëse ne marrim pjesë në mbledhjet tona, i mbajmë dhe i përmbushim përgjegjësitë në Kishë dhe u shërbejmë të tjerëve, kjo vëzhgohet publikisht.

Nga ana tjetër, gjërat e ungjillit zakonisht janë më pak të dukshme dhe më të vështira për t'u matur, por kanë rëndësi më të madhe në përjetësi. Për shembull, sa besim kemi ne në të vërtetë? Sa pendohemi? Sa kuptimplote janë ordinancat në jetën tonë? Sa të përqendruar jemi në besëlidhjet tona?

E përsëris: ne kemi nevojë për ungjillin *dhe* për Kishën. Në fakt, qëllimi i Kishës është të na ndihmojë që të jetojmë ungjillin. Ne shpesh pyesim veten: Si mund të jetë dikush plotësisht aktiv në Kishë në rini dhe mos të jetë më aktiv kur rritet në moshë? Si mundet një i rritur, që ka marrë pjesë dhe ka shërbyer rregullisht, të pushojë së ardhuri? Si mundet një njeri, që është zhgënjyer nga një udhëheqës apo një anëtar tjetër, ta lejojë atë që t'i japë fund pjesëmarrjes së tij në Kishë? Ndoshta arsyeja është se ata nuk qenë të kthyer mjaftueshëm në ungjill – në gjërat e përjetësisë.

Unë sugjeroj tri mënyra për ta pasur ungjillin themelin tonë:

1. *Ta zgjerojmë kuptueshmërinë tonë për Hyjninë.* Një njohuri e pandërprerë dhe dashuria për tre anëtarët e Kreut-Perëndi janë të domosdoshme. T'i lutemi me vëmendje Atit, në emrin e Birit dhe të kërkojmë drejtim nga Fryma e Shenjtë. Të kombinojmë lutjen me studimin e vazhdueshëm dhe meditimin e përlulur që të ndërtojmë në vazhdimësi besim të patundur te Jezu Krishti. "Pasi, si do ta njohi një njeri zotëruesin . . . që është i huaj për të dhe është larg nga mendimet dhe qëllimet e zemrës së tij?" (Mosia 5:13).
2. *Të përqendrohemi tek ordinancat dhe besëlidhjet.* Nëse ka ndonjë prej ordinancave thelbësore ende për t'u kryer në jetën tuaj, përgatituni me qëllim që të merrni secilën prej tyre. Më pas na duhet të vendosim disiplinën për të qenë besnikë ndaj

besëlidhjeve tona, duke e përdorur plotësisht dhuratën e përjavshme të sakramentit. Shumë prej nesh nuk po ndryshohen rregullisht nga fuqia e tij pastruese për shkak të mungesës së nderimit tonë për këtë ordinancë të shenjtë.

3. *Të njëjtësojmë ungjillin me Kishën.* Ndërsa përqendrohemi te ungjilli, Kisha do të bëhet një bekim më shumë, jo më pak, në jetën tonë. Ndërsa vijmë në çdo mbledhje të përgatitur për të “kërk[uar] të mësojmë] madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (DeB 88:118), Fryma e Shenjtë do të jetë mësuesi ynë. Nëse vijmë për t’u zbavitur, do të zhgënjehemi shpesh. Presidentin Spenser W. Kimball e pyetën dikur: “Çfarë bëni ju kur e gjeni veten në një mbledhje të mërzitshme sakramenti?” Përgjigjja e tij qe: “Nuk e di. Nuk kam qenë kurrë në një të tillë” (cituar nga Gene R. Cook, në Gerry Avant, “Learning Gospel Is Lifetime Pursuit”, *Church News*, 24 mars 1990, f. 10).

Në jetën tonë duhet të dëshirojmë atë që ndodhi pasi Zoti erdhi te njerëzit e Botës së Re dhe themeloi Kishën e Tij. Në shkrimet e shenjta lexohet: “Dhe ndodhi që kështu ata [domethënë dishepujt e Tij] shkuan mes gjithë popullit të Nefit dhe predikuan ungjillin e Krishtit mes gjithë njerëzve mbi faqen e dheut, dhe ata u kthyen në besim te Zoti, dhe u bashkuan me kishën e Krishtit, dhe kështu njerëzit e atij brezi, . . . qenë të bekuar” (3 Nefi 28:23).

Zoti dëshiron që anëtarët e Kishës së Tij të kthehen në besim plotësisht në ungjillin e Tij. Kjo është e vetmja mënyrë e sigurt për të pasur siguri shpirtërore tani dhe lumturi përgjithmonë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Ai me të Vërtetë na Do

Nga Plaku Pol E. Kolliker,
i Të Shtatëdhjetëve

Për shkak të modelit të përcaktuar qiellor të familjes, ne e kuptojmë më plotësisht mënyrën se si Ati ynë Qiellor me të vërtetë e do secilin prej nesh në mënyrë të barabartë dhe plotësisht.

Më pëlqen kaq shumë të jem me misionarët kohëplotë. Ata janë plot me besim, shpresë dhe dashuri të vërtetë hyjnore. Përvoja e tyre misionare është si një jetë e plotë, ku gjithçka ndodh në vetëm 18 deri në 24 muaj. Ata vijjnë në terrenin e misionit tamam si foshnjat shpirtërore me oreks të rëndë për të mësuar dhe largohen nga misioni si të rritur të pjekur, dukshëm të gatshëm për të mposhtur çfarëdolloj dhe të gjitha sfidat e vendosura përpara tyre. Gjithashtu i dua misionarët e devotshëm të moshuar, që janë plot me durim, urtësi dhe vetëbesim të qetë. Ata i sjellin një dhuratë qëndrueshmërie dhe dashurie forcës rinore nga misionarët më të rinj përreth tyre. Së bashku, misionarët me kohë të plotë dhe ata të moshuar janë një forcë e fuqishme e këmbëngulëse për mirë, që është duke pasur një ndikim të thellë në jetën e tyre dhe tek ata që ndikohen nga shërbimi i tyre.

Së fundi, dëgjova dy prej këtyre misionarëve të rinj të mrekullueshëm, teksa rishqyrtaan përvojat dhe përpjekjet e tyre. Në atë moment reflektues, ata menduan për individët që kishin kontaktuar atë ditë, disa prej të cilëve ishin më shumë reagues se të tjerët. Ndërsa morën parasysh rrethanat, ata pyetën: “Në ç’ mënyrë mund ta ndihmojmë secilin individ të zhvillojë dëshirën për të ditur më shumë rreth Atit Qiellor? Si i ndihmojmë ata të ndiejnë Shpirtin e Tij? Si mund t’i ndihmojmë ata të dinë se ne i duam?”

Në përfytyrimin tim mund t'i shihja këta dy të rinj tre ose katër vjet pas përfundimit të misioneve të tyre. I përfytyrova ata teksa e kishin gjetur shoqen e tyre të përjetshme dhe duke shërbyer në kuorumet e pleqve ose duke u dhënë mësim një grupi të rinjsh. Tani, në vend që të mendonin rreth kërkuesve të tyre, ata po bënin të njëjtat pyetje rreth anëtarëve të tyre të kuorumit ose të rinjve që ata ishin ngarkuar për t'i ushqyer. Unë pashë se si përvoja e tyre misionare mund të zbatohet si një shembull për ushqimin e të tjerëve gjatë pjesës tjetër të jetës së tyre. Ndërsa kjo mori e dishepujve të drejtë kthehet nga misionet e tyre në shumë vende nëpër botë, ata po bëhen kontribuesit kryesorë në veprën e krijimit të Kishës.

Profeti Lehi i Librit të Mormonit mund të ketë qenë duke meditaruar të njëjtin grup pyetjesh si këta misionarë kur dëgjoi përgjigjen e bijve të tij për drejtimin dhe vegimin që u kishte dhënë: “Dhe kështu Lamani dhe Lemueli, duke qenë më të mëdhenj, mërmëritën kundër atit të tyre. Dhe mërmëritën, sepse nuk i dinin veprimet e atij Perëndie që i kishte krijuar ata” (1 Nefi 2:12).

Ndoshta të gjithë ne e kemi ndier zhgënjimin që Lehi provoi me dy djemtë e tij më të mëdhenj. Kur përballemi me një fëmijë të lëkundur, një kërkues të paangazhuar apo një plak të ardhshëm joreagues, zemrat tona fryhen siç i ndodhi Lehit dhe ne pyesim: “Si mund t'i ndihmoj ata të ndiejnë dhe të dëgjojnë Shpirtin, në mënyrë që të mos marrin pjesë në hutimet e botës?” Dy shkrime të shenjta janë ngulitur në mendjen time, që mund të na ndihmojnë të gjejmë udhën tonë përmes këtyre hutimeve dhe të ndiejmë fuqinë e dashurisë së Perëndisë.

Nefi na jep çelësin për portën e të mësuarit përmes përvojës së tij personale: “Unë, Nefi, . . . duke pasur dëshira të mëdha për të ditur misteret e Perëndisë, prandaj i thirra Zotit dhe vini re, ai më vizitoi dhe ma zbuti zemrën, sa që unë besova të gjitha fjalët që ishin thënë nga ati im; prandaj unë nuk ngrita krye kundër tij, si vëllezërit e mi” (1 Nefi 2:16).

Zgjimi i dëshirës për të mësuar rreth diçkaje na jep aftësinë shpirtërore për të dëgjuar zërin e qiellit. Gjetja e mënyrës për të zgjuar e ushqyer atë dëshirë është kërkesa dhe përgjegjësia e secilit prej nesh – misionar, prind, mësues, udhëheqës dhe anëtar.

Ndërkohë që ndiejmë atë dëshirë duke u formuar në zemrat tona, ne përgatitemi që të përfitojmë nga mësimi i shkrimit të dytë të shenjtë që dëshiroj të përmend.

Në qeshor të vitit 1831, ndërsa po drejtoheshin thirrjet e udhëheqësit e hershëm të Kishës, Jozefit iu tha se “Satani është përhapur në tokë dhe ai shkon duke i mashtruar kombet”. Për të luftuar këtë ndikim hutues, Zoti tha se do të na japë “një model në gjithçka, që [ne] të mos mashtrohe[mi]” (DeB 52:14).

Modelet janë shembuj, drejtues, hapa të përsëritur ose shtigje që dikush ndjek për të qëndruar i rreshtuar me qëllimin e Perëndisë. Nëse këto modele ndiqen, do të na mbajnë të përlur, të zgjuar dhe të aftë të dallojmë zërin e Shpirtit të Shenjtë nga ato zëra që na hutojnë dhe na largojnë. Më pas, Zoti na udhëzon: “Ai që dridhet nën fuqinë time, do të forcohet dhe do të sjellë fryte lavdërimi e urtësie, në përputhje me zbulesat dhe të vërtetat që ju kam dhënë” (DeB 52:17).

Bekimi i lutjes së përlur, të ofruar me qëllim të vërtetë, e lejon Shpirtin e Shenjtë t’i prekë zemrat tona dhe na ndihmon të kujtojmë atë që dinim para se të lindeshim në këtë përvojë të vdekshme. Kur e kuptojmë më qartë planin e Atit tonë Qiellor për ne, ne fillojmë të pranojmë përgjegjësinë tonë për t’i ndihmuar të tjerët të mësojnë e të kuptojnë planin e Tij. E lidhur ngushtë me të ndihmuarin e të tjerëve të kujtojnë është mënyra se si e jetojmë ungjillin dhe e zbatojmë atë në jetën tonë vetjake. Kur e jetojmë vërtet ungjillin sipas modelit të dhënë mësim nga Zoti Jezu Krisht, aftësia jonë për t’i ndihmuar të tjerët rritet. Përvoja në vijim është një shembull i mënyrës se si mund të funksionojë ky parim.

Dy misionarë të rinj trokitën në një derë me shpresën që të gjenin dikë për të pranuar mesazhin e tyre. Dera u hap dhe një burrë trupmadh i përshëndeti ata me një zë antipatik: “Mendova se ju thashë të mos trokisni më në derën time. Ju paralajmërova më parë se, nëse do të vinit përsëri, kjo nuk do të ishte një përvojë e këndshme. Tani më lini të qetë.” Ai me ngut mbylli derën.

Kur misionarët u larguan, misionari më i vjetër e më me përvojë vendosi dorën mbi shpatullën e misionarit më të ri për ta ngushëlluar dhe për t’i dhënë zemër. Pa u vënë re nga ata, burri i pa nga dritarja për t’u siguruar se ata e kishin kuptuar mesazhin

e tij. Ai priste që t'i shihte ata tërësisht të qeshur dhe të bënin shaka me përgjigjen e tij të shkurtër e të pasjellshme për vizitën e tyre në tentativë. Megjithatë, ndërsa ai pa shprehjen e mirësisë midis dy misionarëve, zemra e tij u zbut në çast. Ai e hapi sërish derën dhe u kërkoi misionarëve të ktheheshin e të ndanin mesazhin e tyre me të.

Kur i dorëzohemi vullnetit të Perëndisë dhe jetojmë modelin e Tij, ndodh që Shpirti i Tij ndihet. Shpëtimtari dha mësim: “Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:35). Ky parim i të pasurit të dashurisë për njëri-tjetrin dhe zhvillimit të aftësisë sonë për të qenë me përqendrimin te Krishti në mënyrën si mendojmë, flasim dhe veprojmë, është thelbësor për t’u bërë dishepuj të Krishtit dhe mësues të ungjillit të Tij.

Zgjimi i kësaj dëshire na përgatit të kërkojmë modelet e premtuara. Kërkimi i modeleve na drejton te doktrina e Krishtit sikurse është dhënë mësim nga Shpëtimtari dhe udhëheqësit e Tij profetë. Një model i kësaj doktrine është të durojmë deri në fund: “Dhe të bekuar janë ata që do të përpiqen të sjellin në dritë Sionin tim në atë ditë, pasi ata do të kenë dhuratën dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë; dhe në qoftë se durojnë deri në fund, ata do të ngrihen lart në ditën e fundit dhe do të shpëtohen në mbretërinë e përjetshme të Qengjit” (1 Nefi 13:37).

Cila është mënyra përfundimtare nëpërmjet së cilës mund të gëzojmë dhuratën dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë? Ajo është fuqia që vjen nga të qenit dishepuj besnikë të Jezu Krishtit. Ajo është *dashuria* jonë për Të dhe bashkëqeniet tona. Është Shpëtimtari që përcaktoi modelin e dashurisë kur na dha mësim se: “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34).

Presidenti Gordon B. Hinkli pohoi këtë parim kur tha: “Të duash Zotin nuk është thjesht këshillë; nuk është thjesht dashamirëse. Është një urdhërim. . . . Dashuria e Perëndisë është rrënja e të gjithë virtytit, e të gjithë mirësisë, e të gjithë forcës së karakterit, e të gjithë besnikërisë për të vepruar drejt” (“Words of the Living Prophet”, *Liahona*, dhjetor 1996, f. 8).

Plani i Atit përcaktoi modelin e organizimit të familjes për të na ndihmuar të mësojmë, zbatojmë dhe kuptojmë fuqinë e

dashurisë. Ditën që u krijua familja ime, unë dhe Ana ime e ëmbël shkuam në tempull dhe hymë në besëlidhjen e martesës. Sa shumë mendova se e doja atë atë ditë, por vetëm sa kisha filluar të shihja vizionin e dashurisë. Kur na u bashkuan fëmijët dhe nipërit e mbesat në jetën tonë, dashuria jona u zgjerua për ta dashur secilin prej tyre njëloj dhe plotësisht. Duket sikur nuk ka mbarim aftësia në rritje për të dashur.

Ndjenja e dashurisë nga Ati ynë Qiellor është si tërheqja e forcës së gravitetit nga qielli. Ndërsa largojmë hutimet që na tërheqin drejt botës dhe ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes për ta kërkuar Atë, ne hapim zemrat tona drejt një force celestiale, që na afron drejt Atij. Nefi e përshkroi ndikimin e tij si “deri në tretjen e mishit [të tij]” (2 Nefi 4:21). Po e njëjta fuqi dashurie bëri që Alma të këndonte “këngën e dashurisë shëlbuese” (Alma 5:26; shih edhe vargun 9). Ajo e emocionoi Mormonin në një mënyrë të tillë që ai na këshilloi të “lut[emi] . . . me të gjithë fuqinë e zemrës [sonë]”, që të mund të mbushemi me dashurinë e Tij (Moroni 7:48).

Si shkrimi i shenjtë modern edhe ai i lashtë janë plot me kujtesa për dashurinë e përjetshme të Atit Qiellor për fëmijët e Tij. Kam besim se krahët e Atit tonë Qiellor shtrihen vazhdimisht, çdo herë të gatshëm për të përqaftuar secilin prej nesh dhe për t’i thënë çdonjërit me atë zë të qetë e depërtues: “Të dua”.

Për shkak të modelit të përcaktuar qiellor të familjes, ne e kuptojmë më plotësisht mënyrën se si Ati ynë Qiellor me të vërtetë e do secilin prej nesh në mënyrë të barabartë dhe plotësisht. Unë dëshmoj se kjo është e vërtetë. Perëndia vërtet na njeh dhe na do. Ai na ka dhënë një vizion të vendit të Tij të shenjtë dhe ka thirrur profetë e apostuj që të japin mësim parimet dhe modelet që do të na çojnë tek Ai. Ndërsa orvatemi të zgjojmë dëshirën për të ditur për veten dhe për të tjerët dhe ndërsa jetojmë modelet që zbulojmë, ne do të afrohem drejt Tij. Unë dëshmoj se Jezusi është vërtet Biri i Perëndisë, Shëmbulli ynë, Shëlbuesi ynë i dashur, që unë e shpreh në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Sakrifica

Nga Plaku Dallin H. Ouks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Jeta jonë plot shërbim e sakrificë është shprehja më e përshtatshme e zotimit tonë për t'i shërbyer Mësuesit dhe bashkëqenieve tona.

Sakrifica shlyese e Jezu Krishtit është quajtur “më e madhërishmja e të gjitha ngjarjeve që nga fillimi i krijimit deri në përjetësi”¹. Ajo sakrificë është mesazhi qendror i të gjithë profetëve. Ajo u kumtua paraprakisht nga flijimet e kafshëve të kërkuara sipas ligjit të Moisiut. Një profet shpalli se i tërë kuptimi i tyre “[vuri] në dukje atë flijim të madh dhe të fundit . . . [të] Biri[t] [të] Perëndisë, po, [të] pafund dhe [të] përjetshëm” (Alma 34:14). Jezu Krishti duroi vuajtje të paimagjinueshme për ta flijuar Vetën për mëkatet e të gjithë njerëzve. Ajo sakrificë ofroi dobinë përfundimtare – Qengjin e dëlirë pa të meta – për vlerën përfundimtare të së keqes – mëkatet e të gjithë botës. Në fjalët e paharrueshme të Eliza R. Snout:

*Të shtrenjtin gjak për ne e dha;
dhe fli u bë për ne.
Një fli pa faj për tonat faj',
shpëtim të gjejmë ne.²*

Ajo sakrificë – Shlyerja e Jezu Krishtit – është në qendër të planit të shpëtimit.

Vuajtja e papërfytyrueshme e Jezu Krishtit, i dha fund sakrificës me anë të derdhjes së gjakut, por nuk i dha fund rëndësisë së sakrificës në planin e ungjillit. Shpëtimtari vazhdon të na kërkojë të bëjmë sakrifica, por sakrificat të cilat i urdhëron tani, janë që ne “t[’i] ofro[jmë] për fli një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar” (3 Nefi 9:20). Ai e urdhëron gjithashtu secilin

prej nesh që ta duam e t'i shërbejmë njëri-tjetrit – në parim, të bëjmë një imitim të vogël të vetë sakrificës së Tij, duke sakrifikuar kohën vetjake dhe përparësitë tona egoiste. Në një himn të frymëzuar, ne këndojmë: "Sakrifica sjell të qiellit bekime"³.

Unë do të flas rreth këtyre sakrificave tokësore që Shpëtimtari ynë na kërkon të bëjmë. Kjo nuk i përfshin sakrificat të cilat jemi të detyruar t'i bëjmë, ose veprimet që mund të jenë të nxitura nga përfitimi vetjak më shumë sesa nga shërbimi apo sakrifica (shih 2 Nefi 26:29).

I.

Feja e krishterë ka një histori sakrifice, përfshirë sakrificën përfundimtare. Në vitet e hershme të epokës së krishterë, Roma martirizoi mijëra vetë për shkak të besimit të tyre në Jezu Krisht. Në shekujt pasues, ndërsa mospajtimet doktrimore i përçanë të krishterët, disa grupe i përdoqën dhe madje u morën jetën anëtarëve të grupeve të tjera. Të krishterët e vrarë nga të krishterët tjerë janë martirët më tragjikë të fesë së krishterë.

Shumë të krishterë kanë bërë vullnetarisht sakrifica të nxitur nga besimi në Krisht dhe dëshira për t'i shërbyer Atij. Disa kanë zgjedhur ta përkushtojnë tërësisht në shërbim të Mësuesit jetën e tyre si të rritur. Ky grup fisnik përfshin ata që janë në urdhrat fetarë të Kishës Katolike dhe ata që kanë dhënë shërbim tërë jetën si misionarë të krishterë në fe të ndryshme protestante. Shembujt e tyre janë sfidues e frymëzues por, për shumicën e besimtarëve në Krisht, as nuk pritet e as nuk janë në gjendje t'ia përkushtojnë të gjithë jetën e tyre shërbimit fetar.

II.

Për shumicën e pasuesve të Krishtit, sakrificat tona përfshijnë atë që mund të bëjmë dita-ditës në jetën tonë të zakonshme vetjake. Në lidhje me këtë përvojë, unë nuk njoh asnjë grup, anëtarët e të cilit të bëjnë më shumë sakrifica se sa shenjtoret e ditëve të mëvonshme. Sakrificat e tyre – sakrificat tuaja, vëllezërit e motrat e mia – janë në kundërshtim me kërkesat e njohura të botës për përmbushje vetjake.

Shembujt e mi të parë janë pionierët tanë mormonë. Sakrificat e tyre heroike të jetës, të marrëdhënieve familjare, shtëpive dhe rehatisë janë në themel të ungjillit të rivendosur. Sara Riç foli

lidhur me atë që i nixti këta pionierë kur përshkroi bashkëshortin e saj, Çarlin, të thirrur në një mision të largët: “Kjo qe vërtet një periudhë e vështirë për mua si dhe për bashkëshortin tim; por detyra na bëri thirrje që të ndaheshim për ca kohë dhe, duke e ditur se [po] i bindeshim vullnetit të Zotit, ne ndiem dëshirën që t’i linim mënjane vetë ndjenjat tona në mënyrë që të ndihmonim për të themeluar punën . . . e të ndihmuarit në ndërtimin e Mbretërisë së Perëndisë në tokë⁴.

Sot, forca më e dukshme e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është shërbimi vetëmohues dhe sakrifica e anëtarëve të saj. Përpara përkushtimit të njërit prej tempujve tanë, një shërbetar i krishterë e pyeti Presidentin Gordon B. Hinkli se përse nuk përmbante asnjë përfaqësim të kryqit, simbolit më të zakonshëm të besimit të krishterë. Presidenti Hinkli u përgjigj se simboli i besimit *tonë* të krishterë është “jeta e njerëzve tanë”⁵. Në të vërtetë, jeta jonë plot shërbim e sakrificë është shprehja më e përshtatshme e zotimit tonë për t’i shërbyer Mësuesit dhe bashkëqenieve tona.

III.

Ne nuk kemi kler të trajnuar profesionalisht dhe me rrogë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Si rezultat, anëtarët joprofesionistë që thirren për të udhëhequr e për të shërbyer në bashkësitë tona, duhet t’i administrojnë të gjitha mbledhjet, programet dhe aktivitetet tona të shumta të Kishës. Ata e bëjnë këtë në më shumë se 14.000 bashkësi vetëm në Shtetet e Bashkuara e në Kanada. Sigurisht, nuk jemi unikë në të pasurin e anëtarëve joprofesionistë në bashkësitë tona që shërbejnë si mësues dhe udhëheqës pa pagesë. Por sasia e kohës së dhuruar nga anëtarët tanë për ta trajnuar e për t’i shërbyer njëri-tjetrit është e madhe në mënyrë të pashoqe. Përpjekjet tona që çdo familje në bashkësitë tona të vizitohet nga mësues shtëpie çdo muaj dhe që çdo grua në moshë madhore të vizitohet nga mësuese vizitore të Shoqatës së Ndhmës çdo muaj, janë shembull për këtë. Ne nuk kemi dijeni për ndonjë shërbim të krahasueshëm me këtë në ndonjë organizatë të botës.

Shembulli më i njohur i shërbimit e sakrificës së pashoqe të shdm-ve, është puna e misionarëve tanë. Aktualisht numërohen më shumë se 50.000 të rinj e të reja dhe mbi 5.000 burra e gra në

moshë madhore. Ata ia përkushtojnë gjashtë muaj deri në dy vjet të jetës së tyre, mësimdhënies së ungjillit të Jezu Krishtit dhe dhënies së shërbimit humanitar në më shumë se 160 vende të botës. Puna e tyre përmban gjithmonë sakrificë, përfshirë vitet që japin për punën e Zotit dhe gjithashtu sakrificat e bëra në sigurimin e të ardhurave për të mbajtur veten.

Ata që mbeten në shtëpi – prindërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes – sakrifikojnë gjithashtu duke jetuar pa praninë dhe shërbimin e misionarëve që dërgojnë. Për shembull, një i ri brazilian mori thirrje si misionar ndërkohë që po punonte për të mbajtur vëllezërit dhe motrat, pasi babai dhe nëna e tij vdiqën. Një Autoritet i Përgjithshëm e përshkroi këtë mbledhje të fëmijëve në këshill dhe kujtimin se prindërit e tyre të ndjerë u kishin mësuar se duhet të ishin gjithnjë të përgatitur për t'i shërbyer Zotit. I riu e pranoi thirrjen e tij si misionar dhe vëllai 16-vjeçar mori përsipër përgjegjësinë për të punuar që të mbante familjen.⁶ Shumica prej nesh di shumë shembuj të tjerë të sakrificave për të shërbyer në mision apo për të mbështetur një misionar. Ne nuk jemi në dijeni për ndonjë shërbim tjetër vullnetar dhe sakrificë si kjo në ndonjë organizatë tjetër të botës.

Ne na pyesin vazhdimisht: “Si i bindni të rinjtë tuaj dhe anëtarët tuaj më në moshë që të lënë shkollimin ose pensionin e tyre për të sakrifikuar në këtë mënyrë?” Kam dëgjuar shumë njerëz të japin këtë shpjegim: “Duke ditur atë që bëri Shpëtimtari im për mua – hirin e Tij në vuajtjen për mëkatet e mia dhe mposhtjen e vdekjes që unë të mund të jetoj përsëri – unë ndihem i/e privilegjuar të bëj sakrificën e vogël që më kërkohet të bëj në shërbim të Tij. Unë dua të ndaj me të tjerët kuptueshmërinë që Ai më ka dhënë.” Si i bindim pasues të tillë të Krishtit që të shërbejnë? Ashtu siç shpjegoi një profet: “Ne [thjesht] ua kërkojmë”⁷.

Sakrifica të tjera që vijnë nga shërbimi misionar, janë sakrificat e atyre që veprojnë sipas mësimëve të misionarëve dhe bëhen anëtarë të Kishës. Për shumë të kthyer në besim, këto sakrifica janë shumë të mëdha, përfshirë humbjen e miqve dhe lidhjeve familjare.

Shumë vite më parë, njerëzit në këtë konferencë dëgjuan për një të ri i cili e gjeti ungjillin e rivendosur ndërkohë që po

studionte në Shtetet e Bashkuara. Kur ky i ri qe gati të kthehej në vendlindje, Presidenti Gordon B. Hinkli e pyeti se çfarë do t'i ndodhte kur të kthehej në shtëpi si i krishterë, "Familja ime do të zhgënjehet", – iu përgjigj i riu. "Ata mund të më dëbojnë dhe të më quajnë të vdekur. Sa për të ardhmen dhe karrierën time, mund të më mbyllën të gjitha dyert."

"A je i gatshëm të paguash një çmim kaq të madh për ungjillin?" – pyeti Presidenti Hinkli.

I riu u përgjigj i përlotur: "Është i vërtetë, apo jo?" Kur profeti e pohoi atë, ai u përgjigj: "Atëherë, çfarë tjetër ka rëndësi?"⁸ Ky është shpirti i sakrificës midis shumë prej anëtarëve tanë të rinj.

Shembuj të tjerë shërbimi e sakrifice shfaqen në jetën e anëtarëve besnikë që shërbejnë në tempujt tanë. Shërbimi në tempull është i pashoq për shenjtoret e ditëve të mëvonshme, por rëndësia e një sakrifice të tillë duhet të jetë e kuptueshme nga të gjithë të krishterët. Shenjtoret e ditëve të mëvonshme nuk kanë asnjë traditë të shërbimit në manastir, por ne prapëseprapë, mund ta kuptojmë e ta nderojmë sakrificën e atyre, besimi i krishterë i të cilëve, i nxit për t'ia përkushtuar jetën asaj veprimtarie fetare.

Vetëm një vit më parë në këtë konferencë, Presidenti Tomas S. Monson tregoi një shembull sakrifice të lidhur me shërbimin në tempull. Në një ishull të vetmuar në Paqësor, një baba besnik shenjtor i ditëve të mëvonshme bëri punë të rëndë fizike në një vend të largët për gjashtë vjet, që të fitonte paratë e nevojshme për të çuar gruan dhe 10 fëmijët e tij që të martoheshin e të vuloseshin për përjetësinë në tempullin e Zelandës së Re. Presidenti Monson shpjegoi: "Ata që i kuptojnë bekimet e përjetshme, të cilat vijnë nga tempulli, e dinë se nuk ka sakrificë tepër të madhe, nuk ka çmim tepër të lartë, nuk ka betejë tepër të vështirë, me qëllim që të marrin ato bekime"⁹.

Unë jam mirënjohës për shembujt e mahnitshëm të dashurisë, shërbimit dhe sakrificës së krishterë që kam parë mes shenjtorëve të ditëve të mëvonshme. Unë ju shoh duke i përmbushur thirrjet tuaja në Kishë, shpesh me sakrificë të madhe kohe, parash dhe mjetesh. Unë ju shoh të shërbeni në misione me vetë shpenzimet tuaja. Ju shoh të dhuroni me gëzim aftësitë tuaja profesionale në shërbim të bashkëgenieve tuaja. Ju shoh të kujdeseni për të varfrit

nëpërmjet përpjekjeve vetjake e nëpërmjet mbështetjes së mirëqenies së Kishës dhe kontributeve humanitare.¹⁰ E gjithë kjo pohohet në një studim mbarëkombëtar që arriti në përfundimin se anëtarët aktivë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme “bëjnë punë vullnetare dhe dhurojnë në mënyrë të konsiderueshme më tepër se mesatarja amerikane dhe madje janë më bujarë në dhënien e kohës dhe parave se besimtarët me shërbim më të lartë [20 përqindësi i sipërm] në Amerikë”¹¹.

Shembuj të tillë të të dhënit ndaj të tjerëve na forcojnë të gjithëve. Ata na kujtojnë mësimin e Shpëtimtarit:

“Në qoftë se dikush don të vijë pas meje, ta mohojë vetveten. . . .

Sepse ai që do të dojë ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë atë” (Mateu 16:24–25).

IV.

Ndofta shembujt më të njohur dhe me të rëndësishëm të shërbimit dhe sakrificës vetëmohuese gjenden në familjet tona. Nënata ia përkushtojnë veten mbajtjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre. Bashkëshortët japin nga vetja për të mbështetur financiarisht bashkëshortet dhe fëmijët e tyre. Sakrificat e përfshira në shërbimin përjetësisht të rëndësishëm ndaj familjeve tona janë tepër të shumta për t’u përmendur dhe shumë të njohura për të qenë nevoja t’i përmendim.

Unë shoh gjithashtu, shenjtorë të ditëve të mëvonshme joegoistë që adoptojnë fëmijë, përfshirë ata me nevoja të veçanta, dhe që përpiqen t’u sigurojnë fëmijëve të birësuar shpresën dhe mundësitë që iu mohuan atyre nga rrethana të mëparshme. Unë ju shoh duke u kujdesur për pjesëtarët e familjes dhe fqinjët që vuajnë nga të meta që prej lindjes, nga sëmundje mendore e fizike dhe vështirësitë e pleqërisë. Edhe Zoti ju shikon dhe Ai i ka bërë profetët e Tij të shpallin se “tekta sakrifikoni për njëri-tjetrin dhe fëmijët tuaj, Zoti do t’ju bekojë”¹².

Unë besoj se shenjtorët e ditëve të mëvonshme që bëjnë shërbim e sakrificë vetëmohuese në ndjekjen plot adhurim të shembullit të Shpëtimtarit, i përkrahin vlerat e përjetshme në një shkallë më të lartë se çdo grup tjetër njerëzish. Shenjtorët e ditëve

të mëvonshme i shohin sakrificat e tyre të kohës dhe të mjeteve si pjesë të shkollimit dhe kualifikimit për përjetësinë. Kjo është një e vërtetë e zbuluar përmes Jozef Smithit, te *Lectures on Faith [Leksione mbi Besimin]* që na mëson se “një fe që nuk kërkon sakrificën e të gjitha gjërave nuk ka kurrë fuqi të mjaftueshme për të prodhuar besimin e mjaftueshëm për jetën e për shpëtimin. . . . Është nëpërmjet kësaj sakrifice dhe vetëm nëpërmjet kësaj, që Perëndia i ka shuguruar njerëzit që të gëzojnë jetën e përjetshme.”¹³

Njësoj siç është sakrifica shlyese e Jezu Krishtit në qendër të planit të shpëtimit, ne, pasuesit e Krishtit, duhet të bëjmë vetë sakrificat tona për t’u përgatitur për fatin që plani ka siguruar për ne.

Unë e di që Jezu Krishti është Biri i Vetëmlindur i Perëndisë, Atit të Përjetshëm. E di se për shkak të sakrificës së Tij shlyese, ne kemi sigurinë e pavdekshmërisë dhe mundësinë për jetë të përjetshme. Ai është Zoti ynë, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, dhe unë dëshmoj për Të, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Bruce R. McConkie, *The Promised Messiah: The First Coming of Christ* (1981), f. 218.
2. “Oh, sa Urti dhe Dashuri”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 19.
3. “Lavdi Njeriut”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 50.
4. Sarah Rich, në Guinevere Thomas Woolstenhulme, “I Have Seen Many Miracles”, në Richard E. Turley Jr. dhe Brittany A. Chapman, botuese *Women of Faith in the Latter Days: Volumi 1, 1775–1820* (2011), f. 283.
5. Gordon B. Hinckley, “The Symbol of Our Faith”, *Liahona*, prill 2005, f. 3.
6. Shih Harold G. Hillam, “Sacrifice in the Service”, *Ensign*, nëntor 1995, f. 42.
7. Gordon B. Hinckley, “The Miracle of Faith”, *Liahona*, korrik 2001, f. 84.
8. Gordon B. Hinckley, “It’s True, Isn’t It?” *Tambuli*, tetor 1993, f. 3–4; shih edhe Nil L. Andersen, “Është i Vërtetë, Apo jo? Atëherë, Çfarë Tjetër ka Rëndësi?” *Liahona*, maj 2007, f. 74; *Konferenca e Përgjithshme*, prill 2007, f. 87.
9. Tomas S. Monson, “Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën”, *Liahona*, maj 2011, f. 91–92.
10. Shih, për shembull, Naomi Schaefer Riley, “What the Mormons Know about Welfare”, *Wall Street Journal*, 18 shkurt 2012, f. A11.
11. Ram Cnaan e të tjerë, “Called to Serve: The Prosocial Behavior of Active Latter-day Saints” (projekt), f. 16.
12. Ezra Taft Benson, “To the Single Adult Brethren of the Church”, *Ensign*, maj 1988, f. 53.
13. *Lectures on Faith* (1985), f. 69.

Male për t'i Ngjitur

Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Nëse kemi besim te Jezu Krishti, kohët më të vështira ashtu si edhe kohët më të lehta në jetë, mund të jenë një bekim.

E dëgjova Presidentin Spenser W. Kimball të kërkonte në një sesion konference që Perëndia t'i jepte atij male sfidash për t'i ngjitur. Ai tha: “Ka sfida të mëdha para nesh, mundësi gjigante që duhen përballur. E mirëpres atë këndvështrim emocionues dhe e ndiej që t'i them Zotit, përulësisht: ‘Ma jep këtë mal’, m’i jep këto sfida.”¹

Zemra ime u frymëzua, duke i ditur, siç i dija unë, disa nga sfidat dhe kundërshtimet që ai kishte përballuar tashmë. Ndieva një dëshirë për të qenë më shumë si ai, një shërbëtor trim i Perëndisë. Kështu që një natë, u luta për një provë që të vërtetonte guximin tim. Unë mund ta kujtoj atë shumë qartë. Në mbrëmje u gjunjëzova në dhomën time të gjumit me një besim që dukej se po e mbushte zemrën time deri në shpërthim.

Brenda një apo dy ditësh, lutja ime mori përgjigje. Sprova më e vështirë e jetës sime më befasoi dhe më përuli. Ajo më siguroi një mësim dy-pjesësh. Së pari, unë pata një provë të qartë se Perëndia e dëgjoi dhe iu përgjigj lutjes sime të besimit. Por së dyti, unë nisa një kurs mësimor që vazhdon ende, për të mësuar rreth arsyes përse ndieva aq mirëbesim atë natë, se një bekim i madh mund të vinte nga sprova që do të ishte më shumë se shpërblyese për çdo çmim.

Sprova që përjetova në atë ditë të hershme, tani më duket e vockël krahasuar me ato që më kanë ndodhur – mua dhe njerëzve që dua, që pas asaj. Shumë prej jush jeni duke kaluar tani sprova fizike, mendore dhe emocionale që mund t’ju bëjnë të

thërrisni fort ashtu siç bëri një shërbëtor i madh e besnik i Perëndisë që unë e njihja mirë. Infermierja e tij e dëgjoji atë të thërriste nga shtrati i tij i dhembjes: “Kur gjatë gjithë jetës sime jam përpjekur të jem i mirë, pse më ndodhi kjo mua?”

Ju e dini se si iu përgjigj Zoti asaj pyetjeje të Profetit Jozef Smith në qelinë e tij të burgut:

“Në qoftë se ti do të hidhesh në gropë apo në duart e vrasësve dhe vendimi me vdekje jepet mbi ty, në qoftë se do të hidhesh në thellësi, në qoftë se dallgët e trazuara komplotojnë kundër teje, në qoftë se erërat e forta bëhen armiku yt, në qoftë se qiejt mbledhin errësirë dhe gjithë elementet ndërthuren për të penguar rrugën; dhe, mbi të gjitha, në qoftë se edhe grykat e ferrit do ta shqyejnë gojën për ty, dije, biri im, se gjithë këto gjëra do të të japin përvojë dhe do të jenë për të mirën tënde.

Biri i Njeriut ka zbritur nën këto të gjitha. A je ti më i madh se ai?

Si rrjedhim, qëndro në udhën tënde dhe priftëria do të mbetet me ty; sepse kufijtë e tyre janë caktuar, ata s’mund të kalojnë. Ditët e tua njihen dhe vitet e tua s’do të numërohen më pak; si rrjedhim, mos ki frikë se ç’mund të bëjë njeriu, sepse Perëndia do të jetë me ty përherë e përgjithmonë.”²

Më ngjan se nuk ka përgjigje më të mirë për pyetjen se përse vijnë sprovat dhe se çfarë duhet të bëjmë, përveç fjalëve të Vetë Zotit, i cili kaloi për ne përmes sprovave që ishin më të tmerrshme sesa mund të përfytyrojmë.

Ju i mbani mend fjalët e Tij kur na këshilloi se prej besimit që kemi në Të, ne duhet të pendohemi:

“Prandaj unë të urdhëroj të pendohesh–pendohu, përndryshe unë të godas me shufrën e gojës sime dhe me zemërimin tim, dhe me indignatën time, dhe vuajtjet e tua do të jenë të ashpra—sa të ashpra ti s’e di, sa therëse ti s’e di, po, sa të vështira për t’u duruar ti s’e di.

Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë;

Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga

çdo por dhe të vuaj si në trup e në shpirt—dhe të dëshiroj që të mos e pi kupën e hidhur e të mpakem—

Megjithatë, lavdi i qoftë Atit dhe unë mora pjesë e i mbarova përgatitjet e mia për fëmijët e njerëzve.”³

Ju dhe unë kemi besimin se mënyra për t’u ngritur gjatë dhe mbi sprovat është që të besojmë se ka një “balsam në Galaad”⁴ dhe se Zoti ka premtuar: “Nuk do të të braktis”⁵. Kjo është ajo që na ka mësuar Presidenti Tomas S. Monson që të na ndihmojë ne dhe ata të cilëve u shërbejmë gjatë atyre që mund të duket se janë sprova të vetmuara dhe tronditëse.⁶

Por Presidenti Monson na ka mësuar gjithashtu me urtësi se një themel besimi i vërtetësisë së atyre premtimeve do kohë që të ndërtohet. Ju mund ta keni parë nevojën për atë themel siç e kam parë unë, anës shtratit të dikujt që është gati për të hequr dorë nga lufta për të duruar deri në fund. Nëse themeli i besimit nuk është bërë pjesë e zemrave tona, fuqia për të duruar do të shkërmoqet.

Qëllimi im sot është të përshkruaj atë që di rreth mënyrës se si mund ta ngremë atë themel të patundur. E bëj këtë me përvullësi të madhe për dy arsye. Së pari, ajo që unë them mund t’i shkurojë disa që po luftojnë në mes të një fatkeqësie të madhe dhe mund të ndiejnë se themeli i tyre i besimit po shkërmoqet. Dhe së dyti, unë e di se prova akoma më të mëdha më presin përpara se jeta të mbarojë. Prandaj, receta që ju jap, është ende për t’u vërtetuar në vetë jetën time nëpërmjet durimit deri në fund.

Kur isha i ri, punova me një firmë kontraktuese që ndërtonte themele dhe zgjerimet në fund të themeleve për shtëpitë e reja. Në të nxehtin e verës që punë e vështirë të përgatisje dheun për kallëpin në të cilin ne hidhnim çimenton për zgjerimet në fund të themelit. Nuk kishte makineri. Ne përdornim një kazmë dhe një lopatë. Ndërtimi i themeleve të qëndrueshme për ndërtesat që punë e vështirë në ato kohë.

Ajo gjithashtu kërkonte durim. Pasi hidhnim materialin për zgjerimet e themelit, ne prisnim derisa të thahej. Megjithëse dëshironim shumë që puna të vazhdonte, ne prisnim edhe pasi hidhnim materialin për themelin përpara se të hiqnim kallëpet.

Dhe madje më shumë mbresëlënëse për një ndërtues fillestar ishte ai që dukej një proces i lodhshëm dhe që të hante kohë, vendosja e shufrave metalike me kujdes brenda kallëpeve për t'i dhënë forcë themelit të përfunduar.

Në mënyrë të ngjashme, dheu duhet të përgatitet me kujdes për themelin tonë të besimit që t'u rezistojë stuhive që do t'i vijnë çdo jete. Ky bazament i fortë për themelin e besimit është integriteti moral vetjak.

Zgjedhja e së drejtës vazhdimisht, kurdoherë që ne vihemi para një zgjedhjeje, krijon dheun e fortë nën besimin tonë. Kjo mund të fillojë në fëmijëri duke qenë se çdo shpirt lind me dhuratën e Shpirtit të Krishtit të dhënë falas. Me atë Shpirt, ne mund ta dimë kur kemi bërë atë që është e drejtë përpara Perëndisë dhe kur kemi bërë padrejtësi në sytë e Tij.

Ato zgjedhje, që ndodhin me qindra herë në pjesën më të madhe të ditëve, e përgatisin dheun e fortë mbi të cilin ngrihet ndërtesa jonë e besimit. Armatura metalike rreth së cilës derdhet substanca e besimit tonë, është ungjilli i Jezu Krishtit, me të gjitha besëlidhjet, ordinancat dhe parimet e tij.

Një prej çelësave për një besim të qëndrueshëm është ta gjykosësh me saktësi kohën që duhet ta lëmë atë të forcohet. Kjo është arsyeja pse unë u tregova i pamatur duke u lutur kaq herët në jetën time për male për t'i ngjitur dhe prova më të mëdha.

Forcimi nuk vjen automatikisht me kalimin e kohës, por vërtet kërkon kohë. Kjo nuk bëhet thjesht me rritjen në moshë. Është shërbimi ndaj Perëndisë dhe të tjerëve vazhdimisht me gjithë zemër e shpirt, që e shndërron dëshminë për të vërtetën në forcë të pamposhtur shpirtërore.

Tani, dëshiroj t'i inkurajoj ata që po përjetojnë sprovë të vështira, që ndiejnë se besimi i tyre mund të jetë duke u zbehur nën stresin e vazhdueshëm të problemeve. Vetë problemi mund të jetë një mënyrë për t'u forcuar e për të fituar më në fund një besim të patundur. Moroni, biri i Mormonit në Librin e Mormonit, na tha se si mund të ndodhte ky bekim. Ai na mëson realitetin e thjeshtë e të ëmbël se të vepruarit, madje me një filiz besimi, i lejon Perëndisë që ta ndihmojë atë të rritet:

“Dhe tani, unë, Moroni, dua të flas pak në lidhje me këto gjëra; unë do t'i tregoj botës se besimi qëndron në gjërat që

shpresohen dhe nuk shihen; prandaj, mos dyshoni, sepse nuk shihni, pasi ju nuk do të merrni asnjë dëshmi, deri pas provës së besimit tuaj.

Pasi, qe në sajë të besimit që Krishti iu shfaq etërve tanë, pasi u ngrit së vdekuri; dhe ai nuk iu shfaq atyre, deri pasi ata patën besim në të, prandaj qe e nevojshme që disa të kishin besim në të, pasi ai nuk iu shfaq botës.

Por për shkak të besimit të njerëzve, ai iu shfaq botës dhe lartësoi emrin e Atit dhe përgatiti një udhë që edhe të tjerët të mund të ishin pjesëtarë të dhuratës hyjnore, që ata të mund të shpresonin në ato gjëra që nuk i kishin parë.

Prandaj, ju gjithashtu mund të keni shpresë dhe të jeni pjesëtarë të dhuratës, në qoftë se do të keni vetëm besim.”⁷

Pjesëza më e çmuar e besimit dhe të cilën ju duhet ta mbronni dhe ta përdorni në cilëndo mënyrë që mundeni, është besimi në Zotin Jezu Krisht. Moroni dha mësim për fuqinë e atij besimi në këtë mënyrë: “Dhe asnjëherë në ndonjë kohë ndonjë njeri nuk ka bërë mrekulli vetëm pas besimit të tij; prandaj ata në fillim besuan në Birin e Perëndisë”⁸.

Kam vizituar një grua që pati një mrekulli forcimi të mjaftueshëm për të duruar humbje të papërfytyrueshme me vetëm aftësinë e thjeshtë për të përsëritur pafundësisht fjalët: “E di se rron Shëlbuesi im”⁹. Ai besim dhe ato fjalë dëshmie qenë ende atje ndërsa kujtimet e fëmijërisë së saj u zbehën, por nuk u zhdukën kurrë plotësisht.

Mbeta i shtangur kur mësova se një grua tjetër e kishte falur dikë që i kishte bërë asaj padrejtësi prej vitesh. U habita dhe e pyeta pse kishte zgjedhur të falte e t’i harronte kaq shumë vite të një abuzimi të pamëshirshëm.

Ajo tha qetësisht: “Qe gjëja më e vështirë që kam bërë ndonjëherë, por thjesht e dija se duhet ta bëja. Kështu që e bëra.” Besimi i saj se Shpëtimtari do ta falte nëse ajo i falte të tjerët, e përgatiti atë me një ndjenjë paqeje dhe shprese ndërsa u përball me vdekjen pak muaj pasi e kishte falur kundërshtarin e saj të papënduar.

Ajo më pyeti: “Si do të jetë në qiell, kur unë të shkoj atje?”

Dhe i thashë: “E di, thjesht nga ajo që kam parë nga aftësia jote për të ushtruar besim dhe për të falur, që do të jetë një kthim i mrekullueshëm në shtëpi për ty”.

Kam një inkurajim tjetër për ata që tani pyesin veten nëse besimi i tyre në Jezu Krisht do të jetë i mjaftueshëm që ata të durojnë plotësisht deri në fund. Unë kam qenë i bekuar që disa prej jush që po dëgjoni tani, ju kam njohur kur ishit më të rinj, energjikë dhe më të talentuar se shumica e atyre që ju rrethonin, e prapëseprapë ju zgjodhët të bënit atë që do të kishte bërë Shpëtimtari. Në bollëkun e bekimeve tuaja ju gjetët mënyra për t’i ndihmuar e për t’u kujdesur për ata që mund t’i kishit shpërfillur apo përbuzur nga pozicioni juaj në jetë.

Kur vijnë sprovat të vështira, besimi për t’i duruar ato siç duhet do të jetë atje, i ndërtuar pa u vënë re prej jush, në kohët kur vepruat sipas dashurisë së pastër të Krishtit, duke u shërbyer të tjerëve e duke falur siç do të kishte bërë Shpëtimtari. Ju ndërtuat një themel besimi duke dashur siç deshte Shpëtimtari dhe duke i shërbyer Atij. Besimi juaj tek Ai ju çoi në vepra të dashurisë hyjnore që sërish do t’ju sjellin shpresë.

Nuk është kurrë vonë për të focuar një themel besimi. Ka gjithmonë kohë. Me besim te Shpëtimtari, ju mund të pendoheni dhe të luteni për të marrë falje. Gjendet dikush që ju mund ta falni. Gjendet dikush që ju mund ta falënderoni. Gjendet dikush që ju mund t’i shërbeni e ta ngrini moralisht. Ju mund ta bëni atë kudo që të jeni dhe sado të vetmuar dhe të shkretë që të mund të ndiheni.

Nuk mund t’ju premtoj një mbarim të sprovave tuaja në këtë jetë. Nuk mund t’ju siguroj se sprovat tuaja do t’ju duken se zgjasin vetëm për pak. Një nga tiparet e sprovave në jetë, është se ato e bëjnë kohën të duket se ecën ngadalë dhe më tutje pothuajse të ndalet.

Ka arsye pse ndodh kjo. Njohja e atyre arsyeve mund të mos japë shumë ngushëllim, por mund t’ju japë një ndjesi durimi. Ato arsye vijin nga ky fakt i vetëm: në dashurinë e Tyre të përsosur për ju, Ati Qiellor dhe Shpëtimtari dëshirojnë që ju të bëheni të përshtatshëm për të jetuar me Ta në familje të përrjetshme. Vetëm ata që janë pastruar përsosmërisht nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, mund të jenë atje.

Nëna ime luftoi me kancerin për afro 10 vjet. Trajtimet dhe ndërhyrjet kirurgjikale dhe së fundi të qenit e detyruar të rrinte në shtrat, qenë disa nga sprovat e saj.

Më kujtohet babai im që tha, ndërsa e pa atë të merrte frymën e saj të fundit: “Një vogëlushe shkoi të çlodhet në shtëpi”.

Një nga folësit në varrimin e saj qe Presidenti Spenser W. Kimball. Midis nderimeve që ai bëri, më kujtohet njëri që qe diçka e tillë si kjo: “Disa prej jush mund të kenë menduar se Mildredi vuajti kaq gjatë dhe kaq shumë për shkak të diçkaje që kishte bërë gabim për të cilën duheshin sprovat”. Më pas, tha: “Jo, Perëndia thjesht dëshironte që ajo të lëmohej pak më shumë”. Më kujtohet që në atë kohë po mendoja: “Nëse një grua aq e mirë kishte nevojë për aq shumë lëmim, po mua çfarë më pret?”

Nëse kemi besim te Jezu Krishti, kohët më të vështira ashtu si edhe kohët më të lehta në jetë, mund të jenë një bekim. Në të gjitha rrethanat, mund të zgjedhim të drejtën me drejtimin e Shpirtit. Ne kemi ungjillin e Jezu Krishtit për t’i dhënë formë e për ta drejtuar jetën tonë, nëse e zgjedhim atë. Dhe me profetët që na zbulojnë vendin tonë në planin e shpëtimit, ne mund të jetojmë me shpresë të përsosur dhe një ndjenjë paqeje. Kurrë nuk na duhet të ndiejmë se jemi vetëm apo që nuk na duan, në shërbimin e Zotit, sepse nuk jemi kurrë. Ne mund ta ndiejmë dashurinë e Perëndisë. Shpëtimtari na ka premtuar engjëj në të majtën e në të djathtë tonë, për të na ngritur lart.¹⁰ Ai e mban gjithmonë fjalën e Tij.

Unë dëshmoj se Perëndia, Ati, jeton dhe se Biri i Tij i Dashur është Shëlbuesi ynë. Fryma e Shenjtë e ka pohuar të vërtetën që është dhënë mësim në këtë konferencë dhe do ta bëjë sërish ndërsa e kërkoni atë kur i dëgjoni dhe më pas i studioni mesazhet e shërbëtorëve të autorizuar të Zotit që janë këtu. Presidenti Tomas S. Monson është profeti i Zotit për të gjithë botën sot. Zoti kujdeset për ju. Perëndia, Ati, jeton. Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti, është Shëlbuesi ynë. Dashuria e Tij është e pandryshueshme. Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Spencer W. Kimball, "Give Me This Mountain", *Ensign*, nëntor 1979, f. 79.
2. Doktrina e Besëlidhje 122:7-9.
3. Doktrina e Besëlidhje 19:15-19.
4. Jeremia 8:22.
5. Jozueu 1:5.
6. Shih Thomas S. Monson, "Look to God and Live", *Ensign*, maj 1998, f. 52-54.
7. Ethëri 12:6-9.
8. Ethëri 12:18.
9. "E di se Rron Shëlbuesi im", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 38.
10. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:88.

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Paraqitur nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Propozohet që ne të mbështesim Tomas Spenser Monson, si profet, shikues dhe zbulues, si dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorf, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë.

Propozohet që ne të mbështesim Bojd Kenet Paker, si President të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ata që vijojnë si anëtarë të atij kuorumi: Bojd K. Paker, L. Tom Peri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson dhe Nil L. Andersen.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë në të njëjtën mënyrë.

Propozohet që ne të mbështesim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Dymbëdhjetë Apostujt si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Plaku Stiven E. Snou është liruar nga thirrja si anëtar i Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që mund të bashkohen me ne në një votim vlerësimi, lutemi ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Plakun Riçard J. Meinis si anëtar të Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që të lirojmë nga thirrja me një votim falënderimi Pleqtë Zherald Zhan Kosé dhe Geri E. Stivenson, si anëtarë të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Pas shumë viteve të shërbimit besnik dhe të efektshëm, propozohet që të lirojmë nga thirrjet Peshkopët H. Dejvid Barton, Riçard C. Exhli dhe Keith B. Mek-Mullin si Peshkopata Kryesuese dhe t'i caktojme ata si Autoritete të Përgjithshme Nderi.

Ata që mund të bashkohen me ne në një votim vlerësimi, lutemi ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të lirojmë sa vijojnë si të Shtatëdhjetë Zonalë, duke filluar nga data 1 maj 2012:

Riçard K. Ahaxhi, Klimato C. A. Almeida, Fernando J. D. Araújo, Marvin T. Brinkerhof, Mario L. Karlos, Rafael E. Castro, Dejvid L. Kuk, Sésar A. Dávila, Mosia S. Delgado, Luis G. Duarte, Huan A. Eçegarai, Stefën L. Flukiger, J. Roxher Fluman, Robert C. Gei, Migel Hidalgo, Garit C. Hill, Dejvid J. Hoare, Dejvid H. Ingram, Tecuxhi Ishii, Kapumba T. Kola, Glendon Lions, R. Brus Merrell, Enrike J. Montoja, Daniel A. Moreno, Adezina J. Olukani, Gamaliel Osorno, Patrik H. Prajs, Markos A. Prieto, Paulo R. Puerta, Karlos F. Rivas, A. Rikardo Sant'Ana, Fabian L. Sinamban, Natá C. Tobias, Stenli Van, Peri M. Ueb, Riçard W. Uiler dhe Skot D. Uaiting.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohjen tonë për shërbimin e tyre të shkëlqyer, lutemi ta tregojnë.

Propozohet që të lirojmë nga thirrjet me një votim vlerësimi të sinqertë, Motrat Xhuli B. Bek, Silvia H. Ollred dhe Barbara Tompson si Presidenca e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës.

Gjithashtu ju drejtojmë lirim të lirimin nga thirrjet anëtareve të bordit të përgjithshëm të Shoqatës së Ndihmës.

Të gjithë ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin këtyre motrave për shërbimin dhe përkushtimin e tyre të shquar, lutemi ta tregoni.

Propozohet që të mbështesim si anëtarë të rinj të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve Krejg A. Kardon, Stenli G. Elis, Leri Eko Houk, Robert C. Gei dhe Skot D. Uaiting.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata kundër, me të njëjtën shenjë.

Propozohet që të mbështesim Geri E. Stivenson si Peshkopin Kryesues të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, me Zherald Zhan Kosé si Këshilltar të Parë dhe Din Majron Dejvis si Këshilltar të Dytë.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër.

Propozohet që të mbështesim personat që vijojnë si të Shtatëdhjetë Zonalë të rinj:

Pedro U. Aduru, Detlef H. Adler, Anhel H. Alarkon, Alei K. Auna i Riu, W. Mark Baset, Robert M. Koll, Hernando Kamargo, Xhin R. Çidester, Hoakin E. Kosta, Ralf L. Djusnap, Ángel A. Duarte, Eduard Dube, Moroni Gaona, Teilor G. Godoi, Francisko D. N. Granxha, Juri A. Gushçin, Riçard K. Hansen, Tod B. Hansen, Kliford T. Herbertson, Aniefiok Udo Inion, Luiz M. Liël, Alehandro Lopez, L. Zhan Klod Mabaja, Alvin F. Meredith III, Adonai S. Obando, Jared R. Ocampo, Adejinka A. Oxhediran, Endrju M. O'Riordan, Hesus A. Ortiz, Fred A. Parker, Su Hong Pon, Abraham E. Kuero, Robert Kler Rien, Horge Luis Romeu, Jorge Saldívar, Gordon H. Smith, Alin Spanaus, Moroni B. Torgan, Stiven L. Toronto dhe Daniel Jirenia-Taviah.

Të gjithë që janë dakord, ju lutemi tregojeni.

Ndonjë kundër.

Propozohet që të mbështesim Linda Kjer Barton si presidente të përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, me Karol Manzel Stivens si këshilltare të parë dhe Linda Shefield Rivs si këshilltare të dytë.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër, mund ta tregojë po ashtu.

Propozohet që ne të mbështesim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetë Zonalë dhe presidencat e përgjithshme të organizatave ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë.

Presidenti Monson, për aq sa kam mundur të vërej, votimi në Qendrën e Konferencave ka qenë unanim në favor të propozimeve të bëra.

Faleminderit, vëllezër dhe motra, për votimin tuaj mbështetës dhe për besimin, përkushtimin dhe lutjet tuaja të vazhdueshme.

I ftojme Autoritetet e Përgjithshme dhe presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës të sapothirrura që të vijnë e të zenë vendet e tyre në panel.

Raporti i Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2011

Paraqitur nga Robert W. Kentuell

Drejtor Administrimi, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës

*Drejtuar Presidencës së Parë të Kishës së Jezu Krishtit
të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*

Të dashur Vëllezër: Siç përshkruhet me anë të zbulësës në seksionin 120 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Këshilli mbi Planifikimin e të Dhjetave autorizon shpenzimin e fondeve të Kishës. Ky këshill përbëhet nga Presidenca e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese.

Ky këshill miraton buxhetet për departamentet e veprimtaritë e Kishës dhe shpërndarjet përkatëse për njësitë kishtare. Subjektet e Kishës i shpenzojnë fondet në përputhje me buxhetet e miratuara dhe në harmoni me politikat e procedurat e Kishës.

Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës i është dhënë e drejta e disponimit të të gjitha dokumenteve dhe sistemeve të nevojshme për të vlerësuar se sa i përshtatshëm është kontrolli ynë mbi fondet e marra, shpenzimet, si dhe mbrojtjen e pasurive të Kishës. Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës është i pavarur nga të gjitha departamentet dhe veprimtaritë e tjera të Kishës dhe stafi përbëhet nga llogaritarë publikë të licensuar, revizorë të brendshëm të licensuar, revizorë të licensuar të sistemeve të informacionit dhe nga profesionistë të tjerë të licensuar.

Bazuar mbi kontrollet financiare të kryera, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës është i mendimit se, të gjitha vlerat materiale, kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe pasuritë e

Kishës për vitin 2011, janë regjistruar dhe administruar në harmoni me praktika të përshtatshme llogaritëse, buxhete të aprovuara dhe politika e procedura të Kishës.

I paraqitur me respekt nga
Departamenti i Kontrollit të Kishës
Robert W. Kentuell
Drejtor Administrimi

Raporti Statistikor, 2011

Paraqitur nga Bruk P. Hejls,
Sekretar i Presidencës së Parë

Për informimin e anëtarëve të Kishës, Presidenca e Parë ka nxjerrë raportin statistikor që vijon, mbi rritjen dhe gjendjen e Kishës deri më 31 dhjetor 2011.

Njësi të Kishës

Kunje	2.946
Misione	340
Distrikte	608
Lagje dhe Degë	28.784

Anëtarësia e Kishës

Anëtarësia e Përgjithshme	14.441.346
Fëmijë të Rinj të Regjistruar gjatë vitit 2011	119.917
Të Kthyer në Besim të Pagëzuar gjatë vitit 2011	281.312

Misionarë

Misionarë Kohëplotë	55.410
Misionarë në Shërbim të Kishës	22.299

Tempujt

Tempujt të Përkushtuar gjatë vitit 2011 (San-Salvador në El-Salvador dhe Kuecalténango në Guatemalë)	2
Tempujt të Ripërkushtuar gjatë vitit 2011 (Atlanta në Xhorxhia)	1

Ish-Drejtues të Përgjithshëm dhe Anëtarë të Tjerë të Kishës që Kanë Ndërruar Jetë që nga Konferenca e Përgjithshme e Prillit të Shkuar

Pleqtë Marion D. Hanks, Xhek H Goaslind i Riu, Monte J. Brug, Ronald E. Polman, Keith W. Uilkoks dhe Harold G. Hillam, të gjithë ish-anëtarë të Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve; Motrat Xhoi F. Evans dhe Çieko N. Okazaki, ish-këshilltare në presidenca të përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës; Motra Norma Voloj Sontag, bashkëshorte e Plakut Filip T. Sontag, një ish-anëtar i Të Shtatëdhjetëve; Motra Leola Xhorxh, e veja e Plakut Lloid P. Xhorxh, një ish-anëtar i Të Shtatëdhjetëve; Motra Argelia Vilanueva de Alvarez, bashkëshortja e Plakut Lino Alvarez, gjithashtu një ish-anëtar i Të Shtatëdhjetëve; dhe Vëllai Uendell M. Smut i Riu, ish-president i Korit të Tabernakullit.

Punëtorët në Vresht

Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ju lutem, dëgjoni nxitjet e Shpirtit të Shenjtë duke ju thënë pikërisht tani, në këtë çast, se ju duhet ta pranoni dhuratën shlyese të Zotit Jezu Krisht.

Duke marrë parasysh thirrjet dhe lirimet që Presidenca e Parë sapo njoftoi, më lejoni të flas për të gjithë ne, duke thënë se do t'i kujtojmë dhe duam gjithmonë ata që kanë shërbyer kaq besnikërisht, ashtu siç menjëherë i duam dhe i mirëpresim ata që tani janë thirrur për të shërbyer në pozicione të ndryshme. Falënderimet tona të përzemërta për të gjithë ju.

Dëshiroj të flas për shëmbëlltyrën e Shpëtimtarit në të cilën zoti i shtëpisë “doli herët në mëngjes për të pajtuar me mëditje punëtorë”. Pasi punësoi grupin e parë në orën 06:00 të mëngjesit, ai u kthye në orën 09:00 të mëngjesit, në orën 12:00 të drekës dhe në 15:00 të pasdites duke punësuar më shumë punëtorë, ndërkohë që rritej urgjenca e korrjes. Shkrimi i shenjtë thotë se ai u kthye për herë të fundit “rreth orës së njëmbëdhjetë” (afërsisht në orën 17:00) dhe punësoi grupin e fundit të njerëzve. Më pas, vetëm një orë më vonë, të gjithë punëtorët u mbloodhën për të marrë pagën e ditës. Çuditërisht, të gjithë punëtorët morën të njëjtën pagë, pavarësisht orëve të ndryshme të punës. Menjëherë, ata që u punësuan në fillim u zemëruan, duke thënë: “Këta të fundit punuan vetëm një orë, dhe ti i trajtove si ne që hoqëm barrën dhe vapën e ditës”¹. Kur e keni lexuar këtë shëmbëlltyrë, ndoshta ju, si edhe ata punëtorë, keni menduar se këtu po bëhej një padrejtësi. Më lejoni të flas shkurtimisht rreth këtij shqetësimi.

Së pari, është e rëndësishme të përmend se *askush* nuk është trajtuar padrejtësisht këtu. Punëtorët e parë ranë dakord për pagën e plotë të ditës dhe e morën atë. Veç kësaj, ata ishin, thjesht

mund ta imagjinoj, shumë mirënjohës që gjetën punë. Në kohën e Shpëtimtarit, një burrë në nivel mesatar dhe familja e tij nuk mund të bënin më shumë sesa të jetonin me ato që kishin fituar atë ditë. Nëse nuk do të punoje ose kultivoje, ose peshkoje apo shisje, ka gjasa të mos ushqeheshe. Me më shumë punëtorë të disponueshëm sesa punë, këta burra të parë të zgjedhur ishin më fatlumët në të gjithë grupin e punëtorëve të disponueshëm atë mëngjes.

Në të vërtetë, nëse do të ndiejmë ndonjë keqardhje, të paktën ajo duhet të jetë fillimisht për burrat e *pazgjedhur* të cilët gjithashtu kishin familje për të cilat duhej të kujdeseshin. Fati dukej sikur nuk ishte kurrë me disa prej tyre. Nga secila vizitë e kujdestarit gjatë gjithë ditës, ata gjithmonë panë dikë tjetër të zgjedhur.

Por pikërisht në fund të ditës, zoti i shtëpisë kthehet papritur të pestën herë me një ofertë të mrekullueshme të orës së njëmbëdhjetë! Këta punëtorë të fundit dhe më shumë të shkurajuarit, thjesht duke dëgjuar se do të trajtoheshin me drejtësi, e pranuan punën madje pa e ditur pagën, duke e ditur se *dicka* do të ishte më mirë se asgjë, që ishte ajo që ata kishin pasur deri tani. Më pas, ndërsa u mblodhën për pagesën e tyre, u habitën që morën të njëjtën shumë si gjithë të tjerët! Sa të befatur mund të kenë qenë dhe sa shumë, shumë mirënjohës! Me siguri kurrë nuk është parë një dhembshuri e tillë në të gjitha ditët e tyre të punës.

Mendoj se me këtë kuptueshmëri të historisë duhet shikuar mërmëritja e punëtorëve të parë. Ndërsa zoti i shtëpisë në shëmbëlltyrë u thotë atyre (dhe po parafrazoj vetëm pak): “Miqtë e mi, unë nuk jam i padrejtë me ju. Ju ratë dakord me pagën për një ditë, një pagë e mirë. Ju ishit shumë të lumtur që e gjetët punën dhe unë jam shumë i lumtur me mënyrën se si shërbyet. Jeni paguar plotësisht. Merrreni pagën tuaj dhe shijojeni bekimin. Sa për të tjerët, *sigurisht që jam i lirë të bëj atë që dua me paratë e mia.*” Pastaj kjo pyetje e mprehtë për cilindo, atëherë dhe tani, që ka nevojë ta dëgjojë: “*Përse duhet të jeni xhelozë për shkak se unë zgjedh të jem i mirë?*”

Vëllezër dhe motra, do të ketë kohë në jetën tonë kur dikush tjetër merr një bekim të papritur ose merr ndonjë vlerësim të

veçantë. A mund të lutem bashkë me ju që të mos pezmatohemi – dhe sigurisht të mos ndihemi ziliqarë – kur bekime të mira i vijnë një personi tjetër? Ne nuk do të na zvogëlohet kur dikujt tjetri i shtohet. Ne nuk jemi në një garë kundër njëri-tjetrit, që të shohim se cili është më i pasuri, ose më i talentuari, ose më i bukuri apo madje më i bekuari. Gara në të cilën jemi *me të vërtetë* është ajo kundër mëkatit dhe sigurisht zilia është një nga mëkatet më universale.

Veç kësaj, zilia është një gabim që thjesht vazhdon. Siç duket, ne vuajmë pak kur ndonjë *fatkeqësi* na ndodh *ne*, por zilia kërkon që të vuajmë për shkak të gjithë *fatit të mirë* që i bie *kujtdo* që njohim! Kjo nuk na jep shpresa të mira për të ardhmen – të mos lumturohesh çdo herë që dikush rreth teje është i lumtur! Do të jetë akoma dhe më e sikletshme, kur të zbulojmë se Perëndia vërtet është edhe i drejtë edhe i mëshirshëm, që u jep të gjithëve që qëndrojnë me Të “gjithë pasurinë e vet”², siç thotë shkrimi i shenjtë. Kështu që, mësimi numër një nga vreshti i Zotit: lakmimi, varja e buzëve apo të kërkosh t’i bësh të tjerët më pak të lumtur *nuk* rrit pozitën *tënde* dhe as të poshtërosh dikë nuk e përmirëson imazhin tënd. Kështu që, jini të mirë dhe jini mirënjohës që Perëndia është i mirë. Është një mënyrë e gëzuar për të jetuar.

Një pikë tjetër që dua të marr nga kjo shëmbëlltysë është gabimi i dhimbshëm që disa mund të bëjnë nëse hiqnin dorë nga paga e tyre në *fund* të ditës, sepse ishin të shqetësuar me gjëra që mendonin se ishin probleme *më herët* gjatë ditës. Në shkrimin e shenjtë nuk thuhet se ndonjëri ia hodhi monedhën në fytyrë të zotit të shtëpisë dhe u largua i zemëruar pa asnjë qindarkë, por supozoj se dikush mund ta ketë bërë.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, ajo që ndodhi në këtë histori në orën 09:00 ose në mesditë, apo në orën 15:00 nuk ka rëndësi në krahasim me pagesën e mrekullueshme dhe bujare për të gjithë në fund të ditës. Formula e besimit është të vazhdojmë, të punojmë, ta bëjmë deri në fund dhe ta lëmë shqetësimin e orëve të para – të vërtetë ose të supozuar – që të largohet për begatinë e çmimit përfundimtar. Mos u ndalni në çështje ose fyerje të vjetra – as kundër vetes as kundër fqinjit, as kundër, mund të shtoj, kësaj Kishe të vërtetë dhe të gjallë. Madhështia e jetës suaj, e jetës së fqinjit tuaj dhe e ungjillit të Jezu Krishtit do

t'u bëhet e ditur në ditën e fundit, edhe nëse kjo madhështi nuk njihet gjithmonë nga secili në fillim. Kështu që mos u shqetësoni për diçka që ndodhi në 09:00 të mëngjesit kur hiri i Perëndisë po përpiqet t'ju shpërblejë në orën 18:00 – çfarëdo qofshin oraret e punës gjatë ditës.

Ne konsumojmë energji të tilla të çmuara emocionale dhe shpirtërore, duke u kapur fort pas kujtimit të një note muzikore të stonuar që luajtëm në recitalin e pianos së fëmijërisë apo të diçkaje që bashkëshorti/ja tha ose bëri 20 vite më parë që jemi të vendosur t'ia kujtojmë edhe për 20 vite të tjera, ose të një incidenti në historinë e Kishës që provoi, as më shumë e as më pak, se të vdekshmit gjithmonë do të luftojnë për të qenë po aq të mirë sa pritshmëritë e Perëndisë për ta. Edhe nëse një nga ato ankesa nuk nisi me ju, mund të përfundojë me ju. Dhe çfarë shpërblimi do të kishte për atë kontribut kur Zoti i vreshtit të sheh në sy dhe llogaritë janë rregulluar në fund të ditës sonë tokësore.

Kjo më drejton në pikën time të tretë dhe të fundit. Kjo shëmbëlltyrë – si të gjitha shëmbëlltyrat e tjera – nuk ka të bëjë aq shumë me punëtorët ose pagën po aq sa ç'kanë të bëjnë shëmbëlltyrat e tjera me delet dhe dhitë. Kjo është një histori për mirësinë e Perëndisë, durimin dhe faljen e Tij dhe Shlyerjen e Zotit Jezu Krisht. Është një histori për bujarinë dhe dhembshurinë. Është një histori për hirin. Ajo nënvizon mendimin që dëgjova shumë vite më parë, se sigurisht gjëja që Perëndinë e gëzon më shumë rreth të qenit Perëndi, është emocioni i të qenit i mëshirshëm, veçanërisht për ata që nuk e presin ose shpesh ndihen sikur nuk e meritojnë.

Nuk e di se cili në këtë audiencë të gjerë sot mund të ketë nevojë të dëgjojë mesazhin për faljen që është pjesë e pandarë e kësaj shëmbëlltyrë, por sado vonë që të mendoni se jeni, pavarësisht shumë shanseve që mendoni se keni humbur, pavarësisht gabimeve të shumta që ndieni se keni bërë apo talenteve që mendoni se nuk i keni, ose distancës nga shtëpia dhe familja, dhe Perëndia që mendoni se jeni larguar, ju dëshmoj se *nuk* keni shkuar përtej shtrirjes së dashurisë hyjnore. Nuk është e mundur që ju të zhyteni më poshtë se drita e pafundme e Shlyerjes së Krishtit që shkëlqen.

Nëse nuk jeni ende të besimit tonë ose ishit me ne një herë dhe nuk jeni më, nuk ka asgjë në asnjërin rast që keni bërë që nuk mund të korrigjohet. Nuk ka asnjë problem që nuk mund ta kapërceni. Nuk ka ëndërr që në shpalosjen e kohës dhe përjetësisë nuk mund të plotësohet ende. Edhe nëse ndiheni se jeni punëtori i humbur dhe i fundit i orës së njëmbëdhjetë, Zoti i vreshtit qëndron duke na e bërë me shenjë. “Le t’i afrohemi me guxim fronit të hirit”³ dhe të biem mbi gjunjët e të Shenjtit të Izraelit. Ejani dhe gostituni “pa para dhe pa paguar”⁴ në tavolinën e Zotit.

Unë veçanërisht bëj një apel për bashkëshortët dhe baballarët, mbajtësit e priftërisë ose mbajtësit e ardhshëm të priftërisë, siç tha Lehi: “Zgjhuni! Ngrihuni nga pluhuri . . . dhe bëhuni burra”⁵. Jo gjithmonë, por shpesh janë burrat që zgjedhin të mos i përgjigjen thirrjes për “t’iu bashkuar radhëve”⁶. Gratë dhe fëmijët shpesh duken më të gatshëm. Vëllezër është koha të veproni. Bëjeni për veten tuaj. Bëjeni për hir të atyre që ju duan dhe po lutem që të përgjigjeni. Bëjeni për hir të Zotit Jezu Krisht, që pagoi një çmim të pamatshëm për të ardhmen që Ai dëshiron që të keni.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, për ata prej jush që janë bekuar nga ungjilli për shumë vite sepse ju ishit me mjaft fat për ta gjetur atë qysh herët, për ata prej jush që i janë afruar ungjillit pak nga pak më vonë dhe atyre prej jush – anëtarë ose ende jo – që ende mund të ngurrojnë [të bashkohen], secilit prej jush, cilitdo dhe të gjithëve, unë dëshmoj për fuqinë përtëritëse të dashurisë së Perëndisë dhe mrekullisë së hirit të Tij. *Shqetësimi i Tij është për besimin që ju do të arrini përfundimisht, jo për orën e ditës në të cilën ju do të shkoni atje.*

Ndaj, nëse keni bërë besëlidhje, mbajini ato. Nëse nuk i keni bërë, bëjini ato. Nëse i keni bërë dhe i keni thyer ato, pendohuni dhe korrigjohuni. Nuk është *kurrë* tepër vonë për aq kohë sa Pronari i vreshtit thotë se ka kohë. Ju lutem, dëgjoni nxitjet e Shpirtit të Shenjtë duke ju thënë pikërisht tani, në këtë çast, se ju duhet ta pranoni dhuratën shlyese të Zotit Jezu Krisht dhe ta shijoni shoqërinë e punës së Tij. Mos u vononi. Po bëhet vonë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Shih Mateu 20:1–15.

2. Lluka 12:44.

3. Hebrenjve 4:16.
4. Isaia 55:1.
5. 2 Nefi 1:14, 21.

6. "We Are All Enlisted", *Hymns*, nr. 250.

Të Vijnë në Vete: Sakramenti, Tempulli dhe Sakrifica e Shërbimit

Nga Plaku Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ne kthehemi në besim dhe bëhemi shpirtërisht të mbështetur te vetja kur i jetojmë me lutje besëlidhjet tona.

Shpëtimtari u tregoi dishepujve të Tij për një djalë që e la të atin e tij të pasur, shkoi në një vend të largët dhe e shpenzoi më kot trashëgiminë e tij. Kur ra një zi buke, i riu pranoi punën e përrulur të të ushqyerit të derrave. Ai qe kaq i uritur, sa që dëshironte të hante lendet që ishin për derrat.

Larg nga shtëpia, larg nga vendi ku dëshironte të ishte dhe në gjendjen e tij të mjeruar, ndodhi diçka me rëndësi të përjetshme në jetën e këtij të riu. Në fjalët e Shpëtimtarit "[ai] erdhi në vete"¹. Ai kujtoi kush ishte, e kuptoi se çfarë kishte humbur dhe filloi të dëshironte bekimet që mund t'i merrte bujarisht në shtëpinë e atit të tij.

Gjatë jetës sonë, qoftë nëse jemi në kohë errësire, sfide, hidhërimi apo mëkati, ne mund të ndiejmë Frymën e Shenjtë që na kujton se jemi me të vërtetë bijtë e bijat e një Ati të Dashur Qiellor, i cili na do dhe ne i dëshirojmë fort bekimet e shenjta që vetëm Ai mund të na i japë. Në kohë të tilla, ne duhet të mundohemi të *vijnë në vete* dhe të kthehemi në dritën e dashurisë së Shpëtimtarit tonë.

Këto bekime u takojnë me të drejtë të gjithë fëmijëve të Atit Qiellor. Dëshirimi i këtyre bekimeve, duke përfshirë një jetë me gëzim e lumturi, është një pjesë thelbësore e planit të Atit Qiellor

për secilin prej nesh. Profeti Alma dha mësim: “Edhe në qoftë se ju nuk mund të bëni më shumë sesa të dëshironi të besoni, lëreni këtë dëshirë të veprojë në ju”².

Ndërsa dëshirat tona shpirtërore shtohen, ne bëhemi shpirtërisht të mbështetur te vetja. Atëherë, si e ndihmojmë veten dhe familjet tona që ta shtojmë dëshirën tonë për të ndjekur Shpëtimtarin dhe për të jetuar ungjillin e Tij? Si e forcojmë dëshirën tonë për t’u penduar, për t’u bërë të denjë dhe për të duruar deri në fund? Si i ndihmojmë të rinjtë dhe të rriturit tanë në moshë madhore që t’i lejojnë këto dëshira të veprojnë në ta derisa të kthehen në besim dhe të bëhen “shenjtor[ë] [të vërtetë] nëpërmjet shlyerjes së Krishtit”³

Ne kthehemi në besim dhe bëhemi shpirtërisht të mbështetur te vetja kur i jetojmë me lutje besëlidhjet tona – nëpërmjet marrjes së sakramentit denjesisht, të qenit të denjë për një rekomandim tempulli dhe duke sakrifikuar për t’u shërbyer të tjerëve.

Me qëllim që ta marrim sakramentin denjesisht, ne kujtojmë se po rinovojmë besëlidhjen që bëmë në pagëzim. Në mënyrë që sakramenti të jetë një përvojë për pastrimin shpirtëror çdo javë, duhet ta përgatisim veten *përpara* se të vijmë në mbledhjen e sakramentit. Ne e bëjmë këtë duke i lënë qëllimisht prapa punën e përditshme e kohën e lirë dhe duke i hequr nga mendja mendimet e shqetësimet e botës. Ndërsa e bëjmë këtë, ne bëjmë vend për Frymën e Shenjtë në mendjen dhe zemrën tonë.

Pastaj jemi të përgatitur për të medituar mbi Shlyerjen. Më shumë se sa thjesht të menduarit rreth fakteve të vuajtjes dhe vdekjes së Shpëtimtarit, meditimi ynë na ndihmon që ta kuptojmë se nëpërmjet sakrificës së Shpëtimtarit, ne kemi shpresën, mundësinë dhe forcën për të bërë ndryshime të vërteta e të singërta në jetën tonë.

Ndërsa këndojmë himnin e sakramentit, marrim pjesë në lutjet e sakramentit dhe marrim emblemat e mishit dhe gjakut të Tij, kërkojmë falje në lutje për mëkatet e të metat tona. Ne mendojmë rreth premtimeve që bëmë dhe mbajtëm gjatë javës së kaluar, dhe bëjmë zotime vetjake të posaçme për ta ndjekur Shpëtimtarin gjatë javës vijuese.

Prindër dhe udhëheqës, ju mund t’i ndihmoni të rinjtë të përjetojnë bekimet e pakrahasueshme të sakramentit duke u

siguruar atyre mundësi të veçanta për të mësuar, diskutuar e zbuluar rëndësinë e Shlyerjes në jetën e tyre. Le t'i hetojnë shkrimet vetë dhe t'i japin mësim njëri-tjetrit nga përvojat e tyre vetjake.

Baballarët, udhëheqësit e priftërisë dhe presidentat e kuorumeve kanë një përgjegjësi të veçantë për t'i ndihmuar mbajtësit e Priftërisë Aarone që të përgatiten me zell për të kryer detyrat e tyre të shenjta të sakramentit. Kjo përgatitje bëhet duke i jetuar standardet e ungjillit gjatë javës. Kur të rinjtë e përgatisin, e bekojnë dhe e shpërndajnë sakramentin me denjësi dhe nderim, ata e ndjekin vërtet shembullin e Shpëtimtarit të Darka e Fundit⁴ dhe bëhen si Ai.

Unë dëshmoj se sakramenti na jep një mundësi për të *ardhur në vete* dhe për të përjetuar një “ndryshim [të] madh” të zemrës⁵ – për të kujtuar cilët jemi dhe atë që dëshirojmë më shumë. Kur e rinovojmë besëlidhjen për t'i mbajtur urdhërimet, fitojmë shoqërimin e Frymës së Shenjtë që të na drejtojë për t'u kthyer në praninë e Atit tonë Qiellor. Nuk është çudi që urdhërohemi që të “mblidhe[mi] shpesh së bashku [që] të [marrim] bukë dhe [ujë]”⁶ dhe që të marrim sakramentin e shpirtave tanë.⁷

Përveç sakramentit, dëshira jonë për t'u kthyer tek Ati Qiellor shtohet ndërsa bëhemi të denjë për të marrë një rekomandim tempulli. Ne bëhemi të denjë duke iu bindur me qëndrueshmëri urdhërimeve. Kjo bindje fillon në fëmijëri dhe rritet gjatë përvojave në Priftërinë Aarone dhe te Të Rejat gjatë viteve të përgatitjes. Pastaj, shpresojmë, priftërinjtë dhe Dafinat vendosin synime dhe e përgatisin veten posaçërisht për të marrë indaumentin dhe për t'u vulosur në tempull.

Cilat janë standardet për mbajtësit e rekomandimeve?

Psalmist i na kujton:

“Kush do t'i ngjitet malit të Zotit?” ose “Kush do të qëndrojë në vendin e tij të shenjtë?”

Njeriu i pafajshëm nga duart dhe i pastër nga zemra.”⁸

Denjësia për të mbajtur një rekomandim tempulli na jep forcë për t'i mbajtur besëlidhjet tona të tempullit. Si e fitojmë atë forcë për veten tonë? Ne mundohemi të fitojmë një dëshmi për Atin Qiellor, Jezu Krishtin, Frymën e Shenjtë, realitetin e Shlyerjes dhe vërtetësinë e Profetit Jozef Smith dhe të Rivendosjes. Ne i

mbështesim udhëheqësit tanë, i trajtojmë familjet tona me mirësi, qëndrojmë si dëshmitarë të Kishës së vërtetë të Zotit, marrim pjesë në mbledhjet e Kishës, i nderojmë besëlidhjet tona, i përmbushim detyrimet prindërore dhe jetojmë një jetë të virtytshme. Ju mund të thoni se kjo tingëllon si thjeshtë të jesh një shenjtor besnik i ditëve të mëvonshme! Ju keni të drejtë. Standardi për mbajtësit e rekomandimeve të tempullit nuk është shumë i lartë për t'u arritur prej nesh. Është thjeshtë të jetojmë besnikërisht ungjillin dhe të ndjekim profetët.

Më pas, si mbajtës të rekomandimeve të tempullit që kanë marrë indaumentin, ne vendosim modele të të jetuarit si Krishti. Këto modele përfshijnë bindjen, bërjen e sakrificave për të mbajtur urdhërimet, dashurinë për njëri-tjetrin, të qenit të dëlirë në mendim e veprim dhe përkushtimin e vetes për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë. Nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe zbatimit të këtyre modeleve themelore të besnikërisë, ne marrim "fuqi nga lart"⁹ për të përballuar sfidat e jetës. Ne kemi nevojë sot më shumë se kurrë për këtë fuqi hyjnore. Ajo është fuqi që e marrim vetëm përmes ordinancave të tempullit. Unë dëshmoj se ia vlen çdo përpjekje e çdo sakrificë që bëjmë për të marrë ordinancat e tempullit.

Ndërsa shtohet dëshira jonë për të mësuar e për ta jetuar ungjillin, kërkojmë në mënyrë të natyrshme që t'i shërbejmë njëri-tjetrit. Shpëtimtari i tha Pjetrit: "Kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu"¹⁰. Më ka lënë shumë mbresa fakti që të rinjtë sot kanë një dëshirë të thellë për t'u shërbyer e për të bekuar të tjerët – për të bërë një ndryshim në këtë botë. Ata gjithashtu e dëshirojnë skajshëm gëzimin që sjell shërbimi.

Megjithatë, është e vështirë për të rinjtë që të kuptojnë se si veprimet që bëjnë tani, do t'i përgatisin ose do t'i përjashtojnë ata nga mundësitë për shërbim në të ardhmen. Të gjithë ne kemi një "detyrë [të] menjëhershme"¹¹ për t'i ndihmuar të rinjtë tanë në përgatitjen për shërbim gjatë gjithë jetës duke i ndihmuar ata të bëhen të mbështetur te vetja. Përveç mbështetjes shpirtërore te vetja për të cilën kemi diskutuar, është dhe mbështetja materiale te vetja, që përfshin shkollim shtesë ose profesional pas diplomimit në shkollën e mesme, të mësuarit për të punuar dhe të kursyerit. Duke e shmangur borxhin dhe duke ruajtur pará

tani, ne përgatitemi për shërbim me kohë të plotë në Kishë në të ardhmen. Qëllimi i mbështetjes materiale dhe shpirtërore te vetja është që ta sigurojmë veten shpirtërisht dhe materialisht, në mënyrë që t'i ndihmojmë dhe të tjerët që janë në nevojë.

Qoftë nëse jemi të rinj apo të vjetër, ajo që bëjmë në të tashmen përcakton shërbimin që do të jemi në gjendje të japim e të gëzojmë në të ardhmen. Dikur një poet tha: "Nga të gjitha fjalët e trishta të gjuhës apo penës, më të trishtat janë këto: 'Ah sikur!'"¹² Le të mos e jetojmë jetën tonë duke u penduar për atë që bëmë apo nuk bëmë!

Të dashur vëllezër dhe motra, i riu për të cilin foli Shpëtimtari, ai të cilin e quajmë djali plangprishës, *u kthye në shtëpi*. I ati nuk e kishte harruar; i ati po e priste. Dhe "kur [i biri] ishte ende larg, i ati e pa dhe pati dhembshuri; u lëshua vrap, dhe . . . e puthi"¹³. Në nder të kthimit të të birit, ai kërkoi t'i sillnin një rrobë, një unazë dhe të bënin një festë me një viç të majmur¹⁴ – kujtues të faktit se asnjë bekim nuk do të na mohohet nëse durojmë besnikërisht në zbatimin e urdhërimeve, që të kthehemi tek Ati ynë Qiellor.

Me dashurinë e Tij dhe dashurinë e Birit të Tij në zemrën time, unë e sfidoj secilin prej nesh që të ndjekë dëshirat e tij/saj shpirtërore dhe *të vijë në vete*. Bëni një bisedë me veten duke u parë në pasqyrë dhe pyesni: "Ku jam në të jetuarin sipas besëlidhjeve të mia?" Ne jemi në shtegun e duhur kur mundemi të themi: "Unë e marr denjësisht sakramentin çdo javë dhe jam i/e denjë për të mbajtur një rekomandim tempulli, dhe sakrifikoj për të shërbyer e për t'i bekuar të tjerët".

Unë jap dëshminë time të veçantë se Perëndia e do kaq shumë çdonjërin prej nesh "sa dha Birin e tij të vetëmlindurin"¹⁵ që të shlyente për mëkatet tona. Ai na njeh dhe na pret, madje edhe kur jemi shpirtërisht larg prej Tij. Ndërsa veprojmë mbi dëshirat tona dhe vijmë në vete, ne do të jemi të "rrethuar përjetësisht në krahët e dashurisë së tij"¹⁶ dhe të mirëpritur në shtëpi. Kështu dëshmoj, në emrin e shenjtë të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Lluca 15:17.
2. Alma 32:27.

3. Mosia 3:19.

4. Shih Mateu 26:17–28; Lluka 22:1–20.
5. Alma 5:12; shih edhe Mosia 5:2; Alma 5:13–14.
6. Moroni 6:6.
7. Shih Moroni 4:3; Doktrina e Besëlidhje 20:77.
8. Psalmeve 24:3–4.
9. Doktrina e Besëlidhje 95:8.
10. Lluka 22:32.
11. Doktrina e Besëlidhje 123:11.
12. John Greenleaf Whittier, “Maud Muller”, *The Complete Poetical Works of Whittier* (1894), f. 48.
13. Lluka 15:20.
14. Shih Lluka 15:22–24.
15. Gjoni 3:16.
16. 2 Nefi 1:15.

Besim, Qëndrueshmëri, Përmbushje: Një Mesazh Drejtuar Prindërve të Vetëm

Nga Plaku Dejvid S. Bakster,
i Të Shtatëdhjetëve

Ju po mundoheni që t'i rrisni fëmijët tuaj në dritë e në të vërtetë, duke e ditur se megjithëse ju nuk mund ta ndryshoni të kaluarën, ju mund t'i jepni formë të ardhmes.

Mesazhi im është për prindërit që janë të vetëm në Kishë, shumica e të cilëve janë nëna të vetme – ju gra guximtare që, përmes rrethanave të ndryshme të jetës, po i rrisni fëmijët dhe po kujdeseni vetë për shtëpinë tuaj. Ndoshta jeni vejushë apo e divorcuar. Ju mund të jeni duke u përballur me sfidat e të qenit prind i vetëm si rezultat i shkeljes së Ligjit të Dëlirësisë përpara martesë, por tani po jetoni në përputhje me parimet e ungjillit duke e ndryshuar jetën tuaj për mirë. Bekuar qofshi që shmangni atë lloj shoqërimi që do të vinte në dëm të virtytit dhe të dishepullimit. Ky do të ishte një çmim tepër i lartë për t'u paguar.

Edhe pse ndonjëherë mund të keni bërë pyetjen “Pse mua?” është nëpërmjet vështirësive të jetës që ne rritemi drejt perëndishmërisë ndërsa karakteri ynë formohet në provën e rëndë të pikëllimit, ndërsa ngjarjet e vështira ndodhin në jetë, sepse Perëndia nuk ndërhyr te liria e zgjedhjes së njerëzve. Ashtu siç komentoi Plaku Nil A. Maksuell, ne nuk mund ta kuptojmë arsyen pse gjërat janë ashtu siç janë sepse “ne nuk i kemi të gjitha faktet”¹.

Cilatdo qofshin rrethanat tuaja ose arsyet përse i keni ato, ju jeni të mrekullueshme. Çdo ditë ju përballeni me mundimet e jetës, duke bërë punën që ishte caktuar të bëhej nga dy prindër, por ju më së shumti e bëni vetëm. Ju duhet të jeni edhe baba edhe nënë. Ju mbani shtëpinë, kujdeseni për familjen tuaj, ndonjëherë mundoheni që të keni mjaft para për të plotësuar nevojat tuaja dhe si për mrekulli gjeni edhe aftësinë për të shërbyer në Kishë në mënyra të rëndësishme. Ju i ushqeni fëmijët tuaj. Ju qani dhe luteni me ta e për ta. Ju dëshironi më të mirën për ta, por çdo natë shqetësoheni se më e mira që mund t'u jepni, mund të mos jetë kurrë e mjaftueshme.

Ndërkohë që nuk dëshiroj të flas tepër për veten, unë jam fryti i një shtëpie me një prind. Gjatë pjesës më të madhe të fëmijërisë sime dhe viteve të adoleshencës, nëna ime na rriti vetëm në kushte të mjeruara. Paraja ndahej me kujdes. Ajo u përball me një vetmi të brendshme, ndonjëherë e dëshpëruar për mbështetje e shoqëri. Prapëseprapë, pavarësisht gjithë kësaj, nëna ime kishte dinjitet, një forcë të jashtëzakonshme vendosmërie dhe një karakter të fortë tipik skocez.

Fatmirësisht, vitet e saj pasuese qenë më të bekuara se vitet e saj të hershme kur qe nënë e vetme. Ajo u martua me një të sapokthyer në besim, që ishte i ve; ata u vulosën në Tempullin e Londrës në Angli dhe pak pas kësaj, shërbyen atje si punonjës ordinancash. Ata qëndruan bashkë për pothuajse një çerek shekulli – të lumtur, të kënaqur dhe të përmbushur derisa ndërruan jetë.

Ka shumë prej jush, gra të mira të Kishës, anembanë botës, që përballen me rrethana të ngjashme dhe që tregojnë të njëjtën aftësi ripërtëritëse vit pas viti.

Kjo nuk është pikërisht ajo që ju shpresuat apo planifikuat, u lutët apo prisnit, kur nisët jetën vite më parë. Udhëtimi juaj përgjatë jetës ka pasur vështirësi dhe ndryshime të papritura, më së shumti, si rezultat i jetës në një botë të rënë që është caktuar të jetë një vend prove.

Ndërkohë, ju po mundoheni që t'i rrisni fëmijët tuaj në dritë e në të vërtetë, duke e ditur se megjithëse ju nuk mund ta ndryshoni të kaluarën, ju mund t'i jepni formë të ardhmes.

Përgjatë rrugës ju do të merrni bekime shpërblyese, edhe pse ato nuk janë të dukshme menjëherë.

Me ndihmën e Perëndisë, ju nuk keni pse të frikësoheni nga e ardhmja. Fëmijët tuaj do të rriten dhe do t'ju shpallin të lumtura dhe çdonjëra prej arritjeve të tyre të shumta do të jetë një nderim për ju.

Ju lutemi, kurrë mos u ndieni sikur pozicioni juaj në Kishë është disi më i ulët se i të tjerëve apo që në një farë mënyre keni më pak të drejtë se të tjerët për bekimet e Zotit. Në mbretërinë e Perëndisë nuk ka qytetarë të klasit të dytë.

Ne shpresojmë se, kur të merrni pjesë në mbledhjet e Kishës dhe të shihni familje që duken të plota e të lumtura apo të dëgjoni dikë që të flasë për idealet e familjes, ju do të ndiheni të lumtura që jeni pjesë e një Kise që vërtet përqendrohet te familjet dhe na mëson për rolin e tyre qendror në planin e Atit Qiellor për lumturinë e fëmijëve të Tij; që në mes të fatkeqësive botërore dhe kalbëzimit moral, ne kemi doktrinën, autoritetin, ordinancat dhe besëlidhjet që ofrojnë shpresën më të madhe për botën, duke përfshirë edhe lumturinë e ardhshme të fëmijëve tuaj dhe familjeve që ata do të krijojnë.

Në mbledhjen e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës në shtator të 2006–s, Presidenti Gordon B. Hinkli rrëfeu një përvojë të treguar nga një nënë e vetme, e divorcuar me shtatë fëmijë, që në atë kohë ishin nga mosha 7 deri në 16 vjeç. Ajo kishte shkuar matanë rrugës për t'i çuar diçka një fqinje. Ajo tha:

“Ndërsa po kthehesha për të shkuar në shtëpi, unë mund të shihja që dritat e shtëpisë sime ishin ndezur. Unë mund të kujtoja çfarë po më thoshin fëmijët ndërsa po dilja nga dera disa minuta më parë. Ata po thoshin: ‘Mami, çfarë do të hamë për darkë?’ ‘A mund të më çosh në bibliotekë?’ ‘Duhet të blej letër projekti sonte.’ E lodhur dhe e këputur, unë hodha sytë drejt asaj shtëpie dhe pashë dritë në secilën nga dhomat. Mendova për të gjithë ata fëmijë që po më prisnin të shkoja në shtëpi dhe t’u plotësoja nevojat. Barrat e mia m’u dukën më të rënda se sa mund të mbaja.

Më kujtohet se pashë drejt qiellit duke qarë dhe thashë: ‘Atë i dashur, unë thjesht nuk mund t’ia dal sonte. Jam shumë e lodhur. Nuk mund ta përballoj. Nuk mund të shkoj në shtëpi dhe të

kujdesem e vetme për të gjithë ata fëmijë. A mund të vij tek Ti dhe të qëndroj me Ty vetëm për një natë? . . .’

Unë nuk i dëgjova në të vërtetë fjalët e përgjigjes, por i dëgjova në mendjen time. Përgjigja ishte: ‘Jo, e vogla ime, ti nuk mund të vish tek unë tani. . . . Por unë mund të vij tek ti.’”²

Ju faleminderit, motra, për gjithçka që po bëni për të rritur familjen tuaj dhe për të mbajtur një shtëpi me dashuri ku ka mirësi, paqe dhe mundësi.

Edhe pse ju shpesh ndiheni vetëm, në të vërtetë ju kurrë nuk jeni *tërësisht* vetëm. Për sa kohë që ju përparoni në durim dhe në besim, Zoti do të jetë me ju; qielli do t’ju japë bekimet që ju nevojiten.

Perspektiva dhe këndvështrimi juaj për jetën do të ndryshojë kur në vend që të dëshpërohemi, ju të shikoni me shpresë drejt Perëndisë.

Shumë prej jush e kanë zbuluar tashmë të vërtetën e madhërishme e shndërruese se, kur jetoni për të lehtësuar barrat e të tjerëve, vetë barrat tuaja bëhen më të lehta. Megjithëse rrethanat mund të mos kenë ndryshuar, ka ndryshuar qëndrimi juaj. Ju jeni në gjendje të përballeni me vetë sprovat tuaja me një pranim më të madh, me një zemër më të kuptueshme dhe me mirënjohje më të thellë për ato që keni, në vend që të pikëlloheni për ato që ende ju mungojnë.

Ju keni zbuluar se, kur mundohemi t’i ngushëllojmë të tjerët që duket se janë të dëshpëruar, ne marrim ngushëllim për vete; kupa jonë me të vërtetë “po derdhet” (Psalmëve 23:5).

Nëpërmjet të jetuarit të drejtë, ju dhe fëmijët tuaj mund të gëzoni një ditë bekimet e të qenit pjesë e një familjeje të plotë, të përjetshme.

Anëtarë e udhëheqës, a mund të bëni ndonjë gjë më tepër për t’i mbështetur familjet me një prind pa i gjykuar apo kritikuar ato? A mund t’i drejtoni të rinjtë e këtyre familjeve, veçanërisht duke u dhënë djemve të rinj shembuj të gjërave që burrat e mirë bëjnë dhe të mënyrës se si burrat e mirë jetojnë? Në mungesë të baballarëve, a po u jepni modele që janë të denja për t’u ndjekur?

Tani, sigurisht, ka disa familje me një prind ku babai është prindi i vetëm. Vëllezër, ne lutemi edhe për ju dhe ju lëvdojmë. Ky mesazh është edhe për ju.

Prindër të vetëm, unë dëshmoj se ndërta bëni më të mirën tuaj në më të vështirën e sfidave njerëzore, qielli do t'ju bekojë. Ju vërtet nuk jeni vetëm. Lëreni fuqinë shëlbuese e të përzemërt të Jezu Krishtit ta bekojë jetën tuaj tani dhe t'ju mbushë me shpresën e premtimit të përjetshëm. Merrni kurajë. Kini besim dhe shpresë. Shiheni të tashmen me guxim dhe shikoni për nga e ardhmja me siguri. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Neal A. Maxwell, *Notwithstanding My Weakness* (1981), f. 68.
2. Te Gordon B. Hinckley, "In the Arms of His Love", *Liahona*, nëntor 2006, f. 117.

Qëndroni në Territorin e Zotit!

Nga Plaku Ulises Soaresh,
i Të Shtatëdhjetëve

Pyetja jonë e përditshme duhet të jetë: “A më vendosin veprimet e mia në territorin e Zotit apo në territorin e kundërshtarit?”

Presidenti Tomas S. Monson tha një herë: “Më lejoni të tregoj një formulë të thjeshtë, nëpërmjet së cilës ju mund të masni zgjedhjet që hasni. Është e lehtë për t’u mbajtur mend: ‘Ju nuk mund të jeni të drejtë duke vepruar gabim; ju nuk mund të jeni gabim duke vepruar drejt’” (“Pathways to Perfection”, *Liahona*, korrik 2002, f. 112). Formula e Presidentit Monson është e qartë dhe e drejtpërdrejtë. Ajo funksionon në të njëjtën mënyrë si funksionoi Liahona që iu dha Lehit. Nëse ushtrojmë besim dhe jemi të zellshëm në zbatimin e urdhërimeve të Zotit, do ta gjejmë lehtësisht drejtimin e duhur për ta ndjekur, veçanërisht kur përballemi me zgjedhjet tona të përditshme.

Apostulli Pal na këshillon rreth rëndësisë së mbjelljes në Frymë dhe të qenit të vetëdijshëm për të mos mbjellë në mish. Ai tha:

“Mos u gënjeni: Perëndia nuk vihet dot në lojë, sepse ç’ të mbjellë njeriu, atë edhe do të korrë.

Sepse ai që mbjell për mish të tij, do të korrë nga mishi i tij prishje, por ai që mbjell për Frymë, do të korrë nga Fryma jetë të përjetshme.

Le të mos lodhemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos lodhemi, do të korrim në kohën e vet” (Galatasve 6:7–9).

Të mbjellësh në Frymë do të thotë se të gjitha mendimet, fjalët dhe veprimet tona duhet të na ngrenë në nivelin e

hyjnueshmërisë së prindërve tanë qiellorë. Megjithatë, shkrimet e shenjta i referohen mishit si natyra fizike apo trupore e njeriut të natyrshëm, që i lejon njerëzit të ndikohen nga pasioni, dëshirat, orekset dhe shtytjet e mishit, në vend të kërkimit për frymëzim nga Fryma e Shenjtë. Nëse nuk jemi të kujdesshëm, ato ndikime të ndërthurura me presionin e së keqes në botë, mund të na nxisin të praktikojmë sjellje të vrazhdë dhe të pamatur, që mund të bëhet pjesë e karakterit tonë. Në mënyrë që t'i shmangim ato ndikime të pahijshme, ne duhet të ndjekim atë për të cilën Zoti e udhëzoi Profetin Jozef Smith rreth mbjelljes vazhdimisht në Frymë: "Prandaj, mos u lodhni së bëri mirë, sepse ju po ngrini themelin e një vepre të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe" (DeB 64:33).

Për ta zmadhuar shpirtin tonë, kërkohet që "të flak[im] larg [nesh] çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi" (Efesianëve 4:31) dhe që të "[jemi] të urtë në ditët e provës [sonë] dhe [të] qëroh[emi] nga çdo fëlliqësi" (Mormoni 9:28).

Ndërsa studiojmë shkrimet e shenjta, ne mësojmë se premtimet që Zoti na ka bërë, varen nga bindja jonë dhe këto premtime nxisin të jetuarin e drejtë. Këto premtime duhet ta ushqejnë shpirtin tonë, duke na sjellë shpresë përmes inkurajimit që të mos heqim dorë, madje edhe kur jemi duke u përballur me sfidat tona të përditshme të të jetuarit në një botë, vlerat etike dhe morale të së cilës po zhduken, që për rrjedhojë, i nxit njerëzit të mbjellin në mish edhe më shumë. Por, në ç'mënyrë mund të jemi të sigurt se zgjedhjet tona po na ndihmojnë të mbjellim në Frymë dhe jo në mish?

Presidenti Xhorxh Albert Smith, duke përsëritur këshillën nga gjyshi i tij, një herë tha: "Ka një vijë kufiri të përcaktuar mirë midis territorit të Zotit dhe territorit të djallit. Nëse ju do të qëndroni nga ana e Zotit e vijës, ju do të jeni nën ndikimin e tij dhe nuk do të keni dëshirë të bëni gabim; por, nëse kaloni në anën e djallit të asaj vije sado pak, ju jeni në fuqinë e tunduesit dhe, nëse ai është i suksesshëm, ju nuk do të jeni në gjendje të mendoni ose madje të arsyetoni siç duhet, sepse ju do ta keni humbur Shpirtin e Zotit" (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Xhorxh Albert Smith* [2011], f. 189).

Si rrjedhojë, pyetja jonë e përditshme duhet të jetë: “A më vendosin veprimet e mia në territorin e Zotit apo në territorin e kundërshtarit?”

Profeti Mormoni e paralajmëroi popullin e tij rreth rëndësisë së të pasurit të aftësisë për të dalluar të mirën nga e keqja:

“Prandaj, të gjitha gjërat që janë të mira vijnë nga Perëndia dhe ajo që është e ligë vjen nga djalli; pasi djalli është armik i Perëndisë dhe lufton kundër tij përherë dhe fton, dhe nxit në mëkat dhe për të bërë atë që është e ligë përherë.

Por vini re, ajo që është e Perëndisë fton dhe nxit për të bërë mirë përherë” (Moroni 7:12–13).

Drita e Krishtit së bashku me shoqërimin e Frymës së Shenjtë duhet të na ndihmojnë të përcaktojmë nëse mënyra jonë e të jetuarit po na vendos ose jo në territorin e Zotit. Nëse qëndrimet tona janë të mira, ato janë të frymëzuara nga Perëndia, pasi çdo gjë e mirë vjen nga Perëndia. Por, nëse veprimet tona janë të këqija, ne po ndikohemi nga kundërshtari sepse ai i bind njerëzit të bëjnë ligësi.

Afrikanët më frymëzojnë për shkak të vendosmërisë dhe zellit të tyre për të qëndruar në territorin e Zotit. Edhe në rrethana të vështira në jetë, ata të cilët e pranojnë ftesën për të ardhur te Krishti, bëhen një dritë për botën. Disa javë më parë, ndërsa po vizitoja një nga lagjet në Afrikën e Jugut, unë pata privilegjin të shoqëroja dy priftërinj të rinj, peshkopin dhe presidentin e tyre të kunjit, në një vizitë të rinjtë më pak aktivë të kuorumit të tyre. U mahnita jashtë mase nga guximi dhe përulesia që treguan ata dy priftërinj, ndërkohë që i ftuan të rinjtë më pak aktivë të kthehen në kishë. Ndërsa u folën këtyre të rinjve më pak aktivë, unë vura re se fytyra e tyre pasqyroi dritën e Shpëtimtarit dhe, në të njëjtën kohë, ajo mbushi me dritë të gjithë ata përreth tyre. Ata po përmbushnin detyrën e tyre për të “ndihm[uar] të dobët, ngri[tur] duart që varen poshtë dhe forc[uar] gjunjët e këputur” (DeB 81:5). Qëndrimi i atyre dy priftërinjve i vendosi ata në territorin e Zotit dhe ata shërbyen si mjete në duart e Tij ndërsa i ftuan të tjerët të bënin po ashtu.

Te Doktrina e Besëlidhje 20:37, Zoti na jep mësim mbi atë se çfarë do të thotë të mbjellësh në Frymë dhe se çfarë na vë në vërtet në territorin e Zotit, sikurse vijon: të përulemi para

Perëndisë, të vijnë me zemra të thyera dhe shpirtra të penduar, të dëshmojmë para Kishës se jemi penduar me të vërtetë për të gjithë mëkatet tona, të marrim mbi vete emrin e Jezu Krishtit, të kemi vendosmëri për t'i shërbyer Atij deri në fund, të manifestojmë me anë të veprave tona se e kemi marrë Shpirtin e Krishtit dhe të merremi me anë të pagëzimit në Kishën e Tij. Gatishmëria jonë për t'i përmbushur këto besëlidhje, na përgatit për të jetuar në praninë e Perëndisë si qenie të ekzaltuara. Kujtimi i këtyre besëlidhjeve mund ta drejtojë sjelljen tonë në lidhje me familjen, në ndërveprimin tonë shoqëror me njerëz të tjerë dhe, veçanërisht, në marrëdhënien tonë me Shpëtimtarin.

Jezu Krishti krijoi modelin e përsosur të sjelljes, me anë të së cilit ne mund t'i ndërtojmë qëndrimet tona që të jemi në gjendje t'i përmbushim këto besëlidhje të shenjta. Shpëtimtari dëboi nga jeta e Tij çdo ndikim që mund ta shpërqendronte nga misioni i Tij hyjnor, veçanërisht kur Ai u tundua nga djalli ose nga pasuesit e tij ndërsa shërbeu këtu në tokë. Edhe pse Ai nuk mëkatoi kurrë, Ai kishte një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar, plot me dashuri për Atin tonë Qiellor dhe për të gjithë njerëzimin. Ai e përuli veten para Atit tonë në Qiell, duke e mohuar vullnetin e Tij vetjak për të përmbushur atë që Ati kishte kërkuar prej Tij në të gjitha gjërat deri në fund. Madje edhe në atë çast dhembjeje të skajshme fizike dhe shpirtërore, duke mbajtur barrën e mëkateve të të gjithë njerëzimit mbi shpatullat e Tij dhe duke derdhur gjak nga porret e Tij, Ai i tha Atit: "Por jo atë që dua unë, por atë që do ti" (Marku 14:36).

Ndërsa mendojmë rreth besëlidhjeve tona, lutja ime, vëllezër dhe motra, është që ne të mund ta mbajmë veten të fortë kundër "shigjeta[ve] [të] flakta të kundërshtarit" (1 Nefi 15:24), duke ndjekur shembullin e Shpëtimtarit në mënyrë që të mund të mbjellim në Frymë dhe të qëndrojmë në territorin e Zotit. Le ta kujtojmë formulën e Presidentit Monson: "Ju nuk mund të jeni të drejtë duke vepruar gabim; ju nuk mund të jeni gabim duke vepruar drejt". Unë i them këto gjëra në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Në Akordim me Muzikën e Besimit

Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Perëndia i do të gjithë fëmijët e Tij. Ai dëshiron që të gjithë ata të kthehen tek Ai. Ai dëshiron që çdokush të jetë i akorduar me muzikën e shenjtë të besimit.

Kur Autoritetet e Përgjithshme të Kishës takohen me anëtarët në mbarë botën, ne [Autoritetet e Përgjithshme] shohim vetë se si shenjtorët e ditëve të mëvonshme janë një trupë mirësie. Ne ju përgëzojmë për gjithçka që bëni për të bekuar jetën e të gjithë njerëzve.

Ata prej Autoriteteve të Përgjithshme me detyra në çështjet me publikun janë jashtëzakonisht të vetëdijshëm se shumë udhëheqës të opinionit dhe gazetarë në SH.B. e përreth botës e kanë shtuar diskutimin e tyre publik për Kishën dhe anëtarët e saj. Një bashkim i pashembullt faktorësh e ka rritur ndjeshëm ndërëgjegjësimin për Kishën.¹

Shumë njerëz që shkruajnë rreth Kishës, kanë bërë një përpjekje të sinqertë për t'i kuptuar njerëzit tanë e doktrinën tonë. Ata janë treguar qytetarë dhe janë përpjekur të jenë objektivë, gjë për të cilën u jemi mirënjohës.

Ne e pranojmë gjithashtu, se shumë individë nuk janë në gjendje t'i kuptojnë gjërat e shenjta. Kryerabini Zoti Saks i Anglisë, në fjalimin e tij drejtuar udhëheqësve katolikë romanë dhjetorin e kaluar në Universitetin Peshkopal Gregorian, vuri në dukje se sa jofetare janë bërë disa pjesë të botës. Ai deklaroi se faktori është “një tonalitet agresiv shkencor i ateizmit, i shurdhët ndaj muzikës së besimit”².

Vegimi i madh hyrës në Librin e Mormonit është ëndrra profetike e Lehit për pemën e jetës.³ Ky vegim i përshkruan qartë sfidat që ekzistojnë në kohën tonë ndaj besimit dhe ndarjen e madhe mes atyre që e duan, e adhurojnë dhe ndiejnë përgjegjësi ndaj Perëndisë dhe ndaj atyre që nuk ndihen kështu. Lehi shpjegon disa nga sjelljet që e shkatërrojnë besimin. Disa janë krenarë, mendjemëdhenj dhe të pamend. Ata interesohen vetëm për të ashtuquajturën urtësi të botës.⁴ Të tjerë mund të kenë pak interes për Perëndinë, por humbasin në mjegullat e errësirës dhe mëkatit të botës.⁵ Disa e kanë shijuar dashurinë e Perëndisë dhe fjalën e Tij, por ndihen të turpëruar për shkak të atyre që i përqeshin dhe bien në “shtigje të ndaluara”⁶.

Së fundmi, janë edhe ata që janë të akorduar me muzikën e besimit. Ju e dini cilët jeni. Ju e doni Zotin dhe ungjillin e Tij dhe përpiqeni vazhdimisht që ta jetoni e shpërndani mesazhin e Tij, veçanërisht me familjet tuaja.⁷ Ju jeni në harmoni me nxitjet e Shpirtit, të zgjuar ndaj fuqisë së fjalës së Perëndisë, keni sjellje besimtare në shtëpitë tuaja dhe përpiqeni me zell që të jetoni një jetë si të Krishtit sikurse dishepujt e Tij.

Ne e dimë se sa të ngarkuar jeni. Duke mos pasur një shërbesë profesionale me pagesë, përgjegjësia për administrimin e Kishës bie mbi ju anëtarë të shenjtëruar. Ne e dimë se është e zakonshme për anëtarët e peshkopatave, presidentat e kunjeve e shumë të tjerë që të japin shërbim të përkushtuar me orar të zgjatur. Presidentat e organizatave ndihmëse dhe të kuorumeve janë shembullore në sakrificat e tyre vetmohuese. Ky shërbim e kjo sakrificë zgjat gjatë gjithë anëtarësisë, për ata që mbajnë dokumentet e zyrës, mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore besnike dhe ata që japin mësim në orët mësimore. Ne u jemi mirënjohës atyre që shërbejnë guximshëm si drejtues bojskautësh dhe çerdhesh gjithashtu. Ju të gjithë e keni dashurinë dhe vlerësimin tonë për atë që bëni e për atë që jeni!

Ne e dimë se ka shumë anëtarë që janë më pak të interesuar dhe më pak besnikë ndaj disa prej mësimëve të Shpëtimtarit. Dëshira jonë është që këta anëtarë të zgjohen plotësisht në besim dhe ta shtojnë aktivizimin dhe zotimin e tyre. Perëndia i do të gjithë fëmijët e Tij. Ai dëshiron që të gjithë ata të kthehen tek Ai.

Ai dëshiron që çdokush të jetë i akorduar me muzikën e shenjtë të besimit. Shlyerja e Shpëtimtarit është një dhuratë për çdokënd.

Duhet dhënë mësim dhe duhet kuptuar se ne i duam e i respektojmë të gjithë njerëzit që Lehi përshkroi.⁸ Kujtoni, nuk na takon neve të gjykojmë. Gjykimi i takon Zotit.⁹ Presidenti Tomas S. Monson na ka kërkuar në mënyrë të posaçme që të kemi “kurajën për t’u përmbajtur nga gjykimi i të tjerëve”¹⁰. Ai i ka kërkuar gjithashtu, çdo anëtar besnik që t’i *shpëtojë* ata që e kanë shijuar frutin e ungjillit dhe më pas janë larguar gjithashtu edhe ata që nuk e kanë gjetur ende shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar. Ne lutemi që ata do të mbahen te shufra dhe do të marrin nga dashuria e Perëndisë, që ua mbush “shpirtin . . . me një gëzim jashtëzakonisht të madh”¹¹.

Ndërsa vegimi i Lehit i përfshin të gjithë njerëzit, koncepti kulmor i doktrinës është rëndësia e përjetshme e familjes. “Familja shugurohet nga Perëndia. Ajo është njësia më e rëndësishme në kohë dhe në përjetësi.”¹² Kur Lehi hëngri frutin e pemës së jetës (dashuria e Perëndisë), ai dëshiroi që “familja [e tij] të hante nga ai gjithashtu”¹³.

Dëshira jonë e madhe është që t’i rrisim fëmijët tanë në të vërtetën e drejtësinë. Një parim që do të na ndihmojë ta arrijmë këtë, është që të shmangim të qenit tej mase gjykues rreth sjelljes që është e pamend ose e pamatur, por jo mëkatuese. Shumë vite më parë, kur gruaja ime dhe unë i kishim fëmijët në shtëpi, Plaku Dallin H. Ouks dha mësim se që e rëndësishme të bëje dallimin mes gabimeve rinore që duhen ndrequr, dhe mëkateve që kërkojnë ndëshkim dhe pendim.¹⁴ Atje ku ka mungesë urtësie, fëmijëve tanë u duhet udhëzim. Atje ku ka mëkat, pendimi është thelbësor.¹⁵ Në familjen tonë, ne kemi zbuluar se kjo të vjen në ndihmë.

Respektimi i fesë në shtëpi i bekon familjet tona. Shembulli është veçanërisht i rëndësishëm. Ajo çka *jemi* shprehet me zë aq të lartë, sa fëmijët tanë mund të mos e dëgjojnë atë që themi. Kur qeshë pothuajse pesë vjeç, nënës sime i erdhën fjalë se vëllai i saj më i vogël që vrrarë kur luftanija në të cilën ai po shërbente u bombardua në brigjet e Japonisë pranë fundit të Luftës II Botërore.¹⁶ Ky lajm që tronditës për të. Ajo që shumë e prekur dhe shkoi në dhomën e gjumit. Pas pak, unë shkova “fshehurazi” në

dhomë për të parë nëse ajo ishte mirë. Ajo që gjunjëzuar pranë shtratit në lutje. Një paqe e madhe më kaploi pasi ajo më kishte mësuar të lutesha e ta doja Shpëtimtarin. Ky që shembulli tipik që ajo më dha gjithmonë. Nënata e baballarët që luten me fëmijët, mund të jenë më të rëndësishëm se çdo shembull tjetër.

Mesazhi, shërbesa dhe Shlyerja e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, është programi thelbësor mësimor që duhet dhënë mësim në familje. Asnjë shkrim i shenjtë nuk e ka përshkruar më mirë besimin se 2 Nefi 25:26: “Dhe, ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin dhe shkruajmë sipas profecive tona, që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre”.

Një nga parimet themelore të vegimit të Lehit, është se anëtarët besnikë duhet të mbahen fort te shufra e hekurit që të qëndrojnë në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar që të çon te pema e jetës. Është thelbësore që anëtarët t’i lexojnë, të meditojnë e t’i studiojnë shkrimet e shenjta.¹⁷

Libri i Mormonit ka një rëndësi madhore.¹⁸ Do të ketë, me siguri, gjithnjë nga ata që do ta nënvlerësojnë rëndësinë ose madje që do ta kritikojnë këtë libër të shenjtë. Disa kanë përdorur humorin. Përpara se të shërbeja në një mision, një profesor i universitetit citoi deklarin e Mark Tuejnit që, nëse do të hiqje frazën “Dhe ndodhi” nga Libri i Mormonit, ai “do të kishte qenë thjesht një pamflet i shkurtër”¹⁹.

Disa muaj më vonë, ndërsa po shërbeja në një mision në Londër të Anglisë, një profesor i shquar, i arsimuar në Universitetin e Oksfordit në Londër, një ekspert egjiptian në gjuhët semite, e lexoi Librin e Mormonit, i shkroi letra Presidentit Dejvid O. Mek-Kei dhe u takua me misionarët. Ai i vuri ata në dijeni se që i bindur se Libri i Mormonit ishte me të vërtetë një përkthim i “mësimeve të hebrenjve dhe gjuhës së egjiptianëve” prej periudhave kohore të përshkruara në Librin e Mormonit.²⁰ Një shembull mes shumë prej atyre që ai përdorte, që fraza lidhëse “Dhe ndodhi” e cila, sipas tij, pasqyronte mënyrën se si ai do ta përkthente frazeologjinë e përdorur në shkrimet e lashta semite.²¹ Profesori ishte në dijeni se ndërkohë që njohuria e tij intelektuale e bazuar në profesionin e tij e kishte ndihmuar, që

ende thelbësore që të kishte një dëshmi shpirtërore. Nëpërmjet studimit dhe lutjes ai fitoi një dëshmi shpirtërore dhe u pagëzua. Kështu që, atë që një humorist i famshëm e pa si një objekt përqeshjeje, një akademik e njohu si një tregues të thellë të vërtetësisë së Librit të Mormonit, e cila iu pohua atij përmes Shpirtit.

Doktrina thelbësore e lirisë së zgjedhjes kërkon që një dëshmi e ungjillit të rivendosur duhet të bazohet te besimi në vend që të bazohet në një provë të jashtme ose shkencore. Përqendrimi ngulmues mbi gjëra ende të pazbuluara plotësisht, për shembull te mënyra se si mund të ketë ndodhur lindja ndërsa Maria që e virgjër apo Ringjallja e Shpëtimtarit ose te mënyra se si i përktheu me saktësi Jozef Smithi shkrimet tona të shenjta, nuk do të jenë të efektshme as nuk do të sjellin përparim shpirtëror. Këto janë çështje besimi. Përfundimisht, përgjigjja është këshilla e Moronit për të lexuar e medituar dhe më pas për të pyetur Perëndinë me gjithë sinqeritetin e zemrës, me një qëllim të vërtetë për t'i vërtetuar të vërtetat e shkrimeve të shenjta nëpërmjet dëshmisë së Shpirtit.²² Përveç kësaj, kur e rrënjosim në jetën tonë rëndësinë e shkrimeve të shenjta dhe e jetojmë ungjillin, ne bekohemi nga Shpirti dhe e ndiejmë mirësinë e Tij me ndjenja gëzimi, lumturie dhe sidomos paqeje.²³

Qartazi, ndryshimi mes atyre që e dëgjojnë muzikën e besimit dhe atyre që nuk e kuptojnë dot ndryshimin mes notave muzikore apo nuk janë të akorduar me të, është studimi aktiv i shkrimeve të shenjta. Unë u preka thellësisht vite më parë që një profet i dashur, Spenser W. Kimballi, theksoi nevojën për t'i lexuar e studiuar vazhdimisht shkrimet e shenjta. Ai tha: "Unë shoh se, kur bëhem rastësor në marrëdhëniet e mia me hyjninë dhe kur duket se asnjë vesh hyjnor nuk po dëgjon e asnjë zë hyjnor nuk po flet, jam larg, shumë larg. Nëse zhytem në shkrimet e shenjta, largësia shkurtohet dhe shpirtshmëria kthehet."²⁴

Shpresoj se ne po e lexojmë rregullisht Librin e Mormonit me fëmijët tanë. Unë kam diskutuar për këtë me vetë fëmijët e mi. Ata më kanë treguar dy gjëra që kanë vënë re. Së pari, këmbëngulja në leximin e shkrimeve të shenjta përditë si familje është çelësi. Vajza ime i përshkruan në një mënyrë gazmore

përpjekjet e saj çdo mëngjes me më së shumti fëmijë adoleshentë, që t'i lexojnë vazhdimisht shkrimet e shenjta. Ajo dhe bashkëshorti i saj zgjohen herët në mëngjes dhe lëvizin përgjumësh për t'u kapur pas parmakut të hekurt përgjatë shkallëve për te një dhomë ku familja e tyre mblidhet për të lexuar fjalën e Perëndisë. Këmbëngulja është përgjigjja dhe një sens humori vjen në ndihmë. Kjo kërkon përpjekje të madhe nga çdo pjesëtar i familjes çdo ditë, por përpjekja ia vlen. Frenimet e përkohshme mposhten nga këmbëngulja.

E dyta është mënyra se si djali ynë më i vogël dhe gruaja e tij janë duke i lexuar shkrimet e shenjta me familjen e tyre të re. Dy prej katër fëmijëve të tyre nuk janë aq të rritur sa të lexojnë. Për pesëvjeçarin ata kanë pesë shenja me gishta ndaj të cilave ai reagon në mënyrë që të marrë pjesë plotësisht në leximin e shkrimeve të shenjta si familje. Kur jepet shenja për gishtin 1, ai duhet të përsërisë: "Dhe ndodhi" kurdoherë që shfaqet në Librin e Mormonit. Më duhet ta pranoj se më pëlqen shumë fakti që kjo frazë shfaqet kaq shpesh. Rastësisht, për interesin e familjeve të reja, shenja për gishtin 2 është "Dhe kështu ne shikojmë"; gishtërinjtë 3, 4 dhe 5 zgjidhen nga prindërit bazuar te fjalët që përmban kapitulli që ata po lexojnë.

Ne e dimë se studimi i shkrimeve të shenjta si familje dhe mbërmbjet familjare në shtëpi nuk janë përherë të përsosura. Pavarësisht sfidave që hasni, mos u shkurajoni.

Ju lutemi, kuptojeni se besimi në Zotin Jezu Krisht dhe zbatimi i urdhërimeve të Tij është dhe do të jetë gjithnjë prova përcaktuese e vdekshmërisë. Mbi gjithçka tjetër, çdonjëri prej nesh duhet ta kuptojë se, kur dikush nuk e dallon dot ndryshimin mes notave muzikore të besimit, ai apo ajo nuk është në harmoni me Shpirtin. Ashtu siç dha mësim profeti Nefi: "Ju keni dëgjuar zërin e tij herë pas here . . . ; dhe ai ju ka folur me një zë të qetë, të ulët, por ju kishit humbur ndjesinë, që ju nuk mund të ndjenit fjalët e tij"²⁵.

Doktrina jonë është e qartë; ne duhet të jemi optimistë dhe të marrim zemër. Ne përforcojmë besimin tonë, jo frikën tonë. Ne gëzohemi në sigurimin e Zotit se Ai do të qëndrojë pranë nesh dhe do të na japë udhëzim e drejtim.²⁶ Fryma e Shenjtë u dëshmon zemrave tona se ne kemi një Atë të dashur në Qiell,

plani mëshirplotë i të cilit për shëlbimin tonë do të përmbushet në çdo aspekt për shkak të sakrificës shlyese të Jezu Krishtit.

Ashtu siç shkroi Naomi W. Rendëll, autorja e himnit “Fëmi i Per’ndis’ Jam”: “Shpirti i tij udhëzon; dashuria e tij siguron largimin e frikës kur besimi bën durim”²⁷.

Prandaj, kudo qofshim në shtegun e dishepullimit të vegimit të Lehit, vendosshim të zgjojmë brenda vetes e familjeve tona një dëshirë më të madhe për të kërkuar dhuratën e papërfytyrueshme të Shpëtimtarit, jetën e përjetshme. Unë lutem që ju do të jeni të akorduar me muzikën e besimit. Unë dëshmoj për hyjnueshmërinë e Jezu Krishtit dhe vërtetësinë e Shlyerjes së Tij, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:30.
2. Jonathan Sacks, “Has Europe Lost Its Soul?” (fjalim i dhënë më 12 dhjetor 2011, në Universitetin Peshkopal Gregorian), chiefrabbi.org/ReadArticle.aspx?id=1843.
3. Shih 1 Nefi 8.
4. Shih 1 Nefi 8:27; 11:35.
5. Shih 1 Nefi 8:23; 12:17.
6. 1 Nefi 8:28.
7. Shih 1 Nefi 8:12.
8. Udhëzimet e Shpëtimtarit janë që të kërkojnë delet e humbura; shih Mateu 18:12–14.
9. Shih Gjoni 5:22; shih edhe Mateu 7:1–2.
10. Tomas S. Monson, “Paçi Kurajë”, *Liahona*, maj 2009, f. 126.
11. 1 Nefi 8:12.
12. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 1.1.1.
13. 1 Nefi 8:12.
14. Shih Dallin H. Oaks, “Sins and Mistakes”, *Ensign*, tetor 1996, f. 62. Plaku Ouks e dha mësim këtë ide kur ai qe president i Universitetit “Brigam Jang” rreth vitit 1980.
15. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:25–27.
16. Shih Marva Jeanne Kimball Pedersen, *Vaughn Roberts Kimball: A Memorial* (1995). Vaughn luajti futboll amerikan për Universitetin “Brigam Jang” në vjeshtën e vitit 1941. Ditën pas betejës në Përl Harbor, më 8 dhjetor 1941, ai u regjistrua në Marinën e SH.B. Ai u vra më 11 maj 1945, nga bombardimi armik kundër USS *Bunker Hill* dhe u varros në det.
17. Shih Gjoni 5:39.
18. Shih Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon—Keystone of Our Religion”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 4; ose *Liahona*, tetor 2011, f. 52.
19. Mark Twain, *Roughing It* (1901), f. 127–128. Çdo brez i ri njihet me komentet e Tuejnit si të ishin një zbulim i ri i rëndësishëm. Zakonisht nuk përmendet shumë fakti se Mark Tuejni ishte po aq indiferent ndaj krishtëritimit por edhe fesë në përgjithësi.
20. 1 Nefi 1:2.
21. E takova Dr. Ebeid Sarofimin në Londër kur misionarët po i jepnin mësim. Shih edhe N. Eldon Tanner, në Conference Report, prill 1962, f. 53. Shumë akademikë të shkrimeve semite dhe egiptiane e kanë vënë re përdorimin e përsëritur të frazës “Dhe ndodhi” në fillim të fjalive; shih Hugh Nibley, *Since Cumorah*, botimi i 2-të. (1988), f. 150.

22. Shih Moroni 10:3–4; shumë pak kritikë e kanë vënë sinqerisht në provë këtë me qëllim të vërtetë.
23. Shih Doktrina e Besëlidhje 59:23.
24. *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 67.
25. 1 Nefi 17:45; shih edhe Ezra Taft Benson, “Seek the Spirit of the Lord”, *Tambuli*, shtator 1988, f. 5. “Më shpesh ne i dëgjojmë fjalët e Zotit nëpërmjet një ndjesie. Nëse jemi të përulur dhe të ndjeshëm, Zoti do të na nxisë nëpërmjet ndjenjave tona.”
26. Shih Doktrina e Besëlidhje 68:6.
27. “When Faith Endures”, *Hymns*, nr. 128.

Si të Merrni Zbulesë dhe Frymëzim për Jetën Tuaj Personale

Nga Plaku Riçard G. Skot,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

*Përse Zoti dëshiron që ne t'i lutemi Atij dhe të pyesim?
Sepse kjo është mënyra se si merret zbulesë.*

Gjithësecili që qëndron në këtë foltore për të dhënë një mesazh, ndien forcën dhe mbështetjen e anëtarëve në mbarë botën. Jam mirënjohës që po kjo mbështetje mund të vijë prej një shoqeje të dashur në anën tjetër të velit. Faleminderit, Zhaninë.

Fryma e Shenjtë komunikon informacion të rëndësishëm që na nevojitet për të na udhëhequr në udhëtimin tonë në vdekshmëri. Kur është i prerë, i qartë dhe thelbësor, ai meriton titullin e zbulesës. Kur është një seri nxitjesh që kemi shpesh për të na udhëhequr hap pas hapi drejt një synimi të denjë, në kontekstin e kësaj bisede, është frymëzim.

Një shembull i zbulesës do të ishte drejtimi që mori Presidenti Spenser W. Kimball, pas përgjërimit të tij të gjatë e të vazhdueshëm ndaj Zotit, në lidhje me dhënien e priftërisë të gjithë burrave të denjë në Kishë, kur në atë kohë ishte e disponueshme vetëm për disa prej tyre.

Një tjetër shembull zbulesë është ky orientim që iu dha Presidentit Jozef F. Smith: “Unë besoj se ne lëvizim dhe e kemi qenien tonë në prani të lajmëtarëve qiellorë dhe të qenieve qiellore. Nuk jemi të ndarë prej tyre. . . . Ne jemi të lidhur ngushtë me farefisin tonë, me paraardhësit tanë . . . të cilët na kanë paraprirë në botën e shpirtave. Ne nuk mund t'i harrojmë; ne nuk reshtim së dashuri ata; ne gjithmonë i mbajmë ata në zemrat

e kujtimet tona dhe kështu, jemi të shoqëruar e të lidhur me ta me anë të fijeve që nuk mund t'i këpusim. . . . Nëse është kështu për ne në situatën tonë të kufizuar, rrethuar nga dobësitë tona të vdekshmërisë, . . . sa më e sigurt është . . . të besosh se ata që kanë qenë besnikë, që kanë shkuar përtej . . . mund të na shohin më mirë sesa i shohim ne; se ata na njohin më mirë nga sa i njohim ne. . . . Ne jetojmë në prani të tyre, ata na shohin, shqetësohen për mirëqenien tonë, na duan tani më shumë se kurrë. Sepse tani ata shohin rreziqet që na sfidojnë; . . . dashuria e tyre për ne e dëshira e tyre për mirëqenien tonë duhet të jenë më të mëdha se ato që ndiejmë për veten tonë.”¹

Marrëdhëniet mund të forcohen përmes velit, me njerëz që i njohim dhe i duam. Kjo bëhet me anë të përpjekjes sonë të vendosur që të bëjmë vazhdimisht atë që është e drejtë. Ne mund ta forcojmë marrëdhënien tonë me njeriun e vdekur që e duam, duke pranuar se ndarja është e përkohshme dhe besëlidhjet e bëra në tempull janë të përjetshme. Kur u bindemi vazhdimisht, besëlidhje të tilla sigurojnë realizimin e përjetshëm të premtimeve të pandara në to.

Një rast shumë i qartë zbulose në jetën time ndodhi kur unë u nxita fuqishëm nga Shpirti që t'i kërkoja Zhaninë Uotkinsit që të vulosej me mua në tempull.

Një nga mësimet e mëdha që secilit prej nesh i duhet të mësojë, është të pyesë. Përse Zoti dëshiron që ne t'i lutemi Atij dhe të pyesim? Sepse kjo është mënyra se si merret zbuluesë.

Kur përballem me një çështje shumë të vështirë, kjo është mënyra se si përpiqem ta kuptoj se çfarë të bëj. Unë agjëroj. Unë lutem që t'i gjej dhe t'i kuptoj shkrimet e shenjta që do të jenë të dobishme. Ai proces është ciklik. Unë filloj të lexoj një fragment shkrimi të shenjtë; meditoj se çfarë do të thotë vargu dhe lutem për frymëzim. Pastaj unë meditoj dhe lutem që të di nëse e kam kapur gjithçka që Zoti dëshiron që të bëj. Shpesh, më shumë mbresa vijnë me rritjen e kuptueshmërisë së doktrinës. Unë kam zbuluar se ky model është një mënyrë e mirë për të mësuar nga shkrimet e shenjta.

Ka disa parime praktike që e shtojnë zbuluesën. Së pari, dorëzimi ndaj emocioneve të tilla si inati, ose lëndimi, ose

justifikimi, do ta largojë Frymën e Shenjtë. Këto emocione duhet të largohen, ose shansi për të marrë zbulesë është i ulët.

Një tjetër parim është të jesh i kujdesshëm me humorin. E qeshura me zë të lartë dhe pavend do ta fyejë Shpirtin. Një sens i mirë humorit e ndihmon zbulesën; e qeshura me zë të lartë jo. Një sens humorit është një valvul shkarkimi për trysnitë e jetës.

Një tjetër armik për zbulesën vjen nga zmadhimi ose i foluri me zë të lartë për atë që po thuhet. E folura e qetë dhe e kujdesshme do ta favorizojë marrjen e zbulesës.

Nga ana tjetër, komunikimi shpirtëror, mund të shtohet nga praktika të mira shëndetësore. Ushtrimi fizik, sasi të arsyeshme gjumi dhe zakone të mira të ushqyerit, e rrisin zotësinë tonë për të marrë dhe kuptuar zbulesë. Ne do të jetojmë për hapësirën tonë të caktuar të jetës. Megjithatë, mund ta rrisim edhe cilësinë e shërbimit edhe vetë mirëqenien tonë duke bërë zgjedhje të kujdesshme dhe me vend.

Është e rëndësishme që aktivitetet tona të përditshme të mos na e tërheqin vëmendjen prej dëgjimit të Shpirtit.

Zbulesa mund të jepet edhe në ëndërr, kur ka një kalim thuajse të pandjeshëm nga gjumi në zgjim. Nëse do të përpiqeni fort ta regjistroni menjëherë përmbajtjen, ju mund të shënoni shumë hollësi, por përndryshe, ajo shuhet shpejt. Komunikimi i frymëzuar natën përgjithësisht shoqërohet nga një ndjenjë e shenjtë gjatë gjithë përvojës. Zoti përdor individë për të cilët ne kemi shumë respekt, që të na mësojnë të vërteta në ëndërr, sepse u mirëbesojmë atyre dhe do ta dëgjojmë këshillën e tyre. Është Zoti që po jep mësim nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Megjithatë, në një ëndërr, Ai mund ta bëjë atë edhe më të lehtë për ta kuptuar edhe me më shumë gjasa që të na prekë zemrën, duke na dhënë mësim nëpërmjet dikujt që e duam dhe e respektojmë.

Kur është për qëllimet e Zotit, Ai mund të na sjellë në kujtesë çfarëdolloj gjëje. Kjo nuk duhet ta dobësojë vendosmërinë tonë për të regjistruar mbresa të Shpirtit. Frymëzimi i shënuar me kujdes i tregon Perëndisë se komunikimet e Tij janë të shenjta për ne. Shënimi do ta rrisë gjithashtu aftësinë tonë për ta rikultuar zbulesën. Shënimi i tillë i udhëzimit prej Shpirtit duhet të mbrohet nga humbja ose ndërhyrja e të tjerëve.

Shkrimet e shenjta japin vërtetim shprehës të mënyrës se si e vërteta, kur jetohet vazhdimisht, hap derën për frymëzim për të ditur se çfarë të bësh dhe, ku nevojitet, të të shtohen zotësitë personale me anë të fuqisë hyjnore. Shkrimet e shenjta përshkruajnë se si zotësia e një njeriu për të mposhtur vështirësinë, dyshimin dhe sfida në dukje të pakapërcyeshme, forcohet nga Zoti në kohë nevoje. Ndërsa meditoni për shembuj të tillë, do të vijë një vërtetim i qetë nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë se përvojat e tyre janë të vërteta. Ju do të arrini të dini se ndihmë e ngjashme është e disponueshme për ju.

Kam parë njerëz të hasnin sfida, të cilët e dinin se çfarë të bënin kur kjo ishte përtej përvojës së tyre, sepse i mirëbesuan Zotit dhe e dinin se Ai do t'i drejtonte për te zgjidhjet që kërkoheshin urgjentisht.

Zoti ka shpallur: "Dhe ju duhet të mësoheni nga lart. Shenjtëroni vetveten dhe do t'ju dhurohet fuqi, që të mund të jepni madje siç kam thënë unë."² Fjalët *shenjtëroni vetveten* mund të duken të çuditshme. Presidenti Harold B. Li shpjegoi dikur: "Ju mund t'i zëvendësoni ato fjalë me frazën: 'Mbani urdhërimet e mia.'" E lexuar në atë mënyrë, këshilla mund të duket më e qartë.³

Njeriu duhet të jetë gjithmonë mendërisht dhe fizikisht i pastër dhe të ketë çiltërsi të qëllimit, që Zoti të mund ta frymëzojë. Njeriu, që është i bindur ndaj urdhërimeve të Tij, ka mirëbesimin e Zotit. Ai individ ka të drejtë për frymëzimin e Tij që të dijë se çfarë të bëjë dhe, si të nevojitet, fuqinë hyjnore për ta bërë atë.

Që shpirtshmëria të bëhet më e fortë dhe më e disponueshme, duhet të mbillet në një mjedis të drejtë. Mendjemadhësia, krenaria dhe arroganca janë si një gurishte që nuk do të prodhojë kurrë frut shpirtëror.

Përulësia është një truall pjellor ku shpirtshmëria rritet dhe prodhon frutin e frymëzimit për të ditur se çfarë të bësh. Ajo të jep të drejtën për fuqi hyjnore që të përmbushësh atë që duhet bërë. Një njeri që nxitet nga një dëshirë për lavdërim ose famë, nuk do të kualifikohet për të marrë mësim prej Shpirtit. Një njeri i cili është arrogant ose që i lejon emocionet që t'i ndikojnë vendimet, nuk do të udhëhiqet fuqishëm nga Shpirti.

Kur veprojmë si mjete në emër të të tjerëve, frymëzohemi më lehtë sesa kur mendojmë vetëm për vete. Në procesin e dhënies së ndihmës për të tjerët, Zoti mund të bashkëngjisë udhëzime që ne të përfitojmë.

Ati ynë Qiellor nuk na vuri në tokë që të dështojmë, por që të kemi sukses në mënyrë të lavdishme. Mund të duket paradoksale, por kjo është arsyeja pse dallimi i përgjigjeve për lutjen nganjëherë mund të jetë shumë i vështirë. Nganjëherë, ne përpiqemi në mënyrë të pamatur, që ta përbalim jetën duke u mbështetur te përvoja dhe zotësia jonë vetjake. Është shumë më e mençur që të kërkojmë nëpërmjet lutjes dhe frymëzimit hyjnor të dimë se çfarë të bëjmë. Bindja jonë siguron që, kur të kërkohet, mund të kualifikohemi për fuqi hyjnore që ta përmbushim një synim të frymëzuar.

Si shumë prej nesh, Oliver Kaudri nuk e njohu provën e përgjigjeve ndaj lutjeve që ishin dhënë tashmë nga Zoti. Për të hapur sytë e tij dhe tanët, iu dha kjo zbulesë nëpërmjet Jozef Smithit:

“Bekuar qofsh për atë që ti ke bërë; sepse ke kërkuar prej meje dhe vër re, sa shpesh që ti ke kërkuar, ke marrë udhëzim nga Shpirti im. Po të mos ishte kështu, ti nuk do të kishe ardhur në vendin ku je në këtë kohë.

Vër re, ti e di se ke kërkuar prej meje dhe unë vërtet e ndriçova mendjen tënde; dhe tani unë t’i them këto gjëra që ti të mund të dish se ke qenë ndriçuar nga Shpirti i së vërtetës.”⁴

Nëse e ndieni se Perëndia nuk u është përgjigjur lutjeve tuaja, meditoni për këto shkrime të shenjta – pastaj kërkonit me kujdes prova në vetë jetën tuaj që Ai tashmë mund t’ju jetë përgjigjur.

Dy tregues se një ndjenjë ose nxitje vjen nga Perëndia, janë se ajo ju jep paqe në zemër dhe një ndjenjë të qetë e të ngrohtë. Ndërsa ndiqni parimet që diskutova, do të jeni të përgatitur për ta dalluar zbulesën në kohë vendimtare në jetën tuaj.

Sa më nga afër ta ndiqni udhëheqjen hyjnore, aq më e madhe do të jetë lumturia juaj këtu dhe për përjetësinë – për më tepër, aq më i bollshëm do të jetë përparimi juaj dhe zotësia për të shërbyer. Unë nuk e kuptoj plotësisht se si bëhet kjo, por ajo udhëheqje në jetën tuaj nuk ua heq lirinë e zgjedhjes. Ju mund të

merrni vendimet që zgjidhni të merrni. Por kujtoni, gatishmëria për të bërë mirë sjell paqe të zemrës dhe lumturi.

Nëse zgjedhjet janë të gabuara, ato mund të ndreqen nëpërmjet pendimit. Kur kushtet e saj plotësohen tërësisht, Shlyerja e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, siguron një lirim nga kërkesat e drejtësisë për gabimet e bëra. Ajo është mrekullisht e thjeshtë dhe me kaq bukuri të pashoqe. Ndërsa vazhdoni të jetoni drejtësisht, ju gjithmonë do të nxiteni që të dini se çfarë të bëni. Nganjëherë, zbulimi i atij veprimi që duhet të ndërmerret, kërkon përpjekje dhe mirëbesim domethënës nga ana juaj. Akoma, ju do të nxiteni që të dini se çfarë të bëni, kur plotësoni kushtet për një udhëheqje të tillë hyjnore në jetën tuaj, domethënë, bindje ndaj urdhërimeve të Zotit, mirëbesim në planin e Tij hyjnor të lumturisë dhe shmangie të çfarëdo gjëje që është në kundërshtim me të.

Komunikimi me Atin tonë në Qiell nuk është një çështje e vogël. Ai është një privilegj i shenjtë. Ai bazohet mbi parime të përjetshme e të pandryshuara. Ne marrim ndihmë nga Ati ynë në Qiell në përgjigje të besimit tonë, bindjes dhe përdorimit të duhur të lirisë së zgjedhjes.

Zoti ju frymëzofte që t'i kuptoni dhe t'i përdorni parimet që çojnë në zbulesë dhe frymëzim personal, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Joseph F. Smith, në Conference Report, prill 1916, f. 2–3; shih edhe *Gospel Doctrine*, bot. 5-të (1939), f. 430–431.
2. Doktrina e Besëlidhje 43:16.
3. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* (2000), f. 34.
4. Doktrina e Besëlidhje 6:14–15.

Fuqitë e Qiellit

Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Mbajtësit e priftërisë, të rinj dhe të vjetër kanë nevojë si për autoritetin edhe për fuqinë – autorizimi i duhur dhe aftësia shpirtërore për të përfaqësuar Perëndinë në punën e shpëtimit.

Vëllezërit e mi të dashur, unë jam mirënjohës që ne mund të adhurojmë së bashku si një grup i madh mbajtësish të priftërisë. Ju dua dhe ju çmoj për denjësinë e ndikimin tuaj për mirë në mbarë botën.

Unë e ftoj secilin prej jush të mendojë se si do t'i përgjigjeshit pyetjes vijuese, të parashtruar shumë vite më parë anëtarëve të Kishës nga Presidenti Dejvid O. Mek-Kei: "Nëse në këtë çast secilit prej jush do t'i kërkohej ta shprehte me një fjali ose frazë tiparin më spikatës të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, cila do të ishte përgjigjja juaj?" ("The Mission of the Church and Its Members", *Improvement Era*, nëntor 1956, f. 781).

Përgjigjja që Presidenti Mek-Kei i dha vetë pyetjes së tij ishte "autoriteti hyjnor" i priftërisë. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme veçohet nga kishat e tjera që pretendojnë se autoriteti i tyre rrjedh nga autoriteti i dhënë person pas personi përgjatë kohës, shkrimet e shenjta ose trajnimi teologjik. Ne bëjmë deklaratën dalluese se autoriteti i priftërisë i është dhënë Profetit Jozef Smith me anë të vënies së duarve drejtpërdrejt nga lajmëtarë qiellorë.

Mesazhi im përqendrohet mbi këtë priftëri hyjnore dhe mbi fuqitë e qiellit. Unë lutem me zell për ndihmën e Shpirtit të Zotit

ndërsa së bashku mësojmë rreth këtyre të vërtetave të rëndësishme.

Autoriteti dhe Fuqia e Priftërisë

Priftëria është autoriteti i Perëndisë deleguar njerëzve mbi tokë, për të vepruar në të gjitha gjërat për shpëtimin e njerëzimit (shih Spencer W. Kimball, "The Example of Abraham", *Ensign*, qershor 1975, f. 3). Priftëria është mjeti me anë të së cilit Zoti vepron përmes burrave për të shpëtuar shpirta. Një nga tiparet përcaktuese të Kishës së Jezu Krishtit, si në lashtësi edhe sot, është autoriteti i Tij. Nuk mund të ketë Kishë të vërtetë pa autoritet hyjnor.

Burrave të zakonshëm u jepet autoriteti i priftërisë. Denjësia dhe gatishmëria – jo përvoja, njohuritë speciale apo arsimimi – janë cilësitë për shugurimin e priftërisë.

Modeli për marrjen e autoritetit të priftërisë përshkruhet në nenin e pestë të besimit: "Ne besojmë se një njeri duhet të thirret nga Perëndia, me anë të profecisë dhe me anë të vënies së duarve prej atyre që janë në autoritet, për të predikuar Ungjillin dhe për të administruar ordinancat e tij". Si rrjedhojë, një djalë ose një burrë merr autoritetin e priftërisë dhe shugurohet në një detyrë të veçantë nga dikush që tashmë e mban priftërinë dhe është autorizuar nga një udhëheqës me çelësat e nevojshëm të priftërisë.

Një mbajtës i priftërisë pritet ta ushtrojë këtë autoritet të shenjtë në përputhje me mendjen, vullnetin dhe qëllimet e shenjta të Perëndisë. Asgjë rreth priftërisë nuk është e përqendruar te vetja. Priftëria gjithnjë përdoret për t'u shërbyer, për të bekuar dhe për të forcuar njerëzit e tjerë.

Priftëria më e lartë merret nga një besëlidhje solemne që përfshin detyrimin për të vepruar sipas autoritetit (shih DeB 68:8) dhe detyrës (shih DeB 107:99) që është marrë. Si mbajtës të autoritetit të shenjtë të Perëndisë, ne jemi agjentë që veprojmë dhe jo objekte që detyrohemi të veprojnë (shih 2 Nefi 2:26). Priftëria është qenësisht aktive në vend se pasive.

Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim:

"Nuk është e mjaftueshme të marrësh priftërinë dhe më pas të rrih në pasivitet e të presësh derisa dikush të të nxisë në aktivitet. Kur marrim priftërinë, ne kemi detyrimin të

përfshihemi aktivisht dhe me zell në përkrahjen e kauzës së drejtësisë në tokë, sepse Zoti thotë:

‘ . . . Ai që nuk bën asgjë derisa të urdhërohet dhe e merr një urdhërim me zemër dyshuese dhe e zbaton atë me ngathtësi, po ai mallkohet’ [DeB 58:29]” (*So Shall Ye Reap* [1960], f. 21).

Presidenti Spenser W. Kimball gjithashtu theksoi me ton plot nënkuptim natyrën aktive të priftërisë: “Një njeri e thyen besëlidhjen e priftërisë duke shkelur urdhërimet – por gjithashtu duke i lënë të papërfunduara detyrat e tij. Prandaj, *për të thyer këtë besëlidhje një njeri duhet vetëm të mos bëjë gjë*” (*The Miracle of Forgiveness* [1969], f. 96).

Kur bëjmë më të mirën tonë për të përmbushur përgjegjësitë tona të priftërisë, ne mund të bekohemi me fuqinë e priftërisë. Fuqia e priftërisë është fuqia e Perëndisë që funksionon nëpërmjet burrave dhe djemve si ne, dhe që kërkon drejtësi vetjake, besnikëri, bindje dhe zell. Një djalë ose një burrë mund ta marrë autoritetin e priftërisë me anë të vënies së duarve, por nuk do të ketë asnjë fuqi priftërie nëse ai është i pabindur, i padenjë ose jo i gatshëm për të shërbyer.

“Të drejtat e priftërisë lidhen në mënyrë të pandashme me fuqitë e qiellit dhe . . . *fuqitë* e qiellit nuk mund të kontrollohen, as përdoren, vetëm mbi bazën e parimeve të drejtësisë.

Që ato mund të na dhurohen, është e vërtetë; por, kur përpiqemi t’i mbulojmë mëkatet tona ose të kënaqim krenarinë tonë, ambicien tonë të kotë ose të ushtrojmë kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtrat e fëmijëve të njerëzve në çfarëdo shkallë padrejtësie, vini re, qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen priftërisë ose autoritetit të atij njeriu” (DeB 121:36–37; theksimi i shtuar).

Vëllezër, që një djalë apo një burrë të marrë autoritetin e priftërisë por të shpërfillë të bëjë atë çka është e domosdoshme për t’u kualifikuar për fuqinë e priftërisë, është e papranueshme për Zotin. Mbjajtësit e priftërisë, të rinj dhe të vjetër kanë nevojë si për autoritetin edhe për fuqinë – autorizimi i duhur dhe aftësia shpirtërore për të përfaqësuar Perëndinë në punën e shpëtimit.

Një Mësim nga Babai Im

Unë u rrita në një shtëpi me një nënë besnike dhe një baba të mrekullueshëm. Nëna ime ishte pasardhëse e pionierëve, të cilët

sakrifikuan gjithçka për Kishën dhe mbretërinë e Perëndisë. Babai im nuk ishte anëtar i Kishës sonë dhe, kur kishte qenë djalë i ri, kishte pasur dëshirë të bëhej një prift katolik. Përfundimisht, ai zgjodhi të mos merrte pjesë në seminarin teologjik dhe në vend të kësaj ndoqi një profesion si bërës veglash e formash prej metali.

Për pjesën më të madhe të jetës së tij bashkëshortore, babai im mori pjesë me familjen tonë në mbledhjet e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Në fakt, pjesa më e madhe e njerëzve në lagjen tonë nuk e kishin idenë që babai im nuk ishte anëtar i Kishës. Ai luajti dhe stërviti ekipin e softbollit të lagjes sonë, ndihmoi për aktivitetet e bojskautit dhe për krahu nënën time në thirrjet e përgjegjësitë e saj të ndryshme. Unë dëshiroj t'ju tregoj juve një nga mësimet e mëdha që mësova nga babai rreth autoritetit dhe fuqisë së priftërisë.

Kur isha djalosh, unë e pyesja babanë shumë herë çdo javë, se kur do të pagëzohej. Ai përgjigjej me përzemërsi por me vendosmëri çdo herë që e ngacmoja: "Dejvid, unë nuk do të bashkohem me Kishën për shkak të nënës tënde, për ty apo për këdo tjetër. Do të bashkohem me Kishën kur ta di se është gjëja e duhur për t'u bërë."

Besoj se isha në vitet e hershme të adoleshencës kur ndodhi bashkëbisedimi i mëposhtëm me babanë tim. Ne sapo ishim kthyer në shtëpi nga marrja pjesë së bashku në mbledhjet e së dielës dhe e pyeta babanë tim se kur do të pagëzohej. Ai buzëqeshi dhe tha: "Je i vetmi njeri që më pyet gjithmonë rreth pagëzimit. Sot kam unë një pyetje për ty." Unë me ngut dhe me entuziazëm arrita në përfundimin se tani po përparojmë!

Babai im vazhdoi: "Dejvid, kisha juaj jep mësim se priftëria u mor nga toka në lashtësi dhe iu rivendos nga lajmëtarë qiellorë Profetit Jozef Smith, apo jo?" Unë u përgjigja se deklarata e tij ishte e saktë. Më pas, ai tha: "Ja dhe pyetja ime. Çdo javë në mbledhjen e priftërisë unë dëgjoj peshkopin dhe udhëheqës të tjerë të priftërisë t'u kujtojnë, luten dhe përgjërohen burrave të bëjnë mësimet e tyre të shtëpisë dhe të kryejnë detyrat e tyre të priftërisë. Nëse kisha juaj vërtet ka priftërinë e rivendosur të Perëndisë, përse shumë burra në kishën tuaj nuk ndryshojnë në kryerjen e detyrës së tyre fetare nga burrat në kishën time?"

Mendja ime djaloshare menjëherë u turbullua plotësisht. Nuk kisha asnjë përgjigje të përshtatshme për babanë tim.

Besoj se babai im e kishte gabim që gjykonte vlefshmërinë e deklaramit të Kishës sonë për autoritetin hyjnor nga cenet e burrave me të cilët ai shoqërohej në lagjen tonë. Por i ngulitur në pyetjen e tij për mua ishte një supozim i saktë se burrat që mbajnë priftërinë e shenjtë të Perëndisë duhet të jenë ndryshe nga burrat e tjerë. Burrat që mbajnë priftërinë nuk janë qenësisht më të mirë se burrat e tjerë, por ata duhet të veprojnë ndryshe. Burrat që mbajnë priftërinë, jo vetëm që duhet të marrin autoritetin e priftërisë por gjithashtu të bëhen mjete të denjë e besnikë të fuqisë së Perëndisë. “Jini të pastër që të mbani enët e Zotit” (DeB 38:42).

Unë kurrë nuk i kam harruar mësimet rreth autoritetit dhe fuqisë së priftërisë që mësova nga babai im, një burrë i mirë jo i besimit tonë, që priste më shumë nga burrat që pretendonin se mbanin priftërinë e Perëndisë. Ai bashkëbisedim i së dielës pasdite me babanë tim shumë vite më parë, krijoi te unë një dëshirë për të qenë një “djalë i mirë”. Unë nuk doja të isha një shembull i ngratë dhe një pengesë për përparimin e babait tim në mësimin rreth ungjillit të rivendosur. Unë thjesht dëshiroja të isha një djalë i mirë. Zoti ka nevojë që të gjithë ne si mbajtës të autoritetit të Tij të jemi të ndershëm, të virtytshëm dhe djem të mirë në të gjitha kohët dhe në të gjithë vendet.

Ju mund të jeni të interesuar të dini se disa vite më vonë, babai im u pagëzua. Dhe në kohët e përshtatshme, unë pata mundësinë t’i jap atij Priftërinë Aarone dhe Melkizedeke. Një nga përvojat më të mrekullueshme të jetës sime ishte të shihja babanë tim të merrte autoritetin dhe, së fundi, fuqinë e priftërisë.

E ndaj me ju këtë mesim të spikatur që mësova nga babai, për të theksuar një të vërtetë të thjeshtë. Marrja e autoritetit të priftërisë me anë të vënies së duarve është një fillim i rëndësishëm, por nuk është e mjaftueshme. Shugurimi jep autoritetin, por kërkohet drejtësi për të vepruar me fuqi ndërsa luftojmë për të ngritur shpirta, për të dhënë mesim e për të dëshmuar, për të bekuar e për të këshilluar dhe për të çuar përpara punën e shpëtimit.

Në këtë kohë shumë të rëndësishme të historisë së tokës, unë dhe ju si mbajtës të priftërisë duhet të jemi burra të drejtë dhe mjete të dobishme në duart e Perëndisë. Ne duhet të shkëlqejmë si burra të Perëndisë. Unë dhe ju do të bënim mirë të mësonim dhe ta mbanim parasysh shembullin e Nefit, nipit të Helamanit dhe të parit nga dymbëdhjetë dishepujt e thirrur nga Shpëtimtari në fillim të shërbesës së Tij midis nefitëve. “Dhe [Nefi] u mësoi atyre shumë gjëra. . . . Dhe Nefi i mësoi me fuqi dhe me autoritet të madh” (3 Nefi 7:17).

“Ju lutem, Ndhimojeni Bashkëshortin Tim të Kuptojë”

Në mbyllje të intervistave për rekomandim tempulli që drejtoja si peshkop dhe president kunji, unë shpesh do t’i pyesja motrat e martuara se si mund t’u shërbeja më mirë atyre dhe familjeve të tyre. Përputhshmëria e përgjigjeve që mora nga ato gra besnike, ishte si udhëzuese edhe alarmuese. Motrat rrallë herë u ankuan apo kritikuan, por ato shpesh u përgjigjën si më poshtë: “Ju lutem, ndihmojeni bashkëshortin tim të kuptojë përgjegjësinë e tij si udhëheqës i priftërisë në shtëpinë tonë. Jam e lumtur që kryesoj në studimin e shkrimeve të shenjta, lutjen familjare dhe mbrëmjen familjare në shtëpi dhe do vazhdoj të veproj kështu. Por shpresoj që bashkëshorti im do të jetë një partner i barabartë dhe do të ofrojë udhëheqjen e fortë të priftërisë që vetëm ai mund ta japë. Ju lutem, ndihmojeni bashkëshortin tim të mësojë se si të bëhet një patriark dhe një udhëheqës i priftërisë në shtëpinë tonë, ku kryeson dhe mbron.”

Unë shpesh mendoj mbi sinqeritetin e atyre motrave dhe për kërkesën e tyre. Udhëheqësit e priftërisë dëgjojnë shqetësime të ngjashme sot. Shumë bashkëshorte po lutën për bashkëshortë që nuk kanë vetëm autoritetin e priftërisë, por edhe fuqinë e priftërisë. Ato digjen nga dëshira të jenë në një zgjedhje bashkë me një bashkëshort besnik dhe shoqërues të priftërisë në punën e krijimit të një shtëpie me Krishtin në qendër dhe të përqendruar te ungjilli.

Vëllezër, unë ju premtoj se, në qoftë se unë dhe ju do t’i meditojmë me lutje kërkesat e këtyre motrave, Fryma e Shenjtë do të na ndihmojë të shohim vetveten siç jemi në të vërtetë (shih DeB 93:24) dhe do të na ndihmojë të njohim gjërat që duhet të

ndryshojmë dhe përmirësojmë. Dhe koha për të vepruar është tani!

Jini Shembuj Drejtësie

Sonte përsëris mësime të Presidentit Tomas S. Monson, që na ka ftuar ne si mbajtës të priftërisë të jemi “shembuj drejtësie”. Ai vazhdimisht na ka kujtuar se jemi në detyrën e Zotit dhe na është dhënë e drejta të kemi ndihmën e Tij, që varet nga denjësia jonë (shih “Shembuj Drejtësie”, *Liahona*, maj 2008, f. 65–68). Unë dhe ju mbajmë autoritetin e priftërisë që është kthyer në tokë në këtë periudhë ungjillore nga lajmëtarë qiellorë, madje Gjon Pagëzori, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni. Dhe si rrjedhojë, çdo burrë që merr Priftërinë Melkizedeke mund të gjurmojë hierarkinë e autoritetit të tij personal drejtpërdrejt te Zoti Jezu Krisht. Unë shpresoj se ne jemi mirënjohës për këtë bekim të mrekullueshëm. Unë lutem që do të jemi të pastër dhe të denjë për të përfaqësuar Zotin ndërkohë që ushtrojmë autoritetin e Tij të shenjtë. U kualifikoftë secili prej nesh për fuqinë e priftërisë.

Unë dëshmoj se priftëria e shenjtë është rivendosur me të vërtetë në tokë në këto ditë të mëvonshme dhe gjendet në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Dëshmoj edhe se Presidenti Tomas S. Monson është prifti i lartë kryesues mbi priftërinë e lartë të Kishës (shih DeB 107:9, 22, 65–66, 91–92) dhe i vetmi person mbi tokë që mban dhe gjithashtu është i autorizuar të ushtrojë të gjithë çelësat e priftërisë. Për këto gjëra unë dëshmoj solemnisht në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen.

Kritja e Vërtetë përmes Riaktivizimit të Anëtarëve më pak Aktivë

Nga Peshkopi Riçard C. Exhli

I Sapoliruar nga Thirrja si Këshilltar i Parë në Peshkopatën Kryesuese

*Shpëtimi i shpirtave është puna që Shpëtimtari na ka
thirrur të gjithëve të bëjmë.*

Muajt e fundit udhëheqësit e Kishës e kanë vendosur theksin gjithnjë e më shumë tek krijimi i “rritjes së vërtetë” [rritja e numrit të anëtarëve aktivë] në Kishë, duke i sjellë të gjithë ata që janë të gatshëm t’i marrin e t’i mbajnë ordinancat dhe besëlidhjet shpëtuese dhe që të jetojnë me një ndryshim të madh të zemrës siç e përshkroi Alma (shih Alma 5:14). Një prej mënyrave më kuptimplote dhe më të rëndësishme për të krijuar rritje të vërtetë është që të ndihmohen e të shpëtohen përsëri ata që janë pagëzuar por që prapëseprapë po enden në një gjendje më pak aktive, pa bekime dhe ordinanca shpëtuese. Pavarësisht thirrjes sonë individuale – mësues shtëpie apo mësuese vizitore, mësues/e i/e Shkollës të së Dieles, peshkop, baba, nënë, apo Autoritet i Përgjithshëm – të gjithë ne mund të përfshihemi në përpjekjen shpëtuese në një mënyrë domethënëse. Në fund të fundit, sjellja e të gjithë njerëzve – përfshirë familjen tonë, joanëtarët, më pak aktivët, mëkatarët – tek Krishti për të marrë ordinancat shpëtuese, është thirrja jonë hyjnore e përbashkët.

Një mëngjes të diele, rreth 30 vite më parë, ndërsa po shërbenim në një presidencë kunji, ne morëm një telefonatë nga njëri prej peshkopëve tanë besnikë. Ai shpjegoi se lagjja e tij ishte rritur aq shpejt sa ai nuk mundej më t’u jepte një thirrje të rëndësishme të gjithë anëtarëve të denjë. Lutja e tij ndaj nesh ishte

që ta ndanim lagjen. Ndërkohë që prisnim për miratimin e kësaj, ne vendosëm si presidencë kunjë që ta vizitonim lagjen dhe t'i thërrisnim këto motra e këta vëllezër të mrekullueshëm e të denjë për t'u bërë misionarë kunjë.

Përafërsisht personi i tretë që takova, ishte një studente e re që frekuentonte universitetin vendor. Pasi biseduam për pak çaste, unë i parashtrova thirrjen për të shërbyer si misionare. Pati heshtje për pak çaste. Pastaj ajo tha: "President, a nuk e dini se unë nuk jam aktive në Kishë?"

Pas disa çastesh heshtjeje nga ana ime, i thashë: "Jo, unë nuk e dija se nuk ishe aktive".

Ajo u përgjigj: "Unë nuk kam qenë aktive në Kishë prej vitesh". Më pas ajo tha: "A nuk e dini se kur ke qenë joaktiv, nuk është aq e lehtë të kthehesh përsëri?"

Iu përgjigja: "Jo. Lagjja jote e fillon mbledhjen në orën 9:00 paradite. Kur vini në shtëpinë e mbledhjes, ju jeni me ne."

Ajo u përgjigj: "Jo, nuk është aq e lehtë. Një njeri që po mendon të kthehet në kishë, shqetësohet për shumë gjëra. Shqetësohesh nëse do të të përshëndesë dikush, apo do të ulesh vetëm dhe i pa vënë re gjatë mbledhjeve. Shqetësohesh edhe nëse do të të pranojnë dhe cilët do të jenë miqtë e tu të rinj."

Me lot që i rridhnin nëpër faqe, ajo vazhdoi: "Unë e di se, prej vitesh, nëna dhe babai im janë lutur për mua që të më kthejnë në Kishë". Pastaj pas një çasti tjetër heshtjeje, ajo tha: "Gjatë tre muajve të fundit unë jam lutur që të gjej guximin, forcën dhe mënyrën për t'u bërë sërish anëtare aktive". Pastaj më pyeti: "President, a mendoni se kjo thirrje mund të jetë një përgjigje për ato lutje?"

Sytë e mi nisën të përloten ndërsa iu përgjigja: "Unë besoj se Zoti u është përgjigjur lutjeve të tua".

Ajo jo vetëm që e pranoi thirrjen; ajo u bë një misionare e shkëlqyer. Dhe unë jam i sigurt se i solli shumë gëzim jo vetëm vetes, por edhe prindërve e ndoshta pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Qenë disa gjëra që i mësova nga kjo dhe intervista të tjera të ngjashme:

- Unë mësova se shumë anëtarë më pak aktivë kanë njerëz të dashur që gjunjëzohen çdo ditë duke iu lutur Zotit për ndihmë për shpëtimin e njeriut të tyre të dashur që është më pak aktiv.
- Mësova se nuk është aq e lehtë apo e rehatshme për një anëtar më pak aktiv që thjesht të kthehet në Kishë. Ata kanë nevojë për ndihmë. Ata kanë nevojë për mbështetje. Ata kanë nevojë për shoqëri.
- Sërish, mësova se ne kemi anëtarë më pak aktivë që janë të gatshëm dhe po përpiqen ta gjejnë shtegun drejt të qenit aktiv.
- Mësova se shumë anëtarë më pak aktivë do t'i mbajnë thirrjet nëse u kërkohet.
- Mësova se një anëtar më pak aktiv meriton të trajtohet si i barabartë dhe të shihet si një bir apo bijë e një Perëndie të dashur.

Gjatë viteve, kam pyetur veten se si mund të kishte shkuar kjo intervistë nëse do t'i isha drejtuar asaj si një anëtare më pak aktive. Po ju lë juve të vendosni se çfarë mund të kishte ndodhur.

Riaktivizimi gjithmonë ka qenë një pjesë e rëndësishme e punës së Zotit. Ndërkohë që riaktivizimi i anëtarëve më pak aktivë është përgjegjësi e çdo anëtari, mbajtësit e Priftërisë Aarone dhe Melkizedeke kanë përgjegjësinë për t'i udhëhequr të tjerët në këtë punë. Në fund të fundit, kjo është ajo për të cilën duhet shërbimi i priftërisë – t'i sjellë të gjithë njerëzit te besëlidhjet ekzaltuese; duke sjellë paqe, lumturi dhe denjësi vetjake.

Nga Libri i Mormonit, do t'ju kujtohet se kur Alma i Riu zbuloi që zoramitet ishin larguar nga Kisha, ai organizoi një grup udhëheqësish të Kishës për t'i shpëtuar këta njerëz. Ndërsa e morën detyrën e tyre, ata iu lutën Zotit me këto fjalë:

“O Zot, na jep mundësi që të kemi sukses për t'i sjellë ata përsëri te ti, në Krisht.

Vër re, O Zot, shpirtrat e tyre janë të çmueshëm dhe shumë prej tyre janë vëllezërit tanë, prandaj, na jep, O Zot, fuqi dhe urtësi

që të mund t'i sjellim këta, vëllezërit tanë, përsëri tek ti" (Alma 31:34–35; theksimi i shtuar).

Disa muaj më parë, pas takimit me të sapokthyer në besim dhe anëtarë më pak aktivë, një zotëri i moshës sime, i riaktivizuar, erdhi tek unë dhe tha: "Unë jam dikush që ka qenë më pak aktiv gjatë pjesës më të madhe të jetës. Unë u largova nga Kisha herët në jetë. Por tani jam kthyer dhe punoj në tempull me gruan time."

Për t'ia bërë të ditur që gjithçka ishte në rregull, përgjigjja ime ishte pak a shumë kjo: "Është e mirë gjithçka që përfundon mirë".

Ai u përgjigj: "Jo, nuk është gjithçka mirë. Unë jam kthyer në Kishë, por kam humbur të gjithë fëmijët dhe nipërit e mbesat e mia. Dhe tani jam dëshmitar i humbjes së stërnipërve e stërmbesave të mia – të gjithë jashtë Kise. Nuk është gjithçka mirë."

Në familjen tonë, ne kemi një paraardhës që u bashkua me Kishën në Europë në fillimet e hershme të Kishës. Një djalë u bë joaktiv. Motra Exhli dhe unë u përpoqëm të gjenim pasardhësit joaktivë të këtij paraardhësi.

Ishte e thjeshtë për bashkëshorten time dhe për mua që të arrinim në përfundimin se gjatë këtyre gjashtë brezave dhe sipas hamendësimeve të arsyeshme, mund të kishte një humbje deri në 3.000 pjesëtarë të familjes. Tani parashikoni se çfarë do të ndodhë pas dy brezash. Humbja mund të arrijë teorikisht 20.000 deri në 30.000 fëmijë të Atit tonë në Qiell.

Përgjegjësia për shpëtim bazohet te një prej doktrinave më themelore të Kishës.

"Kujtoni që vlera e shpirtave është e madhe në sytë e Perëndisë;

Sepse, vini re, Zoti, Shëlbuesi juaj vuajti vdekjen në mish; prandaj ai vuajti dhembjen e *gjithë njerëzve*, që *gjithë njerëzit të mund të pendohen e të vijnë tek ai*. . . .

Dhe nëse është që ju duhet të punoni gjithë ditët tuaja për t'u shpallur pendim këtyre njerëzve dhe sillni qoftë edhe një shpirt tek unë, sa i madh do të jetë gëzimi juaj me të në mbretërinë e Atit tim!" (DeB 18:10–11, 15; theksimi i shtuar).

Unë kam pasur privilegjin të shpëtoj disa anëtarë më pak aktivë gjatë jetës sime. Tani, kur ndihmoj për ta kthyer dikë në

aktiv në Kishë, unë nuk përfytyroj një shpirt të vetëm; unë shoh gjashtë, shtatë ose më shumë breza – mijëra shpirtra. Dhe pastaj mendoj për shkrimin e shenjtë: “Sillni qoftë edhe një shpirt tek unë, sa i madh do të jetë gëzimi juaj me të në mbretërinë e Atit tim” (DeB 18:15).

Zoti u tha Apostujve të Tij: “E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak” (Mateu 9:37). Punëtorët nuk duhet të jenë pak. Ne kemi mijëra mbajtës të aftë e të denjë të priftërisë dhe miliona anëtarë të përkushtuar të Kishës në të gjitha anët e botës. Ne kemi këshilla lagjeje, kuorume priftërie, Shoqata të Ndhmës që funksionojnë, dhe organizata të tjera të gjitha me përgjegjësinë për t’i riaktivizuar anëtarët më pak aktivë. Shpëtimi i shpirtave është puna që Shpëtimtari na ka thirrur të gjithëve të bëjmë.

Më herët në fjalët e mia, përmenda lutjen që bënë Alma dhe miqtë e tij ndërsa u nisën për të shpëtuar zoramitët. Gjatë Luftës II Botërore, pothuajse 500 ushtarë amerikanë dhe qytetarë vendorë që i mbështetën ata, u mbajtën robër në një kamp burgimi. Për shkak të vuajtjes dhe shqetësimit për sigurinë e tyre, u zgjodh një trupë vullnetare prej pothuaj 100 ushtarësh amerikanë për t’i shpëtuar këta të burgosur. Pasi u grumbulluan vullnetarët, oficeri në komandë, i udhëzoi ata pak a shumë kështu: “Këtë mbremje ju djema, takohuni me udhëheqësit tuaj shpirtërorë, bini në gjunjë dhe premtojini Perëndisë se, për sa kohë që merrni frymë, ju nuk do të lejoni që ndonjëri prej këtyre burrave të vuajë për asnjë çast më tepër”. (Shih Hampton Sides, *Ghost Soldiers: The Forgotten Epic Story of World War II’s Most Dramatic Mission* [2001], f. 28–29.) Ky shpëtim i suksesshëm qe një shpëtim nga vuajtjet fizike e tokësore. A mos duhet të jemi ne më pak guximtarë në përpjekjet tona për t’i shpëtuar ata që mund të vuajnë pasoja shpirtërore dhe të përrjetshme? A mos duhet të bëjmë një zotim më të dobët ndaj Zotit?

Si përfundim, si anëtarë të Kishës së vërtetë e të gjallë të Krishtit, zotimi ynë vjen nga fakti se Zoti vuajti për secilin prej nesh – joanëtarin, anëtarin më pak aktiv, mëkatarin dhe pjesëtarët tanë të familjes. Unë besoj se ne mund të sjellim mijëra vetë te gëzimi, paqja dhe ëmbëlsia e ungjillit dhe qindra mijëra, madje miliona në brezat vijues. Unë besoj se ne mund t’ia dalim mbanë,

sepse kjo është Kisha e Zotit dhe, nëpërmjet virtytit të priftërisë dhe anëtarësisë sonë, ne jemi thirrur që t'ia dalim mbanë. Unë jua le këtë dëshmi, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Priftëri Aarone: Ngrihu dhe Përdore Fuqinë e Perëndisë

Nga Adrián Oçoa,

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rinjve

Ashtu si çdo fuqi tjetër, priftëria duhet ushtruar që të kryejë ndonjë të mirë. Ju jeni thirrur që “të ngriheni e të shkëlqeni”, jo që ta fshihni dritën tuaj në errësi.

Jo shumë kohë më parë, unë isha në Afrikën e Jugut dhe po vizitoja një shtëpi me Tabizon, ndihmësin e parë në kuorumin e priftërinjve në Lagjen e Kagizos. Tabizo dhe peshkopi i tij, i cili kryeson dhe mban çelësat për kuorumin, ishin lutur për anëtarët e kuorumit që qenë më pak aktivë, duke kërkuar frymëzim lidhur me cilin të vizitonin dhe si t’i ndihmonin ata. Ata ndien shtysën për të vizituar shtëpinë e Tebelos dhe më ftuan edhe mua që të shkoja me ta.

Pasi ia dolëm të kalonim qenin e egër rojë, u gjendëm në dhomën e ndenjjes me Tebelon, një të ri të qetë që kishte ndalur së ardhuri në kishë sepse kishte qenë i zënë duke bërë gjëra të tjera të dielave. Ai qe në siklet, por i lumtur që na kishte në shtëpi dhe madje ftoi familjen e tij të bashkohej me të. Peshkopi shprehu dashurinë e tij për familjen dhe dëshirën e tij për t’i ndihmuar ata që të bëheshin një familje e përrjetshme duke u vulosur në tempull. Ata u mallëngjyen dhe ne të gjithë mund ta ndienim praninë e fortë të Frymës së Shenjtë që drejtonte çdo fjalë e çdo emocion.

Por qenë fjalët e Tabizos që sollën ndryshimin gjatë vizitës. M’u duk sikur ky prift i ri po fliste gjuhën e engjëjve – fjalë dashurie që ne të gjithë mund t’i kuptonim plotësisht, por që

prekën veçanërisht mikun e tij. “Më pëlqente kaq shumë të flisja me ty gjatë gjithë kohës në kishë”, tha ai. “Ti ke gjithmonë fjalë të mira për mua. Dhe ti e di, skuadra jonë e futbollit nuk po ecën mirë tani që nuk të kemi ty. Ti je aq i mirë në futboll.”

“Më vjen keq”, u përgjigj Tebelo. “Unë do të bashkohem përsëri me ju djema.”

“Kjo do të jetë e hatashme”, tha Tabizo. “Dhe a e mban mend se si e kishim zakon të përgatiteshim për të shërbyer si misionarë? A mund të fillojmë ta bëjmë atë përsëri?”

“Po”, përsëriti Tebelo, “unë dua të kthehem përsëri.”

Ndoshta, gëzimi më i madh që unë përjetoj si këshilltar në presidencën e përgjithshme të Të Rinjve, është t’i shoh mbajtësit e Priftërisë Aarone nëpër botë duke ushtruar fuqinë e Priftërisë Aarone. Por ndonjëherë, unë gjithashtu bëhem dëshmitar, trishtueshëm, i kaq shumë të rinjve që nuk e kuptojnë se sa shumë të mira mund të bëjnë me fuqinë që mbajnë.

Priftëria është fuqia dhe autoriteti i Vetë Perëndisë për të vepruar në shërbim të fëmijëve të Tij. Oh, sa e mrekullueshme do të ishte nëse çdo mbajtës i Priftërisë Aarone, do të mund ta kuptonte plotësisht se priftëria e tij zotëron çelësat e shërbesës së engjëjve. Do të ishte e mrekullueshme sikur ata të mund ta kuptonin se kanë detyrën e shenjtë për t’i ndihmuar miqtë e tyre që të gjejnë shtegun që të çon te Shpëtimtari. Do të ishte e mrekullueshme sikur ata ta dinin se Ati Qiellor do t’u japë atyre fuqinë për t’i shpjeguar të vërtetat e ungjillit të rivendosur me një qartësi e sinqeritet të tillë, sa që të tjerët do ta ndiejnë vërtetësinë e pamohueshme të fjalëve të Krishtit.

Të rinj të dashur të Kishës, më lejoni t’ju bëj një pyetje të cilën shpresoj se do ta mbani në zemër për pjesën tjetër të jetës suaj. Çfarë fuqie më të madhe se priftëria e Perëndisë mund të fitoni në tokë? Çfarë fuqie mund të jetë më e madhe se aftësia për të ndihmuar Atin tonë Qiellor në ndryshimin e jetës së bashkëqënieve tuaja, për t’i ndihmuar ata përgjatë shtegut drejt lumturisë së përjetshme duke u pastruar nga mëkati dhe keqbërja?

Ashtu si çdo fuqi tjetër, priftëria duhet ushtruar që të kryejë ndonjë të mirë. Ju jeni thirrur që “të ngriheni e të shkëlqeni” (DeB 115:5), jo që ta fshihni dritën tuaj në errësirë. Vetëm ata që janë

trima, do të numërohen mes të zgjedhurve. Ndërsa e ushtroni fuqinë e priftërisë suaj të shenjtë, guximi dhe siguria juaj në vetvete do të rriten. Të rinj, ju e dini se po bëni më të mirën tuaj kur jeni në shërbim të Perëndisë. Ju e dini se ju jeni më të lumtur kur jeni të angazhuar me zell në një kauzë të mirë. Lartësojeni fuqinë e priftërisë suaj duke qenë të pastër e të denjë.

Unë e përsëris dhe e përforcoj thirrjen që Plaku Holland ju bëri gjashtë muaj përpara nga kjo foltore. “Unë . . . po kërkoj”, tha ai, “burra të rinj e të moshuar, të cilët kujdesen mjaftueshëm për këtë betejë mes së mirës e së ligës sa të përfshihen dhe të flasin haptas. Ne jemi në luftë.” Ai vazhdoi: “Unë kërkoj . . . një zë më të fortë dhe më të përkushtuar, një zë jo vetëm kundër së keqes . . . , por një zë për të mirën, një zë për . . . ungjillin, një zë për Perëndinë” (“Ne Jemi të Gjithë të Rekrutuar”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 44, 47).

Po, mbajtës të Priftërisë Aarone, ne jemi në luftë. Dhe në këtë luftë, mënyra më e mirë për t’u mbrojtur kundër së ligës është që ta reklamojmë aktivisht drejtësinë. Ju nuk mund të dëgjoni fjalë të pahijshme dhe të bëni sikur nuk dëgjoni. Ju nuk mund të shikoni, vetëm apo me të tjerët, pamje të cilat e dini se janë të fëlliqura dhe të bëni sikur nuk shihni. Ju nuk mund të prekni diçka të papastër dhe të bëni sikur nuk do të ketë pasoja. Ju nuk mund të rrii duarkryq kur Satani kërkon të shkatërrojë atë që është e dobishme dhe e pastër. Përkundrazi, mbrojeni guximshëm atë që e dini se është e vërtetë! Kur të dëgjoni apo të shihni ndonjë gjë që shkel standardet e Zotit, kujtoni cilët jeni – një ushtar në ushtrinë e Vetë Perëndisë, i fuqizuar me priftërinë e Tij të shenjtë. Nuk ka armë më të mirë kundër armikut, atit të gënjeshtreve, sesa e vërteta që do të dalë nga goja juaj ndërkohë që ushtroni fuqinë e priftërisë. Shumica e moshatarëve tuaj do t’ju respektojnë për guximin dhe integritetin tuaj moral. Disa nuk do t’ju respektojnë. Por kjo nuk ka rëndësi. Ju do të fitoni respektin dhe mirëbesimin e Atit tuaj Qiellor për shkak se ju e përdorët fuqinë e Tij për të arritur qëllimet e Tij.

Unë i bëj thirrje çdo presidence kuorumi të Priftërisë Aarone që ta ngrini edhe njëherë titullin e lirisë dhe t’i organizoni e t’i drejtoni batalionet tuaja. Përdoreni fuqinë tuaj të priftërisë duke i ftuar ata që ju rrethojnë që të vijnë tek Krishti nëpërmjet pendimit

e pagëzimit. Ju keni komandën dhe fuqinë e Atit Qiellor për ta bërë atë.

Dy vjet më parë, ndërsa po vizitoja qytetin e Santiagos, në Kili, më bëri shumë përshtypje Daniel Olate, një i ri që i shoqëronte shpesh misionarët. I kërkova atij të më shkruante dhe, me lejen e tij, do t'ju lexoj një pjesë të mesazhit të tij të fundit elektronik: "Sapo mbusha 16 vjeç dhe të dielën u shugurova në detyrën e priftit. Në po të njëjtën ditë pagëzova një shoqe; ajo quhet Karolina. Unë i mësova asaj ungjillin dhe ajo e frekuentoi rregullisht kishën, madje mori dhe medaljen e Përparimit të saj Personal, por prindërit e saj nuk e lejuan të pagëzohej derisa ata arritën të më njihnin e të më mirëbesonin. Ajo dëshironte që ta pagëzoja unë, kështu që na u desh të prisnim për një muaj deri të dielën kur u bëra 16 vjeç. Ndihem kaq mirë që kam ndihmuar një njeri kaq të mirë që të pagëzohej dhe ndihem i lumtur që isha unë ai që e pagëzoi."

Danieli është një nga të rinjtë e shumtë në mbarë botën që po jetojnë në përputhje me fuqinë që Perëndia u ka besuar. Një tjetër është Luis Fernando, nga Hondurasi, i cili vuri re se miku i tij po bënte zgjedhje shpirtërisht të rrezikshme në jetën e tij dhe ndau dëshminë e tij me të duke i shpëtuar me të vërtetë jetën (shih "A Change of Heart", lds.org/youth/video). Olavo, nga Brazili, është një shembull tjetër. Olavo, një shërbestar i vërtetë në shtëpinë e tij (shih DeB 84:111), e frymëzoi nënën e tij për t'u kthyer në aktivitet të plotë në Kishë (shih "Reunited by Faith", lds.org/youth/video). Ju mund t'i gjeni disa nga këto histori dhe shumë të tjera si ato, në faqen e internetit të Kishës për rininë youth.lds.org. Meqë ra fjala, interneti, mediat sociale dhe teknologji të tjera janë mjete që Zoti i ka vënë në duart tuaja për t'ju ndihmuar të ushtroni detyrat tuaja të priftërisë dhe ta zgjeroni ndikimin e së vërtetës dhe virtytit.

Të rinj të dashur, kur ju e ushtroni Priftërinë Aarone në mënyrën që kam përshkruar, ju po përgatiteni për përgjegjësitë e të ardhmes suaj. Por ju po bëni goxha më shumë se kaq. Ashtu si Gjon Pagëzori, ai shembull i shkëlqyer i mbajtjes së Priftërisë Aarone, edhe ju po përgatisni udhën e Zotit dhe po i drejtoni shtigjet e Tij. Kur ju e shpallni me guxim ungjillin e pendimit dhe pagëzimit, ashtu siç bëri Gjoni, ju po i përgatisni njerëzit për

ardhjen e Zotit (shih Mateu 3:3; DeB 65:1–3; 84:26–28). Shpesh ju tregojnë rreth potencialit tuaj të madh. Mirë, tani është koha për ta përdorur atë potencial, për t’i përdorur aftësitë që Perëndia ju ka dhënë për t’i bekuar të tjerët, për t’i nxjerrë ata nga errësira në dritë dhe për të përgatitur udhën e Zotit.

Kisha ju ka dhënë librin Detyrë ndaj Perëndisë si një burim për t’ju ndihmuar që t’i mësoni dhe t’i përmbushni detyrat tuaja. Studiojeni atë shpesh. Gjunjzohuni, larg nga teknologjia dhe kërkoni drejtimin e Zotit. Dhe më pas ngrihuni dhe përdoreni fuqinë e Perëndisë. Unë ju premtoj se do të merrni përgjigje nga Ati Qiellor mbi mënyrën se si ta drejtoni vetë jetën tuaj dhe se si t’i ndihmoni të tjerët.

Po citoj fjalët e Presidentit Tomas S. Monson: “Mos e nënvlerësoni kurrë ndikimin e gjerë të dëshmisë suaj. . . . Ju keni aftësinë për të vënë re atë që kalon pa u vënë re. Kur keni sy për të parë, veshë për të dëgjuar dhe zemra për të ndier, ju mund të ndihmoni dhe t’i shpëtoni [të tjerët]” (“Bëhu Shembull”, *Liahona*, maj 2005, f. 115; *Konferenca e Përgjithshme*, prill 2005, f. 137).

Unë ju dëshmoj se fuqia e priftërisë është e vërtetë. E fitova dëshminë time duke e ushtruar edhe vetë priftërinë. Unë kam parë të bëhen mrekulli pas mrekullie nga ata që kanë fuqinë e Priftërisë Aarone. E kam dëshmuar fuqinë e shërbesës së engjëjve teksa mbajtës besnikë të Priftërisë Aarone thonë fjalë shprese të frymëzuara nga Shpirti, duke hapur zemrën e dikujt në nevojë për dritë e dashuri. Në emrin e Jezu Krishtit, Zotit tonë, udhëheqësit tonë dhe Shpëtimtarit tonë, amen.

Arsyet dhe Qëllimet e Shërbimit të Priftërisë

Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Të kuptuarit e arsyeve dhe qëllimeve pse e jetojmë ungjillin dhe e arsyeve dhe qëllimeve pse e kemi dhe e përdorim priftërinë do të na ndihmojë ta shohim qëllimin hyjnor të të gjithë kësaj.

Më pëlqen jashtë mase kjo mundësi e mrekullueshme për t'u takuar me vëllezërit e priftërisë dhe për t'u ngazëllyer me ju në mrekullinë dhe bukurinë e ungjillit të Jezu Krishtit. Ju përgëzoj për besimin tuaj, punën tuaj të dobishme dhe drejtësinë tuaj të vazhdueshme.

Ne kemi një lidhje të përbashkët, që të gjithë kemi marrë shugurimin në priftërinë e Perëndisë nga ata anëtarë të besuar me autoritetin dhe fuqinë e shenjtë të priftërisë. Ky është një bekim i mrekullueshëm. Është një përgjegjësi e shenjtë.

Fuqia e Arsyeve dhe Qëllimeve

Kohët e fundit kam menduar për dy thirrje të rëndësishme që mora si mbajtës i priftërisë në Kishë.

E para nga këto thirrje erdhi kur isha dhjak. Unë ndiqja me familjen time degën e Kishës në Frankfurt të Gjermanisë. Ne ishim bekuar të kishim shumë njerëz të mrekullueshëm në degën tonë të vogël. Njëri ishte presidenti ynë i degës, Vëllai Landshulc. E admiroja shumë, edhe pse ai gjithnjë dukej të ishte goxha serioz, shumë zyrtar dhe pjesën më të madhe të kohës i veshur me një kostum të errët. Mbaj mend kur isha i ri që bëja shaka me miqtë e mi se sa i dalë mode dukej presidenti ynë i degës.

Kur mendoj për këtë tani, më vjen të qesh, sepse ka shumë mundësi që rinia e sotme e Kishës të më shohë në mënyrë shumë të ngjashme.

Një të diel, Presidenti Landshulc pyeti nëse mund të flisnim. Mendimi im i parë ishte: “Çfarë gabimi kam bërë?” Mendja ime në mënyrë të rrufeshme mendoi shumë gjëra që mund të kisha bërë, të cilat mund ta kishin frymëzuar këtë bisedë midis një presidenti dege dhe një dhjaku.

Presidenti Landshulc më ftoi në një klasë të vogël – kisha jonë nuk kishte një zyrë për presidentin e degës – dhe atje ai më drejtoi një thirrje për të shërbyer si president i kuorumit të dhjakëve.

“Ky është një pozicion i rëndësishëm”, tha ai, dhe më pas mori kohë dhe e përshkroi arsyen. Ai shpjegoi atë që ai dhe Zoti prisnin prej meje dhe se si mund të merrja ndihmë.

Nuk më kujtohet shumë nga çfarë tha ai, por vërtet, mbaj mend shumë mirë se si u ndieva. Ndërsa ai më foli, ndieva Shpirtin e shenjtë dhe hyjnor. Unë mund të ndieja se kjo ishte Kisha e Shpëtimtarit. Dhe ndieva se thirrja që ai më drejtoi, ishte e frymëzuar nga Fryma e Shenjtë. Më kujtohet që dola nga ajo klasë e vocërr duke u ndier pak fare më i gjatë sesa më parë.

U bënë afro 60 vite që nga ajo ditë, dhe ende i ruaj si thesar këto ndjenja të mirëbesimit dhe dashurisë.

Kur isha duke menduar përsëri mbi këtë përvojë, u përpoqa të kujtoj thjesht se sa dhjakë qenë në degën tonë në atë kohë. Me gjithë ç’mund të kujtoj, besoj se ishin dy. Megjithatë, ky mund të jetë një ekzagjerim i madh.

Por me të vërtetë nuk kishte rëndësi qoftë nëse kishte një dhjak apo dhjetra. Unë u ndieva i nderuar dhe doja të shërbeja me më të mirën e aftësisë time dhe të mos e zhgënjeja as presidentin e degës sime, as Zotin.

Tani e kuptoj se presidenti i degës mund të ma kishte drejtuar thirrjen pa i kushtuar shumë vëmendje, kur më thirri për atë pozicion. Ai thjesht mund të më kishte thënë në korridor ose gjatë mbledhjes sonë të priftërisë se unë isha presidenti i ri i kuorumit të dhjakëve.

Përkundrazi, ai kaloi kohë me mua dhe më ndihmoi të kuptoj jo vetëm se *cila* ishte detyra dhe përgjegjësia ime e re, por, më e rëndësishmja, *arsyen dhe qëllimin* e detyrës.

Ajo është diçka që nuk do ta harroj kurrë.

Kuptimi i kësaj historie nuk është që thjesht të përshkruaj se si duhen dhënë thirrjet në Kishë (edhe pse ky ishte një mësim i mrekullueshëm i mënyrës së duhur për ta bërë atë). Ky për mua është një shembull lidhur me fuqinë nxitëse të udhëheqjes së priftërisë që e zgjon shpirtërisht një njeri dhe frymëzon veprim.

Ne kemi nevojë t'i sjellim vazhdimisht ndër mend arsyet e përjetshme që qëndrojnë pas gjërave që urdhërohemi të bëjmë. Parimet themelore të ungjillit duhet të harmonizohen në jetën tonë, edhe nëse do të thotë t'i mësosh ato pa pushim. Ajo nuk do të thotë se ky proces duhet të jetë rutinë apo i mërzitshëm. Përkundrazi, kur ne i japim mësim parimet themelore në shtëpitë tona ose në kishë, entuziazmi për të jetuar ungjillin dhe një dëshmi e fuqishme le t'u sigurojnë njohuri, paqe dhe lumturi shpirttrave të njerëzve që u japim mësim.

Nga dhjaku më i ri i shuguruar deri te prifti i lartë më i vjetër, ne të gjithë kemi lista të *gjërave të kërkuara* që mund të bëjmë dhe duhet të bëjmë në përgjegjësitë tona të priftërisë. *Gjëja e kërkuar* është e rëndësishme në punën tonë dhe ne duhet të merremi me të. Por është te *arsyeja dhe qëllimi* i shërbimit të priftërisë që ne gjejmë zjarrin, pasionin dhe fuqinë e priftërisë.

Gjëja e kërkuar e shërbimit të priftërisë na mëson se çfarë të bëjmë. *Arsyeja dhe qëllimi* frymëzojnë shpirtin tonë.

Gjëja e kërkuar informon, por *arsyeja dhe qëllimi* shndërron.

Një Bollëk i Gjërave "Të Mira" Për t'u Bërë

Një tjetër thirrje e priftërisë për të cilën kam menduar, m'u dha shumë vite më vonë, kur kisha vetë familjen time. Ne ishim kthyer në Frankfurt të Gjermanisë dhe unë sapo kisha marrë një ngritje në detyrë, që do të kërkonte një pjesë të madhe të kohës dhe vëmendjes sime. Gjatë kësaj periudhe të ngarkuar të jetës sime, Plaku Jozef B. Uirthlin më drejtoi një thirrje për të shërbyer si president kunji.

Gjatë intervistës me të, shumë mendime më kaluan me shpejtësi në mendje, nga të cilët jo më pak i rëndësishmi qe shqetësimi turbullues që mund të mos kisha kohën që kjo thirrje

do të kërkonte. Edhe pse u ndieva i përvulur dhe i nderuar nga thirrja, për një kohë të shkurtër vrava mendjen nëse mund ta pranoja. Por ishte veçse një mendim i shkurtër, sepse e dija që Plaku Uirthlin ishte thirrur nga Perëndia dhe që po bënte punën e Zotit. Çfarë mund të bëja përveçse ta pranoja?

Ka çaste kur ne duhet të veprojmë me besim ndonëse nuk e dimë se ku do na shpien veprimet tona, me besim në vete se Perëndia do të na sigurojë përgjigjet dhe drejtimin për të cilin kemi nevojë sapo veprojmë me besim. Dhe kështu që e pranova me gëzim, duke e ditur se Perëndia do të ma siguronte kohën.

Në fillim të kësaj detyre, ne qemë të privilegjuar si kunj që të merrnim trajnim nga disa prej mësuesve dhe udhëheqësve më të shkëlqyer në Kishë – burra si Plaku Rasëll M. Nelson dhe Presidenti Tomas S. Monson erdhën në zonën tonë. Mësimdhënia e tyre qe si një bekim nga qielli dhe një frymëzim për ne. Unë ende i kam shënimet që mora gjatë këtyre sesioneve të trajnimit. Këta Vëllezër na dhanë *kuptimin* e asaj që do të thotë të ndërtosh mbretërinë e Perëndisë, duke ndërtuar dëshmitë vetjake dhe duke forcuar familjet. Ata na ndihmuan të shihnim se si t'i zbatonim të vërtetën dhe parimet e ungjillit në rrethanat tona të veçanta dhe për kohën tonë të posaçme. Për ta marrë në një aspekt tjetër, udhëheqësit e frymëzuar na ndihmuan të shihnim *arsyet dhe qëllimet* e ungjillit dhe neve na u desh të përvishnim mëngët dhe të shkonim të punonim.

Nuk zgjati shumë përpara se të kuptonim se kishte shumë gjëra që një presidencë kunji mund të bëjë – kaq shumë në fakt saqë, nëse nuk do të vendosnim përparësi të frymëzuara, mund të harronim të bënim ato të rëndësishmet. Përparësi konkurruese filluan të dilnin, duke e shmangur përqendrimin tonë nga përfytyrimi i treguar nga Vëllezërit. Kishte shumë gjëra “të mira” për t’u bërë, por jo të gjitha prej tyre kishin rëndësi më tepër.

Ne mësuam një mësim të rëndësishëm: fakti se diçka është e mirë, nuk është gjithmonë arsye e mjaftueshme që të kërkojë kohën dhe burimet tona. Aktivitetet, iniciativat dhe planet tona duhet të jenë të frymëzuara dhe të bazuara mbi *arsyen dhe qëllimin* e shërbimit tonë të priftërisë dhe jo nga çdo prirje e çastit apo interes i momentit. Përndryshe, ato mund t’i shpërqendrojnë përpjekjet tona, t’i dobësojnë energjitë tona dhe të na mbajnë të

përqendruar tërësisht mbi vetë interesat tona, shpirtërore ose tokësore, që nuk janë në qendër të dishepullimit.

Vëllezër, ne të gjithë e dimë se kërkohet vetëdisiplinë për të mbetur i përqendruar mbi çështjet që kanë fuqinë më të madhe për të rritur dashurinë tonë për Perëndinë dhe bashkëqeniet, për të frymëzuar martesat, forcuar familjet dhe ndërtuar mbretërinë e Perëndisë në tokë. Ashtu si një pemë frutore me një bollëk degësh dhe gjetesh, ne duhet të “krasitemi” herë pas here që të sigurohemi se po e përdorim energjinë dhe kohën tonë për të përmbushur qëllimin tonë të vërtetë – “të jap[im] fryte të mira!”¹

Ju Nuk Jeni Vetëm

Pra, si ta dimë se çfarë të zgjedhim? Ne të gjithë kemi përgjegjësinë ta përcaktojmë këtë për vetveten. Megjithatë, ne urdhërohemi t’i studiojmë me zell shkrimet e shenjta, t’ua vëmë veshin fjalëve të profetëve dhe ta bëjmë atë një çështje lutjeje të mbushur me besim, të rëndësishme dhe të dedikuar.

Vëllezër, Perëndia është besnik. Nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë, Ai do t’u flasë mendjeve dhe zemrave tona përsa i përket shtegut që duhet të ndjekim gjatë çdo pjese të jetës sonë.

Nëse zemra jonë është e kulluar – nëse nuk kërkojmë vetë lavdinë tonë, por lavdinë e Perëndisë së Plotfuqishëm, nëse kërkojmë të bëjmë vullnetin e Tij, nëse dëshirojmë të bekojmë jetën e familjes dhe bashkëqenieve tona – ne nuk do të lihem të ecim të vetëm. Sikurse na ka kujtuar shpesh Presidenti Monson: “Kur jemi në punën e Zotit, na është dhënë e drejta të kemi ndihmën e Zotit”².

Ati juaj Qiellor “do të shkoj[ë] përpara fytyrës suaj. [Ai] do të [jetë] në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti [i Tij] do të jetë në zemrat tuaja e engjëjt e [Tij] përreth jush, për t’ju ngritur lart.”³

Fuqia e Të Bërit

Vëllezërit e mi të dashur, bekimet hyjnore për shërbimin e priftërisë vihen në veprim nga përpjekjet tona të zellshme, gatishmëria jonë për të sakrifikuar dhe dëshira jonë për të bërë atë që është e drejtë. Le të jemi ata që veprojmë dhe të mos detyrohemi të veprojmë. Predikimi është i mirë, por predikimet që nuk të çojnë në veprim, janë si zjarret pa nxehtësi ose uji që nuk mund ta shuajë etjen.

Kur ne e zbatojmë doktrinën, fuqia shenjtëruese e ungjillit ka një ndikim më të madh dhe fuqia e priftërisë na mbush me entuziazëm.

Tomas Edisoni, njeriu që shpiku dritën elektrike, tha se “një ide është e vlefshme vetëm kur përdoret”⁴. Në një mënyrë të ngjashme, doktrina e ungjillit bëhet më e çmuar kur vihet në zbatim.

Ne nuk duhet t’i lejojmë doktrinat e priftërisë të mbeten të plogështa në zemrat tona dhe të pazbatuara në jetën tonë. Nëse ka ndonjë martesë ose familje në nevojë për shpëtim – ndoshta edhe vetë martesë ose familja jonë – le të mos presim dhe të shohim. Përkundrazi, le ta falënderojmë Perëndinë për planin e lumturisë që përfshin besimin, pendimin, faljen dhe fillimet e reja. Zbatimi i doktrinës së priftërisë do të na kualifikojë si bashkëshortë, baballarë dhe bij që e kuptojnë *arsyen dhe qëllimin* e priftërisë dhe fuqinë e saj për të rikrijuar dhe ruajtur bukurinë e shenjtërinë e familjeve të përjetshme.

Konferenca e përgjithshme është gjithmonë koha e duhur edhe për të dëgjuar edhe për të vepruar. Si rrjedhojë, le të “bëh[emi] bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues”⁵. Vëllezër, unë ju ftoj t’i mendoni fjalët e thëna nga shërbëtorët e Perëndisë këtë fundjavë. Më pas gjunjëzohuni. Kërkojini Perëndisë, Atit tonë Qiellor, t’ju ndriçojë mendjen dhe t’ju prekë zemrën. Lutjuni Perëndisë për drejtim në jetën e përditshme, në përgjegjësitë tuaja në Kishë dhe në sfidat tuaja të veçanta në këtë kohë. Ndiqini nxitjet e Shpirtit – mos u vononi. Nëse i bëni të gjitha këto, unë ju premtoj se Zoti nuk do t’ju lërë të punoni vetëm.

Vazhdoni me Durim

Ne e dimë se pavarësisht qëllimeve tona më të mira, gjërat jo gjithmonë shkojnë sipas planit. Ne bëjmë gabime në jetë dhe në shërbimin tonë të priftërisë. Me raste ne pengohemi dhe privohemi.

Kur Zoti na këshillon të “vazhdo[jmë] me durim derisa të përsose[mi]”⁶, Ai është i vetëdijshëm se kjo kërkon kohë dhe këmbëngulje. Të kuptuarit e *arsyeve dhe qëllimeve* pse e jetojmë ungjillin dhe e *arsyeve dhe qëllimeve* pse e kemi dhe e përdorim priftërinë do të na ndihmojë ta shohim qëllimin hyjnor të të gjithë kësaj. Kjo do të na japë shtysë dhe forcë për të bërë gjërat e

duhura, madje edhe kur ato janë të vështira. Të qenit të përqendruar mbi parimet themelore të të jetuarit të ungjillit do të na bekojë me qartësi, urtësi dhe drejtim.

“A nuk do të vazhdojmë në një kauzë kaq të madhe?”⁷ Po, vëllezër, do të vazhdojmë!

Të drejtuar nga Shpirti i Shenjtë, ne do të mësojmë nga gabimet tona. Nëse pengohemi, do të ngrihem. Nëse lëkundemi, ne do të vazhdojmë përpara. Ne kurrë nuk do të ngurrojmë; kurrë nuk do të heqim dorë.

Si një vëllazëri e fuqishme e priftërisë së përjetshme të Perëndisë, ne do të qëndrojmë së bashku, krah për krah, të përqendruar mbi parimet e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit dhe duke u shërbyer me mirënjohje Perëndisë dhe bashkëqenieve tona me përkushtim e dashuri.

Perëndia Jeton!

Vëllezërit e mi të dashur, unë ju dëshmoj këtë ditë se Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, jetojnë. Ata janë të vërtetë! Ata janë atje!

Ju nuk jeni vetëm. Ati juaj në Qiell kujdeset për ju dhe dëshiron t’ju bekojë dhe t’ju përkrahë në drejtësi.

Jini të sigurt se Perëndia i flet njerëzimit në kohën tonë. Ai do t’ju flasë juve!

Profeti Jozef Smith pa atë që tha se pa. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme u rivendos në tokë me anë të fuqisë dhe autoritetit të Perëndisë së Plotfuqishëm.

Lutja ime është që, si mbajtës të priftërisë së Tij, ne të punojmë gjithnjë në harmoni me *arsyen dhe qëllimin* e shërbimit të priftërisë, si dhe t’i përdorim parimet e ungjillit të rivendosur për të ndryshuar jetën tonë dhe jetën e atyre të cilëve u shërbejmë.

Ndërsa bëjmë kështu, fuqia e pamasë e Shlyerjes do t’i pastrojë, lëmojë dhe do t’i gdhendë shpirtat dhe karakteret tona derisa të bëhemi burrat që jemi paracaktuar të bëhemi. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Mateu 7:18.
2. Tomas S. Monson, “Të Mësojmë, Të Bëjmë, Të Jemi”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 62.
3. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
4. Thomas Edison, në Elbert Hubbard, *Little Journeys to the*

- Homes of Good Men and Great, Libri 2*
(1910), f. 155.
5. Jakobi [Bibla] 1:22.
6. Doktrina e Besëlidhje 67:13.
7. Doktrina e Besëlidhje 128:22.

Familje që Kanë Bërë Besëlidhje

Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

*Nuk ka asgjë që ka ardhur apo do të vijë në familjen
tuaj, aq të rëndësishme sa bekimet e vulosjes.*

E vlerësoj mbledhjen këtu me ju në këtë takim, në të cilin janë të ftuar të gjithë mbajtësit e priftërisë së Perëndisë në tokë. Ne jemi të bekuar që kryesohemi nga Presidenti Tomas S. Monson. Si President i Kishës, ai është i vetmi burrë i gjallë që mban përgjegjësi për çelësat që vulosin familjet dhe të gjitha ato ordianca priftërie të nevojshme për të marrë jetën e përjetshme, më të madhen e të gjitha dhuratave të Perëndisë.

Është një baba që po dëgjon sonte, i cili është kthyer nga të qenit joaktiv pasi e dëshiron me gjithë zemër sigurinë e vulosjes. Ai dhe bashkëshortja e tij i duan dy fëmijët e tyre të vegjël. Ashtu si prindërit e tjerë, ai mund ta përfytyrojë lumturinë qiellore ndërsa lexon këto fjalë: “Dhe po ai shoqërim që ekziston mes nesh këtu, do të ekzistojë mes nesh atje, veçse do të jetë me lavdi të përjetshme, lavdi të cilën nuk e gëzojmë tani”¹.

Ai baba që po dëgjon bashkë me ne sonte, e njih shtegun për tek ai drejtim i lavdishëm. Nuk është e lehtë. Ai tashmë e di këtë. Kërkohej besim në Jezu Krisht, pendim i thellë dhe një ndryshim në zemrën e tij që erdhi me një peshkop të mirë, që e ndihmoi atë të ndiente faljen e përzemërt të Zotit.

Ndryshime të mrekullueshme vazhduan kur ai shkoi në tempullin e shenjtë për një indaument që Zoti ua përshkroi atyre që Ai i fuqizoi në tempullin e parë, në këtë periudhë ungjillore. Ndodhi në Kirtland të Ohajos. Zoti tha rreth kësaj:

“Prandaj, për këtë shkak unë ju jap urdhërimin që ju duhet të shkoni në Ohio; dhe atje do t’ju jap ligjin tim; dhe atje do t’ju dhurohet fuqi nga lart;

Dhe që atje, . . . sepse unë kam një punë të madhërishtme të vendosur në ruajtje, sepse Izraeli do të shpëtohet e unë do t’i udhëheq ata kudo që dua dhe asnjë pushtet s’mund ta durojë dorën time”².

Për mikun tim të kthyer në aktivitetet së fundmi dhe për të gjithë mbajtësit e priftërisë, një punë e madhe ende për t’u bërë është të udhëheqim drejt shpëtimit pjesën e Izraelit për të cilën jemi ose do të jemi përgjegjës, që është familja. Ai e dinte se që të shpëtohej familja, duhet të vulosej me anë të fuqisë së Priftërisë Melkizedeke në një tempull të shenjtë të Perëndisë.

Ai kërkoi që ta kryeja unë vulosjen. Ai dhe bashkëshortja e tij, dëshironin që të bëhej sa më shpejt të ishte e mundur. Me kohën e ngarkuar të afrimit të konferencës së përgjithshme, ia lashë çiftit dhe peshkopit të tyre që të flisnin me sekretaren time për të gjetur datën më të mirë.

Përfytyroni habinë dhe kënaqësinë time kur babai më tha se vulosja ishte vendosur për në datën 3 prill. Ajo që dita në vitin 1836 kur Elia, profeti i marrë në qiell, u dërgua në Tempullin e Kirtlandit për t’u dhënë fuqinë vulosëse Jozef Smithit dhe Oliver Kaudrit. Ata çelësa ndodhen në Kishë sot dhe do të vazhdojnë të jenë deri në mbarim të kohës.³

Është po i njëjti autorizim hyjnor i dhënë Pjetrit nga Zoti ndërsa Ai pati premtuar: “Dhe unë do të të jap çelësat e mbretërisë së qiejve; gjithçka që të kesh lidhur mbi tokë, do të jetë lidhur në qiej, dhe gjithçka që të kesh zgjidhur mbi tokë, do të jetë zgjidhur në qiej”⁴.

Kthimi i Elias i bekoj të gjithë ata që mbajnë priftërinë. Plaku Harold B. Li e bëri atë të qartë ndërsa foli në konferencën e përgjithshme, duke cituar Presidentin Jozef Filding Smith. Dëgjoni me vëmendje: “Unë mbaj priftërinë; ju vëllezër këtu mbani priftërinë; ne kemi marrë Priftërinë Melkizedeke – që u mbajt nga Elia dhe nga profetë të tjerë dhe nga Pjetri, Jakobi dhe Gjoni. Por megjithëse kemi autoritet për të pagëzuar, megjithëse kemi autoritetin për të vendosur duart për dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe për të shuguruar të tjerët, dhe për t’i bërë të gjitha

këto gjëra, pa fuqinë vulosëse ne nuk do të mund të bënim asgjë, pasi nuk do të kishte vlefshmëri për ato ordinanca që kryem.”

Presidenti Smith vazhdoi:

“Ordinancat më të larta, bekimet më të mëdha që janë thelbësore për ekzaltimin në mbretërinë e Perëndisë dhe që mund të merren vetëm në vende të caktuara, asnjë burrë nuk e ka të drejtën për t’i kryer, po të mos e marrë autoritetin për ta bërë atë nga burri që mban çelësat. . . .

. . . Nuk ka asnjë burrë mbi faqen e dheut që ka të drejtën të shkojë përpara dhe të administrojë në ndonjërin prej këtyre ordinancave të këtij ungjilli, përveç në se Presidenti i Kishës, që mban çelësat, të japë miratimin. Ai na ka dhënë autoritet; ai e ka vendosur fuqinë vulosëse në priftërinë tonë sepse ai i mban ato çelësa.”⁵

E njëjta siguri erdhi nga Presidenti Boyd K. Paker ndërsa shkroi për fuqinë vulosëse. Të di se këto fjalë janë të vërteta është një ngushëllim për mua, ashtu siç do të jetë për familjen që do të vulos më 3 prill: “Pjetri duhet t’i mbante çelësat. Pjetri duhet ta mbante fuqinë vulosëse, . . . për të lidhur ose për të vulosur në tokë ose për të zgjidhur në tokë dhe do të ishte kështu në qiej. Këta çelësa i përkasin Presidentit të Kishës – profetit, shikuesit dhe zbuluesit. Ajo fuqi e shenjtë vulosëse është me Kishën tani. Asgjë nuk konsiderohet me meditim më të shenjtë nga ata që e dinë domethënien e këtij autoriteti. Asgjë nuk mbahet më pranë. Ka relativisht pak burra të cilëve iu është deleguar kjo fuqi vulosëse në tokë në çfarëdo kohe të dhënë – në çdo tempull ka vëllezër të cilëve iu është dhënë fuqia vulosëse. Asnjë nuk mund ta marrë atë përveçse nga profeti, shikuesi e zbuluesi dhe Presidenti i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.”⁶

Kur erdhi Elia jo vetëm që iu dha fuqia priftërisë, por kishte edhe zemra për t’u kthyer: “Shpirti, fuqia dhe thirrja e Elias është që ju keni fuqi të mbani çelësin e zbulesës, ordinancave, orakujve, fuqive dhe indaumenteve të plotësisë së Priftërisë Melkizedeke dhe të mbretërisë së Perëndisë në tokë; dhe për të marrë, siguruar dhe kryer të gjitha ordinancat që i përkasin mbretërisë së Perëndisë, madje në kthimin e zemrave të etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit, madje atyre që janë në qiell”⁷.

Ajo ndjenjë e kthimit të zemrës së tij, i ka ardhur tashmë mikut tim dhe familjes së tij. Mund t'ju ketë ardhur juve në këtë mbledhje. Ju mund ta keni përfytyruar në mendjen tuaj, ashtu siç kam bërë unë, fytyrën e babait apo nënës suaj. Fytyra mund të ketë qenë e një motre apo vëllai. Mund të ketë qenë e një bije apo biri.

Njeriu që përfytyruat, mund të jetë në botën e shpirtave ose kontinente larg jush. Por gëzimi erdhi nga një ndjesi se lidhjet me ta janë të sigurta sepse ju jeni ose mund të bëheni të lidhur me ta, me anë të ordinancave të priftërisë që Perëndia do t'i respektojë.

Mbajtësve të Priftërisë Melkizedeke që janë etër në familjet e vulosura, u është mësuar se çfarë duhet të bëjnë. Nuk ka asgjë që ka ardhur apo do të vijë në familjen tuaj, aq të rëndësishme sa bekimet e vulosjes. Nuk ka asgjë më të rëndësishme se nderimi i besëlidhjeve të martesës e familjes që ju bëtë ose do të bëni në tempujt e Perëndisë.

Mënyra për ta bërë atë është e qartë. Shpirti i Shenjtë i Premtimit, nëpërmjet bindjes dhe sakrificës sonë, duhet t'i vulosë besëlidhjet tona të tempullit në mënyrë që të merren në botën që do të vijë. Presidenti Harold B. Li shpjegoi se çfarë do të thotë të vulosesh me anë të Shpirtit të Shenjtë të Premtimit, duke cituar Plakun Melvin J. Ballard: "Ne mund t'i mashtrojmë njerëzit, por nuk mund ta mashtrojmë Frymën e Shenjtë dhe bekimet tona nuk do të jenë të përgjeshme, po të mos jenë vulosur gjithashtu nga Shpirti i Shenjtë i premtimit. Fryma e Shenjtë është ai që i lexon mendimet dhe zemrat e njerëzve dhe u jep miratimin e tij vulosës bekimeve të shqiptuara mbi kokat e tyre. Atëherë vulosja është e detyrueshme, e efektshme dhe plotësisht e vlefshme."⁸

Kur Motra Ajring dhe unë u vulosëm në Tempullin e Loganit, nuk e kuptova atëherë domethënien e plotë të atij premtimi. Unë ende po përpiqem që të kuptoj gjithë domethënien e tij, por bashkëshortja ime dhe unë vendosëm në fillim të pothuaj 50 viteve të martesës sonë, që ta ftonim sa më shumë të mundeshim Frymën e Shenjtë në jetën tonë dhe në familjen tonë.

Kur isha baba i ri, i vulosur në tempull dhe me zemrën time të kthyer ndaj bashkëshortes sime dhe një familjeje të re, takova Presidentin Jozef Filding Smith për herë të parë. Në dhomën e këshillit të Presidencës së Parë, ku isha ftuar, më erdhi një dëshmi

tërësisht e sigurt ndërsa Presidenti Harold B. Li më pyeti mua, duke treguar me gisht për nga Presidenti Smith: “A e besoni ti se ky burrë mund të jetë Profeti i Perëndisë?”

Presidenti Smith sapo ishte futur në dhomë dhe nuk kishte thënë ende asnjë fjalë. Unë jam përjetësisht mirënjohës që qeshë në gjendje të përgjigjesha me vendosmëri: “E di se ai është” dhe e dija me aq siguri siç e dija se dielli po ndriçonte, që ai mbante fuqinë vulosëse të priftërisë për të gjithë tokën.

Ajo përvojë u dha fjalëve të Presidentit Smith një fuqi të madhe për mua dhe bashkëshorten time kur, në një sesion konference më 6 prill 1972, Presidenti Jozef Filding Smith dha këshillën vijuese: “Është vullneti i Zotit që të forcohet dhe të ruhet njësia familjare. Ne u lutemi etërve që të marrin vendin që u takon si kreu i shtëpisë. Ne u kërkojmë nënave që t’i mbështesin dhe t’i përkrahin bashkëshortët e tyre dhe të jenë shembuj për fëmijët e tyre.”⁹

Më lini t’ju sugjeroj katër gjëra që mund të bëni si një baba me priftëri, për ta lartësuar dhe udhëhequr familjen tuaj për t’u kthyer sërish në shtëpi me Atin Qiellor dhe Shpëtimtarin.

Së pari, fitoni dhe mbani një dëshmi të sigurt se çelësat e priftërisë janë me ne dhe mbahen nga Presidenti i Kishës. Lutuni për atë çdo ditë. Përgjigjja do të vijë me një shtim të vendosmërisë për ta udhëhequr familjen tuaj, shtim të ndjenjave tuaja të shpresës dhe me lumturi më të madhe në shërbimin tuaj. Ju do të jeni më të gëzuar dhe më optimistë, një bekim i madh për bashkëshorten dhe familjen tuaj.

Kërkesa e dytë është ta doni bashkëshorten tuaj. Do të duhet besim dhe përlulësi që t’i vini interesat e saj mbi tuajat në mundimet e jetës. Ju keni përgjegjësinë për të siguruar dhe për ta edukuar familjen me të ndërkohë që u shërbeni të tjerëve. Ndonjëherë, ajo mund t’jua harxhojë të gjithë energjinë dhe forcën që keni. Moshë dhe sëmundja mund t’i shtojnë nevojat e bashkëshortes suaj. Nëse do të zgjidhni edhe atëherë që ta vinit lumturinë e saj mbi tuajën, ju premtoj se dashuria e saj për ju do të rritet.

Së treti, kërkonin ndihmë nga e gjithë familja që ta doni njëri-tjetrin. Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim:

“Duke marrë parasysh përjetësinë, shpëtimi është një përgjegjësi familjare. . . .

Mbi gjithçka tjetër, fëmijët kanë nevojë të dinë dhe të ndiejnë se i duan, i mirëpresin dhe i vlerësojnë. Ata kanë nevojë që të sigurohen për këtë shpesh. Natyrisht, ky është një rol që prindërit duhet ta përmbushin dhe, më shpesh, nëna mund ta bëjë këtë më së miri.”¹⁰

Një burim thelbësor për atë ndjesi që të duan është dashuria nga fëmijët e tjerë në familje. Përkujdesja e vazhdueshme e vëllezërve dhe motrave për njëri-tjetrin do të vijë vetëm me përpjekjen ngulmuese të prindërve dhe me ndihmën e Perëndisë. Ju e dini se ajo është e vërtetë nga përvoja në vetë familjet tuaja. Dhe ajo vërtetohet sa herë që ju lexoni për përplasjet familjare të përjetuara nga Lehi i drejtë dhe gruaja e tij Saria, në analin e Librit të Mormonit.

Sukseset që ata arritën, na sigurojnë neve një udhëzues. Ata ua mësuam ungjillin e Jezu Krishtit kaq mirë dhe kaq me ngulmim, sa që fëmijëve dhe madje disa pasardhësve ndër breza iu zbut zemra kundrejt Perëndisë dhe njëri-tjetrit. Për shembull, Nefi dhe të tjerë u shkruan dhe i ndihmuan pjesëtarët e familjes që kishin qenë armiqtë e tyre. Shpirti ndonjëherë i zbuti zemrat e mijëra vetëve dhe e zëvendësoi urrejtjen me dashurinë.

Një mënyrë se si ju mund t’i imitoni sukseset e Baba Lehit është nga mënyra se si i drejtoni lutjet familjare dhe kohën për familjen, të tilla si mbrëmjet familjare në shtëpi. Jepuni fëmijëve mundësi për t’u lutur kur ata mund të luten për të tjerët në rrethin që ka nevojë për bekime. Dallojini shpejt fillimet e mosmarrëveshjeve dhe vërinë në dukje veprat e shërbimit vetmohues, veçanërisht ndaj motrave e vëllezërve. Kur ata luten për njëri-tjetrin dhe i shërbejnë njëri-tjetrit, zemrat do të zbuten dhe do të kthehen te njëri-tjetri dhe te prindërit e tyre.

Mundësia e katërt për ta udhëhequr familjen tuaj në udhën e Zotit, vjen kur nevojitet disiplina. Ne mund ta përmbushim detyrimin tonë për t’i korrigjuar në mënyrën e Zotit dhe për t’i udhëhequr ata drejt jetës së përjetshme.

Ju do t’i mbani mend fjalët, por ndoshta mund të mos e keni parë fuqinë e tyre në jetën e një mbajtësi të Priftërisë Melkizedeke që po e përgatit familjen e tij për të jetuar në të njëjtat

marrëdhënie që do të kenë në mbretërinë çelestiale: Ju i mbani mend fjalët. Ato janë kaq të njohura:

“Asnjë fuqi apo ndikim nuk mund ose nuk duhet të mbahet me anë të priftërisë, veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur;

Nëpërmjet mirësisë dhe diturisë së pastër, të cilat do ta zgjerojnë shumë shpirtin, pa hipokrizi dhe pa mashtrim –

Duke qortuar në kohën e duhur me mprehtësi, kur u nixte nga Fryma e Shenjtë; dhe atëherë duke treguar më pas rritje të dashurisë ndaj atij që e ke qortuar, që ai të mos të të vlerësojë si armikun e tij;

Që ai të mund ta dijë se besnikëria jote është më e fortë se zinxhirët e vdekjes.”¹¹

Dhe më vonë vjen premtimi me vlerë të madhe për ne si etër në Sion: “Fryma e Shenjtë do të jetë shoqëruesi yt i vazhdueshëm dhe skeptri yt një skeptër i pandryshueshëm i drejtësisë dhe së vërtetës; dhe sundimi yt do të jetë një sundim i përjetshëm dhe, pa mënyra detyruese, ai do të rrjedhë tek ty përherë e përgjithmonë”¹².

Ai është një standard i lartë për ne por, kur i kontrollojmë me besim inatet tona dhe e mposhtim krenarinë tonë, Fryma e Shenjtë jep miratimin e Tij dhe premtimet e besëlidhjet e shenjta bëhen të sigurta.

Ju do t’ia dilni mbanë nëpërmjet besimit se Zoti i dërgoi sërish çelësat e priftërisë, që janë ende me ne – me një lidhje të sigurt dashurie me bashkëshorten tuaj, me ndihmën e Zotit në kthimin e zemrave të fëmijëve tuaj te njëri-tjetri dhe te prindërit në dashuri dhe duke ju udhëzuar me dashuri që të korrighoni dhe të paralajmëroni në një mënyrë që fton Shpirtin.

Unë e di që Jezusi është Krishti dhe Shpëtimtari ynë. Unë dëshmoj se Presidenti Tomas S. Monson, të cilin do ta dëgjomë tani, mban dhe ushtron të gjithë çelësat e priftërisë në tokë sot. Unë e dua dhe e mbështes atë. Ju dua dhe lutem për ju. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Doktrina e Besëlidhje 130:2.
2. Doktrina e Besëlidhje 38:32–33.
3. Shih Joseph Fielding Smith, *Sealing Power and Salvation*, Brigham

- Young University Speeches of the Year (12 janar 1971), speeches.byu.edu.
4. Mateu 16:19.
 5. Joseph Fielding Smith, cituar nga Harold B. Lee, në Conference Report, tetor 1944, f. 75.
 6. Bojd K. Paker, "Tempulli i Shenjtë", *Liahona*, tetor 2010, f. 34.
 7. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 331.
 8. Melvin J. Ballard, cituar nga Harold B. Lee, në Conference Report, tetor 1970, f. 111.
 9. Joseph Fielding Smith, "Counsel to the Saints and to the World", *Ensign*, korrik 1972, f. 27.
 10. Ezra Taft Benson, "Salvation—a Family Affair", *Liahona*, nëntor 1992, f. 3, 4.
 11. Doktrina e Besëlidhje 121:41–44.
 12. Doktrina e Besëlidhje 121:46.

Të Gatshëm dhe të Denjë për të Shërbyer

Nga Presidenti Tomas S. Monson

Mrekullitë gjenden gjithkund kur priftëria kuptohet, kur fuqia e saj nderohet e përdoret siç duhet dhe besimi shfaqet.

Vëllezër të mi të dashur, sa mirë është që takohem me ju edhe një herë. Kurdoherë që jam i pranishëm në mbledhjen e përgjithshme të priftërisë, meditoj rreth mësimëve të disa prej udhëheqësve më fisnikë të Perëndisë që kanë folur në mbledhjet e përgjithshme të priftërisë së Kishës. Shumë kanë ndërruar jetë dhe prapëseprapë na kanë dhënë drejtim të frymëzuar nga mendjet e tyre të ndritshme, nga thellësitë e shpirtave të tyre dhe nga ngrohtësia e zemrave të tyre. Sonte, do të ndaj me ju disa prej mësimëve lidhur me priftërinë.

Nga Profeti Jozef Smith: “Priftëria është një parim i përjetshëm dhe ekzistonte me Perëndinë që nga përjetësia, dhe do të ekzistojë në përjetësi, pa fillim të ditëve ose fund të viteve”¹.

Nga fjalët e Presidentit Uillford Udraf mësojmë: “Priftëria e Shenjtë është udha përmes së cilës Perëndia komunikon dhe merret me njeriun në tokë; dhe lajmëtarët qiellorë që kanë vizituar tokën për të komunikuar me njeriun, janë njerëz që e kishin dhe e nderuan priftërinë ndërsa qenë në mish; dhe gjithçka që Perëndia ka bërë të ndodhë për shpëtimin e njeriut, që nga ardhja e njeriut mbi tokë deri në shëlbimin e botës, ka qenë dhe do të jetë përmes virtytit të priftërisë së përjetshme”².

Presidenti Jozef F. Smith ka shpjeguar më tej: “Priftëria . . . është . . . fuqia e Perëndisë dhënë njeriut përmes së cilës njeriu

mund të veprojë në tokë për shpëtimin e familjes njerëzore, në emrin e Atit dhe të Birit dhe të Frymës së Shenjtë, dhe të veprojë arsyeshëm; duke mos supozuar se e ka atë autoritet, duke mos e marrë hua nga brezat që kanë ndërruar jetë dhe kanë ikur, por autoritet që i është dhënë në këtë kohë në të cilën ne jetojmë përmes shërbesës së engjëjve dhe shpirtave nga lart, *drejtpërdrejt nga prania e Perëndisë së Plotfuqishëm*³.

Dhe përfundimisht nga Presidenti Xhon Tejlor: “Çfarë është priftëria? . . . Ajo është qeverisja e Perëndisë, qoftë në tokë ose në qiej, pasi është nëpërmjet asaj fuqie, lirie zgjedhjeje apo atij parimi që të gjitha gjërat qeverisen në tokë dhe në qiej, dhe me anë të asaj fuqie të gjitha gjërat përkrahen dhe mbahen. Ajo i qeveris të gjitha gjërat – ajo i drejton të gjitha gjërat – ajo i mbështet të gjitha gjërat – dhe ka të bëjë me të gjitha gjërat me të cilat lidhet Perëndia dhe e vërteta.”⁴

Jemi shumë të bekuar që jemi këtu në këto ditë të fundit, kur priftëria e Perëndisë është në tokë. Jemi shumë të privilegjuar që e mbajmë këtë priftëri. Priftëria është më shumë porosi për të shërbyer sesa dhuratë, privilegj për të ngritur shpirtërisht dhe mundësi për të bekuar jetën e të tjerëve.

Nga këto mundësi vijnë përgjegjësitë dhe detyrat. Më pëlqen dhe e dua fort fjalën fisnike *detyrë* dhe gjithçka që ajo të lë të kuptosh.

Në një detyrë apo në një tjetër, në një mjedis apo në një tjetër, kam qenë i pranishëm në mbledhjet e priftërisë për 72 vitet e fundit – që kur u shugurova dhjak në moshën 12 vjeçare. Koha me siguri ecën. Detyra jonë rritet me të njëjtën masë që ecën koha. Detyra nuk zbehet as nuk zvogëlohet. Konflike shkatërrimtare vijnë e shkojnë, por lufta që zhvillohet për shpirtat e njerëzve vazhdon pambarim. Si një thirrje e mprehtë vjen fjala e Zotit për ju, për mua dhe për mbajtësit e priftërisë kudo: “Si rrjedhim, tani çdo njeri duhet ta mësojë *detyrën* e tij dhe të veprojë në thirrjen që është caktuar, gjithë zell”⁵.

Thirrja e detyrës i erdhi Adamit, Noeut, Abrahamit, Moisiut, Samuelit, Davidit. Ajo i erdhi Profetit Jozef Smith dhe secilit prej pasuesve të tij. Thirrja e detyrës i erdhi djaloshit Nefi kur u udhëzua nga Zoti, përmes të atit, Lehit, për t’u kthyer në Jerusalem me vëllezërit e tij që t’i merrte fletët prej tunxhi

Labanit. Vëllezërit e Nefit mërmëritën, duke thënë se ishte një gjë e vështirë ajo që u ishte kërkuar atyre. Cila ishte përgjigjja e Nefit? Ai tha: “Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar, pasi e di se Zoti nuk u jep urdhërimet fëmijëve të njerëzve pa përgatitur një udhë për ta, që ata të mund të plotësojnë gjënë, që ai i urdhëron”⁶.

Kur e njëjta thirrje vjen tek unë dhe tek ju, cila do të ishte përgjigjja jonë? A do të mërmërisim, sikurse veproi Lamani dhe Lemueli dhe të themi: “Kjo është një gjë e vështirë që na kërkohet”? Apo, me Nefin, do të shpallnim individualisht: “Unë do të shkoj. Unë do të bëj.” A do të jemi të gatshëm të shërbejmë dhe të bindemi?

Ndonjëherë urtësia e Perëndisë shfaqet si të jetë e marrë ose thjesht shumë e vështirë, por një nga mësimet më të mrekullueshme dhe më të vlefshme që mund të mësojmë në vdekshmëri është se, kur Perëndia flet dhe njeriu bindet, ai njeri do të ketë gjithmonë të drejtë.

Kur mendoj për fjalën *detyrë* dhe se si përmbushja e detyrës mund të pasurojë jetën tonë dhe jetën e të tjerëve, unë rikujtoj fjalët e shkruara nga një poet dhe krijues i famshëm:

*Fjeta dhe ëndërrova
Se jeta qe gëzim;
U zgjova dhe pashë
Se jeta qe detyrë
Veprua dhe vura re se
Detyra ishte gëzim.*⁸

Robert Luis Stivensoni e shprehu në një mënyrë tjetër. Ai tha: “E di se çfarë është kënaqësia, pasi kam bërë punë të mirë”⁹.

Ndërkohë që përmbushim detyrat tona dhe ushtrojmë priftërinë tonë, do të gjejmë gëzim të vërtetë. Ne do të përjetojmë kënaqësinë e të përmbushurit të detyrave tona.

Neve na janë mësuar detyra të posaçme për priftërinë që mbajmë, qoftë nëse mbajmë Priftërinë Aarone apo Priftërinë Melkizedeke. Unë ju nxis të mendoni për këto detyra dhe më pas të bëni gjithçka brenda fuqisë suaj për t’i realizuar ato. Për ta bërë këtë, secili prej nesh duhet të jetë i denjë. Le të kemi duar të shkathëta, duar të pastra dhe duar të gatshme, që të mund të

marrim pjesë në sigurimin e asaj që Ati ynë Qiellor do të donte që të tjerët të merrnin prej Tij. Nëse nuk jemi të denjë, ka mundësi të humbasim fuqinë e priftërisë dhe; nëse e humbasim atë, do të humbasim atë që është e nevojshme për ekzaltimin tonë. Le të jemi të denjë për të shërbyer.

Presidenti Harold B. Li, një nga mësuesit e mrekullueshëm në Kishë, tha: “Kur dikush bëhet mbajtës i priftërisë, ai bëhet vetëveprues para Zotit. Ai duhet ta konsiderojë thirrjen e tij sikur të ishte në punën e Zotit.”¹⁰

Gjatë Luftës II Botërore, në pjesën e parë të vitit 1944, një përvojë që përfshiu priftërinë, ndodhi ndërsa flota e Shteteve të Bashkuara po sulmonte për të pushtuar dhe zotëruar Kvajalein Atollin, pjesë e ishujve Marshall dhe që lokalizohej në Oqeanin Paqësor, diku në mes të rrugës mes Australisë dhe Havait. Ajo që ndodhi në këtë histori, u tregua nga një korrespondent – jo anëtar i Kishës – që punonte për një gazetë në Havai. Në artikullin e gazetës së vitit 1944 që shkroi pas përvojës, ai shpjegoi se ai dhe korrespondentë të tjerë ishin pjesë e grupit të dytë që ndiqte flotën në Kvajalein Atoll. Ndërsa bënë përpara, vunë re një marinar të ri duke qëndruar pezull me fytyrë poshtë në ujë, qartësisht i plagosur rëndë. Uji i cekët përreth tij ishte bërë i kuq nga gjaku. Dhe më pas, vunë re një marinar tjetër që po shkonte në drejtim të shokut të tij të plagosur. Marinari i dytë ishte gjithashtu i plagosur, me krahun e majtë që i varej pafuqishëm në anë. Ai ngrii lart kokën e atij që po qëndronte pezull në ujë në mënyrë që ta ruante nga mbytja. Me një zë të tmerruar bëri thirrje për ndihmë. Korrespondentët e panë përsëri djalin që po mbante dhe i thanë: “Bir, askush nuk mund të bëjë asgjë për këtë djalë”.

“Më pas”, shkroi korrespondenti, “unë pashë diçka që nuk e kisha parë kurrë më parë.” Ky djalë, i plagosur vetë keqas, shkoi te bregu me trupin në dukje të pajetë të shokut të vet marinar. Ai “e vuri kokën e shokut të tij mbi gju. . . Çfarë pamje e habitshme që qe – këta dy djem të plagosur për vdekje – të dy . . . të rinj të dëlirë, të pashëm, edhe në situatën e tyre të vështirë. Dhe njëri djalë përkuli kokën e tij pranë tjetrit dhe tha: ‘Unë të urdhëroj ty, në emrin e Jezu Krishtit dhe nëpërmjet fuqisë së priftërisë, të qëndrosh i gjallë derisa të marr ndihmë mjekësore’.”

Korrespondenti e përfundoi artikullin e tij: “Të tre ne, [të dy

marinarët dhe unë], jemi këtu në spital. Doktorët nuk e dinë [se si ata mbërritën të gjallë], por unë e di.”¹¹

Mrekullitë gjenden gjithkund kur priftëria kuptohet, kur fuqia e saj nderohet e përdoret siç duhet dhe besimi shfaqet. Kur besimi zëvendëson dyshimin, kur shërbimi vetëmohues zhduk përpjekjen egoiste, fuqia e Perëndisë i përmbush qëllimet e Tij.

Thirrja e detyrës mund të vijë qetësisht, ndërsa ne që mbajmë priftërinë u përgjigjemi punëve që na jepen. Presidenti Xhorxh Albert Smith, ai udhëheqës modest por efikas deklaroi: “Së pari është detyra juaj të mësoni atë që dëshiron Zoti dhe pastaj, me anë të fuqisë dhe forcës së Priftërisë së Tij të shenjtë, ta lartësoni [në mënyrë të tillë] thirrjen tuaj në prani të shokëve tuaj . . . që njerëzit të jenë të gëzuar t’ju ndjekin ju”¹².

Një thirrje e tillë e detyrës – një thirrje shumë më pak dramatike, por që megjithatë ndihmoi për të shpëtuar një shpirt – më erdhi në vitin 1950 kur isha peshkop i sapothirrur. Përgjegjësitë e mia si peshkop qenë të shumta e të ndryshme dhe unë u përpoqa me të gjitha aftësitë e mia që të bëja gjithçka që më kërkohet. Në atë kohë, Shtetet e Bashkuara qenë të përfshira në një tjetër luftë. Për shkak se shumë nga anëtarët tanë po shërbenin në shërbimet ushtarake, një detyrë erdhi nga selia e Kishës për të gjithë peshkopët, që t’i siguronin çdo ushtaraku një abonim në *Church News* dhe *Improvement Era*, në atë kohë gazeta të Kishës. Veç kësaj, secilit peshkop iu kërkua të shkruante një letër personale mujore për secilin ushtarak nga lagjja e tij. Lagjja jonë kishte 23 burra që po shërbenin në ushtri. Kuoromet e priftërisë, me përpjekje, siguruan fonde për abonimet në botime. E pranova punën, madje detyrën, për të shkruar 23 letra personale çdo muaj. Pas gjithë atyre viteve, ende i kam kopjet e shumë prej letrave dhe përgjigjeve të marra. Kur i rilexoj këto letra, është e lehtë që të më dalin lot. Është gëzim të mësosh sërish për premtimin e një ushtari për të jetuar ungjillin, vendimin e një marinari për të qëndruar besnik bashkë me familjen e vet.

Një mbrëmje, ia dorëzova një motre në lagje grumbullin me 23 letra për muajin e fundit. Detyra e saj ishte të merrej me postimin dhe të mirëmbante listën e adresave që ndryshonte vazhdimisht. Ajo i hodhi një shikim një zarfi dhe, me buzëqeshje,

pyeti: “Peshkop, a nuk shkurajoheni ndonjëherë? Ja dhe një letër tjetër për Vëllain Brisën. Kjo është letra e 17-të që i keni dërguar pa një përgjigje.”

Unë iu përgjigja: “Epo, ndoshta ky do të jetë muaji që do të më shkruajë”. Siç rezultoi, ai ishte muaji. Për herë të parë, ai iu përgjigj letres sime. Përgjigja e tij është një kujtim i dashur, një thesar. Ai po shërbente tepër larg, në një vend të thellë, të izoluar, i përmallur për shtëpinë, i vetëm. Ai shkroi: “I dashur Peshkop, unë nuk jam i mirë në të shkruar”. (Mund t’ia kisha thënë *këtë* shumë muaj më parë.) Letra e tij vijoi: “Faleminderit për *Church News* dhe gazetatat, por mbi të gjitha faleminderit për letrat personale. Kam hapur një faqe të re në jetën time. Jam shuguruar prift në Priftërinë Aarone. Zemra ime është plot me emocione. Jam një njeri i lumtur.”

Vëllai Brisën nuk ishte më i lumtur sesa ishte peshkopi i tij. Kam mësuar si ta zbatoj në jetën time fjalën e urtë: “Bë[ni] detyrën [tuaj]; kjo është më e mira; lërja Zotit të tjerat”¹³.

Vite më vonë, ndërsa isha i pranishëm në Kunjin e Kotonudit të Solt-Lejkut, kur Xhejms E. Faust shërbente si president i tij, e rrëfeva këtë histori në përpjekje për t’i nxitur njerëzit t’u kushtonin më tepër vëmendje ushtarakëve tanë. Pas mbledhjes, një i ri i pashëm doli përpara. Ma kapi dorën dhe tha: “Peshkop Monson, a më mban mend?”

Befas e kuptova se kush ishte. “Vëllai Brisën!” Thirra. “Si jeni? Çfarë po bëni në Kishë?”

Me ngrohtësi e krenari të dukshme, ai u përgjigj: “Jam mirë. Shërbej në presidencën e kuorumit të pleqve. Faleminderit sërish për interesimin tuaj për mua dhe letrat personale që më dërguat dhe që i çmoj.”

Vëllezër, bota është në nevojë për ndihmën tonë. A po bëjmë gjithçka që duhet? A i mbajmë mend fjalët e Presidentit Xhon Tejlor: “Nëse nuk i lartësoni thirrjet tuaja, Perëndia do t’ju mbajë përgjegjës për ata të cilët ju mund t’i kishit shpëtuar, nëse do të kishit bërë detyrën tuaj”¹⁴. Ka këmbë që ne mund t’i bëjmë të qëndrueshme, duar që mund t’i shtrëngojmë, mendje që mund t’i nxisim, zemra që mund t’i frymëzojmë dhe shpirtra që mund t’i shpëtojmë. Bekimet e përjetësisë ju presin juve. I juaji është privilegj për të mos qenë spektatorë, por pjesëmarrës në skenën e

shërbimit të priftërisë. Le t'ia vëmë veshin kujtuesit frymëzues që gjendet te letra e Jakobit: "Bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues, që gënjejnë vetveten"¹⁵.

Le ta mësojmë dhe kuptojmë detyrën tonë. Le të jemi të gatshëm dhe të denjë për të shërbyer. Le të ndjekim hapat e Mësuesit në përmbushjen e detyrës sonë. Ndërsa unë dhe ju ecim në shtegun ku eci Jezusi, do të zbulojmë se Ai është më shumë se foshnja në Bethlehem, më shumë se i biri i marangozit, më shumë se mësuesi më i madh që ka jetuar ndonjëherë. Ne do të arrijmë ta njohim Atë si Birin e Perëndisë, Shpëtimtarin tonë dhe Shëlbuesin tonë. Kur thirrja e detyrës i erdhi Atij, Ai u përgjigj: "Atë, vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë"¹⁶. Secili prej nesh veproftë kështu, unë lutem në emrin e Tij të shenjtë, në emrin e Jezu Krishtit, Zotit, amen.

Shënime

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 108.
2. *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f. 38.
3. Joseph F. Smith, *Gospel Doctrine*, bot. i 5-të (1939), f. 139–140; theksimi i shtuar.
4. *Teachings of Presidents of the Church: John Taylor* (2001), f. 119.
5. Doktrina e Besëlidhje 107:99; theksimi i shtuar.
6. 1 Nefi 3:7; shih edhe vargjet 1–5.
7. Shih 1 Nefi 3:5.
8. Rabindranath Tagore, në William Jay Jacobs, *Mother Teresa: Helping the Poor* (1991), f. 42.
9. Robert Louis Stevenson, në Elbert Hubbard II, përmbll., *The Note Book of Elbert Hubbard: Mottoes, Epigrams, Short Essays, Passages, Orphic Sayings and Preachments* (1927), f. 55.
10. *Stand Ye in Holy Places: Selected Sermons and Writings of President Harold B. Lee* (1976), f. 255.
11. Në Ernest Eberhard Jr., "Giving Our Young Men the Proper Priesthood Perspective", dorëshkrim, 19 korrik 1971, f. 4–5, Church History Library.
12. George Albert Smith, në Conference Report, prill 1942, f. 14.
13. Henry Wadsworth Longfellow, "The Legend Beautiful", në *The Complete Poetical Works of Longfellow* (1893), f. 258.
14. *Teachings: John Taylor*, f. 164.
15. Jakobit [Bibla] 1:22.
16. Moisiu 4:2.

Të Mëshirshmit Gjejnë Mëshirë

Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Kur zemrat tona janë të mbushura me dashurinë e Perëndisë, ne bëhemi “të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke falur”.

Vëllezër e motra të mia të dashura, jo shumë kohë më parë, mora një letër nga një nënë e shqetësuar, e cila lutej për një bisedë në konferencën e përgjithshme mbi një temë që do të ishte veçanërisht e dobishme për dy fëmijët e saj. Midis tyre që ngritur një mur emocional dhe ata kishin pushuar së foluri me njëri-tjetrin. Nënës i qe thyer zemra. Në letër, ajo më siguroi se një mesazh në konferencën e përgjithshme mbi këtë temë, do t'i pajtonte fëmijët e saj dhe gjithçka do të ishte mirë.

Lutja e sinqertë dhe e çiltër e kësaj motre të mirë, ishte vetëm një nga disa prej shtysave që kam marrë gjatë muajve të fundit se duhet të them disa fjalë sot mbi një temë që është një shqetësim në rritje – jo vetëm për një nënë të shqetësuar, por për shumë në Kishë dhe, sigurisht, në botë.

Më la mbresa besimi i kësaj nëne të dashur që një bisedë në konferencën e përgjithshme do të ndihmonte për të ndrequr marrëdhënien mes fëmijëve të saj. Jam i sigurt se siguria e saj nuk ishte aq shumë tek aftësitë e folësve por te “virtyti i fjalës së Perëndisë”, që ka një “ndikim më të fuqishëm mbi mendjet e njerëzve sesa . . . çdo gjë tjetër”¹. Motër e dashur, unë lutem që Shpirti do t'i prekë zemrat e fëmijëve të tu.

Kur Marrëdhëniet Prishen

Marrëdhëniet e tensionuara e të shkatërruara janë aq të vjetra sa njerëzimi vetë. Kaini i lashtë që i pari që i lejoi ndjenjat e hidhura dhe shpirtligësinë që ta mposhtnin dhe t'i dëmtonin emocionet. Ai i ndihmoi ndjenjat e zilisë dhe urrejtjes që të rriteshin brenda tij dhe i lejoi këto ndjenja që të piqueshin derisa ai bëri të papërfytyrueshmen – duke vrarë të vëllanë e vet e duke u bërë gjatë procesit, krijuesi i gënjeshtreve të Satanit [këtu në tokë].²

Që nga ato ditë të hershme, ndjenjat e zilisë dhe urrejtjes kanë shkakuar disa nga ngjarjet më tragjike të historisë. Ato e kthyen Saulin kundër Davidit, bijtë e Jakobit kundër vëllait të tyre Jozefit, Lamanin dhe Lemuelin kundër Nefit dhe Amalikian kundër Moronit.

Unë mendoj se çdo njeri në tokë është prekur në një farë mënyre nga ndjenjat shkatërruese të grindjes, mllëfit dhe hakmarrjes. Ndoshta ka edhe raste kur vetë ne i kemi këto ndjenja brenda vetes. Kur ndihemi të lënduar, të zemëruar apo ziliqarë, është mjaft e lehtë t'i gjykojmë njerëzit e tjerë, shpesh, duke u veshur arsye keqdashëse veprimeve të tyre në mënyrë që të justifikojmë ndjenjat tona të fyerjes.

Doktrina

Sigurisht, ne e dimë se kjo është e gabuar. Doktrina është e qartë. Ne të gjithë varem nga Shpëtimtari; asnjëri prej nesh nuk mund të shpëtohet pa Të. Shlyerja e Krishtit është e pafundme dhe e përvetshme. Falja për mëkatet *tona* vjen me kushte. Ne duhet të pendohemi dhe duhet të jemi të gatshëm t'i falim të tjerët. Jezusi dha mësim: “Falni njëri-tjetrin; sepse ai që nuk . . . fal . . . mbetet i dënuar përpara Zotit; sepse atij i ngelet mëkati më i madh”³ dhe “Lum ata që janë të mëshirshëm, sepse ata do të gjejnë mëshirë”⁴.

Sigurisht, këto fjalë duken krejtësisht me vend – kur zbatohen për dikë tjetër. Ne mund t'i shohim aq qartë dhe lehtësisht pasojat e dëmshme që vijnë kur *të tjerët* gjykojnë dhe mbajnë mëri. Dhe neve me siguri nuk na pëlqen kur njerëzit na gjykojnë.

Por kur është fjala për vetë paragjykimet dhe ankesat tona, ne tepër shpesh justifikohemi se zemërimi ynë është i drejtë dhe

gjykimi ynë është i besueshëm dhe me vend. Edhe pse nuk mund të shohim brenda zemrës së dikujt tjetër, ne e marrim me mend se e njohim një qëllim të keq ose madje një njeri të keq kur e shohim një të tillë. Ne bëjmë përjashtime kur është fjala për vetë ashpërsinë tonë, sepse ne ndiejmë se, në rastin tonë ne kemi të gjithë informacionin që na duhet, për ta parë dikë me përbuzje.

Apostulli Pal, në letrën e tij drejtuar romakëve, tha se ata që i gjykojnë të tjerët janë “të pafalshëm”. Në çastin kur gjykojmë dikë tjetër, shpjegoi ai, ne dënojmë veten tonë, pasi askush nuk është pa mëkat⁵. Të mos pranosh të falësh, është një mëkat i rëndë – mëkat për të cilin Shpëtimtari na paralajmëroi. Vetë dishepujt e Jezusit “kërkuan rast kundër njëri-tjetrit dhe nuk e falën njëri-tjetrin në zemrat e tyre; dhe për këtë ligësi ata u brengosën dhe u ndëshkuan rreptësisht”⁶.

Shpëtimtari ynë ka folur aq qartë mbi këtë temë, saqë s’ka vend për interpretime vetjake. “Unë, Zoti, do të fal kë do të fal”, por më pas Ai tha: “. . . nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit.”⁷

A mund të shtoj një sqarim këtu? Kur Zoti kërkon që ne t’i falim të gjithë njerëzit, këtu përfshihet falja e vetes. Ndonjëherë, nga të gjithë njerëzit në botë, ai që është më i vështiri për t’u falur – si dhe ndoshta ai që ka më shumë nevojë për faljen tonë – është njeriu që na shikon nga pasqyra.

Parimi Themelor

Kjo temë e të gjykuarit të të tjerëve faktikisht mund të jepet mësim në një predikim dyfjalësh. Kur është fjala për urrejtjen, thashethemnajën, injorimin, përqeshjen, mbajtjen e mërisë apo dëshirën për të bërë keq, ju lutem të ndiqni këtë udhëzim:

Ndalojeni atë!

Kaq e thjeshtë është. Ne thjesht duhet të ndalojmë së gjykuari të tjerët dhe t’i zëvendësojmë mendimet dhe ndjenjat gjykuese me një zemër plot ndjenja dashurie për Perëndinë dhe fëmijët e Tij. Perëndia është Ati ynë. Ne jemi fëmijët e Tij. Ne jemi të gjithë vëllezër e motra. Unë nuk e di si ta artikuloj saktësisht këtë pikë të mosgjykimit të të tjerëve me rrjedhshmëri, pasion e bindje të mjaftueshme sa t’ju bëj që ta kujtoni gjithmonë. Unë mund ta citoj shkrimin e shenjtë, mund të përpiqem ta shpjegoj doktrinën e madje do të citoj edhe një afishe që pashë së fundmi prapa një automjeti. Ajo që ngjitur në anën e prapme të një makine, shoferi

i së cilës dukej sikur qe pak i ashpër, por fjalët në afishe më mësuan një mësim të mprehtë. Aty lexohej: “Mos më gjykoni ngaqë mëkatoj në mënyrë të ndryshme nga ju”.

Ne duhet ta pranojmë se jemi të gjithë të papërkryer – që jemi lypësa përpara Perëndisë. A nuk i jemi afruar të gjithë butësisht pajtuesit të mëshirës e jemi lutur për të marrë hir, herë pas here? A nuk kemi uruar me të gjithë energjinë e shpirttrave tanë për mëshirë – për të marrë falje për gabimet që kemi bërë dhe për mëkatet që kemi kryer?

Duke qenë se të gjithë varemi nga mëshira e Perëndisë, si mund t’ia mohojmë të tjerëve çfarëdolloj pjese të hirit të cilën e dëshirojmë kaq skajshëm për veten? Vëllezër e motra të mia të dashura, a nuk duhet të falim sikurse urojmë të falemi?

Dashuria e Perëndisë

A është e vështirë për t’u bërë?

Patjetër që po.

Falja e vetes dhe e të tjerëve nuk është e lehtë. Në fakt, për shumicën prej nesh duhet një ndryshim madhor në qëndrimin dhe mënyrën tonë të të menduarit – madje një ndryshim i zemrës. Por ka lajme të mira. Ungjilli i Jezu Krishtit është hartuar që të shkaktojë pikërisht këtë “ndryshim [të] madh”⁸ të zemrës në jetën tonë.

Si bëhet kjo? Njëpërmjet dashurisë së Perëndisë.

Kur zemrat tona mbushen me dashurinë e Perëndisë, na ndodh diçka e mirë dhe e kulluar. Ne “zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda. Sepse çdo gjë që ka lindur nga Perëndia e mund botën.”⁹

Sa më shumë që e lejojmë dashurinë e Perëndisë t’i kontrollojë mendjet dhe emocionet tona – sa më shumë e lejojmë dashurinë tonë për Atin Qiellor të rritet brenda zemrave tona – aq më e lehtë është t’i duam të tjerët me dashurinë e pastër të Krishtit. Kur i hapim zemrat ndaj agimit përflakës të dashurisë së Perëndisë, errësira dhe i ftohti i urrejtjes dhe zilisë do të treten përfundimisht.

Si përherë, Krishti është shembulli ynë i përkryer. Në mësimet e Tij sikurse edhe në jetën e Tij, Ai na e tregoi udhën. Ai i fali të ligjtë, të vrazhdët dhe ata që kërkuan ta lëndonin dhe t’i bënë keq.

Jezusi tha se është e lehtë t'i duam ata që na duan; edhe të ligjtë mund ta bëjnë atë. Por Jezu Krishti dha mësim një ligj më të lartë. Fjalët e Tij jehojnë nëpër shekuj dhe zbatohen për ne sot. Ato janë thënë për të gjithë ata që dëshirojnë të jenë dishepujt e Tij. Ato janë thënë për ju dhe mua: "Duani armiqtë tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin"¹⁰.

Kur zemrat tona janë të mbushura me dashurinë e Perëndisë, ne bëhemi "të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njërin-tjetrin, sikurse edhe Perëndia [na] ka falur"¹¹.

Dashuria e pastër e Krishtit mund t'i zhdukë ndjenjat e inatit dhe tërbimit që ndikojnë te mënyra si i perceptojmë gjërat, duke na lejuar t'i shohim të tjerët ashtu siç na sheh Ati ynë Qiellor: që ne jemi të gjithë të vdekshëm me të meta e të papërkryer, që kemi potencial dhe vlerë përtej aftësisë sonë për ta përfytyruar. Për shkak se Perëndia na do kaq shumë, edhe ne duhet ta duam e ta falim njëri-tjetrin.

Udha e Dishepullit

Të dashur vëllezër e motra të mia, quajini pyetjet vijuese si një provim për veten:

A mbani mëri kundrejt dikujt?

A bëni thashetheme, madje edhe kur ajo që thoni mund të jetë e vërtetë?

A i përrjashtoni, i largoni nga vetja apo i ndëshkoni të tjerët për shkak të diçkaje që ata kanë bërë?

A jeni fshehtësisht ziliqarë ndaj dikujt?

A dëshironi t'i bëni keq dikujt?

Nëse iu përgjigjet 'po' ndonjëres prej këtyre pyetjeve, ju mund të dëshironi të zbatoni predikimin e mëparshëm dyfjalësh: ndalojeni atë!

Në një botë akuzash dhe armiqësisë, është e lehtë të gjesh arsye për të mbledhur e për të hedhur gurë gjykimi. Por përpara se të bëjmë kështu, le t'i kujtojmë fjalët e Atij që është Mjeshtri dhe modeli ynë: "Kush nga ju është pa mëkat, le ta hedhë i pari gurin"¹².

Vëllezër dhe motra, le t'i ulim gurët tanë.

Le të jemi të sjellshëm.

Le të falim.

Le të flasim paqësisht me njëri-tjetrin.

Le t'i mbushë zemrat tona dashuria e Perëndisë.

"Le t'u bëjmë të mirën të gjithëve."¹³

Shpëtimtari premtoi: "Jepni dhe do t'ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese. . . . sepse me atë masë që [përdorni], do t'ju matet edhe juve gjithashtu"¹⁴.

A nuk duhet të jetë ky premtim i mjaftueshëm që t'i përqendrojmë gjithmonë përpjekjet tona te veprat e mirësisë, falja dhe dashuria hyjnore në vend të çfarëdolloj sjelljeje negative?

Le t'i përgjigjemi të keqes me të mirë, si dishepuj të Jezu Krishtit.¹⁵ Le të mos kërkojmë hakmarrje e të mos e lejojmë tërbimin të na pushtojë.

"Sepse është shkruar: 'Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpëguar', thotë Zoti.

'Në qoftë se armiku yt, pra, ka uri, jepi të hajë; në pastë etje, jepi të pijë.' . . .

'Mos u mund nga e keqja, por munde të keqen me të mirën.'¹⁶

Mbani mend: në fund, janë të mëshirshmit ata që gjejnë mëshirë.¹⁷

Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, kudoqofshim, le të njihemi si një popull që "ke[m]i dashuri për njëri-tjetrin"¹⁸.

Duajeni Njëri-Tjetrin

Vëllezër e motra, ka mjaftueshëm vuajtje e hidhërim në jetë pa i shtuar ata përmes kokëfortësisë, ashpërsisë dhe mllefrit tonë vetjak.

Ne nuk jemi të përkryer.

Njerëzit rreth nesh nuk janë të përkryer.¹⁹ Njerëzit bëjnë gjëra që na mërzisin, na zhgënjëjnë dhe na zemërojnë. Në këtë jetë në vdekshmëri, gjithnjë do të jetë kështu.

Megjithatë, ne duhet të heqim dorë nga ankesat tona. Pjesë e qëllimit të vdekshmërisë është të mësojmë se si të heqim dorë prej të tilla gjërave. *Kjo është mënyra e Zotit.*

Mbani mend, qielli është i mbushur me ata që kanë këtë të përbashkët: Ata janë falur. Dhe ata falin.

Jepjani barrat tuaja emocionale Shpëtimtarit që të hiqni dorë prej tyre. Hiqni dorë nga gjykimi. Lejojeni Shlyerjen e Krishtit që

t'jua ndryshojë e t'jua shërojë zemrën. Duajeni njëri-tjetrin. Faleni njëri-tjetrin.

Të mëshirshmit do të gjejnë mëshirë.

Për këtë unë dëshmoj në emrin e Atij që deshi kaq shumë e kaq plotësisht, sa dha jetën e Tij për ne, miqtë e Tij – në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.

Shënime

- | | |
|--|--|
| 1. Alma 31:5. | 10. Mateu 5:44; shih edhe vargjet 45–47. |
| 2. Shih Moisiu 5:16–32. | 11. Efesianëve 4:32. |
| 3. Doktrina e Besëlidhje 64:9. | 12. Gjoni 8:7. |
| 4. Mateu 5:7. | 13. Galatasve 6:10. |
| 5. Shih Romakëve 2:1. | 14. Lluka 6:38. |
| 6. Doktrina e Besëlidhje 64:8. | 15. Shih Mateu 5:39–41. |
| 7. Doktrina e Besëlidhje 64:10; theksimi i shtuar. | 16. Romakëve 12:19–21. |
| 8. Mosia 5:2. | 17. Shih Mateu 5:7. |
| 9. 1 Gjoni 5:3–4. | 18. Gjoni 13:35. |
| | 19. Shih Romakëve 3:23. |

Falë i Qoftë Perëndisë

Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Sa më mirë do të ishte nëse të gjithë do të mund të kishin më shumë njohuri për fuqinë hyjnore dhe dashurinë e Perëndisë dhe t'ia shprehnin atë mirënjohje Atij.

Të dashur vëllezër dhe motra, ju falënderojmë për mbështetjen tuaj të qëndrueshme dhe besnikërinë tuaj. Ne shprehim mirënjohjen dhe dashurinë tonë për secilin prej jush.

Kohët e fundit, unë dhe Motra Nelson shijua bukuri dhe peshqve tropikalë në një akvarium të vogël privat. Peshqit me ngjyra të larmishme dhe shumëllojshmëri formash e përmasash, turren si shigjetë prapa dhe para. E pyeta kujdestaren pranë: “Kush i ushqen këta peshq të bukur?”

Ajo u përgjigj: “Unë”.

Më pas e pyeta: “A të kanë falënderuar ndonjëherë?”

Ajo u përgjigj: “Ende jo!”

Mendova për disa njerëz që i njoh, që janë aq të pavëmendshëm ndaj Krijuesit të tyre dhe “bukë[s] [së tyre të vërtetë të] jetës”¹. Ata jetojnë çdo ditë pa një njohuri për Perëndinë dhe mirësinë e Tij ndaj tyre.

Sa më mirë do të ishte nëse të gjithë do të mund të kishin më shumë njohuri për fuqinë hyjnore dhe dashurinë e Perëndisë dhe t'ia shprehnin atë mirënjohje Atij. Amoni dha mësim: “Le t’i japim falënderime [Perëndisë], pasi ai punon me drejtësi përgjithnjë”². Shkalla jonë e mirënjohjes tregon masën e dashurisë sonë për Të.

Perëndia është Ati i shpirtave tanë.³ Ai ka një trup të përlevduar dhe perfekt prej mishi e kockash.⁴ Ne jetuam me Të në qiell përpara se të lindeshim.⁵ Dhe kur Ai na krijoi si trupa fizikë,

ne u krijuam në shëmbëlltyrën e Perëndisë, secili me një trup vetjak.⁶

Mendoni për ushqimin tonë fizik. Është me të vërtetë i dërguar nga qielli. Gjërat e domosdoshme si ajri, ushqimi dhe uji, të gjitha vijnë te ne si dhurata nga një Atë i dashur Qiellor. Toka u krijua për të mbështetur ekzistencën tonë të shkurtër në vdekshmëri.⁷ Ne u lindëm me aftësinë për t'u rritur, për të dashur, për t'u martuar dhe për të krijuar familje.

Martesa dhe familja shugurohen nga Perëndia. Familja është njëësia më e rëndësishme shoqërore në kohë e në përjetësi. Për shkak të planit të madh të Perëndisë për lumturinë, familjet mund të vulosen në tempuj dhe të përgatiten që të kthehen për të banuar në praninë e Tij të shenjtë përgjithmonë. Kjo është jeta e përjetshme! Ajo përmbush dëshirat më të thella të shpirtit njerëzor – dëshirën natyrore për shoqërimin e vazhdueshëm me anëtarë të dashur të familjes së një individi.

Ne jemi pjesë e qëllimit të Tij hyjnor: “Vepra ime dhe lavdia ime”, tha Ai, është “të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut.”⁸ Në mënyrë që t'i përmbushte ato synime, “Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.”⁹ Ai veprim që një manifestim hyjnor i dashurisë së Perëndisë. “Sepse [Ai] nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohet prej tij.”¹⁰

Kryesor për planin e përjetshëm të Perëndisë është misioni i Birit të Tij, Jezu Krishtit.¹¹ Ai erdhi për të shëlbuar fëmijët e Perëndisë.¹² Për shkak të Shlyerjes së Zotit, ringjallja (ose pavdekësia) u përmbush.¹³ Falë Shlyerjes, jeta e përjetshme u bë një mundësi për të gjithë ata që do të kualifikohen. Jezusi e shpjegoi në këtë mënyrë:

“Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë.

Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë.”¹⁴

Për shkak të Shlyerjes së Zotit dhe dhuratës së Tij të ringjalljes – për këtë mesazh sublim të Pashkës – falë i qoftë Perëndisë!

Dhuratat Fizike

Aty ynë Qiellor i do fëmijët e Tij.¹⁵ Ai e ka bekuar çdonjërin me dhurata fizike dhe shpirtërore. Më lejoni të flas për secilin lloj [dhurate]. Kur ju këndon "Fëmi i Per'ndis' Jam", mendoni për dhuratën e Tij për ju, të vetë trupit tuaj fizik. Tiparet shumë të mahnitshme të trupit tuaj dëshmojnë për "natyrë[n] [tuaj] hyjnore"¹⁶.

Çdo organ i trupit tuaj është një dhuratë e mahnitshme nga Perëndia. Secili sy ka aftësi për ta vendosur automatikisht në fokus atë që sheh. Nervat dhe muskujt kontrollojnë dy sytë që të krijojnë një imazh të vetëm tre dimensional. Sytë lidhen me trurin, që regjistron pamjet e shikuara.

Zemra juaj është një pompë e pabesueshme.¹⁷ Ajo ka katër valvula delikate që kontrollojnë drejtimin e rrjedhjes së gjakut. Këto valvula hapen dhe mbyllen më shumë se 100.000 herë në ditë – 36 milionë herë në vit. Ende, veç nëse ndryshojnë nga sëmundja, ato janë në gjendje ta përballojnë një tension të tillë, pothuajse për një kohë të pacaktuar.

Mendoni për sistemin mbrojtës të trupit. Për ta mbrojtur atë nga e keqja, ai ndien dhimbje. Në përgjigje të infeksionit, ai prodhon kundërtrupa. Lëkura ofron mbrojtje. Ajo paralajmëron kundër dëmtimit që mund të shkaktojë nxehtësia ose i ftohti i tepërt.

Trupi i gjallëron qelizat tona të vjetruara dhe i rregullon nivelet e përbërësve tanë jetësorë. Trupi shëron të prerat, mavijosjet dhe kockat e thyera. Aftësia e tij për riprodhim është një dhuratë tjetër e shenjtë nga Perëndia.

Ne duhet të kujtojmë se dikujt nuk i nevojitet një trup i përsosur për të arritur fatin e tij hyjnor. Faktikisht, disa nga shpirtrat më të ëmbël strehohen në trupa të brishtë ose të papërkryer. Shpesh, nga njerëzit me sfida fizike zhvillohet forcë e madhe shpirtërore, pikërisht ngaqë ata janë shumë të sfiduar.

Çdokush që i studion funksionimet e trupit njerëzor, me siguri ka "parë Perëndinë duke lëvizur në madhësinë dhe fuqinë e tij"¹⁸. Për shkak se trupi qeveriset nga ligji hyjnor, çdo shërim vjen me anë të bindjes ndaj ligjit mbi të cilin është predikuar ai bekim.¹⁹

Ende, disa njerëz mendojnë gabimisht se këto tipare të mrekullueshme fizike ndodhën nga ndryshimi apo rezultuan nga big bengu diku. Pyeteni veten: "A mundet një shpërthim në një shtypshkronjë që të prodhojë një fjalor?" Mundësia është *shumë* e largët. Por nëse do të ndodhte, ai nuk do të mundte kurrë që t'i rregullonte vetë faqet e tij të grisura apo të prodhonte vetë botimet e tij të reja!

Nëse aftësia e trupit për funksionim, mbrojtje, ndreqje, rregullim dhe ripërtëritje normale do të vazhdonte pa kufij, jeta këtu do të vazhdonte në përjetësi. Po, ne do të ngecnim këtu në tokë! Krijuesi ynë mëshirëplotë siguroi procesin e plakjes dhe të tjera procese që do të çonin përfundimisht në vdekjen tonë fizike. Vdekja, sikurse lindja, është pjesë e jetës. Shkrimet e shenjta na mësojnë se "nuk ishte e nevojshme që njeriu të shëlbehej nga kjo vdekje fizike, pasi një gjë e tillë do të shkatërronte planin e madh të lumturisë"²⁰. Të kthehesh te Perëndia përmes portës që ne e quajmë vdekje, është një gëzim për ata që e duan dhe janë të përgatitur për ta takuar Atë.²¹ Përfundimisht, koha do të vijë kur çdo "shpirt dhe trup do të bashkohen përsëri në formën . . . [e] përkryer; dhe si gjymtyrët ashtu dhe nyjet do të rivendosen në të njëjtin trup"²², për të mos u ndarë më kurrë. Për këto dhurata fizike, falë i qoftë Perëndisë!

Dhuratat Shpirtërore

Aq i rëndësishëm sa është trupi, ai shërben si një tabernakull për shpirtin e përjetshëm të dikujt. Shpirtrat tanë ekzistuan në mbretërinë para lindjes²³ dhe do të vazhdojnë të jetojnë edhe pasi trupi të vdesë.²⁴ Shpirti i siguron trupit përvoja jetësore dhe personalitet.²⁵ Në këtë jetë dhe në tjetrën, kur shpirti dhe trupi do të bashkohen së bashku, do të bëhen një shpirt i gjallë me vlerë hyjnore.

Për shkak se shpirti i dikujt është kaq i rëndësishëm, zhvillimi i tij është me pasoja të përjetshme. Ai forcohet ndërsa komunikojmë në lutje të përlulur me Atin tonë të dashur Qiellor.²⁶

Tiparet përmes të cilave do të gjykohehi një ditë, janë të gjitha shpirtërore.²⁷ Ato përfshijnë dashurinë, virtytin, integritetin moral, dhembshurinë dhe shërbimin ndaj të tjerëve.²⁸ Shpirti juaj, i bashkuar dhe i strehuar në trupin tuaj, është në gjendje t'i zhvillojë dhe manifestojë këto tipare në mënyra që janë thelbësore

për përparimin tuaj të përjetshëm.²⁹ Përparimi shpirtëror arrihet përmes hapave të besimit, pendimit, pagëzimit, dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund, përfshirë marrjen e indaumentit dhe ordinancat vulosëse të tempullit të shenjtë.³⁰

Ashtu si trupi kërkon ushqim të përditshëm për të mbijetuar, edhe shpirti ka nevojë për ushqim. Shpirti ushqehet përmes të vërtetës së përjetshme. Vitin e kaluar, ne festuam 400-vjetorin e përkthimit të versionit anglisht të mbretit Jakob të Biblës së Shenjtë. Dhe ne kemi pasur Librin e Mormonit për afro 200 vjet. Ai tashmë është përkthyer plotësisht apo si përzgjedhje në 107 gjuhë. Për shkak të këtyre dhe shkrimeve të tjera të çmuara, ne e dimë se Perëndia është Ati ynë i Përjetshëm dhe se Biri i Tij, Jezu Krishti është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Për këto dhurata shpirtërore, falë i qoftë Perëndisë!

Dhurata të Ungjillit

Ne e dimë se profetë të shumë periudhave ungjillore si Adami, Noeu, Moisiu dhe Abrahami, të gjithë dhanë mësim për hyjninë e Atit tonë Qiellor dhe të Jezu Krishtit. Periudha jonë e tanishme ungjillore u paraqit nga Ati Qiellor dhe Jezu Krishti, kur Ata iu shfaqën Profetit Jozef Smith në 1820. Kisha u organizua në vitin 1830. Tani, 182 vjet më pas, ne mbetemi nën besëlidhje për ta çuar ungjillin te “çdo komb, fis, gjuh[ë] dhe popull”³¹. Kur veprojmë kështu, si dhënësit edhe marrësit do të bekohen.

E jona është përgjegjësia për t’u dhënë mësim fëmijëve të Tij dhe për të zgjuar brenda tyre njohurinë për Perëndinë. Shumë kohë më parë, Mbreti Benjamin tha:

“Besoni në Perëndinë; besoni se ai është dhe se ai krijoi të gjitha gjërat, si në qiell ashtu edhe në tokë; besoni se ai ka të gjithë diturinë dhe të gjithë fuqinë, si në qiell ashtu edhe në tokë; . . .

. . . Besoni se ju duhet të pendoheni për mëkatet tuaja dhe t’i braktisni ato, dhe të përlun veten tuaj para Perëndisë; dhe të kërkonin në çiltërsinë e zemrës, që ai t’ju falë juve; dhe tani, në qoftë se ju besoni të gjitha këto gjëra, shikoni që t’i bëni ato.”³²

Perëndia është i njëjtë dje, sot dhe përgjithmonë, por ne jo. Çdo ditë, është sfida jonë që të përdorim fuqinë e Shlyerjes, në mënyrë që të ndryshojmë me të vërtetë, të bëhemi më shumë si

Krishti dhe të kualifikohemi për dhuratën e ekzaltimit e të jetojmë përjetësisht me Perëndinë, Jezu Krishtin dhe familjet tona.³³ Për këto fuqi, privilegje dhe dhurata të ungjillit, falë i qoftë Perëndisë!

Unë dëshmoj se Ai jeton, se Jezusi është Krishti, se kjo është Kisha e Tij, e rivendosur në këto ditë të mëvonshme për të përmbushur fatin e saj hyjnor. Ne drejtohem sot nga Presidenti Tomas S. Monson, të cilin e duam dhe e mbështesim me gjithë zemrën tonë, sikurse i mbështesim edhe këshilltarët e tij dhe Dymbëdhjetë Apostujt si profetë, shikues e zbulues. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Gjoni 6:35, 48; shih edhe vargun 51.
2. Alma 26:8; shih edhe Alma 7:23.
3. Shih Veprat e Apostujve 17:27–29.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:22.
5. Shih Moisiu 6:51; Romakëve 8:16; Hebrejve 12:9; Jeremia 1:4–5.
6. Shih Zanafilla 2:7; 1 Korintasve 15:44; Moisiu 3:7.
7. Shih 1 Nefi 17:36.
8. Moisiu 1:39.
9. Gjoni 3:16.
10. Gjoni 3:17.
11. Synimet e Tij janë përmbledhur shkurtimisht te 3 Nefi 27:13–22.
12. Shih Alma 11:40.
13. Shih 2 Nefi 9:6–7, 20–22.
14. Gjoni 11:25–26.
15. Shih 1 Nefi 17:40; 1 Gjoni 4:10.
16. 2 Pjetër 1:4.
17. Zemra pompon rreth 7.570 litra për ditë.
18. Doktrina e Besëlidhje 88:47.
19. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:21. Me të vërtetë, ai ligj hyjnor është i pamohueshëm.
20. Alma 42:8.
21. Psalmisti shprehu pikëpamjen e Hyjnisë: “Është e çmueshme në sytë e Zotit vdekja e të shenjtëve të tij” (Psalmeve 116:15); shih edhe Predikuesit 12:7.
22. Alma 11:43; shih edhe Predikuesit 12:7; Alma 40:23; Doktrina e Besëlidhje 138:17.
23. Shih Doktrina e Besëlidhje 93:38.
24. Shih Alma 40:11; Abraham 3:18.
25. Shpirti është në ngjashmërinë e vetes (shih Doktrina e Besëlidhje 77:2).
26. Shih 3 Nefi 14:9–11.
27. Shpirti, jo trupi është përbërësi aktiv, përgjegjës i shpirtit. Trupi pa frymën është i vdekur (shih Jakobi 2:26). Si rrjedhojë, është shpirti që zgjedh të mirën ose të keqen dhe do të mbahet përgjegjës në Gjykimin Përfundimtar si për tiparet pozitive edhe për ato negative që zotëron (shih Alma 41:3–7).
28. Tiparet shpirtërore gjithashtu përfshijnë “besimin, virtytin, diturinë, maturinë, durimin, mirësinë vëllazërore, perëndishmërinë, dashurinë hyjnore, përlësinë [dhe] zellin” (Doktrina e Besëlidhje 4:6).
29. Shih 2 Nefi 2:11–16, 21–26; Moroni 10:33–34.
30. Kjo është doktrina e Krishtit (shih 2 Nefi 31:11–21).
31. Mosia 15:28; shih edhe 1 Nefi 19:17; 2 Nefi 26:13; Mosia 3:20; 15:28; 16:

- 1; Alma 37:4; Doktrina e Besëlidhje 1:18–23; 77:11; 133:37. Perëndisë” (Doktrina e Besëlidhje 14:7).
32. Mosia 4:9–10.
33. “Jet[a] [e] përjetshme . . . është më e madhja nga të gjitha dhuratat e

Mësime të Veçanta

Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Është shpresa dhe lutja ime që ne do të vazhdojmë t'i mbajmë fisnikërisht barrat tona dhe do t'i ndihmojmë ata mes nesh që po vuajnë.

Gjatë 20 muajve të kaluar, familja jonë është bekuar me privilegjin për të pasur një foshnjë shumë veçantë.

Pakstoni i vogël, nipi ynë, ka lindur me një çrregullim shumë të rrallë kromozomik, një çrregullim gjenetik që e bën atë të dallueshëm, me plot kuptimin e fjalës, nga qindra miliona njerëz të tjerë. Për vajzën tonë dhe bashkëshortin e saj, nisi një udhëtim i paplanifikuar që u ndryshoi jetën kur lindi Pakstoni. Kjo përvojë është bërë një provë e vështirë për marrjen e mësimeve të veçanta lidhur me të ardhmen e tyre në përjetësi.

I shtrenjti Plaku Rasëll M. Nelson, i cili sapo na foli, dha mësim:

“Për arsye zakonisht të panjohura, disa njerëz lindin me kufizime fizike. Pjesë të caktuara të trupit mund të mos jenë normale. Sistemet biologjike mund të mos funksionojnë siç duhet. Dhe të gjithë trupat tanë mund të sëmuren dhe do të vdesin. Prapëseprapë, dhurata e një trupi fizik është e paçmueshme. . . .

Nuk është e detyrueshme që të kemi trupa të përsosur që të bëhemi si Perëndia. Në fakt, disa nga shpirttrat më të ëmbël strehohen në trupa të brishtë. . . .

Përfundimisht do të vijë koha kur çdo ‘shpirt dhe trup do të bashkohe[t] përsëri në formën e . . . përkryer; dhe si gjymtyrët ashtu dhe nyjet do të rivendosen në të njëjtin trup’ (Alma 11:43). Më pas, falë Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne mund të bëhemi të përsosur në Të.”¹

Të gjithë ju që keni sfida, shqetësime, zhgënjime apo hidhërime për një njeri të dashur, dijeni këtë: me dashuri të pafundme dhe mëshirë të përjetshme, Perëndia, Ati ynë Qiellor e do njeriun tuaj që vuan, dhe Ai ju do ju!

Kur përballen me një vuajtje të tillë disa mund të pyesin: “Si mundi ta lejonte Perëndia i Plotfuqishëm që të ndodhte kjo?” Dhe më pas bëjnë atë pyetje që duket e pashmangshme: “Pse më ndodhi kjo mua?” Përse duhet të përjetojmë sëmundje dhe ngjarje që i bëjnë të paaftë ose u shkaktojnë vdekje të parakohshme pjesëtarëve të familjes apo u shkaktojnë atyre vite të tëra vuajtjeje? Pse këto dhembje?

Në këto çaste, mund të kthehemi te plani i madh i lumturisë i hartuar nga Ati ynë Qiellor. Ai plan, kur u paraqit në jetën paratokësore, na bëri të gjithëve të lëshonim britma gëzimi.² E thënë thjesht, kjo jetë është një përgatitje për ekzaltimin e përjetshëm dhe ky proces nënkupton prova dhe sfida. Gjithmonë ka qenë kështu dhe askush nuk përjashtohet.

Mirëbesimi në vullnetin e Perëndisë është një pjesë thelbësore e jetës sonë në vdekshmëri. Me besim në Të, ne marrim fuqinë e Shlyerjes së Krishtit në ato kohë kur pyetjet janë të shumta dhe përgjigjet janë të pakta.

Pas Ringjalljes së Tij, kur vizitoi kontinentin amerikan, Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, u bëri të gjithë njerëzve këtë ftesë:

“A ka mes jush ndonjë që është i sëmurë? Silleni këtu. A ka ndonjë që është i çalë ose i verbër, ose i gjymtë, ose sakat, ose i lebrosur, ose i deformuar, ose i shurdhër, ose i prekur në ndonjë mënyrë? I sillni këtu dhe unë do t’i shëroj ata, pasi kam dhembshuri për ju; zemra ime është e mbushur me mëshirë. . . .

Dhe ndodhi që pasi u foli kështu, e gjithë turma, të gjithë së bashku, shkuan para me të sëmurët dhe me fatkeqët, dhe me të çalët, dhe me të verbërit, dhe me memecët, dhe me të gjithë ata që ishin të prekur në ndonjë mënyrë; dhe ai i shëroi, secilin që sollën në prani të tij.”³

Mund të gjendet një forcë e madhe në fjalët “e gjithë turma . . . shk[oi] para” – e gjithë, vëllezër dhe motra. Ne të gjithë përjetojmë sfida. Dhe më pas fraza: “që ishin të prekur në ndonjë mënyrë”. Të gjithë ne mund ta gjejmë veten këtu, apo jo?

Pak pasi lindi Pakstoni i çmuar, ne e dinim se Ati Qiellor do të na bekonte e do të na jepte mësim të veçanta. Ndërsa i ati dhe unë i vendosëm gishtat në kokën e tij të vockël në bekimin e parë prej shumë të tjerëve, në mendje më erdhën fjalët nga kapitulli i nëntë i Gjonit: “Kjo ndodhi që tek ai të dëftohen veprat e Perëndisë”⁴.

Veprat e Perëndisë po dëftohen nëpërmjet Pakstonit.

Ne po mësojmë durimin, besimin dhe mirënjohjen nëpërmjet fuqisë shëruese të shërbimit, orëve të panumërta të emocioneve të thella, lotëve të dhembshurisë dhe lutjeve e shprehjeve të dashurisë për njerëzit tanë të dashur në nevojë, veçanërisht për Pakstonin dhe prindërit e tij.

Presidenti Xhejms E. Faust, presidenti i kunjtit në fëmijërinë time, tha: “Kam një mirënjohje të madhe për ata prindër të dashur që qetësisht dhe trimërisht e durojnë dhe e mposhtin ankthin dhe hidhërimin për një fëmijë që ka lindur apo e ka zhvilluar më vonë një kufizim të rëndë mendor ose fizik. Ky ankth, shpesh, vazhdon çdo ditë, pa u lehtësuar, gjatë jetës së prindit ose fëmijës. Jo rrallë, prindërve u kërkohet të japin përkujdesje të jashtëzakonshme edukuese që nuk ndalet kurrë, ditë apo natë. Shumë nëna kanë punuar si fizikisht ashtu edhe emocionalisht për vite me radhë, duke i dhënë ngushëllim dhe duke e lehtësuar vuajtjen e fëmijëve të tyre të veçantë.”⁵

Siç përshkruhet te Mosia, ne kemi dëshmuar dashurinë e pastër të Shpëtimtarit që i është dhënë familjes së Pakstonit, dashuri e cila u jepet të gjithë njerëzve: “Dhe tani ndodhi që barrat që iu vunë Almës dhe vëllezërve të tij u lehtësuan; po, Zoti i forcoi ata që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtruan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit”⁶.

Një natë, pak pasi kishte lindur Pakstoni, ne ishim në njësinë e përkujdesjes intensive për foshnjat e porsalindura në Qendrën Mjekësore të Fëmijëve të Fillores në Solt-Lejk-Siti, në Juta, të mahnitur nga vëmendja e përkushtuar dhe e pandërprerë e dhënë nga doktorët, infermieret dhe kujdestarët. E pyeta vajzën time se si do mundeshim të paguanim për këtë dhe llogarita me hamendje se sa do të kushtonte. Një doktor që po qëndronte aty pranë më tha se “kisha sugjeruar një çmim shumë të ulët” dhe se përkujdesja për Pakstonin e vogël do të kushtonte goxha më

tepër seç e kisha llogaritur unë. Ne mësuam se shumë nga shpenzimi për përkujdesjen e dhënë në këtë spital mbulohet nga dhuratat bujare të kohës dhe kontributeve në para të tjerëve. Fjalët e tij më përlulën kur mendova për vlerën që kishte shpirti i këtij vogëlushi, për ata që po kujdeseshin kaq mirë për të.

M'u kujtua një shkrim i shenjtë i njohur për misionarët që mori një kuptim të ri: "Kujtoni që vlera e shpirtave është e madhe në sytë e Perëndisë"⁷.

Unë qava ndërsa mendova për dashurinë e pakufijshme që Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti, kanë për secilin prej nesh, ndërsa mësova në një mënyrë të fuqishme se cila është vlera e një shpirti, si fizikisht, ashtu edhe shpirtërisht, për Perëndinë.

Familja e Pakstonit ka mësuar se është e rrethuar nga engjëj të panumërt shërbestarë qiellorë e tokësorë. Disa kanë ardhur për të ndihmuar qetësisht kur ka qenë nevoja dhe janë larguar pa u ndier. Të tjerë kanë ardhur në derë duke sjellë ushqim, duke larë rrobat, duke i shoqëruar vëllezërit e motrat e Pakstonit, duke telefonuar për të dhënë inkurajim dhe veçanërisht duke u lutur për Pakstonin. Në këtë mënyrë nxirret një mësim tjetër i veçantë: Nëse do të gjenit dikë që është duke u mbytur, do ta pyesnit nëse ka nevojë për ndihmë – apo do të ishte më mirë që thjesht të hidheshit dhe ta shpëtonit nga ujërat e thella kërcënuese? Megjithëse ka një qëllim të mirë dhe bëhet shpesh, oferta: "Më thuaj nëse mund të të ndihmoj" në të vërtetë nuk është fare ndihmë.

Ne vazhdojmë të mësojmë vlerën e rëndësishme të të qenit në dijeni dhe të interesuar për jetën e atyre që na rrethojnë, duke mësuar jo vetëm rëndësinë e dhënies së ndihmës, por edhe gëzimin e madh që vjen nga ndihma që u japim të tjerëve.

I shtrenjti Presidenti Tomas S. Monson, i cili është një shembull kaq i shkëlqyer i lehtësimit të të shtypurve, tha: "Perëndia i bekoftë të gjithë ata që mundohen të jenë rojtarët e vëllezërve të tyre, që dhurojnë për të lehtësuar vuajtjen, që përpiqen me gjithçka të mirë që kanë brenda vetes për ta bërë botën më të mirë. A e keni vënë re se këta njerëz kanë një buzëqeshje më të shndritshme? Hapat e tyre janë më të sigurt. Ata duket se janë më të lumtur e më të kënaqur . . . sepse dikush

nuk mund të përfshihet në dhënien e ndihmës ndaj të tjerëve pa u bekuar bollshëm edhe vetë.”⁸

Megjithëse do të përballemi me sprova, fatkeqësi, paaftësi, hidhërime dhe të gjitha llojet e vuajtjeve, Shpëtimtari ynë i përkujdesur e i dashur, do të jetë gjithmonë aty për ne. Ai ka premtuar:

“Nuk do t’ju lë bonjakë, do të kthehem te ju. . . .

Po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u trondittë dhe mos u frikësoftë.”⁹

Sa mirënjohës jemi ne ndaj Atit tonë në Qiell për kampionin tonë Pakstonin. Nëpërmjet tij, Zoti ka dëftuar veprat e Tij dhe vazhdon të na i japë këto mësimë të vlefshme, të shenjta e të veçanta.

Do të dëshiroja ta mbyllja me fjalët e një himni të dashur:

*Ne jemi të gjithë të rekrutuar derisa përleshja të mbarojë,
Të lumtur jemi! Të lumtur jemi!
Ushtarë në ushtri, një shpërblim i madh na pret;
Përleshjen dhe shpërblimin do ta fitojmë.*¹⁰

Vëllezër e motra, është shpresa dhe lutja ime që ne do të vazhdojmë t’i mbajmë fisnikërisht barrat tona dhe do t’i ndihmojmë ata mes nesh që po vuajnë dhe kanë nevojë të lartësohen e të inkurajohen. E falënderofshim të gjithë Perëndinë për bekimet e Tij dhe e përtëritshim zotimin tonë ndaj Atit tonë në Qiell për të kryer shërbim të përlulur ndaj fëmijëve të Tij. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Russell M. Nelson, “We Are Children of God”, *Liahona*, janar 1999, f. 103.
2. Shih Jobit 38:7.
3. 3 Nefi 17:7, 9.
4. Gjoni 9:3.
5. James E. Faust, “The Works of God”, *Ensign*, nëntor 1984, f. 54.
6. Mosia 24:15.
7. Doktrina e Besëlidhje 18:10.
8. Thomas S. Monson, “Our Brothers’ Keepers”, *Ensign*, qershor 1998, f. 39.
9. Gjoni 14:18, 27.
10. “We Are All Enlisted”, *Hymns*, nr. 250.

Vizioni i Profetëve lidhur me Shoqatën e Ndihmës: Besim, Familje, Ndihmë

Nga Xhuli B. Bek,

E Sapoliruar nga Thirrja si Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës

Besim, familje dhe ndihmë – këto tri fjalë të thjeshta kanë arritur të shprehin vizionin e profetëve për motrat në Kishë.

Vitet e fundit, Shpirti më ka nxitur që të flas shpesh për Shoqatën e Ndihmës – qëllimin dhe cilësitë e saj¹, vlerën e historisë së saj², veprën dhe bashkëpjesëmarrjen e saj me peshkopët dhe kuorumet e Priftërisë Melkizedeke³. Duket e rëndësishme tani të përqendrojmë vëmendjen te vizioni i profetëve lidhur me Shoqatën e Ndihmës⁴.

Pikërisht ashtu si profetët e Zotit u kanë dhënë mësim vazhdimisht pleqve dhe priftërinjve të lartë për qëllimet dhe detyrat e tyre, ata kanë treguar vizionin e tyre për motrat e Shoqatës së Ndihmës. Nga këshilla e tyre është e qartë se qëllimet e Shoqatës së Ndihmës janë për të rritur besimin e drejtësinë vetjake, për të forcuar familjen e shtëpinë dhe për të kërkuar e ndihmuar ata në nevojë. *Besim, familje dhe ndihmë* – këto tri fjalë të thjeshta kanë arritur të shprehin vizionin e profetëve për motrat në Kishë.

Që nga fillimi i Rivendosjes, profetët kanë treguar vizionin e tyre për gra të forta, besnike e të vendosura, të cilat e kuptojnë vlerën dhe qëllimin e tyre të përjetshëm. Kur Profeti Jozef Smith themeloi Shoqatën e Ndihmës, ai e drejtoi presidenten e parë të saj që të “kryesonte mbi këtë shoqëri, në përkujdesjen për të

varfrit – administrimin për nevojat e tyre dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të këtij institucioni”⁵. Ai e përfytyroi organizatën si “një shoqëri të zgjedhur, të ndarë nga të gjitha të ligat e botës”⁶.

Brigam Jangu, Presidenti i dytë i Kishës, i udhëzoi këshilltarët e tij dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve që t’i drejtonin peshkopët që “t’i lejonin [motrat] të organizonin Shoqatat Femërore të Ndihmës në lagjet e ndryshme”. Ai shtoi: “Disa mund të mendojnë se kjo është një gjë e vockël, por nuk është”⁷.

Më vonë, Presidenti Jozef F. Smith tha se, në dallim nga organizatat e botës, që “janë krijuar nga burrat ose nga gratë”, Shoqata e Ndihmës “është krijuar hyjnisht, autorizuar hyjnisht, filluar hyjnisht dhe shuguruar hyjnisht nga Perëndia”⁸. Presidenti Jozef Filding Smith u tha motrave se atyre u “ishte dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë gjëra shumë të mëdha”⁹. Ai tha: “Ju jeni anëtare të organizatës më të madhe të grave në botë, një organizatë që është pjesë jetësore e mbretërisë së Perëndisë në tokë dhe që është hartuar e vënë në funksionim në mënyrë të tillë që të ndihmojë anëtarët e saj besnike për të fituar jetë të përjetshme në mbretërinë e Atit tonë”¹⁰.

Një Fushë e Gjerë Ndikimi

Çdo vit, qindra mijëra gra dhe të reja bëhen pjesë e kësaj “shoqërie motrash”¹¹ gjithmonë në zgjerim. Pasi bëhet anëtare, kudo që një motër të jetojë e të shërbejë, ajo e ruan anëtarësinë e saj dhe shoqërimin në Shoqatën e Ndihmës¹². Për shkak të qëllimeve të rëndësishme të Shoqatës së Ndihmës, Presidenca e Parë ka shprehur dëshirën që të rejat ta fillojnë përgatitjen e tyre për Shoqatën e Ndihmës shumë më parë se të mbushin 18 vjeç¹³.

Shoqata e Ndihmës nuk është një program. Ajo është një pjesë zyrtare e Kishës së Zotit që është “shuguruar hyjnisht nga Perëndia” për të dhënë mësim, forcuar e frymëzuar motrat në qëllimin e tyre në lidhje me besimin, familjen dhe ndihmën. Shoqata e Ndihmës është një mënyrë jetese për gratë shenjto-re të ditëve të mëvonshme dhe ndikimi i saj shtrihet shumë më larg se një orë mësimore të dielën apo një mbledhje shoqërore. Ajo ndjek modelin e besimtareve që shërbyen me Zotin Jezu Krisht dhe Apostujt e Tij në Kishën e Tij të hershme¹⁴. Neve na është mësuar se “është një detyrim për një grua që t’i bëjë pjesë të jetës së saj virtytet që ushqehen nga Shoqata e Ndihmës, pikërisht siç është

një detyrim për burrat që të ndërtojnë në jetën e tyre modelet e karakterit që ushqehen nga priftëria”¹⁵.

Kur Profeti Jozef Smith organizoi Shoqatën e Ndhimës, ai u mësoi motrave se ato duhet të “lehtësonin të varfrit” dhe të “shpëtonin shpirtra”¹⁶. Në detyrën e tyre për të “shpëtuar shpirtra”, motrat u autorizuan të organizojnë e të marrin pjesë në një fushë të gjerë ndikimi. Presidentja e parë e Shoqatës së Ndhimës u veçua për të shpjeguar shkrimet e shenjta dhe Shoqata e Ndhimës ende mbart një përgjegjësi thelbësore për mësimdhënie në Kishën e Zotit. Kur Jozef Smithi u tha motrave se organizata e Shoqatës së Ndhimës do t’i përgatiste ato për “privilegjet, bekimet dhe dhuratat e priftërisë”¹⁷, puna e Zotit për shpëtimiu shpjegua atyre. Shpëtimi i shpirtrave përfshin ndarjen e ungjillit dhe pjesëmarrjen në punën misionare. Ai përfshin angazhimin në punën në tempull dhe për historinë e familjes. Ai përfshin bërjen e çdo gjëje të mundur për t’u bërë e mbështetur te vetja shpirtërisht dhe materialisht.

Plaku Xhon A. Uidso deklaroi se Shoqata e Ndhimës ofron “lehtësim të varfërisë, lehtësim të sëmundjes, lehtësim të dyshimit, lehtësim të padijes – lehtësim nga gjithçka që frenon gëzimin dhe përparimin e gruas. Çfarë porosie madhështore!”¹⁸

Presidenti Bojd K. Paker e ka krahasuar Shoqatën e Ndhimës me “një mur mbrojtës”¹⁹. Përgjegjësia për të mbrojtur motrat dhe familjet e tyre e rrit rëndësinë e vëzhgimit ruajtës e të shërbesës së mësueseve vizitore dhe është një tregues i gatishmërisë sonë për të kujtuar besëlidhjet tona me Zotin. Si “shërbestare për nevojtarët dhe të pikëlluarit”, ne punojmë bashkë me peshkopët për t’u kujdesur për nevojat materiale dhe shpirtërore të shenjtorëve²⁰.

Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Ka shumë motra që po jetojnë në zhele – zhele shpirtërore. Ato kanë të drejtën për mantele të mrekullueshme, mantele shpirtërore. . . . Është privilegji juaj që të shkoni nëpër shtëpi dhe t’i shkëmbeni zhelet me mantele.”²¹ Presidenti Harold B. Li tregoi këtë vizion. Ai tha: “A nuk mund ta kuptoni se përse Zoti ia ka dhënë përgjegjësinë . . . Shoqatës së Ndhimës që të vizitohet këto shtëpi? Sepse përveç vetë Mësuesit, nuk ka të tjerë në Kishë që të kenë një ndikim më

të dashur, një kuptueshmëri më të plotë të zemrës dhe të jetës së këtyre individëve.”²²

Presidenti Jozef F. Smith i paralajmëroi motrat e Shoqatës së Ndhmës dhe udhëheqëset e tyre, duke thënë se ai nuk dëshironte “të shihte kohën kur Shoqatat tona të Ndhmës do të pasonin, ose do të përziheshin dhe do ta humbisnin vetë identitetin e tyre duke u përzier me . . . organizata të krijuara nga gratë”. Ai priste që motrat “ta udhëheqin botën dhe . . . veçanërisht gratë e botës, në gjithçka që është e denjë për t’u lavdëruar, gjithçka që është si Perëndia, gjithçka që është lartësuese dhe që është dëlirësuese për fëmijët e njerëzve”²³. Këshilla e tij thekson detyrën për të larguar traditat, motivet, modat e tendencat dhe për të përfshirë praktika që janë në harmoni me qëllimet e Shoqatës së Ndhmës.

Udhëheqëset që kërkojnë zbulësë, mund të sigurojnë se çdo mbledhje, mësim, orë mësimore, aktivitete dhe përpjekje e Shoqatës së Ndhmës të përmbushë qëllimet për të cilat ajo u organizua. Shoqërimi, miqësia dhe uniteti që dëshirojmë, do të jenë rezultatet e ëmbla të shërbimit së bashku me Zotin në punën e Tij.

Përmbushja e Vizionit të Profetëve

Presidenti Tomas S. Monson dhe këshilltarët e tij kohët e fundit kanë dëshmuar se “Zoti e ka rivendosur plotësinë e ungjillit nëpërmjet Profetit Jozef Smith dhe se Shoqata e Ndhmës është një pjesë e rëndësishme e asaj rivendosjeje”. Si provë e dëshirës së tyre që ajo “trashëgimi e lavdishme” e Shoqatës së Ndhmës të ruhet, Presidenca e Parë botoi dhe shpërndau kohët e fundit në mbarë botën librin *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society [Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Vepra e Shoqatës së Ndhmës]*. Në faqet e këtij libri, ne mund të gjejmë modelet dhe shembujt e motrave dhe vëllezërve që punojnë në bashkëpjesëmarrje në familje dhe në Kishë, dhe mund të mësojmë parimet mbi atë se cilat jemi, çfarë besojmë dhe çfarë duhet të mbrojmë. Presidenca e Parë na ka nxitur që ta studiojmë këtë libër të rëndësishëm dhe që “t’i lejojmë të vërtetat e tij të përjetshme dhe shembujt e tij frymëzues të ndikojnë në jetën [tonë]”²⁴.

Ndërsa motrat harmonizohen më shumë me qëllimet e Shoqatës së Ndihmës, vizioni i profetëve do të përmbushet. Presidenti Kimball tha: “Ka një fuqi në këtë organizatë [të Shoqatës së Ndihmës] që nuk është ushtruar ende plotësisht, për të forcuar shtëpitë e Sionit dhe për të ndërtuar Mbretërinë e Perëndisë – dhe as nuk do të ushtrohet derisa edhe motrat edhe priftëria të rrokin vizionin e Shoqatës së Ndihmës”²⁵. Ai profetizoi se “shumica e rritjes më të madhe që po i vjen Kishës në kohët e fundit, do të vijë sepse shumë prej grave të mira të botës (në të cilat shpesh ka . . . një ndjesi të brendshme shpirtshmërie) do të tërhiqen në Kishë në numër të madh. Kjo do të ndodhë në atë masë që gratë e Kishës . . . të shihen si të dalluara e të ndryshme – në mënyra të lumtura – nga gratë e botës.”²⁶

Unë jam mirënjohëse për vizionin e profetëve lidhur me Shoqatën e Ndihmës. Unë, ashtu si Presidenti Gordon B. Hinkli, “jam [e] bindur se nuk ka askund ndonjë organizatë që të barazohet me Shoqatën e Ndihmës së kësaj Kishe”²⁷. Është përgjegjësia jonë tani që të rreshtohemi me vizionin e profetëve në lidhje me Shoqatën e Ndihmës ndërsa përpiqemi të rrisim besimin, forcojmë familjet dhe sigurojmë ndihmë.

Po e mbyll me fjalët e Presidentit Lorenzo Snou: “E ardhmja e Shoqatës [së Ndihmës] është plot me premtim. Ndërsa Kisha rritet, Shoqata do të bëhet më gjerësisht e dobishme dhe do të jetë edhe më e fuqishme për mirë sesa ka qenë në të shkuarën.”²⁸ Motrave që ndihmojnë në përparimin e mbretërisë së Perëndisë, ai u tha: “Meqenëse keni marrë pjesë në këto punë, me shumë siguri po ashtu do të merrni pjesë në triumfin e veprës dhe në ekzaltimin e lavdinë që Zoti do t’u japë fëmijëve të Tij besnikë”²⁹. Për këtë vizion unë gjithashtu jap dëshmi, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Shih Xhuli B. Bek, “Plotësimi i Qëllimit të Shoqatës së Ndihmës”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 108–111.
2. Shih Julie B. Beck, BYU Women’s Conference address (29 prill 2011), <http://ce.byu.edu/cw/womensconference/archive/2011/>

pdf/JulieB_openingS.pdf; Xhuli B. Bek, “Ajo çka Unë Shpresoj se Mbesat e Mia (dhe Nipërit e Mi) do të Kuptojnë rreth Shoqatës së Ndihmës”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 109–113; Xhuli B. Bek, “Shoqata e

- Ndihmës: Një Punë e Shenjtë”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 110–114.
3. Shih Julie B. Beck, “Why We Are Organized into Quorums and Relief Societies” (Brigham Young University devotional address, 17 janar 2012), speeches.byu.edu.
 4. Ky mesazh nuk është një këqyrje gjithëpërfshirëse e të gjitha deklaratave profetike në lidhje me Shoqatën e Ndhmës. Është vetëm një model i vizionit dhe drejtimit të tyre. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society*, raportet e konferencave dhe botime të tjera të Kishës përmbajnë më shumë mësim mbi këtë temë.
 5. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 13.
 6. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 15.
 7. Brigham Young, në *Daughters in My Kingdom*, f. 41.
 8. Joseph F. Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 65–66.
 9. Joseph Fielding Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 142.
 10. Joseph Fielding Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 97.
 11. Boyd K. Packer, në *Daughters in My Kingdom*, f. 85.
 12. Shih Boyd K. Packer, “The Circle of Sisters”, *Ensign*, nëntor 1980, f. 110.
 13. Shih First Presidency letters, 19 mars 2003 dhe 23 shkurt 2007.
 14. Shih *Daughters in My Kingdom*, f. 3–6.
 15. Boyd K. Packer, në *Daughters in My Kingdom*, f. 16.
 16. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 17.
 17. Joseph Smith, në *History of the Church*, 4:602.
 18. John A. Widtsoe, në *Daughters in My Kingdom*, f. 25.
 19. Boyd K. Packer, *Ensign*, nëntor 1980, f. 110.
 20. Joseph Fielding Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 142.
 21. Spencer W. Kimball, në *Daughters in My Kingdom*, f. 117.
 22. Harold B. Lee, “The Place of Relief Society in the Welfare Plan”, *Relief Society Magazine*, dhjetor 1946, f. 842.
 23. Joseph F. Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 66.
 24. The First Presidency, në *Daughters in My Kingdom*, f. ix.
 25. Spencer W. Kimball, në *Daughters in My Kingdom*, f. 142.
 26. Spencer W. Kimball, në *Daughters in My Kingdom*, f. 95.
 27. Gordon B. Hinckley, në *Daughters in My Kingdom*, f. 160.
 28. Lorenzo Snow, në *Daughters in My Kingdom*, f. 19.
 29. Lorenzo Snow, në *Daughters in My Kingdom*, f. 7.

Doktrina e Krishtit

Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Në Kishë sot, ashtu si edhe në Kishën e hershme, vendosja e doktrinës së Krishtit ose korrigjimi i shmangieve doktrimore është çështje e zbulesës hyjnore.

I shprehim mirënjohjen dhe dashurinë tonë më të thellë Motrës Bek, Motrës Ollred dhe Motrës Tompson, si dhe trupës drejtuese të Shoqatës së Ndihmës.

Ne kemi parë së fundi një rritje të interesit publik për bindjet e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kjo është diçka që ne e mirëpresim, sepse, në fund të fundit, qëllimi kryesor i Kishës është që të japë mësim ungjillin e Jezu Krishtit, doktrinën e Tij, në të gjithë botën (shih Mateu 28:19–20; DeB 112:28). Por ne duhet ta pranojmë se ka pasur dhe ende vazhdon të ketë ca ngatërresa rreth doktrinës sonë dhe mënyrës si u themelua ajo. Kjo është tema për të cilën dëshiroj të flas sot.

Shpëtimtari e dha mësim doktrinën e Tij në meridianin e kohës dhe Apostujt e Tij luftuan fuqimisht që ta ruanin atë nga një sulm i vazhdueshëm i traditave të rreme dhe filozofisë. Letrat e Dhiatës së Re përmendin një sërë incidentesh që tregojnë se një braktisje e rëndë dhe e përhapur gjerësisht, kishte filluar tashmë gjatë shërbesës së Apostujve.¹

Shekujt që vijuan, u ndriçuan nga rreze rastësore të dritës së ungjillit derisa, në shekullin e 19-të, zbardhi në botë një agim i shndritshëm i Rivendosjes dhe ungjilli i Krishtit, i tërë e i plotësuar, qe sërish në tokë. Kjo ditë e lavdishme filloi kur, në “një shtyllë drite . . . më [të] shkëlqyeshme se dielli” (Joseph Smith – Historia 1:16), Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti, vizituan të riun Jozef Smith dhe nisën atë që do të bëhej si

një përmbytje zbuluese që erdhi së bashku me fuqi dhe autoritet hyjnor.

Në këto zbuluesa, ne gjejmë atë që mund të quhet doktrina themelore e Kishës së rivendosur të Jezu Krishtit mbi tokë. Vetë Jezusi e përkufizoi atë doktrinë në këto fjalë të shënuara në Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit:

“Kjo është doktrina ime dhe ajo është doktrina që Ati më dha mua; dhe unë dëshmoj për Atin dhe Ati dëshmon për mua, dhe Fryma e Shenjtë dëshmon për Atin dhe për mua; dhe unë dëshmoj që Ati i urdhëron të gjithë njerëzit, kudo, të pendohen dhe të besojnë në mua.

Dhe kushdo që beson në mua dhe pagëzohet, po ai do të shpëtojë; dhe ata janë ata që do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë.

Dhe kushdo që nuk beson në mua dhe nuk pagëzohet, do të mallkohet.

. . . dhe kushdo që beson në mua, beson gjithashtu në Atin; dhe atij Ati do t’i dëshmojë për mua, pasi ai do ta vizitojë atë me zjarr dhe me Frymën e Shenjtë. . . .

Në të vërtetë, në të vërtetë, unë ju them juve se kjo është doktrina ime dhe kushdo që ndërton mbi këtë, ndërton mbi shkëmbin tim dhe portat e ferrit nuk do të triumfojnë mbi të” (3 Nefi 11:32–35, 39).

Ky është mesazhi ynë, shkëmbi mbi të cilin ne ndërtojmë, themeli i gjithçkaje tjetër në Kishë. Si gjithçka që vjen nga Perëndia, kjo doktrinë është e kulluar, është e pastër, është e thjeshtë për t’u kuptuar – madje dhe për një fëmijë. Me zemra të gëzuara, ne i ftojmë të gjithë ta marrin atë.

Në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme “ne besojmë gjithçka që Perëndia ka zbuluar, gjithçka që Ai zbulon tani dhe ne besojmë se Ai përsëri do të zbulojë shumë gjëra të mëdha dhe të rëndësishme lidhur me Mbretërinë e Perëndisë” (Nenet e Besimit 1:9). Kjo do të thotë se, ndërkohë që ka mjaft gjëra që ende nuk i dimë, të vërtetat dhe doktrina që kemi marrë kanë ardhur dhe do të vazhdojnë të vijnë nëpërmjet zbuluesës hyjnore. Në disa tradita besimi, teologët pretendojnë autoritet të barabartë mësimdhënieje me udhëheqjen fetare dhe çështjet doktrimore mund të bëhen një luftë opinionesh

midis tyre. Disa mbështeten te këshillat e mëdhenj të Mesjetës dhe kredot e tyre. Të tjerët e vënë theksin kryesisht te arsyetimet pas kohës së Apostujve ose mbi parimet e interpretimit të Biblës dhe interpretimet shpjeguese apo kritikuese të Biblës. Ne e çmojmë diturinë që zgjeron kuptueshmërinë, por në Kishë sot, ashtu si edhe në Kishën e hershme, vendosja e doktrinës së Krishtit ose korrigjimi i shmangieve doktrimore është çështje e zbulues hyjnore për ata që Zoti u jep autoritetin e një Apostulli.²

Në vitin 1954, Presidenti J. Ruben Klark i Riu, në atë kohë këshilltar në Presidencën e Parë, shpjegoi mënyrën si bëhet e njohur doktrina në Kishë dhe për rolin parësor të Presidentit të Kishës. Duke folur për anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ai shpalli: “[Ne] duhet të [sjellim] ndër mend se disave prej Autoriteteve të Përgjithshme u është caktuar një thirrje e veçantë; ata zotërojnë një dhuratë të veçantë; ata mbështeten si profetë, shikues e zbulues, që u jep atyre një indaument të veçantë shpirtëror në lidhje me mësimet që ata u japin njerëzve. Ata kanë të drejtën, fuqinë dhe autoritetin për t’u deklaruar njerëzve mendimet dhe vullnetin e Perëndisë, të varur nga fuqia e plotë dhe autoriteti i Presidentit të Kishës. Disa të tjerëve prej Autoriteteve të Përgjithshme nuk u është dhënë kjo dhuratë dhe autoritet i veçantë shpirtëror lidhur me mësimdhënien e tyre; për ata rezulton një kufizim dhe, kufizimi rezultues në fuqinë dhe autoritetin e tyre në mësimdhënie, zbatohet për çdo drejtues dhe anëtar tjetër të Kishës, pasi asnjëri prej tyre nuk ka marrë dhuratën shpirtërore si profet, shikues e zbulues. Veç kësaj, siç tregohet, Presidenti i Kishës ka një dhuratë më tepër e të veçantë në këtë drejtim, pasi ai është Profet, Shikues dhe Zbulues për të gjithë Kishën.”³

Si ua zbulon Shpëtimtari vullnetin dhe doktrinën e Tij profetëve, shikuesve e zbuluesve? Ai mund të veprojë nëpërmjet një lajmëtari ose personalisht. Ai mund të flasë me vetë zërin e Tij ose me anë të zërit të Shpirtit të Shenjtë – një komunikim Shpirt me shpirt që mund të shprehet me fjalë ose ndjenja që përçojnë kuptueshmëri përtej fjalëve (shih 1 Nefi 17:45; DeB 9:8). Ai mund t’u drejtohet Vetë shërbëtorëve të Tij një e nga një ose si këshill (shih 3 Nefi 27:1–8).

Po përmend dy histori nga Dhiata e Re. E para qe një zbulesë drejtuar kreut të Kishës. Në fillim të librit të Veprave të Apostujve ne shohim se Apostujt e Krishtit po ua shpallnin vetëm judenjve mesazhin e ungjillit, duke ndjekur modelin e shërbesës së Jezusit (shih Mateu 15:24), por tani, sipas kalendarit të Zotit, kishte ardhur koha për një ndryshim. Në Jopë, Pjetri pa një ëndërr në të cilën pa një larmi kafshësh që zbritën nga qielli në tokë me anë të “një çarçafi të madh . . . të lidhur në të katër cepat” (Veprat e Apostujve 10:11) e u urdhërua të “ther[te] dhe [të] ha[nte]” (Veprat e Apostujve 10:13). Pjetri nuk pranoi duke qenë se disa prej kafshëve qenë “të papastra” sipas ligjit të Moisiut dhe Pjetri nuk e kishte thyer kurrë urdhërimin që qe kundër ngrënies së tyre. Megjithatë, zëri në ëndërr i tha Pjetrit: “Gjërat që Perëndia i ka pastruar, ti mos i bëj të papastra” (Veprat e Apostujve 10:15).

Domethënia e kësaj ëndrre u bë e qartë kur menjëherë pas kësaj, disa burra të dërguar nga centurioni romak Korneli, mbërritën në banesën e Pjetrit me një kërkesë që ai të shkonte t’i jepte mësim të zotit. Korneli kishte mbledhur një grup të konsiderueshëm të afërmish e miqsh dhe, kur i gjeti ata duke pritur me padurim që të merrnin mesazhin e tij, Pjetri tha:

“Perëndia më dëftoi që të mos e quaj asnjë njeri të papastër a të ndotur. . . .

. . . Në të vërtetë unë po e marr vesh se Perëndia nuk tregohet i anshëm;

por në çfarëdo kombi, ai që ka frikë prej tij dhe vepron drejtësisht, është i pranuar nga ai” (Veprat e Apostujve 10:28, 34–35; shih edhe vargjet 17–24).

“Ndërsa Pjetri ende po i thoshte këto fjalë, Fryma e Shenjtë zbriti mbi të gjithë ata që po e dëgjonin fjalën.

Dhe të gjithë [ata që qenë me Pjetrin] . . . u mrekulluan që dhurata e Frymës se Shenjtë u shpërnda edhe mbi johebrenjtë.

. . . Atëherë Pjetri filloi të thotë:

‘A mund ta ndalojë dikush ujin, që të mos pagëzohen këta që kanë marrë Frymën e Shenjtë pikërisht si ne?’” (Veprat e Apostujve 10:44–47).

Me anë të kësaj përvoje dhe zbulesë ndaj Pjetrit, Zoti i ndryshoi praktikat e Kishës dhe u zbuloi dishepuje të Tij një

kuptueshmëri më të plotë. Dhe kështu predikimi i ungjillit u zgjerua për të përfshirë të gjithë njerëzimin.

Më tej në librin e Veprave të Apostujve, ne gjejmë një histori të lidhur ngjashëm, këtë herë duke treguar se si zbulesa në çështjet doktrinale mund të vijë në një mbledhje këshilli. Lindën polemika rreth faktit nëse duhej vazhduar rrethprerja e detyrueshme sipas ligjit të Moisiut si një urdhërim i ungjillit dhe Kishës së Krishtit (shih Veprat e Apostujve 15:1, 5). “Atëherë apostujt dhe pleqtë u mbledhën për ta shqyrtuar këtë problem” (Veprat e Apostujve 15:6). Dokumentimi i këtij këshilli prej nesh është me siguri i mangët, por na është thënë se pas “një diskutim[i të] madh” (Veprat e Apostujve 15:7), Pjetri, Apostulli më i moshuar, u ngrit dhe shpalli atë që Fryma e Shenjtë i kishte pohuar atij. Ai i kujtoi këshillit se kur filloi t’u predikohet ungjilli johebrenjve të parrethprerë në shtëpinë e Kornelit, ata e morën Frymën e Shenjtë njësoj siç e kishin marrë të kthyerit në besim judenj që qenë të rrethprerë. Perëndia, tha ai “nuk bëri asnjë dallim midis nesh dhe atyre, duke i pastruar zemrat e tyre me anë të besimit.

Tani, pra, pse e tundoni Perëndinë, duke u vënë mbi qafën e dishepujve një zgjedhë që as etërit tanë e as ne nuk mund ta mbajmë?

Po ne besojmë se do të shpëtohem me anë të hirit të Zotit Jezu Krishtit, dhe në të njëjtën mënyrë edhe ata” (Veprat e Apostujve 15:9–11; shih edhe vargun 8).

Pasi Pali, Barnaba e ndoshta edhe të tjerë, folën për të përkrahur shpalljen e Pjetrit, Jakobi propozoi që vendimi të dërgohej me shkrim në Kishë dhe këshilli që i bashkuar “me një zemër” (Veprat e Apostujve 15:25; shih edhe vargjet 12–23). Në letrën që njoftonte vendimin e tyre, Apostujt thanë: “Na u duk mirë Frymës së Shenjtë dhe neve” (Veprat e Apostujve 15:28), ose me fjalë të tjera, ky vendim erdhi nga zbulesa hyjnore nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë.

Në Kishën e rivendosur të Jezu Krishtit ndiqen sot po të njëjtat modele. Presidenti i Kishës mund të njoftojë ose të interpretojë doktrina bazuar te zbulesat që i jepen (shih për shembull, DeB 138). Interpretimi doktrinor mund të vijë edhe nëpërmjet bashkimit të dy këshillave të Presidencës së Parë dhe

atij të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve (shih për shembull, Deklaratën Zyrtare 2). Diskutimet në këshill do të përfshijnë shpesh një peshim të veprave standarde të shkrimeve të shenjta, mësimet e udhëheqësve të Kishës dhe praktikata e mëparshme. Por në fund, ashtu si në Kishën e Dhiatës së Re, synimi nuk është thjesht marrëveshja e përgjithshme mes anëtarëve të këshillit, por zbulesa nga Perëndia. Ky është një proces që përfshin edhe arsyen edhe besimin për të mësuar mendjen dhe vullnetin e Zotit.⁴

Në të njëjtën kohë, duhet mbajtur mend se jo çdo deklaram i bërë nga një udhëheqës i Kishës, në të shkuarën ose në të tashmen, është doktrinë detyruese. Është përgjithësisht e kuptueshme në Kishë se një deklaram i bërë nga një udhëheqës mbi një rast të vetëm, shpesh përfaqëson një opinion vetjak, sado që është i menduar mirë, që nuk është e thënë të jetë zyrtar ose i detyrueshëm për të gjithë Kishën. Profeti Jozef Smith dha mësim se “një profet [është] një profet vetëm kur ai vepron si i tillë”⁵. Presidenti Klark, i cituar më sipër, vuri re:

“Kjo pikë vërtetohet nga një histori e thjeshtë që më ka treguar im atë kur isha i vogël, nuk e di për cilin autoritet, por e ilustron këtë pikë. Historia e tij që që, gjatë entuziazmit lidhur me ardhjen e Ushtrisë [së Xhonstonit], Vëllai Brigam u dha njerëzve në një mbledhje mëngjesi, një predikim që vlonte nga kundërshtimet për ushtrinë që po afrohej, dhe deklaronte një qëllim për t’u dalë kundër e për t’i kthyer mbrapsht. Në mbledhjen e pasdites, ai u ngrit dhe tha se në mëngjes kishte folur Brigam Jangu, por tani do të fliste Zoti. Më pas ai mbajti një fjalim, mesazhi i të cilit që në kundërshtim me fjalimin e mëngjesit. . . .

. . . Kisha do ta dijë me anë të dëshmisë së Frymës së Shenjtë që u jepet anëtarëve, nëse vëllezërit që thonë këndvështrimet e tyre, ‘nxiten nga Fryma e Shenjtë’; dhe përfundimisht ajo njohuri do të dëftohet.”⁶

Profeti Jozef Smith pohoi rolin qendror të Shpëtimtarit në doktrinën tonë në një fjali përkufizuese: “Parimet themelore të besimit tonë janë dëshmia e Apostujve dhe Profetëve në lidhje me Jezu Krishtin, që Ai vdiq, u varros, u ngrit sërish ditën e tretë dhe u ngjiti në qiell; dhe gjithë gjërat e tjera që i përkasin besimit tonë

janë vetëm shtojca të kësaj⁷⁷. Dëshmia e Jozef Smithit për Jezusin është se Ai jeton, “pasi [ai] e pa Atë, madje në të djathtën e Perëndisë; dhe [ai] e dëgjo[i] zërin duke dhënë dëshmi se ai është i Vetëmlinduri i Atit” (DeB 76:23; shih edhe vargun 22). Unë u bëj thirrje të gjithë atyre që e dëgjojnë apo e lexojnë këtë mesazh, që të kërkojnë përmes lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta të njëjtën dëshmi të natyrës hyjnore, të Shlyerjes dhe Ringjalljes së Jezu Krishtit. Pranojeni doktrinën e Tij me anë të pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe më pas gjatë gjithë jetës duke zbatuar ligjet dhe besëlidhjet e ungjillit të Jezu Krishtit.

Ndërsa festa jonë e Pashkës afron, unë shpreh dëshminë time vetjake se Jezusi i Nazaretit ishte dhe është Biri i Perëndisë, i njëjti Mesia i profecisë së lashtë. Ai është Krishti që vuajti në Gjetseman, që vdiq në kryq e u varros dhe që u ngrit vërtet ditën e tretë. Ai është Zoti i ringjallur, përmes së cilit të gjithë ne do të ringjallemi dhe me anë të të cilit të gjithë ata që janë të gatshëm, mund të shëlbepen dhe ekzaltohen në mbretërinë e Tij qiellore. Kjo është doktrina jonë, që pohon të gjitha dëshmitë e mëparshme të Jezu Krishtit dhe që u shpall sërish për kohën tonë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Shih Neal A. Maxwell, “From the Beginning”, *Ensign*, nëntor 1993, f. 18–19:

“Jakobi qortoi ‘luftërat dhe grindjet te’ Kisha (Jakobi 4:1). Pali u pikëllua për ‘përçarje[t]’ në Kishë dhe mënyrën se si ‘ujqër[it] grabitqarë’ nuk do ta kursenin ‘tufën’ (1 Korintasve 11:18; Veprat e Apostujve 20:29–31). Ai e dinte se po afronte braktisja dhe u shkroi thesalonikasve se ardhja e dytë e Jezusit nuk do të ndodhte ‘pa ardhur më parë rënia’; duke këshilluar më tej se ‘pa dhësi[a] në fakt është tashmë në veprim’ (2 Thesalonikasve 2:3, 7).

Pranë fundit, Pali e pranoi sa e plotë që braktisja: ‘Të gjithë ata që

janë në Azi më kthyen krahët’ (2 Timoteut 1:15). . . .

Lavirësia dhe idhujtaria e përhapur gjerësisht i alarmoi apostujt (shih 1 Korintasve 5:9; Efesianëve 5:3; Judë 1:7). Si Gjoni ashtu dhe Pali vajtojnë ngritjen e Apostujve të rremë (shih 2 Korintasve 11:13; Zbulesa 2:2). Kisha që qartazi nën rrethim. Disa jo vetëm që u larguan nga Kisha, por e kundërshtuan atë haptas. Në një rrethanë, Pali qëndroi i vetëm dhe u ankua se ‘të gjithë më lanë’ (2 Timoteut 4:16). Ai i kritikoi gjithashtu ata që ‘ngatërr[uan] familje të tëra’ (Titit 1:11).

Disa udhëheqës vendorë u rebeluan, pasi njëri, të cilit i pëlqente epërsia e tij, refuzoi t’i

priste vëllezërit (shih 3 Gjoni 1:9–10).

Nuk është çudi që Presidenti Brigam Jang vuri në dukje: ‘Është thënë se Priftëria u mor nga Kisha, por nuk është kështu, Kisha u largua nga Priftëria’ (në *Journal of Discourses*, 12:69).’’

Me kalimin e kohës, ashtu siç e shprehu Plaku Maksuell, “arsyeja, që qe tradita filozofike greke, e mbizotëroi, më pas e zëvendësoi mbështetjen te zbulesa, një rezultat ky, ndoshta i përshpejtuar nga të krishterë me qëllime të mira, që dëshironin t’i bënëin bindjet e tyre më të pranuar gjerësisht në kulturën e kohës. . . .

. . . Le të jemi të matur [gjithashtu] mbi interpretimin e zbulësive që të jenë më në harmoni me atë që besojnë shumica e njerëzve” (*Ensign*, nëntor 1993, f. 19–20).

2. Apostuj dhe profetë të tillë si Jozef Smithi shpallin fjalën e Perëndisë por, përveç kësaj, ne besojmë se burrat dhe gratë në përgjithësi dhe madje fëmijët mund të mësojnë dhe mund të drejtohen nga frymëzimi hyjnor në përgjigje të lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta. Njësoj si në kohën e Apostujve të lashtë, anëtarëve të Kishës së Jezu Krishtit u jepet dhurata e Frymës së Shenjtë, e cila mundëson një komunikim të vazhdueshëm me Atin e tyre Qiellor, ose, me fjalë të tjera, zbulësë personale (shih Veprat e Apostujve 2:37–38). Në këtë mënyrë, Kisha bëhet një grup individësh të zotuar dhe të pjekur shpirtërisht, besimi i të cilëve nuk është i pranuar pa kushte, por i bazuar në të parin e rezultateve të përvojës vetjake – i dhënë njoftim dhe i vërtetuar nga Shpirti i Shenjtë. Kjo nuk do të thotë se çdo anëtar flet në emër të Kishës apo mund të përcaktojë doktrinat e saj,

por që secili mund të marrë drejtim hyjnor në përballjen me sfidat dhe mundësitë e jetës së tij apo të saj.

3. J. Reuben Clark Jr., “When Are Church Leaders’ Words Entitled to Claim of Scripture?” *Church News*, 31 korrik 1954, f. 9–10; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 28:1–2, 6–7, 11–13.
4. Përgatitja dhe kualifikimet e kërkuara për pjesëmarrësit në kështill janë “drejtësi, shenjtëri e përlulesi të zemrës, butësi e durim, . . . besim, dhe virtyt, dhe dituri, vetkontroll, qëndrësë, përëndishmëri, mirësi vëllazërore dhe dashuri hyjnore; Ngaqë premtimi është: nëse këto gjëra gjenden me shumicë në ta, ata nuk do të jenë të pafryt në diturinë e Zotit” (Doktrina e Besëlidhje 107:30–31).

5. Joseph Smith, në *History of the Church*, 5:265.

6. J. Reuben Clark Jr., “Church Leaders’ Words”, f. 10. Mbi historinë që i tregoi i ati për Brigam Jangun, Presidenti Klark shkroi me tej:

“Nuk e di nëse ka ndodhur kjo ndonjëherë, por them se e ilustron një parim – që madje vetë Presidenti i Kishës, mund të mos jetë gjithmonë ‘i nxitur nga Fryma e Shenjtë’, kur ai u flet njerëzve. Kjo ka ndodhur për çështje doktrinore (zakonisht të një natyre shumë të diskutueshme) ku Presidentët pasues të Kishës dhe vetë njerëzit kanë ndier se në shpalljen e doktrinës, njoftuesi nuk qe ‘i nxitur nga Fryma e Shenjtë’.

Si do ta dijë Kisha se kur këto ekspedita aventureske të vëllezërve në këto parime e doktrina shumë të diskutueshme i përbushin kërkesat e statuteve se njoftuesit kanë qenë për pasojë ‘të nxitur nga Fryma e Shenjtë’? Kisha do ta dijë me anë të dëshmisë së Frymës së

Shenjtë që u jepet anëtarëve, nëse vëllezërit që thonë këndvështrimet e tyre, 'nxiten nga Fryma e Shenjtë'; dhe përfundimisht ajo njohuri do

të dëftohet" ("Church Leaders' Words", f. 10).

7. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 52.

Vrapimi i Jetës

Nga Presidenti Tomas S. Monson

Nga kemi ardhur? Përse jemi këtu? Ku shkojmë pasi largohemi nga kjo jetë? Këto pyetje universale nuk kanë pse të mbeten më pa përgjigje.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, këtë mëngjes dëshiroj t'ju flas për të vërtetat e përjetshme – ato të vërteta që do ta pasurojnë jetën tonë dhe do të na kthejnë të sigurt në shtëpi.

Gjithandej njerëzit e kanë me ngut. Avionë me motorë reaktivë çojnë me vrik ngarkesën e tyre të çmuar njerëzore përmes kontinenteve të mëdha dhe oqeanëve të paanë që të mund të merret pjesë në takimet e punës, të përmbushen detyrimet, të gëzohen pushimet ose të vizitohen familjet. Gjithandej rrugët tokësore – duke përfshirë rrugë shumëkalimshe, autostrada dhe rrugë për automjete të shpejta – mbajnë miliona automjete, të mbushura me miliona njerëz, në një rrjedhë në dukje të pafund dhe për një tufë arsyesish ndërsa nxitojmë në punën e përditshme.

Në këtë jetë me ritëm të përshpejtuar, a ndalojmë ne ndonjëherë për çaste meditimi – madje mendime për të vërteta të përjetshme?

Kur krahasohen me të vërtetat e përjetshme, shumica e pyetjeve dhe shqetësimeve të jetës së përditshme janë me të vërtetë shumë të parëndësishme. Çfarë duhet të hamë për darkë? Me çfarë ngjyre duhet ta lyejmë dhomën e ndenjes? A duhet ta regjistrojmë Xhonin në futboll? Këtyre pyetjeve dhe të tjerave të panumërta si këto, u zbehet rëndësia kur vijnë kohë krizash, kur njerëz të dashur lëndohen apo dëmtohen, kur sëmundja hyn në një shtëpi me shëndet të mirë, kur qiriri i jetës tretet dhe errësira

kërcënon. Mendimet tona bëhen të mprehta dhe ne jemi lehtësisht të aftë të përcaktojmë se çfarë është vërtet e rëndësishme dhe çfarë është thjesht e parëndësishme.

Së fundi, vizitova një grua që po lufton me një sëmundje të rrezikshme për jetën prej më tepër se dy vjet. Ajo tregoi se, përpara sëmundjes, ditët e saj qenë të mbushura me aktivitete të tilla si pastrimi i shtëpisë së saj deri në përsosmëri dhe mbushja e saj me mobilje të bukura e të kushtueshme. Ajo shkante tek parukierja dy herë në javë dhe shpenzonte para e kohë çdo muaj duke i shtuar veshje gardërobës së saj. Nipërit e mbesat e saj nuk ftoheshin shpesh për vizitë, sepse ajo qe gjithmonë e shqetësuar se ato që ajo i konsideronte zotërimet e saj me vlerë, mund të thyheshin ose të prisheshin në ndonjë mënyrë tjetër, nga duar të vockëla e të pakujdesshme.

Dhe më pas ajo mori lajmin tronditës se jeta e saj në vdekshmëri qe në rrezik dhe se asaj mund t'i kishte mbetur një kohë shumë e kufizuar këtu. Ajo tha se, në çastin që dëgjoi diagnozën nga doktori, ajo e dinte menjëherë se do ta kalonte atë kohë që i kishte mbetur, me familjen e miqtë e saj dhe me ungjillin në qendrën e jetës së saj, sepse këto përfaqësonin atë që ishte më me vlerë për të.

Çaste të tilla qartësie na vijnë të gjithëve ne në një kohë apo në një tjetër, edhe pse ndoshta jo gjithmonë përmes një rrethane kaq dramatike. Ne shohim qartë se çfarë është ajo që ka vërtet rëndësi në jetën tonë dhe si duhet të jetojmë.

Tha Shpëtimtari:

“Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin, përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin.

Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj.”¹

Në kohët tona të meditimit më të thellë apo nevojës më të madhe, shpirti njerëzor zgjatet drejt qiellit, duke kërkuar një përgjigje hyjnore për pyetjet më të mëdha të jetës: *Nga kemi ardhur? Përse jemi këtu? Ku shkojmë pasi largohemi nga kjo jetë?*

Përgjigjet e këtyre pyetjeve nuk zbulohen brenda kapakëve të librave akademikë ose duke kërkuar në internet. Këto pyetje e kapërcejnë vdekshmërinë. Ato përqafojnë përjetësinë.

Nga kemi ardhur? Kjo pyetje mendohet në mënyrë të pashmangshme, edhe nëse nuk shprehet, nga çdo qenie njerëzore.

Apostulli Pal u tha athinasve në mes të Aeropagut se “ne jemi pasardhës të Perëndisë”². Duke qenë se e dimë që trupat tanë fizikë e kanë prejardhjen nga prindërit tanë të vdekshëm, duhet të kërkojmë kuptimin e deklaramit të Palit. Zoti deklaroi se “fryma e trupi janë shpirti i njeriut”³. Kështu është shpirti që është pasardhës i Perëndisë. Autori i hebrenjve i drejtohet Atij si “Ati [i] shpirtave”⁴. Shpirtrat e të gjithë njerëzve janë me të vërtetë “bija e bija të lindura të [Tij]”⁵.

Ne vëmë re se poetë të frymëzuar, për studimin e kësaj teme nga ana jonë, kanë shkruar mesazhe mallëngjyese dhe mendime të mrekullueshme. Poeti anglez Uilliam Uordsuorth shkroi të vërtetën:

*Lindja jonë është veç një gjumë e një harresë:
Shpirti që kemi në lindje, është si një yll,
Tjetërkund e ka banesën,
Dhe prej së largu vjen:
Ne nuk kemi harruar gjithçka,
Dhe nuk jemi tërësisht të papërgatitur,
Por prej shtigje resh të lavdishme ne vijmë
Nga Perëndia, që është shtëpia jonë:
Qiellin e kemi pranë në foshnjërinë tonë!*⁶

Prindërit meditojnë rreth përgjegjësisë së tyre për të dhënë mësim, frymëzuar dhe për të dhënë udhëzim, drejtim dhe shembull. Dhe ndërsa prindërit mendojnë thellë, fëmijët – dhe veçanërisht të rinjtë – bëjnë pyetjen depërtuese: “Përse jemi këtu?” Zakonisht, i thuhet dhe i shprehet në heshtje shpirtit: “Përse jam unë këtu?”

Sa mirënjohës duhet të jemi që një Krijues i urtë i dha formë tokës dhe na solli këtu me një vel harrese për ekzistencën tonë të mëparshme në mënyrë që të përjetojmë një periudhë prove, një

mundësi për të provuar veten, që të mund të kualifikohemi për gjithçka që Perëndia ka përgatitur që të marrim.

Qartazi, një qëllim kryesor i ekzistencës sonë në tokë është që të marrim një trup prej mishi e kockash. Neve na është dhënë gjithashtu dhurata e lirisë së zgjedhjes. Ne jemi të privilegjuar në një mijë mënyra për të zgjedhur për veten tonë. Këtu ne mësojmë nga mbikëqyrësi i rreptë i përvojës. Ne dallojmë të mirën nga e keqja. Ne bëjmë dallimin mes të hidhurës e të ëmbles. Ne zbulojmë se ka pasoja të lidhura me veprimet tona.

Me anë të bindjes ndaj urdhërimeve të Perëndisë, ne mund të kualifikohemi për atë "shtëpi" për të cilën foli Jezusi kur deklaroi: "Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa. . . . Unë po shkoj t'ju përgatis një vend . . . që aty ku jam unë, të jeni edhe ju."⁷

Megjithëse vijmë në vdekshmëri prej "shtigje resh të lavdishme", jeta shkon përpara në mënyrë të pamëshirshme. Rinia ndjek fëmijërinë dhe pjekuria vjen përherë kaq pa u kuptuar. Nga përvoja, ne mësojmë nevojën për t'iu drejtuar qiellit për ndihmë ndërsa ecim përgjatë udhës së jetës.

Perëndia, Ati ynë, dhe Jezu Krishti, Zoti ynë, e kanë shënuar udhën drejt përsosmërisë. Ata na thërrasin që të ndjekim të vërtetat e përgjithshme dhe që të bëhemi të përkryer, si janë Ata të përkryer.⁸

Apostulli Pal e krahasoi jetën me një vrapim. Ai u bëri thirrje hebrejve: "Duke hedhur tej . . . mëkatin që na qarkon vazhdimisht duke na joshur, le të rendim me durim në udhën që është përpara nesh"⁹.

Në përkushtimin tonë, le të mos e anashkalojmë këshillën e urtë nga Predikuesit: "Vrapimi nuk fitohet nga ai që është i shpejtë as beteja nga të fortët"¹⁰. Në të vërtetë, çmimi i përket atij ose asaj që duron deri në fund.

Kur mendoj për vrapimin e jetës, unë kujtoj një lloj tjetër vrapimi, madje që nga ditët e fëmijërisë. Shokët e mi dhe unë merrnim thika xhepi në dorë dhe formonim barka të vogla e të kohës prej lodre nga druri i butë i një peme shelgu. Me një velë të pambuktë në formë trekëndore të vendosur, secili do ta lëshonte barkën e tij të papërpunuar mirë në një garë përgjatë ujërave të trazuara të lumit të Provos në Juta. Ne vraponim përgjatë bregut të lumit dhe i shihnim anijet e vockëla herë duke pluskuar fort në

rrymën e shpeshtë dhe herë duke lundruar qetësisht ndërsa uji thellohej.

Gjatë një gare të tillë, ne vumë re se një barkë i drejtoi gjithë të tjerat drejt vijës së caktuar të përfundimit. Papritur, rryma e tërhoqi atë pranë një vorbulle të madhe dhe barka u anua dhe u përmbys. Ajo u tërhoq rreth e rrotull, pa mundur të çante për t'u kthyer sërish në rrymën kryesore. Në fund ajo pati një ndalesë të parehatshme në fund të vorbullës, mes mbeturinave të anijeve e ngarkesave që e rrethuan, e ngecur mes tentakulave të myshkut të gjelbër që e shtrëngonte.

Barkat prej lodre të fëmijërisë nuk kishin bazament për qëndrueshmëri, as timon për të siguruar drejtim dhe asnjë burim fuqie. Fati i tyre qe në mënyrë të pashmangshme që të ndiqnin rrymën – shtegun me rezistencë më të pakët.

Ndryshe nga barkat prej lodre, neve na janë siguruar karakteristika hyjnore që ta drejtojnë udhëtimin tonë. Ne hyjmë në vdekshmëri jo që të pluskojmë sipas rrymave të jetës që lëvizin, por me fuqi për të menduar, për të arsyetuar dhe për të pasur arritje.

Ati ynë Qiellor nuk na hodhi në udhëtimin tonë të përjetshëm pa na siguruar mjetet nëpërmjet të cilave ne mund të merrnim udhëzim nga Ai për të siguruar kthimin tonë të sigurt. Po flas për lutjen. Po flas edhe për pëshpëritjet nga ai zë i qetë, i ulët; dhe nuk lë pa përmendur shkrimet e shenjta që përmbajnë fjalët e Zotit dhe fjalët e profetëve – të cilat na janë siguruar për të na ndihmuar të arrijmë me sukses te vija e përfundimit.

Në njëfarë kohe të misionit tonë në vdekshmëri, shfaqet çapitja ngurruese, buzëqeshja e venitur dhe dhembja e sëmundjes – madje zhdukja e verës së rinisë, afrimi i vjeshtës, acari i dimrit të plakjes dhe përvoja që e quajmë vdekje.

Çdo njeri i kujdesshëm i ka bërë vetes pyetjen që e shprehu më së miri Jobi i lashtësisë: “Në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë?”¹¹ Sado të përpiqemi ta mbajmë pyetjen jashtë mendimeve tona, ajo gjithnjë kthehet. Vdekja i vjen të gjithë njerëzimit. U vjen të moshuarve ndërsa çapiten me këmbë të ligështuara. Thirrja e saj është dëgjuar nga ata që thuajse kanë arritur në mes të rrugës në udhëtimin e jetës. Ndonjëherë pushon të qeshurën e fëmijëve të vegjël.

Po çfarë lloj ekzistence ka përtej vdekjes? A është vdekja fundi i gjithçkaje? Robert Bletçford, në librin e tij *God and My Neighbor [Perëndia dhe i Afërmi Im]*, i sulmoi me forcë bindjet e pranuar të krishtera të tilla si: Perëndia, Krishti, lutja dhe veçanërisht pavdekshmëria. Ai pohoi me guxim se vdekja që fundi i ekzistencës sonë dhe se askush nuk mund të vërtetonte të kundërtën. Pastaj ndodhi diçka e habitshme. Muri i tij i skepticizmit papritmas u shkërmoq në pluhur. Ai mbeti i nënshtruar dhe i pambrojtur. Ngadalë, ai filloi të ndiente rrugën e kthimit për te besimi që kishte përqeshur dhe braktisur. Çfarë e kishte shkaktuar këtë ndryshim të thellë në pikëpamjen e tij? Bashkëshortja e tij vdiq. Me zemër të thyer ai shkoi në dhomën ku qëndronte gjithçka që e vdekshme prej saj. Ai pa përsëri fytyrën që e deshte aq shumë. Duke dalë, ai i tha një mikui: “Ajo është dhe prapëseprapë nuk është. Gjithçka ka ndryshuar. Diçka që e atje më parë është zhdukur. Ajo nuk është e njëjta. Çfarë mund të ketë ikur përveç shpirtit?”

Më pas ai shkroi: “Vdekja nuk është ajo që shumë njerëz përfytyrojnë. Është thjesht si të shkosh në një dhomë tjetër. Tek ajo dhomë tjetër ne do të gjejmë . . . gratë e burrat e dashur dhe fëmijët e ëmbël që kemi dashur dhe i kemi humbur.”¹²

Vëllezër e motra të mia, ne e dimë se vdekja nuk është fundi. Kjo e vërtetë është dhënë mësim nga profetët e gjallë nëpër epoka. Ajo gjendet edhe në shkrimet tona të shenjta. Në Librin e Mormonit ne lexojmë fjalë të posaçme dhe ngushëlluese:

“Tani, në lidhje me gjendjen e shpirtit midis vdekjes dhe ringjalljes – Vër re, mua m’u bë e ditur nga një engjell që shpirtrat e të gjithë njerëzve, posa të largohen nga ky trup i vdekshëm, po, shpirtrat e të gjithë njerëzve, qofshin ata të mirë ose të ligj, çohen në shtëpi tek ai Perëndi që u dha atyre jetë.

Dhe do të ndodhë që shpirtrat e atyre që janë të drejtë pranohen në një gjendje lumturie që quhet parajsë, një gjendje e pushimit, një gjendje e paqes, ku ata do të prehen nga të gjitha trazirat e tyre dhe nga të gjitha vuajtjet dhe brengat.”¹³

Pasi Shpëtimtari u kryqëzua dhe trupi i Tij që dergjur në varr për tri ditë, shpirti hyri përsëri në trup. Guri u rrokullis dhe Shëlbuesi i ringjallur shkoi përpara, i veshur me një trup të pavdekshëm prej mishi e kockash.

Përgjigjja për pyetjen e Jobit: “Në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë?” erdhi kur Maria dhe të tjerat u afruan te varri dhe panë dy burra me veshje të shndritshme që u folën atyre: “Pse e kërkonit të gjallin midis të vdekurve? Ai nuk është këtu, por është ringjallur.”¹⁴

Si rrjedhim i fitores së Krishtit mbi varrin, ne të gjithë do të ringjallemi. Ky është shëlbimi i shpirtit. Pali shkroi: “Ka trupa qiellorë dhe trupa tokësorë; por tjetër është lavdia e trupave qiellorë e tjetër e atyre të tokës”¹⁵.

Është lavdia çelestiale ajo që kërkojmë ne. Është në prani të Perëndisë vendi ku dëshirojmë të banojmë. Është familja e përhershme ajo ku duam të jemi pjesëtarë. Bekime të tilla fitohen gjatë një jete mundimesh, kërkimi, pendimi dhe më në fund arritjes së suksesit.

Nga kemi ardhur? Përse jemi këtu? Ku shkojmë pasi largohemi nga kjo jetë? Këto pyetje universale nuk kanë pse të mbeten më pa përgjigje. Nga thellësia e shpirtit tim dhe me të gjithë përlësinë, unë dëshmoj se ato gjëra për të cilat kam folur janë të vërteta.

Ati ynë Qiellor gëzohet për ata që i mbajnë urdhërimet e Tij. Ai është i shqetësuar edhe për fëmijën e humbur, adoleshentin e vonuar, rininë e pabindur, prindin e papërgjegjshëm. Mjeshtri u flet me dhembisuri këtyre dhe në të vërtetë të gjithëve: “Kthehuni. Ngrihuni. Hyni. Ejani në shtëpi. Ejani tek unë.”

Për një javë ne do të festojmë Pashkën. Mendimet tona do të shkojnë te jeta e Shpëtimtarit, vdekja e Tij dhe Ringjallja e Tij. Si dëshmitar i Tij i veçantë, unë ju dëshmoj se Ai jeton dhe se Ai pret kthimin tonë ngadhënjimtar. Qoftë një kthim i tillë ai i yni, unë lutem përlësisht në emrin e Tij të shenjtë – madje Jezu Krishtit, Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, amen.

Shënime

1. Mateu 6:19–21.
2. Veprat e Apostujve 17:29.
3. Doktrina e Besëlidhje 88:15.
4. Hebrejve 12:9.
5. Doktrina e Besëlidhje 76:24.
6. William Wordsworth, *Ode: Intimations of Immortality from Recollections of Early Childhood* (1884), f. 23–24.
7. Gjoni 14:2–3.
8. Shih Mateu 5:48; 3 Nefi 12:48.
9. Hebrejve 12:1.
10. Predikuesit 9:11.
11. Jobi 14:14.
12. Shih Robert Blatchford, *More Things in Heaven and Earth: Adventures in Quest of a Soul* (1925), f. 11.
13. Alma 40:11–12.
14. Lluca 24:5–6.

15. 1 Korintasve 15:40.

Fuqia e Çlirimit

Nga Plaku L. Tom Peri,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ne mund të çlirohemi nga mënyrat mëkatore dhe ligësia duke u kthyer te mësimet e shkrimeve të shenjta.

Kam një mik shumë të mirë, i cili më dërgon nga një kravatë të re për ta vënë gjatë sesionit që flas në çdo konferencë të përgjithshme. Ka shije perfekte, a jeni dakord?

Miku im i ri ka disa sfida të vështira. Në disa mënyra ato e kufizojnë atë, por në mënyra të tjera ai është i jashtëzakonshëm. Për shembull, guximi i tij si misionar mund të krahasohet me atë të bijve të Mosias. Thjeshtësia e besimit që ka, i bën bindjet e tij tepër të forta dhe të qëndrueshme. Besoj se në mendjen e Skotit është e paimagjinueshme që jo çdokush është anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe që jo çdokush e ka lexuar Librin e Mormonit dhe ka një dëshmi të vërtetësisë së tij.

Më lejoni t'ju tregoj një ngjarje nga jeta e Skotit, kur ai po bënte udhëtimin e tij të parë vetëm me avion për të vizituar të vëllanë. Një fqinj, që ishte ulur pranë, dëgjoji padashur bisedën e Skotit me një person të ulur të krah të tij:

“Përshëndetje, emri im është Skot. Po ju, si quheni?”

Personi i ulur për krah i tha emrin e tij.

“Me çfarë merreni?”

“Jam inxhinier.”

“Bukur. Ku banoni?”

“Në Las Vegas.”

“Ne kemi një tempull atje. A e dini se ku ndodhet tempulli mormon?”

“Po. Është një ndërtesë e bukur.”

“A jeni mormon?”

“Jo.”

“Epo, duhet të jeni. Është një fe e mrekullueshme. A e keni lexuar Librin e Mormonit?”

“Jo.”

“Epo, duhet ta lexoni. Është një libër i mrekullueshëm.”

Unë jam dakord për zemërsisht me Skotin – Libri i Mormonit është një libër i mrekullueshëm. Fjalët e Profetit Jozef Smith, të cituara në faqen e hyrjes së Librit të Mormonit, gjithnjë kanë qenë të veçanta për mua: “Unë u thashë vëllezërve se Libri i Mormonit ishte më i sakti nga ndonjë libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë, dhe se një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër”.

Këtë vit në orët mësimore të Shkollës të së Dielës ne jemi duke studiuar Librin e Mormonit. Ndërsa përgatitemi dhe marrim pjesë, qofshim të nxitur për të ndjekur shembullin e guximshëm të Skotit për të ndarë dashurinë tonë për këtë shkrim të shenjtë të veçantë me të tjerë, jo të besimit tonë.

Një temë kryesore e Librit të Mormonit pasqyrohet në vargun e fundit të kapitullit të parë të 1 Nefit. Nefi shkroi: “Por, vini re, unë, Nefi, do t’ju tregoj se mëshirat e dhembshura të Zotit janë mbi të gjithë ata që ai ka zgjedhur, për shkak të besimit të tyre, për t’i bërë ata të pushtetshëm, madje, deri në fuqinë e çlirimit” (1 Nefi 1:20).

Dëshiroj të flas rreth mënyrës se si Libri i Mormonit, që është thellësia e mëshirës së Zotit e ruajtur për këto ditë të mëvonshme, na çliron duke na dhënë mësim në një mënyrë të pastër dhe “më [të saktë]” doktrinën e Krishtit.

Shumë nga historitë e Librit të Mormonit janë histori çlirimi. Nisja e Lehit në vendin e shkretët me familjen e tij ishte rreth çlirimit nga shkatërrimi i Jerusalemit. Historia e Jareditëve është një histori çlirimi, sikurse është historia e mulekitëve. Alma i Ri u çlirua nga mëkati. Luftëtarët çunakë të Helamanit u çliruan në betejë. Nefi dhe Lehi u çliruan nga burgu. Tema e çlirimit është e dukshme gjatë gjithë Librit të Mormonit.

Ka dy histori në Librin e Mormonit që janë shumë të ngjashme dhe të mësojnë një mësim të rëndësishëm. E para është nga libri i Mosias, duke filluar me kapitullin 19. Këtu mësojmë

për mbretin Limhi që jetonte në tokën e Nefit. Lamanitët kishin bërë luftë kundër popullit të Limhit. Përfundimi i luftës që se lamanitët do ta lejonin mbretin Limhi të qeveriste vetë popullin e tij, por do të ishin në robëri ndaj lamanitëve. Ishte një paqe shumë e parehatshme. (Shih Mosia 19–20.)

Kur populli i Limhit ishte i lodhur nga abuzimet e lamanitëve, ata e bindën mbretin të kthehej në luftë kundër lamanitëve. Tri herë populli i Limhit u godit. Barra të rënda u vunë mbi ta. Përfundimisht ata e përlulën veten dhe qanë fuqishëm ndaj Zotit që Ai t'i çlironte. (Shih Mosia 21:1–14.) Vargu 15 i kapitullit 21 na tregon përgjigjen e Zotit: “Dhe tani, Zoti që i ngadalshëm të dëgjonte lutjen e tyre, për shkak të paudhësive të tyre; megjithatë Zoti i dëgjoi lutjet e tyre dhe filloi t'ua zbuste zemrat Lamanitëve, që ata të fillonin të lehtësonin barrat e tyre; prapëseprapë, Zoti nuk e pa të udhës që t'i çlironte nga robëria”.

Pak kohë pasi mbërritën Amoni dhe një grup i vogël burrash nga Zarahemla, dhe me Gideonin – një nga drejtuesit e popullit të Limhit – ata organizuan një plan që që i suksesshëm, dhe ata shpëtuan nga abuzimet lamanite. Zoti që i ngadalshëm të dëgjonte lutjet e tyre. Përse? Për shkak të paudhësive të tyre.

Historia e dytë është e ngjashme në shumë mënyra, por gjithashtu e ndryshme. Rrëfimi është shënuar te Mosia 24.

Alma dhe populli e tij ishin vendosur në tokën e Helamit, kur një ushtri e lamanitëve erdhi në kufijtë e tokës. Ata u takuan dhe gjetën një zgjidhje paqësore. (Shih Mosia 23:25–29.) Shpejt drejtuesit e lamanitëve filluan ta impononin vullnetin e tyre mbi popullin e Almës dhe i vunë barra të rënda për t'i mbajtur (shih Mosia 24:8). Te vargu 13 lexojmë: “Dhe ndodhi që zëri i Zotit u erdhi në pikëllimet e tyre, duke thënë: Ngrini kokat tuaja dhe ngushëllohuni, pasi unë e di besëlidhjen që ju keni bërë me mua; dhe unë do të bëj besëlidhje me popullin tim dhe do ta çliroj nga robëria”.

Populli i Almës u çlirua nga duart e lamanitëve dhe u kthye i sigurt për t'u bashkuar me popullin e Zarahemlës.

Cili ishte ndryshimi midis popullit të Almës dhe popullit të mbretit Limhi? Siç duket, kishte shumë ndryshime: populli i Almës ishte i qetë dhe shumë i drejtë; ata tashmë ishin pagëzuar

dhe kishin hyrë në besëlidhje me Zotin; ata e përlënë veten para Zotit madje përpara se mundimet e tyre të fillonin. Të gjithë këto ndryshime bënë të përshtatshme dhe të drejtë që Zoti t'i çlirointe shpejt, në një mënyrë çudibërëse, nga ata që i mbajtën në robëri. Këto shkrime të shenjta na japin mësim për fuqinë çliruese të Zotit.

Profecitë e parashikuara për jetën dhe misionin e Jezu Krishtit na premtojnë çlirimin që Ai do të sigurojë. Nëse pendohe mi, Shlyerja dhe Ringjallja e Tij na sigurojnë të gjithëve ne arratisjen nga vdekja fizike, arratisjen nga vdekja shpirtërore, duke sjellë me të bekimet e jetës së përjetshme. Premtimet e Shlyerjes dhe të Ringjalljes, premtimet e çlirimit nga vdekja fizike dhe shpirtërore, iu shpallën Moisiut nga Perëndia kur tha: “Sepse, vër re, kjo është vepra ime dhe lavdia ime—të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39).

Në kundërshtim me besimet e përcaktuara bukur për ne në shkrimet e shenjta, ne gjejmë forcat e kundërta të laicizmit që kundërshtojnë besimet e lashta në shkrimet e shenjta – shkrime që na kanë dhënë drejtim gjatë këtyre shekujve të shumtë, në mbrojtje të vlerave dhe standardeve të përjetshme për sjelljen tonë përgjatë jetës. Ato shpallin se mësimet në Bibël janë false dhe mësimet e Mësuesit janë të dala mode. Ato pretendojnë se çdo njeri mund të ketë lirinë të vendosë standardet e tij apo të saj personale; ato orvaten të shndërrojnë të drejtat e besimtarëve, në kundërshtim me atë që jepet mësim në shkrimet e shenjta dhe në fjalët e profetëve.

Çfarë bekimi është të kemi rrëfimin e misionit të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë të shpallur te Libri i Mormomit për të shtuar një dëshmi tjetër për doktrinën e shpallur në Bibël. Përse është e rëndësishme për botën që të ketë si Biblën edhe Librin e Mormomit? Besoj se përgjigjja gjendet në kapitullin 13 të 1 Nefit. Nefi regjistron: “Dhe atëherë engjëlli foli, duke thënë: Këto anale të fundit, që ti ke parë mes Johebrenjve [Librin e Mormomit], do të vendosin të vërtetën e të parit [Biblës], që janë nga dymbëdhjetë apostujt e Qengjit dhe ato do të bëjnë të ditur gjërat e qarta dhe të çmueshme që janë hequr prej tyre; dhe do t’u bëjnë të njohur të gjitha racave, gjuhëve dhe njerëzve, se Qengji i Perëndisë është Biri i Atit të Amshuar dhe Shpëtimtari i botës; dhe se të gjithë

njerëzit duhet të vijnë tek ai ose ata nuk mund të shpëtohen” (vargu 40).

As Bibla as Libri i Mormonit të veçuara nuk janë të mjaftueshme. Të dyja janë të nevojshme për ne për të na dhënë mësim dhe për të na mësuar doktrinën e gjerë dhe të plotë të Krishtit. Nevoja për tjetrën nuk zvogëlon asnjërën prej tyre. Si Bibla edhe Libri i Mormonit janë të nevojshme për shpëtimin dhe ekzaltimin tonë. Sikurse Presidenti Ezra Taft Benson dha mësim kaq fuqishëm: “Kur përdoren së bashku, Bibla dhe Libri i Mormonit shkatërrojnë doktrinën e rreme” (“A New Witness for Christ”, *Ensign*, nëntor 1984, f. 8).

Dëshiroj ta mbyll duke përmendur dy histori – njëren nga Dhiata e Vjetër, tjetrën nga Libri i Mormonit – për të treguar se si librat funksionojnë në harmoni së bashku.

Historia e Abrahamit fillon me çlirimin e tij nga kaldeasit që adhuronin idhuj (shih Zanafilla 11:27–31; Abraham 2:1–4). Ai dhe bashkëshortja e tij, Sara, më vonë u çliruan nga dhimbja e tyre dhe iu premtua se, nëpërmjet pasardhësit të tyre, të tërë kombet e tokës do të bekoheshin (shih Zanafilla 18:18).

Dhiata e Vjetër përmban rrëfimin e Abrahamit që merr me vete jashtë Egjiptit Lotin, nipin e tij. Duke i dhënë zgjedhjen e parë për tokë, Loti zgjodhi liset e Jordanit dhe e ngriti çadrën e tij drejt Sodomës, qytetit të ligësisë së madhe. (Shih Zanafilla 13:1–12.) Pjesa më e madhe e problemeve që Loti ndeshi më vonë në jetë, dhe ato ishin të shumta, mund të gjurmohen deri te vendimi i tij i hershëm për ta vendosur derën e çadrës së tij në drejtim të Sodomës.

Abrahami, babai i besnikërisë, e përjetoi jetën ndryshe. Sigurisht, kishte shumë sfida, por do të ishte një jetë e bekuar. Ne nuk e dimë se në cilin krah ishte e drejtuar dera e çadrës së Abrahamit, por ka një të dhënë të rëndësishme në vargun e fundit të kapitullit 13 të Zanafillës. Aty thuhet: “Atëherë Abrami [ose Abrahami] i ngriti çadrat e tij dhe vajti të banojë në liset e Mamres, që ndodhen në Hebron; dhe aty ndërtoi një altar kushtuar Zotit” (Zanafilla 13:18).

Megjithëse nuk e di, personalisht besoj se dera e çadrës së Abrahamit ishte përballë altarit që ai ndërtoi për nder të Zotit. Si mund ta nxjerr këtë përfundim? Është për shkak se di historinë e

Librit të Mormonit rreth udhëzimeve të mbretit Benjamin drejtuar popullit të tij kur ata u mbloodhën për të dëgjuar fjalimin e tij të fundit. Mbreti Benjamin i udhëzoi ata t'i drejtonin dyert e çadrave të tyre në drejtim të tempullit (shih Mosia 2:1–6).

Ne mund të çlirohemi nga mënyrat mëkatore dhe ligësia duke u kthyer te mësimet e shkrimeve të shenjta. Shpëtimtari është Çliruesi i Madh, sepse Ai na çliron nga vdekja dhe nga mëkati (shih Romakëve 11:26; 2 Nefi 9:12).

Unë shpall se Jezusi është Krishti dhe se ne mund t'i afrohemi Atij duke lexuar Librin e Mormonit. Libri i Mormonit është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit. Dhiatat e para të Shpëtimtarit tonë janë Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re – ose Bibla.

Sërish, le të kujtojmë përshkrimin e mikut tim Skot për Librin e Mormonit: “Është një libër i mrekullueshëm”. Unë ju dëshmoj se shumica e madhështisë së Librit të Mormonit vjen nga harmonia e tij me Biblën e Shenjtë, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Që të Humburit të Mund të Gjenden

Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ndërsa kërkonti të jetoni ungjillin dhe doktrinën e Krishtit, Fryma e Shenjtë do t'ju udhëheqë ju dhe familjen tuaj.

Sipas shkrimeve të shenjta, Liahona ishte “një sferë [e] rrumbullaktë me mjeshtëri të çuditshme” që kishte dy akrepa, njëri prej të cilëve tregonte rrugën nëpër të cilën familja e atit Lehi duhet të shkonte në vendin e shkretë (1 Nefi 16:10).

Mendoj se e di se përse Lehi u mahnit shumë kur e pa atë për herë të parë, sepse më kujtohet reagimi im herën e parë që pashë e dëshmovava një pajisje GPS në veprim. Në mendjen time, ajo ishte një pajisje e kohëve moderne “me mjeshtëri të çuditshme”. Disi, në njëfarë mënyre që unë as nuk mund ta përfytyroj, kjo pajisje e vogël, pikërisht në telefonin tim, mund ta lokalizojë saktësisht vendin ku jam dhe mund të më thotë saktësisht se si të shkoj atje ku dëshiroj të shkoj.

Për të dy ne, bashkëshorten time Barbara dhe mua, GPS-ja është një bekim. Për Barbarën kjo ka kuptimin se nuk i duhet të më thotë që të ndaloj e të kërkoj orientim; dhe për mua ka kuptimin se mund të kem të drejtë kur i them: “Nuk më duhet të pyes ndonjë njeri. E di me saktësi se ku po shkoj.”

Tani, vëllezër e motra, ne kemi në dispozicion një mjet edhe më të mrekullueshëm se GPS-ja më e mirë. Gjithkush e humbet rrugën në ndonjë pikë, në njëfarë mase. Është nëpërmjet nxitjeve të Frymës së Shenjtë që ne mund të kthehemi të sigurt në shtegun e drejtë dhe është sakrifica shlyese e Shpëtimtarit që mund të na kthejë në shtëpi.

Shoqëri të tëra si dhe individë mund të humbasin rrugën. Sot ne jetojmë në një kohë kur shumë prej kësaj bote e ka humbur rrugën, veçanërisht në lidhje me vlerat dhe përparësitë brenda shtëpive tona.

Njëqind vjet më parë, Presidenti Jozef F. Smith e lidhi lumturinë drejtpërsëdrejti me familjen dhe na paralajmëroi që t'i përqendrojmë përpjekjet tona atje. Ai tha: "Nuk mund të ketë lumturi të çiltër të ndarë dhe të veçuar nga shtëpia. . . . Nuk ka lumturi pa shërbim dhe nuk ka shërbim më të madh se sa ai që e kthen shtëpinë në një institucion hyjnor dhe që nxit e ruan jetën familjare. . . . Shtëpia është ajo që ka nevojë të reformohet" (*Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* [1998], f. 382, 384).

Janë shtëpitë e familjet tona që kanë nevojë të reformohen në këtë botë gjithnjë e më shumë materialiste e laike. Një shembull shushatës është shkujdesja në rritje për martesën këtu në Shtetet e Bashkuara. Nga fillimi i këtij viti, *New York Times* raportoi se "pjesa e fëmijëve të lindur nga gra të pamartuara ka kaluar një prag: më shumë se gjysma e lindjeve të fëmijëve prej grave amerikane nën 30 vjeçe ndodhin jashtë martese" (Jason DeParle and Sabrina Tavernise, "Unwed Mothers Now a Majority Before Age of 30", *New York Times*, 18 shkurt 2012, A1).

Dimë gjithashtu se, nga çiftet në Shtetet e Bashkuara që martohen, gati gjysma divorcohen. Edhe ata që mbeten të martuar, shpesh e humbasin rrugën duke lënë që gjëra të tjera të ndërhyjnë në marrëdhëniet e tyre familjare.

Po aq shqetësues është hendeku në thellim mes të pasurve e të varfërve dhe mes atyre që përpiqen fort të ruajnë vlerat e zotimet familjare dhe atyre që kanë hequr dorë prej kësaj. Statistikisht, ata që kanë më pak arsimim dhe, për pasojë, të ardhura më të ulta, kanë më pak gjasa që të martohen e të shkojnë në kishë dhe më shumë gjasa që të përfshihen në krim e të kenë fëmijë jashtë martese. Dhe këto prirje janë gjithashtu shqetësuese në shumicën e pjesës tjetër të botës. (Shih W. Bradford Wilcox and others, "No Money, No Honey, No Church: The Deinstitutionalization of Religious Life among the White Working Class", e disponueshme në www.virginia.edu/marriageproject/pdfs/Religion_WorkingPaper.pdf.)

Në kundërshtim me atë çfarë kanë menduar shumë njerëz, begatia dhe arsimit duket të jenë të lidhur me një gjasë më të lartë të të pasurit të familjeve dhe vlerave tradicionale.

Pyetja e vërtetë, sigurisht, është për *shkakun* dhe *pasojën*. A kanë vlera e familje më të forta, disa pjesë të shoqërisë, *sepse* janë më të arsimuara e më të begata, apo janë më të arsimuara e më të begata *për shkak të* vlerave dhe familjeve të forta të tyre? Në këtë Kishë mbarëbotërore, ne e dimë se është kjo e fundit. Kur njerëzit bëjnë zotime familjare e fetare ndaj parimeve të ungjillit, ata fillojnë të kenë rezultate më të mira shpirtërore dhe shpesh edhe materiale.

Dhe sigurisht, shoqëritë në përgjithësi, forcohen kur forcohen familjet. Zotimi ndaj familjes dhe vlerave janë *shkaku* themelor. Thuajse gjithçka tjetër është *pasojë*. Kur çiftet martohen dhe i bëjnë zotime njëri-tjetrit, ata i rritin shumë shanset e tyre për mirëqenie ekonomike. Kur fëmijët linden në martesë dhe kanë edhe nënë edhe baba, mundësitë e tyre dhe gjasat për sukses profesional rriten deri në qiell. Dhe kur familjet punojnë e luajnë së bashku, mëhallat dhe komunitetet lulëzojnë, ekonomitë përmirësohen dhe kërkohen ndihma shoqërore më të pakta e të ulëta prej qeverisë.

Kështu, lajmi i keq është se dobësimi i familjes po shkakton një mori problemesh shoqërore dhe ekonomike. Por lajmi i mirë është se, ashtu si për çdo lidhje shkak-pasojë, këto probleme mund të prapësohen nëse ndryshohet ajo çfarë po i shkakton. Padrejtësitë zgjidhen duke jetuar parimet dhe vlerat e sakta. Vëllezër e motra, *kauza* më e rëndësishme e jetës sonë janë familjet tona. Nëse do t'i kushtohemi kësaj kauze, do ta përmirësojmë çdo aspekt tjetër të jetës sonë dhe do të bëhemi, si popull dhe si kishë, një shembull e një fanar për të gjithë popujt e botës.

Por kjo nuk është e lehtë në një botë ku zemrat janë kthyer në shumë drejtime dhe ku i gjithë planeti duket të lëvizë e të ndryshojë vazhdimisht me një ritëm që nuk ishte përfytyruar kurrë më parë. Asgjë nuk mbetet e njëjta për shumë kohë. Stilet, prirjet, idetë aktuale, korrektësia politike dhe madje edhe perceptimet e së drejtës e të gabuarës, ndërrojnë e lëvizin. Siç e parashikoi profeti Isaia, e keqja portretizohet si e mirë dhe e mira si e keqe (shih Isaia 5:20).

Ndarja shpirtërore bëhet gjithnjë e më e gjerë ndërsa e liga bëhet gjithnjë e më mashtruese e më e mprehtë dhe i tërheq njerëzit si një magnet i errët – madje ashtu si ungjilli i së vërtetës dhe dritës i tërheq të ndershmit në zemër dhe të ndershmit e tokës, që kërkojnë atë që është e moralshme dhe e mirë.

Ne mund të jemi relativisht të pakët në numër por, si anëtarë të kësaj Kisha, mund të zgjatemi mbi këto hendeqe në zgjerim. Ne e njohim fuqinë e shërbimit të përqendruar te Krishti që i bashkon bijtë e Perëndisë pavarësisht gjendjes së tyre shpirtërore ose ekonomike. Një vit më parë, Presidenca e Parë na ftoi të merrnim pjesë në një ditë shërbimi në kremtim të 75 viteve të programit të mirëqenies, që i ndihmon njerëzit të bëhen më të mbështetur te vetja. Miliona orë u dhanë si kontribut nga anëtarët tanë në mbarë botën.

Kisha është një mol në këtë det të stuhishëm, një spirancë në ujërat e trazuara të ndryshimit e ndarjes dhe një far për ata që e vlerësojnë dhe e kërkojnë drejtësinë. Zoti e përdor këtë Kishë si një mjet për t'i tërhequr fëmijët e Tij në mbarë botën, drejt mbrojtjes së ungjillit të Tij.

Shpirti i Elias, që nuk ka kufij, është gjithashtu një fuqi e madhe në qëllimet e Zotit për fatin e përjetshëm të fëmijëve të Tij. Me fjalët e Malakias, Shpirti i Frymës së Shenjtë bën “që zemra e etërve t’u kthehet bijve dhe zemra e bijve etërve” (Malakia 4:6).

Kisha qëndron si një shembull i kthimit të zemrave dhe si një katalizator për mirë në botë. Mes anëtarëve të Kishës, që janë të martuar në tempull dhe që marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e së dielës, shkalla e divorcit është shumë më e ulët se ajo në botë dhe familjet mbeten më të afërta e janë në komunikim më të shpeshtë. Shëndeti në familjet tona është më i mirë dhe ne jetojmë disa vite më shumë sesa mesatarja e popullsisë. Ne japim kontribut me më shumë burime financiare dhe më shumë shërbim për frymë ndaj atyre në nevojë dhe ka më shumë gjasa që të kërkojmë arsim më të lartë. I vë në dukje këto gjëra jo që të krenohem, por për të dëshmuar se jeta është më e mirë (dhe shumë më e lumtur) kur zemrat kthehen ndaj familjes dhe kur familjet jetojnë në dritën e ungjillit të Krishtit.

Kështu që, çfarë mund të bëjmë që të shmangim humbjen e rrugës? Së pari, më lejoni të sugjeroj që të *vëmë përparësi*.

Vendoseni gjithçka bëni jashtë shtëpisë në varësi dhe në mbështetje të asaj që ndodh brenda shtëpisë suaj. Kujtoni këshillën e Presidentit Harold B. Li që “puna më e rëndësishme . . . që do të bëni ndonjëherë, do të jetë brenda mureve të shtëpisë suaj” (*Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* [2000], f. 134) dhe këshillën për çdo kohë të Presidentit Dejvid O. Mek-Kei që “asnjë sukses tjetër nuk mund ta kompensojë dështimin në shtëpi” (cituar nga J. E. McCulloch, *Home: The Savior of Civilization* [1924], f. 42; në Conference Report, prill 1935, f. 116).

Organizojeni jetën tuaj që të siguron kohë për lutjet dhe shkrimet e shenjta, dhe aktivitetet familjar. Jepuni fëmijëve tuaj përgjegjësi në shtëpi që do t’ju mësojnë atyre se si të punojnë. Mësojuni atyre se të jetuarit e ungjillit do t’i largojë nga ndyrësia, shthurja seksuale dhe dhuna e internetit, mediave dhe video lojërave. Ata nuk do të humbasin dhe do të përgatiten për të trajtuar përgjegjësinë kur të pllakosë mbi ta.

Së dyti, na duhet t’i bëjmë gjërat sipas *radhës së saktë!* Martesa së pari dhe pastaj familja. Jashtëzakonisht shumë njerëz në botë e kanë harruar këtë radhë të natyrshme të gjërave dhe mendojnë se mund ta ndryshojnë ose madje ta kthejnë mbrapsht atë. Hiqeni cilëndo prej frikave tuaja me besim. Mirëbesojini fuqisë së Perëndisë që t’ju udhëheqë.

Për ju që nuk jeni martuar ende, kushtojini vëmendje me kujdes gjetjes së shokut/shoqes tuaj të përjetshëm. Të rinj, kujtoni edhe diçka tjetër që tha Presidenti Jozef F. Smith: “Beqaria . . . [i përçon] mendjes sipërfaqësore idenë se [është] e dëshirueshme sepse [sjell] me [vete] minimumin e përgjegjesisë. . . . Gabimi i vërtetë qëndron tek të rinjtë. Mungesa e kufizimit të moshës i largon nga shtigjet e detyrës dhe përgjegjesisë. . . . Motrat e tyre [në besim] janë viktimat . . . [dhe] do të martoheshin nëse do të mundnin, dhe do të pranonin me gëzim përgjegjësitë e jetës familjare” (*Gospel Doctrine*, bot 5-të [1939], f. 281).

Dhe për ju të reja, do të shtoja që edhe ju gjithashtu duhet të mos e harroni këtë përgjegjësi. Asnjë karrierë nuk mund t’ju sjellë aq përmbushje sa ngritja e një familjeje. Dhe kur të jeni në moshën time, do ta kuptoni këtë edhe më shumë.

Së treti, bashkëshortë e bashkëshorte, ju duhet të jeni *partnerë të barabartë* në martesën tuaj. Lexojeni shpesh dhe kuptojeni

proklamatën mbi familjen, dhe ndiqeni atë. Shmangeni sundimin e padrejtë në çfarëdolloj forme. Askush nuk e zotëron bashkëshorten/in ose fëmijët; Perëndia është Ati i të gjithëve ne dhe na ka shtrirë privilegjin për të pasur vetë familjen tonë, që më parë ishte vetëm e Tija, për të na ndihmuar që të bëhemi më shumë si Ai. Si fëmijët e Tij, duhet të mësojmë në shtëpi që ta duam Perëndinë dhe ta dimë se mund t'i kërkojmë Atij ndihmën që na duhet. Gjithkush, të martuar a beqarë, mund të jenë të lumtur e mbështetës brenda cilësdo familje që mund të kenë.

Dhe së fundi, përdorini *burimet e Kishës për familjen*. Në rritjen e fëmijëve, familjet mund të kërkojnë ndihmën e lagjes. Mbështetini dhe punoni së bashku me udhëheqësit e priftërisë dhe të shoqatave ndihmëse dhe përfitoni plotësisht nga programet e Kishës për rininë dhe familjen. Kujtoni një tjetër nga frazat kuptimplote të Presidentit Li – që Kisha është struktura mbështetëse me të cilën ndërtojmë familje të përjetshme (shih *Teachings: Harold B. Lee* [2000], f. 148).

Tani, nëse për çfarëdolloj arsyeje ju veçmas ose si familje e keni humbur rrugën, atëherë ju duhet vetëm që të zbatoni mësimet e Shpëtimtarit nga Lluka, kapitulli 15, që ta korrigjoni kursin tuaj. Këtu Shpëtimtari tregon për përpjekjen e një bariu që kërkon delen e humbur, të një gruaje që kërkon një monedhë të humbur dhe për mirësearchjen që mori biri plangprishës kur u kthye në shtëpi. Përse Jezusi i dha mësim këto shëmbëlltyra? Ai dëshironte që ne të dinim se askush prej nesh nuk do të humbasë aq shumë sa të mos mundet ta gjejë rrugën e vet sërish nëpërmjet Shlyerjes së Tij dhe mësimëve të Tij.

Ndërsa kërkonte të jetoni ungjillin dhe doktrinën e Krishtit, Fryma e Shenjtë do t'ju udhëheqë ju dhe familjen tuaj. Ju do të keni një pajisje GPS shpirtërore që t'ju tregojë gjithmonë se ku jeni dhe ku po shkoni. Unë jap dëshmi se Shëlbuesi i ringjallur i njerëzimit na do të gjithëve ne dhe Ai ka premtuar, nëse do ta ndjekim, se Ai do të na udhëheqë të sigurt sërish në praninë e Atit tonë Qiellor, për të cilin dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Të Pasurit e Vizionit për të Vepruar

Nga Plaku O. Vinsent Halek,
i Të Shtatëdhjetëve

Nëse duhet të përparojmë në vend që të shfrenohemi, ne duhet të fitojmë një vizion për veten ashtu si na sheh Shpëtimtari.

Si të gjithë prindërit e mirë, prindërit e mi dëshironin një të ardhme të ndritur për fëmijët e tyre. Babai im nuk ishte anëtar dhe, për shkak të rrethanave të pazakonta që ekzistonin në atë kohë, prindërit e mi vendosën që vëllezërit e motrat e mia dhe unë duhej të largoheshim nga shtëpia në ishull në Samoan Amerikane, në Paqësorin Jugor, dhe të udhëtonim për në Shtetet e Bashkuara për t'u arsimuar.

Vendimi për t'u ndarë prej nesh ishte i vështirë për prindërit e mi, sidomos për mamanë. Ata e dinin se do të kishte sfida të panjohura kur ne të gjendeshim në mjedise të reja. Megjithatë, me besim dhe vendosmëri, ata vazhduan me planin e tyre.

Për shkak se nëna ime u rrit si shenjtorë e ditëve të mëvonshme, ajo i njihte parimet e agjërimit e të lutjes dhe të dy prindërit e mi ndien se kishin nevojë që bekimet e qiellit t'i ndihmonin fëmijët e tyre. Me atë dëshirë, ata filluan të caktonin një ditë çdo javë për të agjëruar dhe për t'u lutur për ne. Vizioni i tyre ishte t'i përgatisnin fëmijët për një të ardhme të ndritur. Ata vepruan për shkak të këtij vizioni, ndërsa e ushtruan besimin e tyre nëpërmjet kërkimit të bekimeve të Zotit. Përmes agjërimit dhe lutjes, ata morën sigurinë, ngushëllimin dhe paqen se gjithçka do të ishte në rregull.

Në ç'mënyrë, në mes të sfidave të jetës sonë, e fitojmë vizionin e nevojshëm për të bërë ato gjëra që do të na afrojnë me

Shpëtimtarin? Duke folur për vizionin, libri i Fjalëve të Urta na jep mësim këtë të vërtetë: “Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar” (Fjalët e Urta 29:18). Nëse duhet të përparojmë në vend që të shfrenohemi, ne duhet të fitojmë një vizion për veten ashtu si na sheh Shpëtimtari.

Shpëtimtari pa më shumë potencial te ata peshkatarë të përlur, të cilët Ai i thirri për ta ndjekur Atë, sesa ata panë në fillim te vetvetja; Ai pa një vizion se cilët mund të bëheshin ata. Ai e njihte mirësinë dhe potencialin e tyre dhe veproi për t’i thirrur ata. Në fillim ata ishin të papërvojë por, ndërsa e ndoqën, panë shembullin e Tij, ndien mësimet e Tij dhe u bënë dishepujt e Tij. Pati një periudhë kur disa nga dishepujt u larguan prej Tij, sepse gjërat që dëgjuan ishin të vështira për ta. I vetëdijshëm se të tjerë mund të largoheshin gjithashtu, Jezusi i pyeti Të Dymbëdhjetët: “A doni edhe ju të largoheni?” (Gjoni 6:67). Përgjigjja e Pjetrit pasqyron mënyrën se si ai kishte ndryshuar dhe kishte marrë vizionin se kush ishte Shpëtimtari. “Te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme” (Gjoni 6:68), iu përgjigj ai.

Me anë të atij vizioni, këta dishepuj besnikë dhe të përkushtuar ishin të gatshëm të bënin gjëra të vështira ndërsa udhëtuan për të predikuar ungjillin dhe për të krijuar Kishën, pasi Shpëtimtari ishte larguar. Përfundimisht, disa prej tyre sakrifikuan jetën për dëshmitë e tyre.

Ka shembuj të tjerë në shkrimet e shenjta të atyre që morën vizionin për ungjillin dhe më pas dolën për të vepruar për shkak të atij vizioni. Profeti Alma e fitoi vizionin e tij kur e dëgjoi Abinadin të jepte mësim dhe të dëshmonte me guxim para mbretit Noe. Alma veproi sipas mësimeve të Abinadit dhe shkoi andej-këtej për të dhënë mësim gjërat që ai kishte mësuar, duke pagëzuar shumë që besonin në fjalët e tij (shih Mosia 17:1–4; 18:1–16). Ndërsa persekutonte shenjtorët e hershëm, Apostulli Pal u kthye në besim në rrugën për Damask dhe më pas veproi duke dhënë mësim e duke dëshmuar për Krishtin (shih Veprat e Apostujve 9:1–6, 20–22, 29).

Në vetë kohën tonë, shumë të rinj, të reja dhe çifte të moshuar kanë pranuar ftesën e profetit të Perëndisë për të shërbyer në misione. Me besim dhe guxim ata largohen nga shtëpitë e tyre dhe çdo gjë e afërt për shkak të besimit të tyre në të mirën e

madhe që ata mund të bëjnë si misionarë. Teksa veprojnë sipas vizionit të tyre për të shërbyer, ata bekojnë jetën e shumë njerëzve dhe, gjatë procesit, ndryshojnë vetë jetën e tyre. Në konferencën e kaluar të përgjithshme, Presidenti Tomas S. Monson na falënderoi për shërbimin që i japim njëri-tjetrit dhe na kujtoi përgjegjësinë tonë për të qenë agjentë të Perëndisë që të bekojmë fëmijët e Tij këtu në tokë (shih “Kur Prapë të Takohemi”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 108). Përmbushja e kësaj detyre ka qenë ngushëlluese, teksa anëtarët e Kishës kanë vepruar për shkak të vizionit të tij.

Përpara se Shpëtimtari të largohej, duke e kuptuar se ne do të kishim nevojë për ndihmë, Ai tha: “Nuk do t’ju lë bonjakë” (Gjoni 14:18). Ai u dha mësim dishepujve të Tij: “Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë” (Gjoni 14:26). Ky është i njëjti Frymë e Shenjtë që mund të na japë mundësinë dhe të na nxisë të bëjmë gjërat që Shpëtimtari, profetët tanë modernë dhe apostujt na japin mësim.

Kur i vëmë në zbatim mësimet e udhëheqësve tanë, ne fitojmë një kuptim më të thellë të vizionit të Shpëtimtarit tonë për ne. Gjatë gjithë kësaj konference, ne kemi marrë këshillë të frymëzuar nga profetët dhe apostujt. Studiojini mësimet e tyre dhe meditojini në zemrat tuaja ndërsa kërkonit Shpirtin e Frymës së Shenjtë që t’ju ndihmojë të merrni një vizion të këtyre mësimëve në jetën tuaj. Ushtrojeni besimin tuaj me anë të atij vizioni, duke vepruar sipas këshillës së tyre.

Hetojini dhe studiojini shkrimet e shenjta me mendimin për të marrë dritë dhe njohuri të mëtejshme për mesazhet e tyre drejtuar juve. Meditojini në zemrën tuaj dhe lejojini t’ju frymëzojnë. Më pas veproni sipas frymëzimit tuaj.

Ndërsa mësojmë si familje, ne veprojmë kur agjerojmë dhe lutemi. Alma foli për agjërimin dhe lutjen si një mënyrë për të marrë siguri kur tha: “Unë kam agjëruar dhe jam lutur për shumë ditë, që t’i di këto gjëra vetë” (Alma 5:46). Ne gjithashtu, arrijmë të njohim mënyrën se si t’u bëjmë ballë sfidave të jetës sonë përmes agjërimit dhe lutjes.

Ne përjetojmë gjëra të vështira në jetën tonë, që ndonjëherë mund ta dobësojnë vizionin dhe besimin tonë për të bërë gjërat që duhet. Ne ngarkohemi aq shumë sa që shpesh ndihemi të

dërrmuar dhe të paaftë për të bërë më shumë. Ndërkohë që secili prej nesh është i ndryshëm, unë përlësisht sugjeroj që ne duhet ta përqendrojmë vizionin tonë te Shpëtimtari dhe mësimet e Tij. Çfarë pa Ai te Pjetri, Jakobi e Gjoni dhe Apostujt e tjerë që e shtynë të vepronte për t'i ftuar ata që ta ndiqnin? Sikurse vizioni i Tij për ta, Shpëtimtari ka një vizion të madh se kush mund të bëhemi. Do të duhet i njëjti besim dhe guxim që kishin Apostujt e parë, në mënyrë që të përqendrohemi mbi ato gjëra që na interesojnë më shumë për të sjellë lumturi të përhershme dhe gëzim të madh.

Kur studiojmë jetën e Shpëtimtarit tonë dhe mësimet e Tij, ne e shohim Atë midis njerëzve duke dhënë mësim, duke u lutur, duke forcuar shpirtërisht dhe duke shëruar. Kur ndjekim shembullin e Tij dhe bëjmë gjërat që e shohim Atë të bëjë, ne fillojmë të shohim një vizion të atyre që mund të bëhemi. Ne do të bekohemi me largpamësi përmes ndihmës së Frymës së Shenjtë për të bërë më shumë të mira. Ndryshimet do të fillojnë të rrjedhin dhe ju do të sillni një organizim të ndryshëm në jetën tuaj, që do t'ju bekojë ju dhe familjen tuaj. Gjatë shërbesës së Tij midis nefitëve, Shpëtimtari pyeti: "Çfarë lloj njerëzish duhet të jeni?" Ai u përgjigj: "Madje siç jam unë" (3 Nefi 27:27). Ne kemi nevojë për ndihmën e Tij që të bëhemi si Ai, dhe Ai na e ka treguar udhën: "Prandaj, kërkoni dhe do t'ju jepet; trokitni dhe do t'ju hapet; pasi ai që kërkon, merr; dhe atij që troket, do t'i hapet" (3 Nefi 27:29).

Unë e di se, ndërsa fitojmë vizionin për veten ashtu si Shpëtimtari na sheh dhe ndërsa veprojmë sipas atij vizioni, jeta jonë do të bekohet në mënyra të paparashikuara. Për shkak të vizionit të prindërve të mi, jeta ime jo vetëm që u bekua nga përvojat arsimore, por unë u gjenda në rrethana ku gjeta dhe përqafova ungjillin. Mbi të gjitha, mësova rëndësinë e prindërve të mirë dhe besnikë. Ta them thjesht, jeta ime ndryshoi përgjithmonë.

Ashtu siç i drejtoi vizioni prindërit e mi për të agjëruar dhe për t'u lutur për mirëqenien e fëmijëve të tyre dhe ashtu siç vegimi i Apostujve të hershëm i drejtoi ata të ndiqnin Shpëtimtarin, po i njëjti vizion është i disponueshëm që të na frymëzojë dhe ndihmojë për të vepruar. Vëllezër dhe motra, ne

jemi një popull me një histori vegimi dhe besimi e guximi për të vepruar. Shikojeni se ku kemi ardhur dhe bekimet që kemi marrë! Besoni se Ai mund t'ju bekojë me vizion në jetën tuaj dhe guxim për të vepruar.

Unë ndaj dëshminë time për Shpëtimtarin dhe dëshirën e Tij që ne të kthehemi tek Ai. Për ta bërë këtë, duhet të kemi besimin për të vepruar – për ta ndjekur Atë dhe për t'u bërë si Ai. Gjatë gjithë kohëve të ndryshme të jetës sonë, Ai zgjat dorën e Tij dhe na fton:

“Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përrulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj.

Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë” (Mateu 11:29–30).

Ashtu sikurse Shpëtimtari pa potencial të madh të dishepujt e Tij të hershëm, Ai gjithashtu sheh të njëjtën gjë te ne. Le ta shohim vetveten ashtu si Shpëtimtari na sheh. Unë lutem që ne do ta kemi atë vizion me besim dhe guxim për të vepruar, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Vetëm mbi Parimet e Drejtësisë

Nga Plaku Leri Y. Uilson,
i Të Shtatëdhjetëve

Prindërit e urtë i përgatisin fëmijët e tyre që të përparojnë me ta. Ata u sigurojnë mundësi për rritje, ndërsa fëmijët fitojnë pjekurinë shpirtërore për të ushtruar siç duhet lirinë e tyre të zgjedhjes.

Një muaj apo më shumë pasi ishim martuar, unë dhe bashkëshortja ime ndërmorëm një udhëtim të gjatë me makinë. Ajo po ngiste makinën dhe unë po përpiquesha të çlodhesha. Them po *përpiquesha* sepse autostrada ku po udhëtonim ishte me “famë” për përdorimin e radarëve dhe bashkëshortja ime mund të ketë pasur një prirje të lehtë për ecjen me shpejtësi në ato kohë. Unë thashë: “Po ecën shumë shpejt. Ngadalësoje.”

Bashkëshortja ime e re mendoi përbrenda: “Epo, e kam ngarë makinën për pothuaj 10 vjet dhe përveç instruktorit tim, askush tjetër nuk më ka thënë ndonjëherë më parë se si t’i jap makinës”. Kështu që ajo u përgjigj: “Çfarë të jep ty të drejtën për të më treguar se si t’i jap makinës?”

Sinqerisht, pyetja e saj më kapi në befasi. Kështu që, duke bërë maksimumin për të marrë përgjegjësitë e mia të reja si burrë i martuar, i thashë: “Nuk e di – sepse jam bashkëshorti yt dhe mbaj priftërinë”.

Vëllezër, thjesht një këshillë të shpejtë: nëse ndonjëherë do të jeni në një situatë të ngjashme, kjo *nuk* është përgjigjja e duhur. Dhe jam i lumtur t’ju njoftoj se, ajo ishte e vetmja dhe e fundit herë që e bëra atë gabim.

Doktrina e Besëlidhje shpjegon se e drejta për ta përdorur priftërinë, në shtëpi apo kudo, lidhet drejtpërdrejt me drejtësinë

në jetën tonë: “Fuqitë e qiellit nuk mund të kontrollohen, as përdoren, vetëm mbi bazën e parimeve të drejtësisë”¹. Vargu vazhdon të thotë se ne e humbasim atë fuqi kur “ushtrojmë kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtrat e [të tjerëve], në çfarëdo shkallë padrejtësie”².

Ky shkrim i shenjtë thotë se ne duhet të drejtohem nëpërmjet “parimeve të drejtësisë”. Parime të tilla zbatohen për të gjithë udhëheqësit në Kishë, përfshirë baballarët dhe nënat në shtëpitë e tyre.³ Ne e humbasim të drejtën tonë për Shpirtin e Zotit *dhe* për çfarëdo autoriteti që kemi nga Perëndia, kur ushtrojmë kontroll mbi një person tjetër në një mënyrë të padrejtë.⁴ Ne mund të mendojmë se të tilla metoda janë për të mirën e njeriut që po “kontrollohet”. Por çdoherë që përpiqemi ta detyrojmë dikë drejt drejtësisë, që *mund* dhe *duhet* ta ushtrojë vetë lirinë e tij apo të saj të zgjedhjes, ne po veprojmë në mënyrë të padrejtë. Kur vendosja e kufijve të fortë për një person tjetër *është* siç duhet, ata kufij duhet gjithmonë të administrohen me durim të përzemërt dhe në një mënyrë që u mëson parime të përjetshme.

Ne thjesht nuk mund t’i detyrojmë të tjerët të bëjnë gjënë e duhur. Shkrimet e shenjta e bëjnë të qartë se kjo nuk është rruga e Perëndisë. Detyrimi ngre mërinë. Ai përçon mosbesim dhe i bën njerëzit të ndihen të paaftë. Kur personat kontrollues me krenari pretendojnë se kanë të gjitha përgjigjet e drejta për të tjerët, mundësitë për të mësuar humbasin. Shkrimet e shenjta thonë se “është natyra dhe prirja e pothuajse të gjithë njerëzve” të angazhohen në këtë “sundim të padrejtë”⁵, kështu që duhet të jemi të kujdesshëm se është një kurth ku bihet lehtë. Gratë gjithashtu mund të ushtrojnë sundim të padrejtë, edhe pse shkrimet e shenjta e vënë në dukje problemin veçanërisht për burrat.

Sundimi i padrejtë shpesh shoqërohet nga kritika e vazhdueshme dhe mos dhënia e miratimit apo dashurisë. Ata mbi të cilët bie ky veprim, ndiejnë se asnjëherë nuk mund t’i kënaqin udhëheqësit apo prindërit e tillë dhe se gjithmonë dështojnë. Prindërit e urtë duhet ta vlerësojnë kohën kur fëmijët janë gati të fillojnë ta ushtrojnë lirinë e tyre të zgjedhjes në një sferë të veçantë të jetës së tyre. Por nëse prindërit kapen te e *gjithë*

fuqia vendimmarrëse dhe e shohin atë si të “drejtën” e tyre, ata kufizojnë rëndë rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Fëmijët tanë janë në shtëpitë tona për një kohë të kufizuar. Nëse presim derisa ata të mos jetojnë më me ne për t’u dhënë atyre frerët e lirisë së zgjedhjes për veten, ne kemi pritur tepër gjatë. Nëse nuk kanë qenë kurrë të lirë për të marrë ndonjë vendim të rëndësishëm ndërsa kanë qenë në shtëpitë tona, ata nuk do ta zhvillojnë papritur aftësinë për të marrë vendime të urta. Fëmijë të tillë shpesh ose rebelohen kundër këtij detyrimi ose kufizohen nga paaftësia për të marrë çfarëdo vendimi personalisht.

Prindërit e urtë i përgatisin fëmijët e tyre që të përparojnë me ta. Ata u sigurojnë mundësi për rritje, ndërsa fëmijët fitojnë pjekurinë shpirtërore për të ushtruar siç duhet lirinë e tyre të zgjedhjes. Dhe po, kjo do të thotë se fëmijët ndonjëherë do të bëjnë gabime dhe do të mësojnë prej tyre.

Familja jonë pati një përvojë që na dha mësim rreth të ndihmuarit të fëmijëve që të zhvillojnë aftësinë e tyre për të bërë zgjedhje. Vajza jonë Meri, ndërsa rritej, ishte një lojtare e famshme futbollit. Një vit ekipi i saj doli në finale dhe, siç pritej, ajo lojë do të zhvillohej në një të diel. Si adoleshente, Meri kishte vite që mësonte se Shabati ishte një ditë pushimi dhe përtëritjeje shpirtërore, jo argëtimi. Por ajo ende ndjeu presionin për të luajtur prej trajnerëve dhe shoqeve të saj të ekipit, si dhe një dëshirë për të mos e lënë në baltë ekipin e saj.

Ajo na pyeti se çfarë duhet të bënte. Gruaja ime dhe unë fare lehtë mund ta kishim marrë këtë vendim për të. Megjithatë, pas shqyrtimit me lutje, vendosëm se në këtë situatë bija jonë ishte gati të merrte përgjegjësi shpirtërore për vendimin e saj personal. Ne lexuam disa shkrime të shenjta me të dhe e nxitëm Merin të lutej dhe të mendonte rreth kësaj.

Pas disa ditësh, na bëri të ditur vendimin e saj. Ajo do të luante të dielën. Tani, çfarë duhej të bënim ne? Pas diskutimit të mëtejshëm dhe marrjes së ripohimit nga Shpirti, vepruam siç kishim premtuar dhe e lejuam atë të vazhdonte me zgjedhjen e saj për të luajtur. Pasi ndeshja përfundoi, Meri me ngadalë eci drejt së ëmës që po e priste. “Oh, Mama”, tha jo, “ndihem kaq keq.

Unë nuk dua kurrë të ndihem kështu përsëri. Unë kurrë nuk do të luaj lojë tjetër ditën e Shabatit.” Dhe ajo kurrë nuk luajti.

Meri tashmë e kuptoi personalisht parimin e mbajtjes së shenjtë të ditës së Shabatit. Nëse do ta kishim detyruar që të mos luante, ne do t’i kishim privuar asaj një përvojë të çmuar dhe të fuqishme mësimi me Shpirtin.

Siç mund ta shihni, të ndihmuarit e fëmijëve të ushtrojnë lirinë e tyre të zgjedhjes siç duhet, kërkon t’u mësojmë atyre se si të luten dhe të marrin përgjigje për lutjet e tyre. Gjithashtu duhet t’u jepet mësim rreth vlerës dhe qëllimit të bindjes, si edhe rreth të gjitha parimeve të tjera thelbësore të ungjillit.⁶

Gjatë rritjes së fëmijëve tanë, vendosëm se qëllimi ynë më i rëndësishëm do të ishte t’i ndihmonim fëmijët të krijojnë vetë lidhjen e tyre me qiellin. Ne e dinim se përfundimisht ata duhej të vareshin te Zoti, jo te ne. Brigam Jangu tha: “Sikur të bëja një dallim ndërmjet të gjitha detyrave që kërkohen nga fëmijët e njerëzve, . . . unë do të vendosja të parën dhe si më kryesoren detyrën e kërkimit të Zotit, Perëndisë sonë derisa të hapim rrugën e komunikimit nga qielli në tokë – nga Perëndia te vetë shpirtat tanë”⁷.

Meri kishte marrë përgjigje për lutjet e saj në situata të tjera të mëparshme dhe kështu që ne patëm besim se bija jonë po e zhvillonte këtë rrugë komunikimi me qiellin në jetën e saj. Si rrjedhojë, ajo mësoi diçka pozitive nga përvoja e saj dhe u përgatit për të bërë zgjedhje më të mira në të ardhmen. Pa një lidhje me Shpirtin, fëmijë e prindër njëlloj do të mund t’i justifikonin të gjitha llojet e vendimeve të dobëta në emër të ushtrimit të lirisë së tyre të zgjedhjes. Premtimi i shkrimit të shenjtë është se “ata që janë të urtë . . . dhe kanë marrë Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin e tyre . . . nuk janë mashtruar”⁸.

Një pasojë tjetër dhe tragjike e sundimit të padrejtë mund të jetë humbja e besimit te dashuria e Perëndisë. Kam njohur disa njerëz që iu ishin nënshtruar udhëheqësve apo prindërve sundues e kontrollues dhe e kanë pasur të vështirë të ndiejnë pikërisht dashurinë nga Ati i tyre Qiellor, që do t’i mbështeste dhe nxiste ata përgjatë rrugës së drejtësisë.

Nëse do t’i ndihmojmë ata që janë në kujdestarinë tonë që të krijojnë lidhjen shumë të rëndësishme me qiellin, duhet të jemi ai

lloj prindi dhe udhëheqësi i përshkruar te Doktrina e Besëlidhje, seksioni 121. Ne duhet të veprojmë “veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur”⁹. Presidenti Henri B. Ajring ka thënë: “Nga e gjithë ndihma që mund t’i japim . . . rini[së], më e madhja do të jetë që [t’i] lëmë të ndiej[në] besimin tonë se [ata janë] në shtegun për në shtëpi te Perëndia dhe [ata] mund t’ia dal[in]”¹⁰.

Ndërsa mendojmë mbi parimet që duhet të na udhëheqin në Kishë dhe shtëpi, më lejoni që ta mbyll me një shembull nga biografia e Presidentit Tomas S. Monson. En Dib, bija e Monsonave, tha se edhe sot e kësaj dite, kur ajo shkon në derën kryesore të shtëpisë ku u rrit, i ati do të thotë: “Oh, shiko kush është këtu. A nuk jemi të lumtur dhe a nuk është e bukur ajo?” Ajo vijon të thotë: “Prindërit e mi gjithmonë më bëjnë ndonjë kompliment; nuk ka rëndësi se si dukem ose se çfarë kam bërë. . . . Kur shkoj dhe takoj prindërit e mi, unë e di se më duan, më bëjnë komplimente, më mirëpresin dhe jam në shtëpi.”¹¹

Vëllezër dhe motra, kjo është udha e Zotit. Edhe nëse jeni nëpërkëmbur në të kaluarën, unë e di se Zoti dëshiron të vini tek Ai.¹² *Të gjithëve na do. Të gjithëve na mirëpret. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.*

Shënime

1. Doktrina e Besëlidhje 121:36.
2. Doktrina e Besëlidhje 121:37; theksimi i shtuar.
3. Shih Neal A. Maxwell, “Put Off the Natural Man, and Come Off Conqueror”, *Tambuli*, janar 1991, f. 13–14.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:37.
5. Doktrina e Besëlidhje 121:39.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 68:25–29.
7. *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 44.
8. Doktrina e Besëlidhje 45:57.
9. Doktrina e Besëlidhje 121:41.
10. Henri B. Ajring, “I Ndhmoni Ata në Rrugën e Tyre për në Shtëpi”, *Liahona*, maj 2010, f. 25.
11. Shih Heidi S. Swinton, *To the Rescue: The Biography of Thomas S. Monson* (2010), f. 372.
12. Shih Mateu 11:28.

A ia Vlente?

Nga Plaku Dejvid F. Evans,
i Të Shtatëdhjetëve

Puna e ndarjes natyrshëm dhe normalisht të ungjillit me ata për të cilët kujdesemi dhe i duam, do të jetë puna dhe gëzimi i jetës sonë.

Gjatë kësaj konference dhe në mbledhje të tjera të kohëve të fundit¹, shumë prej nesh kanë vrarë mendjen: “Çfarë mund të bëj unë që të ndihmoj për të ngritur Kishën e Zotit dhe për të parë rritje të vërtetë aty ku jetoj?”

Për këtë dhe për çdo orvatje tjetër të rëndësishme, puna jonë më e rëndësishme është gjithmonë brenda vetë shtëpisë dhe familjes sonë.² Pikërisht brenda familjes Kisha ngrihet dhe ndodh rritja e vërtetë.³ Ne duhet t’u japim mësim fëmijëve tanë parimet dhe doktrinën e ungjillit. Ne duhet t’i ndihmojmë ata të kenë besim te Jezu Krishti dhe t’i përgatisim për pagëzim kur mbushin tetë vjeç.⁴ Ne vetë duhet të jemi besnikë që ata të mund të shohin shembullin tonë të dashurisë për Zotin dhe Kishën e Tij. Kjo ndihmon që fëmijët tanë të ndiejnë gëzim në mbajtjen e urdhërimeve, lumturi në familje dhe mirënjohje në shërbimin ndaj të tjerëve. Brenda shtëpive tona duhet të ndjekim modelin që dha Nefi kur tha:

“Ne punojmë me zell që . . . të bindim fëmijët tanë . . . të besojnë në Krisht dhe të pajtohen me Perëndinë . . .

. . . Ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin dhe shkruajmë sipas profecive tona, që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre.”⁵

Ne punojmë me zell për t’ua sjellë këto bekime fëmijëve tanë duke frekuentuar kishën me ta, duke mbajtur mbrëmje familjare dhe duke lexuar së bashku shkrimet e shenjtja. Ne lutemi çdo ditë

me familjet tona, pranojmë thirrje, vizitojmë të sëmuret e të vetmuarit dhe bëjmë gjëra të tjera që ua bëjnë të ditur fëmijëve tanë se i duam ata dhe se i duam Atin tonë Qiellor, Birin e Tij dhe Kishën e Tyre.

Ne flasim dhe profetizojmë për Krishtin kur japim një mësim në mbrëmje familjare ose ulemi me një fëmijë dhe shprehim dashurinë tonë për të si dhe dëshminë tonë për ungjillin e rivendosur.

Ne mund të shkruajmë për Krishtin duke u shkruar letra atyre që janë larg. Misionarët që shërbejnë, bij ose bija në ushtri, si dhe ata që i duam, të gjithë bekohen nga letrat që u shkruajmë. Letrat nga shtëpia nuk janë thjesht mesazhe të shpejta elektronike. Letrat e vërteta na pajisin me diçka të prekshme që mund ta mbash, ta mendosh dhe ta duash.

I ndihmojmë fëmijët tanë të mbështeten te Shlyerja e Shpëtimtarit dhe ta njohin faljen e një Ati të dashur Qiellor duke treguar dashuri e falje me anë të vetë prindërimit tonë. Dashuria dhe falja jo vetëm që i afrojnë fëmijët tanë te ne, por gjithashtu ndërtojnë besimin e tyre në dijen se Ati Qiellor i do ata dhe se Ai do t'i falë kur përpiqen të pendohen dhe të bëjnë më mirë e të jenë më të mirë. Ata e besojnë këtë të vërtetë sepse e kanë provuar të njëjtën gjë nga prindërit e tyre tokësorë.

Përveç punës që do të bëjmë brenda vetë familjes sonë, Nefi dha mësim se “ne punojmë me zell që . . . të bindim . . . vëllezërit tanë të besojnë në Krisht dhe të pajtohen me Perëndinë”⁶. Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, secili prej nesh ka bekimin dhe përgjegjësinë për të ndarë ungjillin. Disa prej atyre të cilëve iu nevojitet ungjilli në jetën e tyre, nuk janë ende anëtarë të Kishës. Disa qenë dikur mes nesh por iu duhet të ndiejnë sërish gëzimin që ndien kur përqaftuan ungjillin në një kohë më të hershme të jetës së tyre. Zoti e do edhe njeriun që nuk e ka dëgjuar kurrë ungjillin, edhe njeriun që po kthehet tek Ai.⁷ Për Atë dhe për ne, kjo nuk ka rëndësi. E gjitha është e njëjta punë. Është vlera e shpirtit, ciladoqoftë gjendja e tyre, që është e madhe për Atin tonë Qiellor, Birin e Tij dhe për ne.⁸ Vepra e Atit tonë Qiellor dhe e Birit të Tij është “të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme”⁹ e të

gjithë fëmijëve të Tij, pavarësisht nga gjendja e tyre aktuale. Bekimi ynë është të ndihmojmë në këtë vepër të shkëlqyer.

Presidenti Tomas S. Monson shpjegoi se si mund të ndihmojmë, kur tha: “Përvojat tona misionare duhet të jenë aktuale. Nuk mjafton të rrish ulur e të meditosh rreth përvojave të mëparshme. Për t’u ndier të përmbushur, juve ju duhet ta ndani ungjillin vazhdimisht dhe natyrshëm.”¹⁰

Puna e ndarjes natyrshëm dhe normalisht të ungjillit me ata për të cilët kujdesemi dhe i duam, do të jetë puna dhe gëzimi i jetës sonë. Më lejoni t’ju tregoj për dy përvoja të tilla.

Dejv Orçard u rrit në Solt-Lejk-Siti, ku shumica e miqve të tij ishin anëtarë të Kishës. Ata patën ndikim të madh mbi të. Përveç kësaj, udhëheqësit e Kishës në mëhallën e tij, e ftuan vazhdimisht në aktivitete. Miqtë e tij bënë po ashtu. Edhe pse ai nuk u bashkua me Kishën në atë kohë, vitet e tij të rritjes u bekuan nga ndikimi i miqve të mirë shdm dhe aktiviteteve të sponsorizuara nga Kisha. Pasi shkoi në universitet, ai u largua nga shtëpia dhe shumica e miqve të tij shkuan në misione. Atë e mori malli për ndikimin e tyre në jetën e tij.

Një nga shokët e shkollës së mesme të Dejvit ishte ende në shtëpi. Ky shok po takohej çdo javë me peshkopin e tij në një përpjekje për ta rregulluar jetën dhe për të qenë në gjendje që të shërbente si misionar. Ai dhe Dejvi u bënë shokë dhome dhe, ashtu siç do të ishte edhe e natyrshme edhe normale, biseduan mbi arsyen përse nuk po shërbente atëherë si misionar dhe përse po takohej shpesh me peshkopin. Shoku shprehu mirënjohjen dhe respektin për peshkopin e tij dhe për mundësinë që të pendohej e të shërbente. Ai pastaj e pyeti Dejvin nëse do t’i pëlqente që të vinte në intervistën e radhës. Çfarë ftese! Por në kontekstin e miqësisë dhe rrethanave të tyre, ishte edhe e natyrshme edhe normale.

Dejvi ra dakord dhe shpejt edhe ai po takohej me peshkopin. Kjo çoi në vendimin e Dejvit për t’u takuar me misionarët. Ai mori një dëshmi se ungjilli është i vërtetë dhe u vendos një datë për pagëzimin e tij. Dejvi u pagëzua nga peshkopi i tij dhe, një vit më vonë, Dejv Orçard dhe Kethrin Evans u martuan në tempull. Ata kanë pesë fëmijë të mrekullueshëm. Kethrina është motra ime

e vogël. Unë do t'i jem përgjithmonë mirënjohës këtij shoku të mirë i cili, bashkë me një peshkop të mirë, e solli Dejvin në Kishë.

Kur Dejvi foli për kthimin në besim dhe dha dëshminë e tij në lidhje me këto ngjarje, ai bëri pyetjen: "Pra, a ia vlente? A ia vlente e gjithë përpjekja e miqve dhe udhëheqësve të rinisë, dhe e peshkopit tim, gjatë gjithë viteve, që të pagëzohej thjesht një djalosh?" Duke treguar nga Kethrina dhe pesë fëmijët e tij, ai tha: "Epo, të paktën për bashkëshorten time dhe pesë fëmijët tanë, përgjigjja është po".

Kurdoherë që ndahet ungjilli, nuk është kurrë "thjesht një djalosh". Kurdoherë kur ndodh kthimi në besim ose dikush kthehet te Zoti, është një familje që shpëtohet. Ndërsa janë rritur, fëmijët e Dejvit dhe Kethrinës që të gjithë e kanë përqafuar ungjillin. Një bijë dhe dy bij kanë shërbyer si misionarë dhe njëri sapo mori thirrjen e tij për të shërbyer në misionin Alpin Gjermanisht Folës. Dy më të rriturit janë martuar në tempull dhe më i vogli është tani në shkollën e mesme, besnik në çdo drejtim. A ia vlente? Oh, po që ia vlente.

Motra Ajlin Ueiti mori pjesë në të njëjtën konferencë kunji ku Dejv Orçardi tregoi për përvojën e tij të kthimit në besim. Gjatë të gjithë konferencës, gjithçka që ajo mundi të mendonte ishte vetë familja e saj dhe veçanërisht motra e saj, Mishela, që prej kohësh ishte larguar nga Kisha. Mishela ishte e divorcuar dhe po përpiquej të rriste katër fëmijë. Ajlina pati përshtypjen që t'i dërgonte asaj një kopje të librit të Plakut M. Rasëll Ballard *Our Search for Happiness [Kërkimi Ynë për Lumturi]*, bashkë me dëshminë e saj, gjë që e bëri. Pikërisht javën tjetër, një shoqe i tha Ajlinës se edhe ajo e kishte ndier se duhet të kontaktonte Mishelën. Ajo shoqe i shkroi gjithashtu Mishelës një shënim, ku ndante dëshminë dhe i shprehte dashurinë e saj. A nuk është interesante se sa shpesh Shpirti punon te disa njerëz për të ndihmuar atë në nevojë?

Koha kaloi. Mishela i telefonoi Ajlinës dhe e falënderoi për librin. Ajo i tha se kishte filluar ta dallonte boshllëkun shpirtëror në jetën e saj. Ajlina i tha se e dinte që pagja të cilën ajo po e kërkonte, mund të gjendej në ungjill. Ajo i tha se e donte dhe dëshironte që ajo të ishte e lumtur. Mishela filloi të bënte ndryshime në jetën e saj. Shumë shpejt, ajo takoi një burrë të

mrekullueshëm që ishte aktiv në Kishë. Ata u martuan dhe, një vit më vonë, u vulosën në Tempullin e Ogdenit. Kohët e fundit, biri i saj 24-vjeçar u pagëzua.

Për të tjerët në familjen e Mishelës dhe për gjithë të tjerët që nuk e dinë ende se kjo Kishë është e vërtetë, ju ftoj ta merrni parasysh me lutje nëse Kisha është e vërtetë. Lejojini familjen, miqtë dhe misionarët që të japin ndihmë. Kur ta dini se është e vërtetë, dhe është e vërtetë, ejani e bashkohuni me ne duke ndërmarrë po atë hap në jetën tuaj.

Fundi i kësaj historie nuk është shkruar ende, por bekime i janë dhënë kësaj gruaje të mrekullueshme dhe familjes së saj kur ato që e duan vepruan sipas një nxitjeje dhe, në mënyrë të natyrshme dhe normale, ndanë dëshminë e tyre dhe e ftuan që të kthehej.

Kam menduar shumë për këto dy përvoja. Një i ri, që po punonte për ta rregulluar jetën e tij, ndihmoi një tjetër të ri që po kërkonte të vërtetën. Një grua ndau dëshminë dhe besimin e saj me të motrën, e cila ishte larguar nga Kisha prej 20 vitesh. Nëse ne lutemi dhe e pyesim Atin Qiellor se cilin mund të ndihmojmë, dhe pretojme të veprojmë sipas nxitjeve që Ai na jep duke na treguar se si mund të ndihmojmë, Ai do t'u përgjigjet lutjeve tona dhe ne do të bëhemi mjete në duart e Tij për të bërë punën e Tij. Veprimi me dashuri sipas nxitjeve të dhëna nga Shpirti, bëhet katalizatori.¹¹

Ndërsa i keni dëgjuar këto përvoja të ndarjes natyrshëm e normalisht të ungjillit me ata për të cilët kujdeseni, shumë prej jush kanë pasur të njëjtën përvojë si Ajlina Uejeti. Ju keni menduar për dikë të cilit t'i zgjasni dorën dhe ose ta ftoni që të kthehet, ose të ndani me të ndjenjat tuaja për ungjillin e Jezu Krishtit. Ftesa ime është të veprojmë, pa vonesë, sipas asaj nxitjeje. Folini mikut tuaj ose anëtarit të familjes. Bëjeni atë natyrshëm dhe normalisht. Tregojuni atyre për dashurinë tuaj për ata dhe për Zotin. Misionarët mund të ndihmojnë. Këshilla ime është e njëjtë me atë që Presidenti Monson e ka dhënë kaq herë nga vetë kjo foltore: "Asnjëherë mos e vononi një nxitje"¹². Ndërsa veproni sipas nxitjes dhe e bëni atë me dashuri, vëzhgoni se si Ati ynë Qiellor e përdor gatishmërinë tuaj për të bërë mrekulli në jetën tuaj dhe në jetën e njeriut për të cilin kujdeseni.¹³

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ne mund ta lartësojmë Kishën e Tij dhe të shohim rritje të vërtetë kur punojmë për të sjellë bekimet e ungjillit te familjet tona dhe tek ata që i duam. Kjo është vepra e Atit tonë Qiellor dhe e Birit të Tij. Unë e di se Ata jetojnë dhe se u përgjigjen lutjeve. Kur veprojmë sipas atyre nxitjeve, duke pasur besim në aftësinë e Tij për të bërë mrekulli, mrekullitë do të ndodhin dhe jetët do të ndryshojnë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Shih Mbledhja e Trajnimit Mbarëbotëror të Udhëheqjes, 11 shkurt 2012, LDS.org.
2. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* (2000), f. 134.
3. Shih Bojd K. Paker, “Fuqia e Priftërisë në Shtëpi”, Mbledhja e Trajnimit Mbarëbotëror të Udhëheqjes, 11 shkurt 2012, LDS.org.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 68:25–28.
5. 2 Nefi 25:23, 26.
6. 2 Nefi 25:23.
7. Shih Lluka 15:4–7.
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 18:10.
9. Moisiu 1:39.
10. “Status Report on Missionary Work: A Conversation with Elder Thomas S. Monson, Chairman of the Missionary Committee of the Council of the Twelve”, *Ensign*, tetor 1977, f. 14.
11. Shih Tomas S. Monson, “Të Angazhuar me Zell”, *Liahona*, nëntor 2004, f. 56–59; “To the Rescue”, *Liahona*, korrik 2001, f. 57–60; “The Doorway of Love”, *Liahona*, tetor 1996, f. 2–7.
12. Shih Ann M. Dibb, “My Father Is a Prophet” (Brigham Young University–Idaho devotional, 19 shkurt 2008), byui.edu/devotionalsandspeeches; Thomas S. Monson, “Stand in Your Appointed Place”, *Liahona*, maj 2003, f. 54–57; “Peace, Be Still”, *Liahona*, nëntor 2002, f. 53–56; “Priesthood Power”, *Liahona*, janar 2000, f. 58–61; “The Spirit Giveth Life”, *Ensign*, maj 1985, f. 68–70.
13. Përveç Presidentit Tomas S. Monson, profetë të tjerë kanë dhënë mësim po të njëjtin parim. Për shembull, Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985) dha mësim për rëndësinë e veprimit sipas përshtypjeve të dhëna nëpërmjet Shpirtit, kur tha: “Perëndia na shikon dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që ai i plotëson nevojat tona. Si rrjedhim, është jetike që ne t’i shërbejmë njëri-tjetrit në mbretëri” (*Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* [2006], f. 82).

Ta Mbajmë të Shenjtë

Nga Plaku Pol B. Pajper,
i Të Shtatëdhjetëve

Gjërat e shenjta duhet të trajtohen me më shumë kujdes, duhet t'u jepet respekt më i madh, duhen marrë në konsideratë me nderim më të thellë.

Afërsisht 1.500 vite para Krishtit, një bari u çua tek një shkurre flakëruese në shpatet e malit Horeb. Ai takim hyjnor nisi shndërrimin e Moisiut nga një bari në një profet dhe të punës së tij nga kullotja e dhenve në mbledhjen e Izraelit. Një mijë e treqind vjet më vonë, një prift i ri e i privilegjuar në oborrin mbretëror u magjeps nga dëshmia e një profeti të dënuar. Ai takim nisi zhvillimin e Almës nga një nëpunës civil në një shërbëtor të Perëndisë. Afro 2.000 vjet më vonë, një djalë 14-vjeçar hyri në pyll duke kërkuar përgjigje për një pyetje të sinqertë. Takimi i Jozef Smithit në koriye e vuri atë në shtegun drejt të qenit profet dhe drejt rivendosjes.

Jetët e Moisiut, Almës dhe Jozef Smithit u ndryshuan që të gjitha nga takimet me hyjnore. Këto përvoja i forcuan ata për të qëndruar besnikë ndaj Zotit dhe veprës së Tij gjatë gjithë jetës së tyre, pavarësisht nga kundërshtimi dërmues dhe sprovat e vështira të njëpasnjëshme.

Përvojat tona me hyjnore mund të mos jenë kaq të drejtpërdrejta ose të befta dhe as sfidat tona aq të mëdha. Megjithatë, sikurse me profetët, forca jonë për të duruar me besnikëri varet nga të pranuarit, të kujtuarit dhe të mbajturit të shenjtë të asaj që marrim nga lart.

Në ditët e sotme, autoriteti, çelësat dhe ordinancat janë rivendosur në tokë. Ka edhe shkrime të shenjta dhe dëshmi të veçanta. Ata që e kërkojnë Perëndinë mund të pranajnë pagëzimin për heqjen e mëkateve dhe konfirmimin “[me anë të]

vën[ies] [së] duar[ve], për pagëzimin prej zjarrit dhe prej Frymës së Shenjtë” (DeB 20:41). Me këto dhurata të çmuara e të rivendosura, takimet tona me hyjnoren do të përfshijnë më së shumti anëtarin e tretë të Kreut-Perëndi, Frymën e Shenjtë.

*Me zë t’ulët, t’qet’, Shpirti mua më flet,
T’me udh’zoi’, t’me shpëtoj’.*

(“Zëri i Ulët i Qetë”, *Liahona*, prill 2006, f. M13)

*“Fryma e Shenjtë le të udhëheqë;
Le të na mësojë ç’është e vërtetë.
Ai për Krishtin do të dëshmojë,
Mendjen me pamjen e qiellit do t’na ndriçojë.”*

(“Let the Holy Spirit Guide” [“Fryma e Shenjtë le të Udhëheqë”], *Hymns*, nr. 143)

Ndërsa kërkojmë përgjigje nga Perëndia, ne ndiejmë zërin e ulët e të qetë t’u pëshpëritë shpirtave tanë. Këto ndjenja – këto përshtypje – janë kaq të natyrshme dhe kaq delikate sa që ne mund të mos i vëmë re ose t’ua atribuojmë ato arsyes apo intuitës. Këto mesazhe individuale dëshmojnë për dashurinë dhe shqetësimin personal të Perëndisë për secilin prej fëmijëve të Tij dhe për misionet e tyre personale në vdekshmëri. Reflektimi i përditshëm mbi përshtypjet që vijnë nga Shpirti dhe shkrimi i tyre, u shërbejnë qëllimeve të dyfishta për të na ndihmuar 1) të dallojmë takimet tona personale me hyjnoren dhe 2) t’i ruajmë ato për veten dhe pasardhësit tanë. Shkrimi i tyre është gjithashtu një njohje dhe pranim formal i mirënjohjes sonë ndaj Perëndisë, pasi “në asgjë nuk e fyen njeriu Perëndinë apo kundër askujt nuk ndizet zemërimi i tij, përveç atyre që nuk e pohojnë dorën e tij në gjithçka” (DeB 59:21).

Në lidhje me atë që marrim me anë të Shpirtit, Zoti thotë: “Kujtoni se ajo që vjen nga lart, është e shenjtë” (DeB 63:64). Deklarimi i Tij është më shumë se një kujtues; është gjithashtu një përkufizim dhe një shpjegim. Drita dhe njohuria nga qielli është e shenjtë. Është e shenjtë sepse buron nga qielli.

E shenjtë do të thotë e denjë për nderim dhe respekt. Përmes kategorizimit të diçkaje si të shenjtë, Zoti tregon se ajo është me

vlerë dhe përparësi më të madhe sesa gjërat e tjera. Gjërat e shenjta duhet të trajtohen me më shumë kujdes, duhet t'u jepet respekt më i madh, duhen marrë në konsideratë me nderim më të thellë. E shenjta klasifikohet në shkallën e lartë të hierarkisë së vlerave qiellore.

Ajo që është e shenjtë për Perëndinë bëhet e shenjtë për ne vetëm përmes ushtrimit të lirisë së zgjedhjes; secili duhet të zgjedhë ta pranojë dhe ta mbajë si të shenjtë atë që Perëndia e përcakton si të shenjtë. Ai dërgon dritë dhe njohuri nga qielli. Ai na fton ta marrim dhe ta trajtojmë atë si të shenjtë.

Por "[ka] një kundërshtim në të gjitha gjërat" (2 Nefi 2:11). E kundërta e së shenjtës është përdhosëse ose laike – ajo që është materiale apo e kësaj bote. Tokësorja konkurren vazhdimisht me të shenjtën për vëmendjen dhe përparësitë tona. Njohuria laike është thelbësore për jetën tonë të përditshme materiale. Zoti na udhëzon që të kërkojmë mësim dhe urtësi, të studiojmë dhe të mësojmë nga librat më të mirë dhe të njihemi me gjuhët, të folurat dhe njerëzit (shih DeB 88:118; 90:15). Si rrjedhojë, zgjedhja që ta vendosim të shenjtën mbi laiken është e një përparësie relative, jo çështje të zgjedhjes së njëres dhe injorimit të tjetres; "të je[mi] të mësuar është mirë, nëse [ne] dëgjoj[më] këshillat e Perëndisë" (2 Nefi 9:29; theksimi i shtuar).

Lufta për përparësi midis së shenjtës dhe laikes tek secila mendje njerëzore mund të tregohet nga përvoja e Moisiut të shkurrja flakëruese. Atje Moisiu mori thirrjen e tij të shenjtë nga Jehovai për të çliruar fëmijët e Izraelit nga robëria. Megjithatë, në fillim njohuria e tij tokësore për fuqinë e Egjiptit dhe të faraonit e bëri të dyshonte. Përfundimisht, Moisiu ushtroi besim në fjalën e Zotit, duke e nënshtruar njohurinë e tij laike dhe duke mirëbesuar tek e shenjta. Ai mirëbesim i siguroi fuqinë për të mposhtur sprovat tokësore dhe për ta udhëhequr Izraelin jashtë Egjiptit.

Pas arratisjes nga ushtritë e Noeut dhe më pas kur ra në robëri në duart e Amulonit, Alma mund ta ketë vënë në dyshim dëshminë shpirtërore që mori kur dëgjoji Abinadin. Megjithatë, ai i mirëbesoi të shenjtës dhe iu dha forcë për të duruar dhe për t'u shpëtuar sprovave të tij të përkohshme.

Jozef Smithi përjetoi një situatë të vështirë në ditët e hershme të përkthimit të Librit të Mormonit. Ai e njihnte natyrën e shenjtë të fletëve dhe punës së përkthimit. Sidoqoftë, ai u bind nga Martin Herrisi që t'u jepte përparësi shqetësimeve tokësore të miqësisë dhe financave, në kundërshtim me udhëzimet e shenjta. Si rezultat, dorëshkrimi i përkthimit humbi. Zoti e qortoi Jozefin për dorëzimin e "[asaj] që ishte e shenjtë, ligësisë" (DeB 10:9) dhe ia hoqi atij për një kohë fletët dhe dhuratën për të përkthyer. Kur përparësitë e Jozefit u rivendosën siç duhet, gjërat e shenjta iu kthyen dhe puna vazhdoi.

Libri i Mormonit ofron shembuj të tjerë të luftës për t'i dhënë përparësi të shenjtës. Ai flet për besimtarë, besimi i të cilëve i drejtoi ata te pema e jetës për të marrë frutin e saj të shenjtë, dashurinë e Perëndisë. Më pas, përqeshjet e atyre në ndërtesën e gjerë dhe të madhe bënë që besimtarët ta zhvendosnin vëmendjen e tyre nga e shenjta te laikja. (Shih 1 Nefi 8:11, 24–28.) Më vonë, nefitët zgjodhën krenarinë dhe mohuan shpirtin e profecisë dhe të zbulesës, "duke u tallur me atë që ishte e shenjtë" (Helamani 4:12). Madje edhe disa dëshmitarë të shenjave dhe çudive të lidhura me lindjen e Zotit zgjodhën t'i injoronin manifestimet e shenjta nga qielli, në favor të shpjegimeve laike (shih 3 Nefi 2:1–3).

Sot lufta vazhdon. Zërat laikë po rriten në volum dhe fuqi. Ata gjithnjë e më shumë i nxitin besimtarët të braktisin besimet që bota i konsideron të paarsyeshme dhe pa vend. Sepse "ne shohim si në pasqyrë, në mënyrë të errët" (1 Korintasve 13:12) dhe "nuk e di[më] kuptimin e të gjitha gjërave" (1 Nefi 11:17), ndonjëherë mund të ndihemi të cënueshëm dhe në nevojë për siguri më të madhe shpirtërore. Zoti i kujtoi Oliver Kaudrit:

"Në qoftë se ti dëshiron dëshmi të mëtejshme, sill ndër mend natën kur më bërtite në zemrën tënde, që të mund të dije lidhur me të vërtetën e këtyre gjërave.

A nuk i fola paqe mendjes tënde lidhur me çështjen? Ç'dëshmi më të madhe mund të kesh sesa nga Perëndia?" (DeB 6:22–23).

Zoti i kujtoi Oliverit, edhe neve, të mbështetemi në dëshmitë e shenjta personale që kemi marrë tashmë, kur besimi ynë të sfidohet. Sikurse për Moisiun, Almën dhe Jozefin më parë, këto

takime hyjnore shërbejnë si spiranca shpirtërore që të na mbajnë të sigurt dhe në drejtimin e duhur në kohë sprove.

E shenjta nuk mund të dorëzohet sipas një përzgjedhjeje. Ata të cilët zgjedhin të braktisin, madje dhe një gjë të shenjtë, do t'i kenë mendjet e tyre të errësuara (shih DeB 84:54) dhe përveç nëse pendohen, drita që kanë do t'ju merret (shih DeB 1:33). Të paankoruar nga e shenjta, ata do ta gjejnë veten të humbur moralisht në një det laik. Në kundërshtim me këtë, ata të cilët i shenjtërojnë gjërat e shenjta, marrin premtime: "Ajo që është prej Perëndisë, është dritë; dhe ai që merr dritë e vazhdon në Perëndinë, merr më shumë dritë; dhe ajo dritë shkëlqen gjithnjë e më shumë, derisa dita është e plotë" (DeB 50:24).

Zoti na bekoftë përherë e përgjithmonë që të njohim, të kujtojmë dhe të mbajmë të shenjtë atë që kemi marrë nga lart. Ju dëshmoj se ndërsa bëjmë kështu, ne do të kemi fuqinë të durojmë sprovat dhe të mposhtim sfidat e kohës sonë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Ç'Mendon Krishti për Mua?

Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ndërsa e doni Atë, shpresoni tek Ai, i besoni Atij dhe e ndiqni Atë, ju do ta ndieni dashurinë dhe miratimin e Tij.

Një gazetar nga një revistë kryesore braziliane studioi mbi Kishën për t'u përgatitur për një artikull të lajmeve kryesore.¹ Ai shqyrtoi doktrinën tonë dhe vizitoi qendrat e trajnimit misionar dhe ato humanitare. Ai foli me miq të Kishës dhe me të tjerë që nuk ishin aq miqësorë. Në intervistën që pati me mua, gazetari dukej haptas në mëdyshje kur më pyeti: "Si mundet një person të mos ju konsiderojë të krishterë?" E dija që po i referohej Kishës, por në një farë mënyre e mora si personale pyetjen dhe e gjeta veten duke pyetur në heshtje "A pasqyron jeta ime dashurinë dhe devotshmërinë që ndiej për Shpëtimtarin?"

Jezusi i pyeti farisenjtë: "Ç'u duket juve për Krishtin?"² Në vlerësimin përfundimtar, dishepullimi ynë vetjak nuk do të gjykohet nga miqtë apo armiqtë. Përkundrazi, sikurse tha Pali: "Të gjithë, . . . do të dalim përpara gjykatës së Krishtit"³. Në atë ditë pyetja e rëndësishme për secilin prej nesh do të jetë: "Ç'mendon Krishti për mua?"

Me gjithë dashurinë e Tij për të gjithë njerëzimin, Jezusi iu referua qortueshëm disave përreth Tij si hipokritë⁴, të marrë⁵ dhe bërës të paudhësisë.⁶ Ai me ton aprovues i quajti të tjerët bijtë e mbretërisë⁷ dhe drita e botës.⁸ Disave me mosmiratim iu drejtua si të verbër⁹ dhe të pafrytshëm.¹⁰ Ai të tjerët i lavdëroi si të pastër në zemër¹¹ dhe të uritur për drejtësi.¹² Ai u pikëllua që disa ishin jobesimtarë¹³ dhe prej bote¹⁴, por të tjerët Ai i vlerësoi si të

zgjedhur¹⁵, dishepuj¹⁶, miq¹⁷. Dhe kështu që secili prej nesh pyet: “Ç’mendon Krishti për mua?”

Presidenti Tomas S. Monson e ka përshtuar botën tonë sot se po largohet “nga gjërat shpirtërore . . . [me] bot[ën] rreth nesh [që] ndryshon dhe ne shohim parimet e moralit të shoqërisë duke u dobësuar [vazhdimisht]”¹⁸. Është koha e mosbesimit në rritje dhe shpërfilljes për Krishtin dhe mësimet e Tij.

Në këtë mjedis të stuhishëm, ne ngazëllemi që jemi dishepuj të Jezu Krishtit. Ne shohim dorën e Zotit plotësisht rreth nesh. Fati ynë është përcaktuar bukur përpara nesh. “Kjo është jeta e përjetshme”, Jezusi u lut “të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.”¹⁹ Të qenit një dishepull në këto ditë të fatit do të jetë një shprehje e respektit përgjatë gjithë përjetësive.

Mesazhet që kemi dëgjuar gjatë kësaj konference, janë shenja nga Zoti për të na drejtuar në udhëtimin tonë të dishepullimit. Ndërkohë që kemi dëgjuar gjatë dy ditëve të kaluara, duke u lutur për drejtim shpirtëror, dhe ndërsa studiojmë dhe lutemi rreth këtyre mesazheve në ditët e ardhshme, Zoti na bekon me drejtim vetjak përmes dhuratës së Frymës së Shenjtë. Këto ndjenja na kthejnë akoma më shumë drejt Perëndisë, duke u penduar, duke u bindur, duke besuar dhe duke shpresuar. Shpëtimtari u përgjigjet veprave tona të besimit: “Nëse ndokush më do, do ta zbatojë fjalën time; edhe Ati im do ta dojë dhe ne do të vijmë tek ai dhe do të bëjmë banesën tek ai”²⁰.

Thirrja e Jezusit: “Eja e më ndiq”²¹ nuk është vetëm për ata që janë të përgatitur të konkurrojnë në Olimpiada shpirtërore. Faktikisht, dishepullimi nuk është fare një konkurs, por një ftesë për të gjithë. Udhëtimi ynë i dishepullimit nuk është një garë e shkurtër rreth pistës, as nuk është plotësisht i krahasueshëm me një maratonë të stërzgjatur. Në të vërtetë, është një udhëtim gjatë gjithë jetës drejt një bote më çelestiale.

Ftesa e Tij është një thirrje për përpjekje të përditshme. Jezusi tha: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”²². “Nëse dikush do të vijë pas meje, le ta mohojë vetveten, ta marrë çdo ditë kryqin e vet dhe të më ndjekë.”²³ Ne mund të mos jemi në aftësinë tonë më të mirë çdo ditë por, nëse po përpiqemi, ftesa e

Jezusit është plot inkurajim dhe shpresë: “Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje”²⁴.

Kudo që do e gjeni tani veten në rrugën e dishepullimit, ju jeni në rrugën e duhur, rrugën drejt jetës së përjetshme. Së bashku ne mund të ngremë dhe forcojmë njëri-tjetrin në ditët e mëdha dhe të rëndësishme të ardhshme. Çfarëdoqofshin vështirësitë që na dalin përballë, dobësitë që na kufizojnë ose pamundësitë që na rrethojnë, le të kemi besim në Birin e Perëndisë, i cili shpalli: “Çdo gjë është e mundshme për atë që beson”²⁵.

Më lejoni t’ju tregoj dy shembuj dishepullimi në veprim. I pari është nga jeta e Presidentit Tomas S. Monson, që tregon fuqinë e mirësisë së thjeshtë dhe mësimin e Jezusit: “Më i madhi prej jush le të jetë shërbëtori juaj”²⁶.

Afro 20 vite më parë, Presidenti Monson foli në konferencën e përgjithshme rreth një të reje 12-vjeçare që vuante nga kanceri. Ai foli për guximin e saj dhe mirësinë e miqve të saj për ta mbajtur në krah në malin Timpanogos, në Jutan qendrore.

Disa vite më parë, takova Xhemi Palmer Brinton dhe dëgjova historinë nga një këndvështrim tjetër – këndvështrimi i asaj që Presidenti Monson kishte bërë për të.

Xhemi e takoi Presidentin Monson në mars të 1993–shit, një ditë pasi iu tha se një kokërr sipër gjurit të saj të djathtë ishte kancer i avancuar në kockë. Me babanë e saj që e ndihmonte, Presidenti Monson administroi një bekim priftërie, duke premtuar se “Jezusi do të jetë në të djathtën e në të majtën tënde për të të ngritur lart”.

“Kur po largohesha nga zyra e tij atë ditë”, tha Xhemi, “unë zgjidha një tullumbace të lidhur te karroca ime me rrota dhe ia dhashë atij. ‘Ti je më i Miri!’ shkruhej me shkronja të ndritshme.”

Nëpër trajtimet e saj me kemioterapi dhe operacionin për shpëtimin e gjymtyrit, Presidenti Monson nuk e harroi atë. Xhemi tha: “Presidenti Monson ilustroi me shembull se çfarë do të thotë të jesh dishepull i vërtetë i Krishtit. [Ai] më ngrii nga pikëllimi te shpresa e mrekullueshme dhe e qëndrueshme.” Tre vjet pas takimit të tyre të parë, Xhemi përsëri u ul në zyrën e Presidentit Monson. Në fund të takimit, ai bëri diçka që Xhemi nuk do ta harrojë asnjëherë. Kaq tipike për vëmendjen e Presidentit Monson, ai e befasoi me po të njëjtën tullumbace që ajo i kishte

dhënë atij tre vjet më parë. “Ti je më i Miri!” tregohej te tullumbacja. Ai e kishte mbajtur, duke ditur se ajo do të kthehej në zyrën e tij pasi të shërohej nga kanceri. Katërmbëdhjetë vjet pas takimit të parë me Xhemin, Presidenti Monson kreu martesën e saj me Xheson Brintonin në Tempullin e Solt-Lejkut.²⁷

Ne mund të mësojmë kaq shumë nga dishepullimi i Presidentit Monson. Ai shpesh i kujton Autoritetet e Përgjithshme ta sjellin në mend këtë pyetje të qartë: “Çfarë do të bënte Jezusi?”

Jezusi i tha kryetarit të sinagogës: “Mos ki frikë, vetëm ki besim”²⁸. Dishepullimi është të besosh në Të në kohë paqeje dhe të besosh në Të në kohë vështirësie, kur dhimbja dhe frika janë lehtësohen vetëm nga besimi se Ai na do dhe i mban premtimet e Tij.

Kohët e fundit takova një familje që është një shembull i mrekullueshëm i mënyrës si ne e besojmë Atë. Olgani dhe Soline Seintelus nga Port-o-Prensi në Haiti më treguan historinë e tyre.

Më 12 janar 2010, kur një tërmet shkatërrues goditi Haitin, Olgani ishte në punë dhe Soline në kishë. Të tre fëmijët e tyre – Ganci, pesë vjeç, Enxhi, tre vjeç dhe Gensli, një vjeç – ishin në shtëpi në apartamentin e tyre me një shok.

Kudo kishte rrënim masiv. Siç do ta kujtoni, dhjetëra mijëra njerëz humbën jetën atë janar në Haiti. Olgani dhe Soline vrapuan aq shpejt sa mundën drejt apartamentit të tyre për të gjetur fëmijët. Ndërtesa tre katëshe ku jetonte familja Seintelus, ishte shkatërruar.

Fëmijët nuk kishin shpëtuar. Asnjë përpjekje për shpëtim nuk do të ofrohej te një ndërtesë që ishte tërësisht e shkatërruar.

Olgani dhe Soline Seintelus kishin shërbyer të dy si misionarë kohëplotë dhe ishin martuar në tempull. Ata besonin te Shpëtimtari dhe te premtimet e Tij për ta. Sidoqoftë zemrat e tyre ishin të copëtuara. Ata qanë pa u përmbajtur.

Olgani më tha se në orën e tij më të errët, ai filloi të lutej. “Atë Qiellor, në qoftë se do të jetë vullneti yt, nëse do mund të ishte gjallë vetëm njëri prej fëmijëve të mi, të lutem, të lutem, na ndihmo.” Pa pushim ai eci përreth ndërtesës, duke u lutur për frymëzim. Fqinjët u përpoqën ta ngushëllonin dhe ta ndihmonin atë ta pranonte humbjen e fëmijëve. Olgani vazhdoi të ecte sa

andej-këtej rrënojave të ndërtesës së shkatërruar, duke shpresuar, duke u lutur. Më pas, diçka krejt e mrekullueshme ndodhi. Olgani dëgjoi të qarën që mezi dëgjohej të një foshnjeje. Ishte e qara e foshnjës së tij.

Me orë të tëra fqinjët gërmuan furishëm në rrënoja, duke rrezikuar vetë jetën e tyre. Në errësirën e natës, përmes zhurmave të forta të çekiçëve dhe daltave, skuadrat e shpëtimit dëgjuan një tjetër tingull. Ata ndaluan goditjet e tyre dhe dëgjuan. Ata nuk mund ta besonin atë që po dëgjonin. Ishte zëri i një fëmije të vogël – dhe ai po këndonte. Ganci pesëvjeçar më vonë tha se e dinte që babai i tij do ta dëgjonte atë nëse do këndonte. Ganci ishte duke kënduar këngën e tij të preferuar “Fëmi i Per’ndis’ Jam”²⁹, poshtë peshës së betonit dërrmues, që më vonë çoi në prerjen e krahut të tij.

Ndërsa orët kalonin, në mes të errësirës, vdekjes dhe dëshpërimit për kaq shumë bij dhe bija të tjera të çmuara të Perëndisë në Haiti, familja Seintelus pati një mrekulli. Ganci, Enxhi dhe Gensli u gjetën të gjallë nën ndërtesën e rrafshuar.³⁰

Mrekullitë nuk janë gjithnjë kaq të menjëhershme. Ndonjëherë ne mendueshëm pyesim veten se përse mrekullia për të cilën jemi lutur me kaq shumë zell, nuk ndodh këtu dhe tani. Por teksa besojmë te Shpëtimtari, mrekullitë e premtuara do të ndodhin. Qoftë në këtë jetë apo në tjetrën, gjithçka do të jetë në rregull. Shpëtimtari shpall: “Zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë”³¹. “Në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën.”³²

Unë dëshmoj se ndërsa e doni Atë, shpresoni tek Ai, i besoni Atij dhe e ndiqni Atë, ju do ta ndieni dashurinë dhe miratimin e Tij. Ndërsa pyesni: “Ç’mendon Krishti për mua?” ju do ta dini se jeni dishepulli i Tij; ju jeni miku i Tij. Përmes hirit të Tij Ai do të bëjë për ju atë që nuk mund ta bëni për veten.

Ne me padurim presim fjalët përmbyllëse të profetit tonë të dashur. Presidenti Tomas S. Monson u shugurua si Apostull i Zotit Jezu Krisht kur unë isha 12 vjeç. Për më shumë se 48 vjet ne jemi bekuar ta dëgjojmë atë të ndajë dëshminë për Jezu Krishtin. Unë dëshmoj se ai tani është në pozicionin e Apostullit më të moshur të Shpëtimtarit në tokë.

Me dashuri dhe admirim të madh për dishepujt e shumtë të Jezu Krishtit që nuk janë anëtarë të kësaj Kishe, ne përvulësisht shpallim se engjëjt janë kthyer në tokë në kohën tonë. Kisha e Jezu Krishtit është rivendosur siç e krijoi Ai në lashtësi, me fuqinë, ordinancat dhe bekimet e qiellit. Libri i Mormonit është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit.

Unë dëshmoj se Jezu Krishti është Shpëtimtari i botës. Ai vuajti dhe vdiq për mëkatet tona dhe u ngrit të tretën ditë. Ai është ringjallur. Në një ditë të ardhshme, çdo gju do të ulet dhe çdo gjuhë do të dëshmojë se Ai është Krishti.³³ Në atë ditë, shqetësimi ynë nuk do të jetë: “A më konsiderojnë të tjerët të krishterë?” Në atë kohë, përqendrimi ynë absolut do të jetë tek Ai dhe shpirtrat tanë do të zhyten në pyetjen: “Ç’mendon Krishti për mua?” Ai jeton. Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Shih André Petry, “Entre a Fé e a Urna”, *Veja*, 2 nëntor 2011, f. 96.
2. Mateu 22:42.
3. Romakëve 14:10.
4. Shih Mateu 6:2.
5. Shih Mateu 23:17.
6. Shih Mateu 7:23.
7. Shih Mateu 13:38.
8. Shih Mateu 5:14.
9. Shih Mateu 15:14.
10. Shih Mateu 13:22.
11. Shih Mateu 5:8.
12. Shih Mateu 5:6.
13. Shih Mateu 17:17.
14. Shih Gjoni 8:23.
15. Shih Gjoni 6:70.
16. Shih Gjoni 13:35.
17. Shih Gjoni 15:13.
18. Tomas S. Monson, “Qëndroni në Vende të Shenjta”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 83, 86.
19. Gjoni 17:3.
20. Gjoni 14:23.
21. Lluca 18:22.
22. Gjoni 14:15.
23. Lluca 9:23.
24. Mateu 11:28.
25. Marku 9:23.
26. Mateu 23:11.
27. Jami Brinton, letër drejtuar autorit, më 27 janar 2012.
28. Marku 5:36.
29. “Fëmi i Per’ndis’ Jam”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58.
30. Nga një diskutim me Olgan dhe Soline Saintelus më 10 shkurt 2012; shih gjithashtu Jennifer Samuels, “Family Reunited in Miami after Trauma in Haiti”, *Church News*, 30 janar 2010, f. 6.
31. Gjoni 14:27.
32. Gjoni 16:33.
33. Shih Romakëve 14:11.

Ndërsa e Mbyllim Këtë Konferencë

Nga Presidenti Tomas S. Monson

I meditoftshi të vërtetat që keni dëgjuar, dhe ju ndihmofshin që të bëheni edhe më të mirë nga sa ishit kur filloi konferenca.

Zemra ime është plot ndërsa i afrohem mbylljes së kësaj konference të lavdishme. Jemi bekuar kaq bollshëm ndërsa kemi dëgjuar këshillën dhe dëshmitë e atyre që na kanë folur. Mendoj se do të jeni dakord me mua se e kemi ndier Shpirtin e Zotit ndërsa zemrat na janë prekur dhe dëshmitë na janë forcuar.

Edhe njëherë jemi kënaqur me muzikë të bukur, që e ka zbukuruar dhe pasuruar secilin sesion të konferencës. U shpreh mirënjohjen time të gjithëve atyre që kanë ndarë talentet e tyre me ne në lidhje me këtë.

Falënderimet e mia të përzemërta shkojnë për secilin që na ka folur, si dhe atyre që kanë ofruar lutjet në secilin prej sesioneve.

Ka njerëz të panumërt që punojnë qoftë pas kuintave, qoftë në pozicione më pak të dukshme për çdo konferencë. Nuk do të ishte e mundur që t'i zhvillonim këto sesione pa ndihmën e tyre. Falënderimet e mia shkojnë te të gjithë ata gjithashtu.

E di se bashkoheni me mua për t'u shprehur mirënjohje të thellë atyre vëllezërve dhe motrave që janë liruar [nga thirrjet] gjatë kësaj konference. Do të na marrë malli për ta. Kontributi i tyre në veprën e Zotit ka qenë i pamasë dhe do të ndihet nëpër brezat që do të vijnë.

Ne kemi mbështetur gjithashtu, duke ngritur duart, vëllezër dhe motra që janë thirrur në detyra të reja gjatë kësaj konference.

U urojmë mirëseardhjen dhe dëshirojmë që ta dinë se mezi po presim të shërbejmë me ta në kauzën e Mësuesit. Ata janë thirrur nëpërmjet frymëzimit nga lart.

Kemi pasur një transmetim të pashoq të konferencës, duke mbërritur te njerëzit kudo përtej kontinenteve dhe oqeanëve. Edhe pse jemi shumë larg prej shumëkujt nga ju, ne e ndiejmë shpirtin tuaj e përkushtimin tuaj dhe ju dërgojmë dashurinë e vlerësimin tonë kudo që jeni.

Sa të bekuar jemi ne, vëllezërit e motrat e mia, që kemi ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit në jetën dhe në zemrën tonë. Ai u jep përgjigje pyetjeve më të mëdha të jetës. Ai i jep kuptim, qëllim dhe shpresë jetës sonë.

Jetojmë në kohë të trazuara. Ju siguroj se Ati ynë Qiellor i di sfidat që hasim. Ai e do secilin prej nesh dhe dëshiron të na bekojë e të na ndihmojë. Ju drejtofshim Atij në lutje, ashtu siç na këshilloi kur tha: “Lutu gjithmonë e unë do të derdh Shpirtin tim mbi ty dhe i madh do të jetë bekimi yt—po, madje më shumë se nëse ti do të fitoje thesare të tokës”¹.

Vëllezërit e motrat e mia, shtëpitë tuaja u mbushëshin me dashuri e mirësjellje dhe me Shpirtin e Zotit. Duajini familjet tuaja. Nëse ka mosmarrëveshje ose grindje midis jush, unë ju shtyj që t’i zgjidhni ato tani. Tha Shpëtimtari:

“Nuk do të ketë grindje mes jush, . . .

Pasi në të vërtetë, në të vërtetë, unë ju them juve se ai që ka shpirtin e grindjes nuk është i imi, por është i djallit i cili është ati i grindjes dhe ai nxit zemrat e njerëzve, që të grinden me zemërim me njëri-tjetrin.

[Por] vini re, kjo nuk është doktrina ime . . . ; por, doktrina ime është *kjo*, që gjëra të tilla duhet të zhduken.”²

Si shërbëtori juaj i përrulur, u bëj jehonë fjalëve të mbretit Beniamin në fjalimin drejtuar popullit të tij, kur tha:

“Unë nuk ju kam urdhëruar të . . . mendoni se unë vetë jam më shumë se një njeri i vdekshëm.

Por, unë jam sikurse ju, mund të prekem nga të gjitha llojet e dobësive në trup dhe mendje; megjithëkëtë, unë jam zgjedhur . . . nga dora e Zotit . . . dhe jam mbajtur dhe ruajtur nga fuqia e tij e pakrahasueshme, për t’ju shërbyer juve me të gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën që Zoti më ka dhënë.”³

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, unë dëshiroj me gjithë zemër që të bëj vullnetin e Perëndisë dhe t'i shërbej Atij e t'ju shërbej juve.

Tani, ndërsa largohemi nga kjo konferencë, i kërkoj bekimet e qiellit mbi secilin prej jush. Ju që jeni larg shtëpisë, u kthefshi të sigurt atje. I meditojshi të vërtetat që keni dëgjuar, dhe ju ndihmofshin që të bëheni edhe më të mirë nga sa ishit kur filloi konferenca dy ditë më parë.

Derisa të takohemi sërish pas gjashtë muajsh, kërkoj që bekimet e Zotit të jenë mbi ju dhe, madje, mbi të gjithë ne, dhe e bëj këtë në emrin e Tij të shenjtë – madje Jezu Krishtit, Zotit dhe Shpëtimtarit tonë – amen.

Shënime

1. Doktrina e Besëlidhje 19:38.
2. 3 Nefi 11:28–30; theksimi i shtuar.
3. Mosia 2:10–11.

Ngrihuni e Shkëlqeni

Nga En M. Dib,

Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Një nga mënyrat më të mrekullueshme se si ne mund të ngrihemi dhe të shkëlqejmë është t'u bindemi me vetëbesim urdhërimeve të Perëndisë.

Është një privilegj për mua të jem këtë mbrëmje me ju. Çdo janar pres me ankth njoftimin e temës së re të Aktiviteteve të Përbashkëta. Megjithatë, unë gjithmonë gjej një moment për të vlerësuar nëse i kam zotëruar mësimet e temës së vitit të kaluar.

Le t'i shqyrtojmë për një moment temat e fundit: "Virtyti duhet t'i stolisë mendimet [tuaja] pa pushim"¹, "[Jini] të qëndruesh[me] dhe të palëvizur[a], gjithmonë plot me vepra të mira"², "Bëhu[ni] shembull për besimtarët"³, "Ji[ni] [të] fort[a] dhe trim[e]"⁴ dhe neni i trembëdhjetë i besimit: "Ne besojmë në qenien të ndersh[me], të vërtet[a], të dëlir[a], mirëdashës[e], të virtytsh[me] dhe në bërjen mirë të gjithë njerëzve"⁵.

Studimi dhe përqendrimi mbi këto shkrime të shenjta për një vit të plotë i ka lejuar ato të bëhen pjesë e zemrave tona, shpirtirave tanë dhe dëshmive tona. Ne shpresojmë se ju do të vazhdoni të ndiqni udhëheqjen e tyre ndërsa e drejtojmë përqendrimin tonë te tema e Aktiviteteve të Përbashkëta për vitin 2012, që gjendet te Doktrina e Besëlidhje.

Kreu për seksionin 115 shpjegon se ishte viti 1838 dhe vendndodhja që Far-Uesti në Misuri. Jozef Smithi ishte "duke bërë të ditur vullnetin e Perëndisë lidhur me ndërtimin e atij vendi dhe të Shtëpisë së Zotit". Profeti ishte optimist dhe plot besim. Në vargun 5, ku gjejmë temën për këtë vit, Zoti i thotë:

“Në të vërtetë unë ju them ju të gjithëve: Ngrihuni e shkëlqeni, që drita juaj të mund të jetë një flamur për kombet”.

Çfarë mendoni ju kur dëgjoni fjalën *ngrihuni*? Unë personalisht mendoj për ju – rininë fisnike të Kishës. Ju përfytyroj duke u ngritur me zell nga shtretërit tuaj çdo ditë për seminarin herët në mëngjes. Ju shoh duke u ngritur besnikërisht nga gjuhëzimi pas përfundimit të lutjeve tuaja ditore. Ju mendoj duke u ngritur me guxim për të ndarë dëshminë tuaj dhe për të mbrojtur standardet tuaja. Jam e frymëzuar nga zotimi juaj ndaj ungjillit dhe shembujt tuaj të mirë. Shumë prej jush tashmë e kanë pranuar këtë ftesë për t’u ngritur e për të shkëlqyer dhe drita juaj u jep zemër të tjerëve që të bëjnë të njëjtën gjë.

Një nga mënyrat më të mrekullueshme se si ne mund të ngrihemi dhe të shkëlqejmë është t’u bindemi me vetëbesim urdhërimeve të Perëndisë. Ne mësojmë për këto urdhërime në shkrimet e shenjta, nga profetët e kohëve të sotme dhe brenda faqeve të broshurës *Për Forcën e Rinisë*. Secila prej jush duhet të ketë kopjen e saj personale. Në kopjen time personale, unë kam rrethuar fjalët *për* dhe *ju*, siç më është mësuar nga një mikeshë e respektuar. Ky veprim i thjeshtë më kujton se këto standarde nuk janë thjesht udhëzime të përgjithshme – ato janë posaçërisht *për mua*. Unë shpresoj se ju do ta gjeni kohën për t’i rrethuar ato fjalë në vetë broshurën tuaj, për ta lexuar nga fillimi në fund dhe për të ndier Shpirtin të dëshmojë se ato janë edhe *për ju*.

Mund të ketë nga ato prej jush që joshen për t’i shpërfillur ose për t’i hequr nga mendja standardet në broshurën *Për Forcën e Rinisë*. Ato mund ta shohin broshurën e të thonë: “Shiko, nënë, libri nuk flet në lidhje me [*plotësojeni me çështjen aktuale*]”. Ose ato mund të justifikojnë vetveten: “Ajo që po bëj nuk është dhe aq e keqe. Unë me siguri nuk jam aq e keqe sa [*vendosni emrin e një mikeshë ose të njohurë*].”

Presidenti Harold B. Li dha mësim: “Më i rëndësishmi i të gjithë urdhërimeve të Perëndisë është ai [urdhërim] për të cilin jeni duke pasur më shumë vështirësi për ta mbajtur sot”⁶. Mbreti Beniamin shpjegoi: “Unë nuk mund t’ju tregoj juve të gjitha gjërat që mund t’ju shtynë të bëni mëkat; pasi ka mënyra dhe mjete të ndryshme, madje aq shumë sa unë nuk mund t’i numëroj ato”⁷. Nëse po luftoni me mbajtjen e këtyre standardeve dhe

urdhërimeve, unë ju nxis të kërkonti mbështetje brenda ungjillit. Lexojini shkrimet tuaja të shenjta. Kaloni kohë në faqen zyrtare të internetit të Kishës, LDS.org, për të gjetur përgjigje për pyetjet tuaja. Flisni me prindërit tuaj, udhëheqësit tuaj të Kishës dhe ata që shkëlqejnë plot ndriçim teksa e jetojnë ungjillin. Lutuni. Hapjani zemrën Atit tuaj Qiellor, i cili ju do. Përdoreni dhuratën e pendimit çdo ditë. Shërbejuni të tjerëve. Dhe më e rëndësishmja, dëgjojini dhe bindjuni nxitjeve të Frymës së Shenjtë.

Presidenti Tomas S. Monson na inkurajon të gjithëve me këto fjalë: “Miq të e mi të rinj, jini të fortë. . . . Ju e dini ç’është e drejtë e ç’është e gabuar dhe asnjë maskim, sado tërheqës, nuk e ndryshon dot këtë. . . . Nëse të ashtuquajturit miq ju nxisin të bëni diçka që e dini se është e gabuar, *ju*, bëhuni ai që mbështet të drejtën, edhe nëse ju duhet ta bëni këtë vetëm.”⁸

Ati Qiellor nuk dëshiron nga ne që të shohim botën dhe të *ndjekim* qëndrimet e saj që ndryshojnë përherë. Ai dëshiron që ne të shohim tek Ati dhe të ndjekim drejtimin e Tij të pandryshueshëm. Ai dëshiron që ne ta jetojmë ungjillin dhe *t’i drejtojmë* të tjerët për tek ai, duke vendosur standarde të larta.

Shkrimet e shenjta tregojnë shumë shembuj të mrekullueshëm për ta ilustruar këtë ide. Në librin e Gjyqtarëve në Dhiatën e Vjetër, ne mësojmë rreth Sansonit. Sansoni u lind me potencial të madh. Të ëmës së tij iu premtua: “Ai do të fillojë ta çlirojë Izraelin nga duart e Filistejve”⁹. Por ndërkohë që Sansoni rritej, ai dëshironte të ndiqte tundimet e botës më shumë se drejtimin e Perëndisë. Ai bëri zgjedhje sepse “[i] pëlqen[in]”¹⁰ në vend që t’i bënte sepse ato zgjedhje ishin të drejta. Shkrimet e shenjta e përdorin në mënyrë të përsëritur frazën “pastaj zbriti”¹¹ ndërsa tregojnë për udhëtimet, veprimet dhe zgjedhjet e Sansonit. Në vend që të ngrihej e të shkëlqente për të përmbushur potencialin e tij të madh, Sansoni u mposht nga bota, humbi fuqinë e dhënë nga Perëndia dhe ndërroi jetë në një vdekje tragjike të parakohshme.

Nga ana tjetër, shkrimet e shenjta tregojnë shembullin e Danielit. Danieli u lind gjithashtu me potencial të madh. Te libri i Danielit, kapitulli 6, ne lexojmë: “Danieli shkëlqente mbi prefektët dhe satrapët e tjerë, sepse ai kishte një frymë më të lartë”¹². Kur Danielit i erdhën sfidat tokësore, ai nuk pa drejt

standardeve të shoqërisë – ai u ngrit dhe pa drejt qiellit. Në vend që të zbatonte dekretin tokësor të mbretit, që për 30 ditë askush nuk duhej t'i lutej askujt përveç mbretit, Danieli "hyri në shtëpinë e vet. Pastaj në dhomën e tij të sipërme, me dritaret e saj të hapura në drejtim të Jeruzalemit, tri herë në ditë gjunjëzohej, lutej dhe falenderonte Perëndinë e tij, siç e bënte zakonisht më parë."¹³

Danieli nuk kishte frikë të ngrihej e të shkëlqente në ndjekjen e urdhërimeve të Perëndisë. Edhe pse kaloi një natë të mundimshme në gropën e luanëve ngaqë qëndroi për atë që ishte e drejtë, ai u mbrojti dhe u bekua për bindjen e tij. Kur mbreti Dar e nxori Danielin nga gropa e luanëve mëngjesin pasues, ai hartoi një dekret që çdokush duhej t'i frikësohej Perëndisë së Danielit dhe të ndiqte shembullin e tij besnik. Me të vërtetë Danieli na tregon se çka do të thotë të qenit një flamur për kombet dhe të mos i ulim asnjëherë standardet tona kur përballemi me tundimet e kësaj bote.

Unë jam bekuar të dëgjoj shumë shembuj të rinisë së sotme, sikurse ju, që nuk kanë frikë të ngrihen e të shkëlqejnë dhe që e lejojnë dritën e tyre të jetë një flamur midis bashkëmoshatarëve të tyre. Xhoana ishte një nga vetëm tre anëtarë të Kishës në shkollën e saj të mesme dhe e vetmja e re në lagjen e saj. Ajo iu zotua vetes dhe Zotit se kurrë nuk do të përdorte gjuhë vulgare. Kur u caktua të punonte në grup me një të ri për një projekt të shkollës, i cili nuk kishte bërë të njëjtin zotim, ajo nuk i uli standardet e saj. Ajo i kërkoi atij t'i respektonte dhe t'i nderonte vlerat e saj. Me kalimin e kohës, me shumë tërheqje të ëmbla të vëmendjes dhe disa relativisht të papëlqyeshme, miku i saj krijoi zakone të reja dhe përdori gjuhë më të dëlirë. Shumë njerëz e vunë re ndryshimin, përfshirë babanë e tij, që e falënderoi Xhoanën që qe një ndikim i mirë në jetën e të birit.¹⁴

Në një detyrë trajnimit të kohëve të fundit në Filipine, unë takova Karenin, e cila tregoi një përvojë që pati si Dafinë ndërkohë që po studionte për diplomën baçelor për administrimin e hoteleve dhe restoranteve. Një mësues kërkoi që çdo student/e të mësonte të bënte e të provonte shumëllojshmërinë e pijeve që do të shërbeheshin në restorantet e tyre. Disa prej pijeve përmbanin alkool dhe Kareni e dinte se ishte kundër urdhërimeve të Zotit që t'i provonte. Me gjithë pasojat

serioze që rrezikonte, Kareni gjeti guxim për t'u ngritur e për të shkëlqyer dhe ajo nuk i provoi pijet.

Kareni shpjegoi: “Mësuesi m'u afrua dhe më pyeti përse nuk po pija. Ai tha: ‘Znjsh. Karen, si mund ta dallosh shijen dhe ta kalosh këtë lëndë të rëndësishme, nëse të paktën nuk i provon pijet?’ Unë i thashë atij se jam anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe si anëtarë nuk i konsumojmë gjërat që janë të dëmshme për ne. Çfarëdolloj gjëje që ai priste prej meje, edhe nëse do të thoshte të merrje një notë jokaluëse, unë do ta kuptoja, por unë nuk do të harroja të jetoja standardet e mia vetjake.”

Javët kaluan dhe nuk u tha më asgjë për atë ditë. Në përfundim të semestrit, Kareni e dinte se nota e saj përfundimtare do të pasqyronte refuzimin e saj për të provuar pijet. Ajo ngurroi ta shihte notën, por kur e pa, zbuloi se kishte marrë notën më të lartë në klasë.

Ajo tha: “Nëpërmjet kësaj përvoje unë mësova se Perëndia . . . pa dyshim do të na bekojë kur e ndjekim Atë. Unë gjithashtu e di se, edhe në qoftë se do të kisha marrë një notë jokaluëse, nuk do të ndieja keqardhje për atë që bëra. Unë e di se kurrë nuk do të dështoj në sytë e Zotit kur zgjedh të bëj atë që e di se është gjëja e duhur.”¹⁵

Të reja të dashura, secila prej jush ka lindur me potencial të madh. Ju jeni bija të dashura të Atit Qiellor. Ai ju njeh dhe ju do. Ai ju fton të “ngrih[eni] e [të] shkëlqeni” dhe Ai premtun se, ndërsa veproni kështu, Ai do t’ju mbështesë e do t’ju bekojë. Unë lutem që secila prej jush do ta gjejë guximin ta pranojë ftesën e Tij dhe të marrë premtimet e Tij, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Doktrina e Besëlidhje 121:45.
2. Mosia 5:15.
3. 1 Timoteut 4:12.
4. Jozueut 1:9.
5. Nenet e Besimit 1:13.
6. *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* (2000), f. 30.
7. Mosia 4:29.
8. Tomas S. Monson, “Shembuj Drejtësie”, *Liahona*, maj 2008, f. 65.
9. Gjqtarët 13:5.
10. Gjqtarët 14:3.
11. Gjqtarët 14:7.
12. Danieli 6:3.
13. Danieli 6:10.
14. Për një pjesë të kësaj historie, shih Joanna Ehrisman, “The Thing about Being Mormon”, në Katilin Medlin dhe të tjerë, botues, *Going on 15: Memoirs of Freshmen* (2010), f. 93–96.

15. Korrespondencë personale me autoren, 2012.

Kërkoni të Mësoni: Ju Keni një Punë për të Bërë

Nga Meri N. Kuk,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Bekojini fëmijët tuaj dhe familjen e ardhshme duke mësuar sa më shumë që të mundeni tani.

Të rejat e mia të dashura, ne e duam shumë çdonjërin prej jush. Ne ju shohim duke vepruar me guxim e duke qenë shembuj drite në një botë ku mundësitë e mëdha shoqërohen nga sfida të mëdha. Kjo mund t'ju bëjë ta pyesni veten: "Çfarë më pret në të ardhmen?" Unë ju siguroj se, si një bijë e virtytshme e Perëndisë, e ardhmja juaj është e ndritur! Ju jetoni në një kohë kur të vërtetat e ungjillit janë rivendosur dhe këto të vërteta mund të gjenden në shkrimet tuaja të shenjta. Ju morët dhuratën e Frymës së Shenjtë, në kohën e pagëzimit tuaj, dhe Fryma e Shenjtë do t'ju mësojë të vërtetën e do t'ju përgatisë për sfidat e jetës.

Perëndia ju dha lirinë morale të zgjedhjes dhe mundësinë për të mësuar ndërsa jeni në tokë dhe Ai ka një punë për t'u bërë nga ju. Për ta përmbushur këtë punë, ju keni një përgjegjësi individuale për të kërkuar të mësoni. Çelësi i të ardhmes suaj, "feneri i shpresës"¹ suaj mund të gjendet te broshura e re *Për Forcën e Rinisë* nën standardin e arsimit dhe te vlera e dijes së Të Rejave.

"Arsimi . . . do t'ju ofrojë mundësi."² Ndërsa e ndiqni paralajmërimin e Zotit që të "kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit"³, ju fitoni jo vetëm dije nga studimi juaj, por edhe njohuri shtesë ndërsa mësoni me anë të besimit.

Kërkoni të mësoni duke studiuar me zell. Rrallë do të jeni në gjendje të shpenzoni aq shumë kohë kushtuar nxënies sa

mundeni tani. Presidenti Gordon B. Hinkli e këshilloi me mençuri rininë e Kishës: “Modeli i studimit që krijoni gjatë shkollimit tuaj zyrtar, do të ndikojë në një masë të madhe te dëshira juaj gjatë gjithë jetës për dije”⁴. “Ju duhet të merrni të gjithë arsimimin që mundeni. . . . Sakrifikoni gjithçka nevojitet të sakrifikohet që të kualifikoheni për të bërë punën e [kësaj] bote. . . . Stërvitni mendjen dhe duart që të bëheni një ndikim për mirë ndërsa përparoni në jetën tuaj.”⁵

Duke u folur veçanërisht grave, Presidenti Tomas S. Monson tha: “Shpesh e ardhmja është e panjohur; prandaj, është e nevojshme që të përgatitemi për situata që nuk mund t’i parashikojmë. . . . Unë ju nxis që të vazhdoni të arsimoheni dhe të mësoni aftësitë që kërkohen, në mënyrë që, nëse ndodh një situatë e tillë, ju të jeni të përgatitura për të siguruar të ardhura.”⁶

Të reja, ndiqni këshillën e këtyre profetëve të urtë e të frymëzuar. Jini nxënëse të mira. Ngrihuni dhe shkëlqeni në shkollat tuaja me punë të palodhur, me ndershmëri dhe integritet moral. Nëse jeni në vështirësi apo të shkurajua me rezultatet tuaja në shkollë, kërkoni ndihmë nga prindërit, mësuesit dhe anëtarët ndihmues të Kishës. Kurrë mos u dorëzoni!

Bëni një listë të gjërave që dëshironi të mësoni, e pastaj “tregojani qëllimet për arsimin familjes, miqve dhe udhëheqësve tuaj në mënyrë që ata t’ju mbështesin dhe nxisin”⁷. Ky është modeli i Përparimit Personal.

Me teknologjinë, ju po bëheni dëshmitare të një shpërthimi njohurish. Ju ngarkoheni gjatë gjithë kohës me tinguj, video dhe komunikim në internet. Jini përzgjedhëse dhe mos e lejoni këtë pushtim njohurish t’ju hutojë apo t’ua ngadalësojë përparimin tuaj. Të Reja, merrni masa! *Ju* i përcaktoni qëllimet tuaja. *Ju* vendosni se çfarë hyn në mendjen e zemrën tuaj.

Një pjesë e nxënies suaj më të rëndësishme do të jetë jashtë klase. Rrethojeni veten me gra shembullore, që mund t’ju mësojnë aftësi për amvisërinë, artin, muzikën, historinë e familjes, sportet, të shkruarin apo të folurin. Njihuni me to dhe kërkoni t’ju këshillojnë. Kur të keni mësuar diçka të re, jepeni atë mësim tek Aktivitetet e Të Rejave ose bëhuni një këshilluese për të reja të tjera si pjesë e kërkesave për medaljonin e Të Rejave “Bleta e Nderit”.

Përveç nënës sime të mrekullueshme, unë kam pasur shumë këshilluese në jetë. Për herë të parë u njoha me procesin e këshillimit kur isha vetëm nëntë vjeçe. Mësuesja ime e Fillores më mësoi të qëndisja me kryq “Unë Do të Sjell Dritën e Ungjillit në Shtëpinë Time”, një figurë që e vara në dhomën time gjatë viteve të mia të adoleshencës. Mësuesja ime më drejtoi, më korrigjoi dhe gjithmonë më nxiti përgjatë rrugës. Këshilluese të tjera vijuan. Dy rrobaqepëse të shkëlqyera në lagjen time më mësuara të qepja. Me drejtimin, durimin dhe inkurajimin e tyre, kur isha 14 vjeçe, unë futa një fustan në një konkurs qepjeje dhe në të vërtetë fitova një çmim! Procesi e shtoi dëshirën time për dije e përsosmëri edhe në fusha të tjera.

Marrja e dijes tani do të jetë shumë me vlerë kur të bëheni nënë. “Niveli arsimor i një nëne ka një ndikim të thellë te zgjedhjet arsimore të fëmijëve të [saj].”⁸ Arsimimi i një nëne mund të jetë “çelësi për të dalë nga varfëria”⁹. Gratë e arsimuara “prijen për të: lindur fëmijë më të shëndetshëm, për të pasur fëmijë që janë më të shëndetshëm, për të pasur më shumë besim te vetja, për t’u përshtatur më shpejt dhe për të pasur arsyetim e gjykim më të mirë”¹⁰.

Ne mësojmë te “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës” se “nënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre”¹¹. Sigurimi i arsimimit për fëmijët tuaj është pjesë e atij edukimi dhe është përgjegjësia juaj e shenjtë. Njësoj si për djemtë luftëtarë që “nënat [i] kishin mësuar”¹², ju do të jeni mësuesja më e rëndësishme që do të kenë ndonjëherë fëmijët tuaj, kështu që zgjidhjeni të mësuarin tuaj me maturi. Bekojini fëmijët tuaj dhe familjen e ardhshme duke mësuar sa më shumë që të mundeni tani.

Kërkoni të mësoni me anë të besimit. Ne mësojmë me anë të besimit ndërsa fitojmë me zell dije shpirtërore përmes lutjes, studimit të shkrimeve të shenjta dhe bindjes, dhe ndërsa kërkojmë drejtimin e Frymës së Shenjtë, që dëshmon për të gjitha të vërtetat. Nëse bëni pjesën tuaj për të fituar dije, Fryma e Shenjtë mund t’ua ndriçojë mendjen. Ndërsa përpiqeni ta mbani veten të denjë, Fryma e Shenjtë do t’ju japë drejtim e do ta rrisë nxënien tuaj.

Kur isha e re, mora hua një komplet skish që ishte tepër i gjatë, çizme që ishin shumë të mëdha, dhe një shoqe më mësoi të bëja ski! Ne shkuaam në një ditë të bukur pranvere plot me diell të shndritshëm, borë të përsosur dhe qiell blu pa re. Ankthi për shpatet e pjerrëta u kthye në kënaqësi. Dhe megjithëse u rrezova goxha herë me atë komplet të gjatë skish, u ngrita dhe vazhdova të përpiqesha. Arrita ta doja atë sport!

Sidoqoftë, shpejt e zbulova se jo të gjitha ditët e skive dhe kushtet e motit qenë aq ideale. Në ditë me qiej të vranët, ne bënim ski në një gjendje të quajtur “dritë e sheshtë”. Drita e sheshtë ndodh kur drita e diellit shpërhapet nga retë. Duke parë drejt dëborës së bardhë, perceptimi i thellësisë zhduket dhe është e vështirë të gjykosh pjerrësinë e shpatit apo të shohësh kodrat e vogla dhe xhungat mbi kodër.

Të reja, ju mund të jeni duke parë drejt të ardhmes suaj në të njëjtën mënyrë siç e pashë unë atë shpat të pjerrët të skive. Ndonjëherë, mund të ndieni se ju jeni në dritë të sheshtë, pa mundur të shihni atë çka ju pret. Mësimi me anë të besimit do t’ju japë siguri dhe do t’ju ndihmojë ta përshkoni rrugën tuaj gjatë periudhave të pasigurta.

Në kapitullin e 25-të të Mateut, shëmbëlltyra e dhjetë virgjëreshave na mëson se përgatitja shpirtërore është thelbësore dhe duhet të arrihet individualisht. Do t’ju kujtohet se të dhjeta virgjëreshat u ftuan për ta shoqëruar dhëndrin në gostinë e dasmës, por vetëm pesë virgjëreshat e mençura qenë përgatitur me vaj në llambat e tyre.

“Dhe budallaçkat u thanë të mençurave: ‘Na jepni nga vaji juaj, sepse llambat tona po na fiken’.

Por të mençurat duke u përgjigjur thanë: ‘Jo, sepse nuk do të mjaftonte as për ne e as për ju; më mirë shkoni te tregtarët dhe e blini’.

Tani kur ato shkuan ta blejnë, erdhi dhëndri; virgjëreshat që ishin gati, hynë bashkë me të në dasmë; dhe dera u mbyll.”¹³

Ju mund të mendoni se pesë virgjëreshat u treguan egoiste që nuk e ndanë vajin, por ajo ishte e pamundur. Përgatitja shpirtërore duhet fituar individualisht, pak e nga pak dhe nuk mund të ndahet.

Tani është koha që veten t'ia kushtoni me zell rritjes së dijës tuaj shpirtërore, pak e nga pak, nëpërmjet lutjes, studimit të shkrimeve të shenjta dhe bindjes. Tani është koha për të vazhduar arsimimin tuaj, – pak e nga pak. Çdo mendim dhe gjithashtu çdo veprim i virtytshëm u shton vaj llambave tuaja, duke ju kualifikuar për drejtimin e Frymës së Shenjtë, mësuesit tonë hyjnor.

Fryma e Shenjtë do t'ju drejtojë në udhëtimin tuaj në këtë jetë edhe kur ndieni se jeni në një dritë të sheshtë, të pasigurta për atë që ju pret. Nuk keni pse të frikësoheni. Teksa qëndroni në shtegun që ju çon drejt jetës së përjetshme, Fryma e Shenjtë do t'ju drejtojë në vendimet dhe të mësuarin tuaj.

Unë dëshmoj nga përvoja vetjake se, nëse do të kërkoni të mësoni jo vetëm me anë të studimit, por edhe me anë të besimit, ju *do të drejtoheni tek ajo që "Zoti . . . do të ketë nevojë që ju të bëni dhe ajo që do t'ju duhet të dini"*¹⁴.

Unë e mora bekimin patriarkal kur isha e re dhe u këshillova ta përgatisja veten me një arsimim të mirë dhe t'i mësoja herët në jetë ato virtyte që kërkon amvisëria dhe përkujdesja për një familje. Unë i dëshiroja vërtet bekimet e një familjeje; megjithatë, ai bekim nuk u përmbush derisa qeshë 37 vjeçe, kur së fundi u martova. Bashkëshorti kishte mbetur i ve kështu që, ditën kur u vulosëm në tempull, papritur unë u bekova jo vetëm me një bashkëshort por edhe me një familje prej katër fëmijësh.

Kohë përpara kësaj, kishte shumë ditë kur ndihesha sikur po bëja ski në një dritë të sheshtë duke bërë pyetjen: "Çfarë më pret në të ardhmen?" U përpoqa të ndiqja këshillat në bekimin tim patriarkal. Studiova me zell për t'u bërë një mësuese shkollë dhe e vazhdova arsimimin tim për t'u bërë drejtoreshë në shkollë fillore. Iu luta Atit tim Qiellor dhe kërkova drejtimin e Frymës së Shenjtë. Unë u besoja me zjarr premtimeve të profetëve që më siguruan se po të "qëndroja e vërtetë dhe besnike, të mbaja besëlidhjet e [mia], t'i shërbeja Perëndisë dhe t'i doja Atin [tim] në Qiell dhe Zotin Jezu Krisht, nuk do të më mohojë asnjë prej bekimeve të përjetshme që Ati ynë Qiellor ka për fëmijët e tij besnikë"¹⁵.

Tani e di se arsimimi im, më përgatiti për një jetë që nuk është fare ashtu siç e kisha përfytyruar kur isha e re. Mendova se

po studioja mësuesi për t'u dhënë mësim fëmijëve të shkollave dhe fëmijëve të mi të ardhshëm, por nuk e dija se Zoti po më përgatiste edhe për të dhënë mësim gjuhën angleze në Mongoli, në një mision me bashkëshortin tim dhe për t'u dhënë mësim të rejave në Kishë anembanë botës ose për t'u mësuar nipërve e mbesave të mia vlerën e dijes – të gjitha bekime të jashtëzakonshme që nuk mund t'i kisha përfytyruar kurrë.

Unë dëshmoj se Ati ynë në Qiell ju njeh dhe ju do. Ai ka vënë mirëbesim të madh te ju dhe ka një punë që vetëm *ju* mund ta bëni. Dëshiroj t'ju siguroj se ju *do të* jeni të përgatitura për atë punë të madhe nëse kërkonit të mësoni me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Gordon B. Hinckley, "Reaching Down to Lift Another", *Liahona*, janar 2002, f. 67.
2. *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 9.
3. Doktrina e Besëlidhje 88:118.
4. Gordon B. Hinckley, *Way to Be! Nine Ways to Be Happy and Make Something of Your Life* (2002), f. 28.
5. Gordon B. Hinckley, "Seek Learning", *New Era*, shtator 2007, f. 2, 4.
6. Thomas S. Monson, "If Ye Are Prepared Ye Shall Not Fear", *Liahona*, nëntor 2004, f. 116.
7. *Për Forcën e Rinisë*, f. 9.
8. Cheryl Hanewicz and Susan R. Cheryl Hanewicz dhe Susan R. Madsen, "The Influence of a Mother on a Daughter's College Decision", *Utah Women and Education Project, Research Snapshots*, nr. 3 (janar 2011): 1.
9. Marjorie Cortez, "Mom's Education Key to Halt Poverty Cycle", *Deseret News*, 23 shtator 2011, A1.
10. Olene Walker, "More Utah Women Need to Finish College", *Salt Lake Tribune*, 30 tetor 2011, O4.
11. "Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës", *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
12. Alma 56:47.
13. Mateu 25:8-10.
14. Henry B. Eyring, "Education for Real Life", *Ensign*, tetor 2002, f. 18.
15. M. Russell Ballard, "Preparing for the Future", *Ensign*, shtator 2011, f. 27.

Tani Është Koha për t'u Ngritur e Shkëlqyer!

Nga Elen S. Dalton,

Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Si bija të Perëndisë, ju jeni lindur për të drejtuar.

Unë kam një pamje mbresëlënëse të Tempullit të Solt-Lejkut nga dritarja ime në zyrën e Të Rejave. Çdo ditë unë shoh engjëllin Moroni që qëndron në majë të tempullit si një simbol i ndritshëm, jo vetëm i besimit të tij, por edhe tonit. Më pëlqen Moroni, sepse në një shoqëri shumë të shthurur, ai qëndroi i pastër dhe i vërtetë. Ai është heroi im. Ai qëndroi i vetëm. Ndonjëherë mendoj se ai qëndron në majë të tempullit sot, duke na e bërë me shenjë që të kemi guxim, të kujtojmë se cilat jemi dhe të jemi të denja për të hyrë në tempullin e shenjtë – për t'u "ngri[tur] e shkëlq[yer]"¹, për të qëndruar mbi thirrjen e kësaj bote dhe, ashtu si profetizoi Isaia, për të "[shkuar] . . . në malin e Zotit"² - tempullin e shenjtë.

Sot këtu janë mbledhur bijat e zgjedhura të Zotit. Nuk ka asnjë grup me ndikim më të madh, që qëndron për të vërtetën dhe drejtësinë në të gjithë botën, sesa të rejat dhe gratë e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. E shoh fisnikërinë tuaj dhe e njoh identitetin dhe fatin tuaj hyjnor. Ju u dalluat në ekzistencën para lindjes. Prejardhja juaj familjare mban me vete besëlidhje dhe premtime. Ju keni trashëguar tiparet shpirtërore të patriarkëve besnikë Abrahamit, Isakut dhe Jakobit. Dikur një profet i Perëndisë iu drejtua secilës prej jush që jeni mbledhur këtu sonte, si "shpresa e ndritshme"³ e së ardhmes. Dhe unë jam dakord! Në një botë shumë sfiduese, drita juaj ndrit me shkëlqim. Në të vërtetë, këto janë "ditë për të mos u harruar kurrë"⁴. Këto janë ditët *tuaja* dhe *tani* është koha për të rejat kudo

që të “ngrih[en] e shkëlqej[në], që drita [e tyre] të mund të jetë një flamur për kombet”⁵.

“Një flamur është një rregull i masës përmes së cilës një person përcakton përpikërinë ose përsosmërinë”⁶. Ne duhet të jemi një flamur i shenjtërisë që e gjithë bota ta shohë! Broshura e re, e ripunuar *Për Forcën e Rinisë* përmban jo vetëm standardet për të jetuar me përpikëri, por edhe bekimet e premtuara nëse veproni kështu. Fjalët e përfshira në këtë broshurë të rëndësishme janë standarde për botën dhe të jetuarit e këtyre standardeve, do t’ju japë mundësinë të dini se çfarë të bëni për t’u bërë më shumë si Shpëtimtari dhe për të qenë të lumtura në një botë që po bëhet gjithnjë e më e errët dhe e ligë. Të jetuarit e standardeve në këtë broshurë, do t’ju ndihmojë të kualifikoheni për shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë. Dhe në botën në të cilën po jetoni, ju do të keni nevojë për atë shoqërim për të marrë vendime kritike, që do të përcaktojnë shumicën e suksesit dhe lumturisë suaj të ardhshme. Të jetuarit e këtyre standardeve do ta ndihmojë secilën prej jush të kualifikohet për të hyrë në tempujt e shenjtë të Zotit dhe për të marrë atje bekimet e fuqinë që ju presin ndërsa bëni dhe mbani besëlidhje të shenjta.⁷

Kur vajza jonë, Emi, ishte e vogël, i pëlqente të shikonte çdo lëvizje timen ndërkohë që bëhesha gati për kishë. Pas vëzhgimit të rutinës sime, ajo do të krihte flokët dhe do të vishte fustanin e saj dhe, më pas, do të më kërkonte gjithmonë që t’i vendosja pak “shkëlqim”. “Shkëlqimi” të cilit i referohej ajo, ishte kremi i trashë që e përdorja për të parandaluar rrudhat. Siç më kërkohej, unë do ta vendosja në faqet e buzët e Emit dhe, më pas, ajo do të buzëqeshte e do thoshte: “Tani jemi gati për të shkuar!” Ajo që Emi nuk kuptoi është se ajo tashmë e kishte “shkëlqimin” e saj. Fytyra e saj shkëlqente pasi ishte aq e dëlirë, e pafajshme dhe e mirë. Ajo kishte Shpirtin me vete dhe kjo dukej.

Unë shpresoj se çdo e re e mbledhur këtu sonte do ta dijë dhe do ta kuptojë se bukuria juaj – “shkëlqimi” juaj – nuk qëndron te tualeti, kremi i trashë ose te veshjet më të fundit apo modeli i flokëve. Ajo qëndron te pastërtia juaj vetjake. Kur ju i jetoni standardet dhe kualifikoheni për shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, ju mund të keni një ndikim të fuqishëm në botë. Shembulli juaj, madje edhe drita në sytë tuaj, do të ndikojë

te të tjerët që e shohin “shkëlqimin” tuaj, dhe ata do të dëshirojnë të jenë si ju. Ku e merrni këtë dritë? Zoti është drita “dhe Shpirti ndriçon çdo njeri në botë, që i bindet zërit të Shpirtit”⁸. Një dritë hyjnore vjen te sytë dhe fytyra juaj kur i afroheni Atit tuaj Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit. Ajo është mënyra si ne e marrin atë “shkëlqim”! Dhe për më tepër, sikurse të gjitha ju mund ta shihni, gjithsesi “kremit shkëlqyes” nuk funksionoi vërtet për rrudhat e mia!

Thirrja për t’u “ngritur e për të shkëlqyer” është një thirrje për secilën prej jush, që ta drejtoni botën në kauzën e madhe – për të ngritur flamurin – dhe ta drejtoni këtë brez te virtyti, dëlirësia dhe denjësia për tempull. Nëse dëshironi të bëni një ndryshim në botë, *ju duhet të jeni ndryshe nga bota*. Unë përsëris fjalët e Presidentit Jozef F. Smith, i cili u tha grave të kësaj kohe: “Ju nuk duhet të drejtoheni nga gratë [e reja] të botës; duhet t’i drejtoni ju . . . gratë [e reja] të botës, në gjithçka që është . . . për t’i bërë të dëlirë fëmijët e njerëzve”⁹. Këto fjalë tingëllojnë të vërteta sot. Si bija të Perëndisë, ju jeni lindur për të drejtuar.

Në botën në të cilën jetojmë, aftësia juaj për të drejtuar do të kërkojë udhëheqjen dhe shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, që do t’ju tregojë “të gjitha gjërat që duhet të bëni”¹⁰ ndërsa i dalloni dhe mbështeteni te udhëheqja dhe nxitjet e Tij. Dhe meqënëse Fryma e Shenjtë nuk banon në tempuj jo të shenjtë, secilës prej nesh do t’i duhet të mendojë për zakonet dhe zemrën e vet. Të gjitha ne do të duhet të ndryshojmë diçka – të pendohemi. Sikurse i ati i mbretit Lamon shpalli te Libri i Mormonit: “Unë do t’i braktis të gjitha mëkatet e mia për të të njohur”¹¹. A jemi ne, unë dhe ju, të gatshme për të bërë të njëjtën gjë?

Një grup të rinjsh në Kuin-Krik të Arizonës vendosën të “ngriheshin e të shkëlqenin” dhe t’i drejtonin të rinjtë në komunitetin e tyre për të jetuar standardet në broshurën *Për Forcën e Rinisë*. Çdonjëri shkroi në ditarin e tij/saj diçka që mendonte se e pengonte të përparonte ose diçka që dëshironte të ndryshonte në jetën e tij/saj, dhe ata vërtet hapën një gropë. Ata u bashkuan, e grisën faqen e ditarit dhe e hodhën brenda gropës në tokë, pikërisht siç vepruan njerëzit e Amonit me armët e tyre të luftës në Librin e Mormonit.¹² Më pas ata i varrosën ato faqe

dhe atë ditë secili bëri një zotim për të ndryshuar. Ata u penduan. Ata vendosën të ngriheshin!

A keni ndonjë gjë në jetën tuaj që duhet ta ndryshoni? Ju mund ta bëni këtë. Ju mund të pendoheni falë sakrificës së pafundme shlyese të Shpëtimtarit. Ai e bëri të mundur për ju dhe mua që të ndryshojmë, të bëhemi të dëlira e të pastra përsëri dhe të bëhemi si Ai. Dhe Ai ka premtuar se, kur ta bëjmë këtë, Ai nuk do t'i kujtojë më mëkatet dhe gabimet tona.¹³

Ndonjëherë mund të duket thujtë e pamundur që të vazhdosh të shkëlqesh. Ju hasni kaq shumë sfida që mund të errësojnë burimin e gjithë dritës, që është Shpëtimtari. Ndonjëherë udha është e vështirë dhe madje mund të duket nganjëherë se një mjegull e dendur e errëson dritën. I tillë qe rasti me një të re të quajtur Florenca Çaduik. Në moshën 10-vjeçare, Florenca zbuloi se ishte një notare e talentuar. Ajo notoi përmes Kanalit Anglez në kohën rekord prej 13 orësh e 20 minutash. Florenca e pëlqente sfidën dhe më vonë ajo u orvat për të notuar midis vijës së bregdetit të Kalifornisë dhe ishullit Katalina – rreth 34 kilometra. Në këtë notim, ajo u lodh pasi kishte notuar për 15 orë. Ra një mjegull e dendur që e errësoi pamjen e vijës së bregdetit. Nëna e saj po lundronte pranë saj në një barkë dhe Florenca i tha së ëmës se nuk mendonte se mund ta përfundonte. Nëna dhe trajneri i saj e nxitën të vazhdonte, por gjithçka që ajo mund të shihte ishte mjegulla. Ajo u dorëzua por, sapo hipi në varkë, zbuloi se kishte hequr dorë nga jo më larg se 1.6 km nga vija e bregdetit. Më vonë, kur e intervistuan dhe e pyetën përse hoqi dorë, ajo rrëfeu se nuk qe për shkak të ujit të ftohtë dhe as për shkak të distancës. Ajo tha: “U mposhta nga mjegulla”¹⁴.

Më vonë, ajo tentoi të notonte përsëri dhe sërish ra një mjegull e dendur. Por këtë herë, ajo vazhdoi të notonte derisa arriti me sukses në vijën e bregdetit. Këtë herë kur e pyetën se çfarë ndryshoi kësaj radhe, ajo tha se mbajti një pamje të vijës së bregdetit në mendje përmes mjegullës së dendur dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së notimit.¹⁵

Për Florenca Çaduikun, vija e bregdetit ishte qëllimi i saj. Për secilën prej nesh, tempulli është qëllimi ynë. Të reja, qëndroni të përqendruara. Mos i humbisni nga sytë qëllimet tuaja. Mos e lejoni mjegullën e dendur të ndotjes morale dhe zërat shkurajues

të botës t'ju pengojnë të arrini qëllimet tuaja, të jetoni standardet, të gëzoni shoqërimin e Frymës së Shenjtë dhe të jeni të denja për të hyrë në tempujt e shenjtë. Ruajeni pamjen e tempullit – të shtëpisë së shenjtë të Shpëtimtarit – përherë në zemrat e mendjet tuaja.

Disa javë më parë, qëndrova në dhomën çelestiale të Tempullit të Renos në Nevada. Drita që përshkonte atë dhomë, ishte e shndritshme dhe u bë akoma më e shndritshme prej llambadarit të kristaltë, që pasqyronte kudo dritën në faqet e tij të shumta e të gdhendura në ylbere ndriçues. U drithërova kur kuptova se Shpëtimtari është “drita dhe jeta e botës”¹⁶, që është në dritën e *Tij* që ne duhet të mbështetemi e të reflektojmë. Ne jemi kristalet e vogla që pasqyrojmë dritën e Tij dhe, për ta bërë atë, duhet të jemi të pastra dhe të çliruara nga pluhuri i botës. Teksa qëndrova në tempull atë ditë, unë dëgjova përsëri në mendjen time thirrjen e Moronit ndaj nesh – bijave të Sionit: “Zgjohu[ni] dhe ngrihu[ni] nga pluhuri”¹⁷. “Të mos prekni dhuratën e ligë, as gjënë e papastër”¹⁸. “Zgjohu[ni] dhe ngrihu[ni] . . . , dhe vish[ni] rrobat e bukura, O bij[a] [të] Sionit . . . , që besëlidhjet e Atit të Amshuar që bëri me [ju], O shtëpi e Izraelit, të mund të plotësohen”¹⁹.

Bekimet e premtuara të tempullit nuk jepen vetëm për ju por për të gjithë brezat. Ndërsa e bëni tempullin qëllimin tuaj, ndikimi juaj për mirë do të tejkalojë kohën e vendin dhe puna që ju bëni për ata që janë larguar nga kjo jetë, do të jetë përmbushja e profecisë!

Në konferencën e kaluar të përgjithshme, u ngazëlleva kur dëgjova Plakun Dejvid A. Bednar të ftonte secilën prej jush që të përfshihet me zell në bërjen e historisë së familjes dhe punës së saj vetjake në tempull për ata që kanë ndërruar jetë përpara pa bekimet e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit.²⁰ Kur ai ua bëri këtë ftesë, zemra ime rrahu fort. Te Doktrina e Besëlidhje ne lexojmë për “të tjerë shpirta të zgjedhur të cilët u ruajtën që të vinin në plotësinë e kohëve për të marrë pjesë në ngritjen e themeleve të veprës së madhe të ditëve të mëvonshme, duke përfshirë ndërtimin e tempujve dhe kryerjen e ordinancave në ta për shëlbimin e të vdekurve”²¹. Kjo është koha juaj dhe puna juaj ka nisur! Tani është koha për të qenë të denja dhe për të marrë një

rekomandim tempulli. Ndërsa bëni këtë punë, ju do të bëheni çlirimtare në malin e Sionit.²²

Plaku Rasëll M. Nelson tha për ju: “Ndikimi i të rejave të Kishës, si një gjigant i fjetur, do t’i zgjojë, do t’i ngrëjë dhe do t’i frymëzojë banorët e tokës si një forcë e fuqishme për drejtësi”²³. Të reja, ngrihuni e zini vendet tuaja në ngjarjet e lavdishme që do t’i japin formë të ardhmes suaj dhe të ardhmes së botës. Tani është koha!

“Maj’ malit atje lart’ një flamur po valon. Ju kombe ngrini syt’; gjith’ botën ngjatjeton!”²⁴ Të reja, ju jeni flamuri! Jini të virtytshme dhe të dëlira, kërkoni shoqërimin e Frymës së Shenjtë, groposini mëkatet e shkeljet tuaja, jini të përqendruara dhe mos e lejoni mjegullën e ndotjes morale të errësojë qëllimet tuaja. Jini të denja për të hyrë në tempull tani. Vendoseni në fytyrë “shkëlqimin” tuaj! Unë dëshmoj me gjithë zemrën time se Perëndia jeton dhe Ai do ta ndriçojë jetën tonë ndërsa afrohemi pranë Birit të Tij të Dashur – Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Dhe unë lutem që, sikurse Moroni, ne do të “ngrih[emi] e shkëlqej[më], që drita [jonë] të mund të jetë një flamur për kombet!”²⁵ Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.

Shënime

1. Doktrina e Besëlidhje 115:5.
2. Isaia 2:3; 2 Nefi 12:3.
3. Gordon B. Hinckley, “Standing Strong and Immovable”, *Worldwide Leadership Training Meeting*, 10 janar 2004, f. 20.
4. Oliver Cowdery, te Joseph Smith–Historia 1:71, shënim.
5. Doktrina e Besëlidhje 115:5.
6. Ezra Taft Benson, “Strengthen Thy Stakes”, *Tambuli*, gusht 1991, f. 4.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 109:22.
8. Doktrina e Besëlidhje 84:46.
9. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 184.
10. 2 Nefi 32:5.
11. Alma 22:18; kursivet shtuar.
12. Shih Alma 24:17.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 58:42.
14. Shih Sterling W. Sill, në *Conference Report*, prill 1955, f. 117.
15. Shih Randy Alcom, “Florence Chadwick and the Fog”, epm.org/resources/2010/Jan/21/florence-chadwick-and-fog. Shih gjithashtu “Florence Chadwick”, në *Encyclopedia of World Biography*, vëll. 19 (2004): f. 64–66; “Navigation Information” dhe “Swim Successes”, Catalina Channel Swimming Federation, swimcatalina.com, hyrë në këtë faqe më 27 mars 2012. Ekzistojnë rrëfime të tjera të ndryshme rreth Florence Chadwick.
16. 3 Nefi 9:18.
17. Moroni 10:31.
18. Moroni 10:30.
19. Moroni 10:31.
20. Shih Dejvid A. Bednar, “Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 24–27.
21. Doktrina e Besëlidhje 138:53–54.

22. Shih Abdia 1:21; Doktrina e Besëlidhje 103:9; dhe *Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 472–473.
23. Russell M. Nelson, “Daughters of Zion”, *New Era Young Women Special Issue*, YW nëntor 1985, f. 9.
24. “Lart në Majën e Malit”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 30.
25. Doktrina e Besëlidhje 115:5.

Besoni, Binduni dhe Duroni

Nga Presidenti Tomas S. Monson

Besoni se të qëndroni të forta dhe besnike ndaj të vërtetave të ungjillit ka rëndësi maksimale. Unë dëshmoj se është kështu!

Të dashura motra të mia të reja, përgjegjësia që t’ju drejtohem juve është përlulëse. Unë lutem për ndihmë hyjnore, që të jem në lartësinë e një mundësie të tillë.

Vetëm 20 vite më parë, ju ende nuk e kishit nisur udhëtimin tuaj nëpër vdekshmëri. Ju ishit ende në shtëpinë tuaj qiellore. Atje ju ishit mes atyre që ju donin dhe që shqetësoheshin për mirëqenien tuaj të përjetshme. Përfundimisht, jeta në tokë u bë thelbësore për përparimin tuaj. Pa dyshim që u shprehën lamtumira dhe u dhanë shprehje mirëbesimi. Ju morët trupa dhe u bëtë të vdekshme, të përjashtuara nga prania e Atit tuaj Qiellor.

Megjithatë, një mirëseardhje e gëzueshme ju priste këtu në tokë. Ato vite të para ishin të çmuara e të veçanta. Satani nuk kishte fuqi që t’ju tundonte, sepse ju nuk ishit bërë ende të përgjegjshme. Ju ishit të pafajshme përpara Perëndisë.

Shpejt ju hytë në atë periudhë që disa e kanë etiketuar si “adoleshenca e tmerrshme”. Unë preferoj ta quaj “adoleshenca fantastike”. Çfarë kohe mundësie, një stinë rritjeje, një periudhë zhvillimi – e shënuar nga fitimi i njohurive dhe kërkimi për të vërtetën.

Askush nuk i ka përshkruar vitet e adoleshencës si të lehta. Shpesh ato janë vite pasigurie, të ndjenjave sikur nuk jeni aq të mira sa duhet, i përpjekjes për të gjetur vendin tuaj mes

bashkëmoshatarëve, i përpjekjes për t'u përshtatur shoqërisht. Kjo është një kohë kur ju bëheni më të pavarura – dhe ndoshta dëshironi më shumë liri sesa janë të gatshëm t'ju japin prindërit tuaj pikërisht tani. Ato janë gjithashtu vitet më të rëndësishme kur Satani do t'ju tundojë dhe do të bëjë më të mirën që mundet, që t'ju tërheqë nga shtegu i cili do t'ju kthejë në atë shtëpi qiellore nga e cila erdhët, do t'ju kthejë te të dashurit tuaj atje dhe do t'ju kthejë tek Ati juaj Qiellor.

Bota përreth jush, nuk është e pajisur për t'ju siguruar ndihmën e cila ju nevojitet për t'ia dalë mbanë përmes këtij udhëtimit shpesh të pabesë. Kaq shumë njerëz në shoqërinë tonë sot duken sikur janë zgjidhur nga moli i sigurisë dhe janë zhvendosur nga limani i paqes.

Lejimi ndaj mëkatimit, imoraliteti, pornografia, drogat, fuqia e shtytjes së shoqërisë – të gjitha këto dhe të tjera – bëjnë që shumë vetë të lëkunden në një det mëkati dhe të dërrmohen në shkëmbijtë e thepisur nënujorë të mundësive të humbura, bekimeve të çuara dëm dhe ëndrrave të shkatërruara.

A ka një udhë drejt sigurisë? A ka shpëtim prej shkatërrimit kanosës? Përgjigjja është një *po* kumbuese! Unë ju këshilloj që të shihni te fari i Zotit. Unë e kam thënë këtë më parë; unë do ta them sërish: nuk ka mjegull aq të dendur, natë aq të errët, tufan aq të fortë, marinar aq të humbur, saqë fari i Zotit të mos mund ta shpëtojë. Ai na sinjalizon gjatë stuhive të jetës. Ai na thërret: "*Këtej drejt sigurisë. Këtej për në shtëpi.*" Ai lëshon sinjale drite që shihen lehtë dhe nuk dështojnë kurrë. Nëse ndiqen, këto sinjale do t'ju udhëheqin për t'u kthyer te shtëpia juaj qiellore.

Dëshiroj t'ju flas sonte për tri sinjale thelbësore nga fari i Zotit që do t'ju ndihmojnë të ktheheni tek ai Atë që pret me padurim kthimin tuaj triumfues në shtëpi. Këto tri sinjale janë: *besoni*, *binduni* dhe *duroni*.

Së pari, po përmend një sinjal që është themelor dhe thelbësor: *besoni*. Besoni se ju jeni një bijë e Atit Qiellor, se Ai ju do dhe se jeni këtu për një qëllim të lavdishëm – që të fitoni shpëtimin tuaj të përrjetshëm. Besoni se të qëndroni të forta dhe besnike ndaj të vërtetave të ungjillit ka rëndësi maksimale. Unë dëshmoj se është kështu!

Mikeshat e mia të reja, besoni në fjalët që thoni çdo javë ndërsa recitoni temën e Të Rejave. Mendoni për kuptimin e atyre fjalëve. Ka të vërtetë atje. Përpiquni fort që t'i jetoni gjithmonë vlerat që përmenden. Besoni që, ashtu siç deklaroi tema juaj, nëse i pranoni dhe veproni sipas atyre vlerave, ju do të jeni të përgatitura të forconi shtëpinë dhe familjen, të bëni dhe të mbani besëlidhjet e shenjta, të merrni ordiancat e tempullit dhe, së fundi, të gëzoni bekimet e ekzaltimit. Këto janë të vërteta të bukura të ungjillit dhe, duke i ndjekur ato, ju do të jeni më të lumtura gjatë gjithë jetës suaj këtu dhe më pas, sesa do të ishit po t'i shpërfillni ato.

Shumicës prej jush ju janë dhënë mësim të vërtetat e ungjillit që nga koha kur keni qenë vogëlushe. Juve ju është dhënë mësim nga prindër të dashur dhe mësues dashamirës. Të vërtetat që ju dhanë ata, ju ndihmuan të fitoni një dëshmi; ju besuat atë që ju është dhënë mësim. Edhe pse ajo dëshmi mund të vazhdojë të ushqehet shpirtërisht dhe të rritet ndërsa studioni, ndërsa luteni për udhëheqje dhe ndërsa merrni pjesë çdo javë në mbledhjet tuaja në Kishë, varet prej jush që ta mbani gjallë atë dëshmi. Satani do të përpiqet me gjithë çka mundet që ta shkatërrojë atë. Gjatë gjithë jetës suaj juve do t'ju duhet ta ushqeni atë. Ashtu si flaka e një zjarri ndriçues që digjet, dëshmia juaj – nëse nuk ushqehet vazhdimisht – do të venitet deri në thëngjij flakërues dhe pastaj do të ftohet plotësisht. Ju nuk duhet ta lejoni që të ndodhë kjo.

Përveç që të ndiqni mbledhjet tuaja të së dielës dhe aktivitetet mbrëmjeve gjatë javës, kur të keni shansin që të përfshiheni në seminar, qoftë herët në mëngjes ose gjatë orëve të lira mësimore, shfrytëzoheni atë mundësi. Shumë prej jush po e frekuentojnë tani seminarin. Ashtu si me çdo gjë në jetë, shumë prej asaj që do të merrni nga përvoja juaj në seminar, varet nga qëndrimi juaj dhe gatishmëria për të marrë mësim. Qoftë qëndrimi juaj një qëndrim përulësie dhe dëshire për të mësuar. Sa mirënjohës jam për mundësinë që pata kur isha adoleshent për të frekuentuar seminarin herët në mëngjes, sepse ai luajti një rol jetik në zhvillimin tim dhe në zhvillimin e dëshmisë sime. Seminari mund të ndryshojë jetën.

Shumë vite më parë, isha në një bord drejtuesish me një burrë të shkëlqyer që kishte qenë jashtëzakonisht i suksesshëm në jetë. Më la mbresë integriteti i tij moral dhe besnikëria ndaj Kishës. Mësova se ai kishte fituar një dëshmi dhe ishte bashkuar me Kishën për shkak të seminarit. Kur ishte martuar, bashkëshortja e tij kishte qenë në Kishë që kur kishte lindur. Ai nuk i përkiste asnjë kisha. Gjatë viteve dhe me gjithë përpjekjet e saj, ai nuk shfaqti interes për të marrë pjesë në kishë me bashkëshorten dhe fëmijët e tij. Dhe më pas ai filloi t'i çonte me makinë dy nga bijat e tij në seminar herët në mëngjes. Ai do të qëndronte në makinë ndërkohë që ato zhvillonin orën e tyre mësimore dhe pastaj do t'i çonte në shkollë me makinë. Një ditë po binte shi dhe një prej të bijave i tha: "Hyr, Babi. Mund të qëndrosh në korridor." Ai e pranoi ftesën. Dera e klasës ishte e hapur dhe ai filloi të dëgjonte. Zemra e tij u prek. Gjatë pjesës tjetër të atij viti shkollor, ai mori pjesë në seminar me bijat e tij, gjë që çoi përfundimisht në anëtarësinë e tij dhe një aktivitet në Kishë gjatë të gjithë jetës. Le të ndihmojë seminari për të ndërtuar dhe forcuar dëshminë tuaj.

Do të ketë kohë kur do të përballeni me sfida që mund ta rrezikojnë dëshminë tuaj, ose ju mund ta shpërfillni ndërsa ndiqni interesa të tjera. Unë ju përgjërohem që ta mbani të fortë. Është përgjegjësia juaj dhe vetëm juaja, që ta mbani flakën e saj të digjet me shkëlqim. Kërkohen përpjekje, por janë përpjekje për të cilat kurrë ndonjëherë nuk do t'ju vijë keq. Më kujtohen fjalët e një kënge të shkruar nga Xhuli de Azevedo Hanks. Duke iu referuar dëshmisë së saj, ajo shkroi:

*Nëpër erërat e ndryshimit
Rrethuar nga retë e dhembjes
Unë e ruaj atë me jetën time
Kam nevojë për ngrohtësi – kam nevojë për dritë
Edhe pse stuhia do të tërbohet
Unë qëndroj kundrejt shiut me rrebesh
Unë mbetem
Një mbajtëse e flakës.¹*

Besofshi dhe pastaj e mbajtshi flakën e dëshmisë suaj që të digjet plot shkëlqim, pavarësisht çfarë mund të ndodhë.

Tjetra, të reja, qofshi të *bindura*. Bindjuni prindërve tuaj. Bindjuni ligjeve të Perëndisë. Ato na janë dhënë nga një Atë i dashur Qiellor. Nëse u bindemi, jeta jonë do të jetë më përmbushëse, më pak e ngatërruar. Sfidat dhe problemet tona do të jenë më të lehta për t'u duruar. Ne do të marrim bekimet e premtuara prej Zotit. Ai ka thënë: "Zoti kërkon zemrën dhe një mendje të gatshme; dhe të gatshmit dhe të bindurit do të hanë të mirat e tokës së Sionit në këto ditë të fundit"².

Ju keni vetëm një jetë për të jetuar. Mbajeni sa më të lirë të mundeni nga telashet. Ju do të tundoheni, nganjëherë nga njerëz që keni menduar se i kishit miq.

Disa vite më parë fola me një këshilluese të grupit Mia Meid, e cila më tregoi një përvojë që kishte pasur me një nga të rejat në klasën e saj. Kjo e re ishte tunduar kohë pas kohe që ta linte shtegun e së vërtetës dhe të ndiqte rrugën e tërthortë të mëkatit. Nëpërmjet këmbënguljes së vazhdueshme të disa prej shoqeve të saj në shkollë, së fundi ajo kishte rënë dakord që të ndiqte një rrugë të tillë tërthore. Ishte bërë plani: ajo do t'u thoshte prindërve se do të shkonte në mbrëmjen e saj të aktiviteteve për Të Rejat. Megjithatë, ajo planifikoi të ishte aty vetëm për aq kohë sa të vinin e ta merrnin shoqet e saj dhe ata me të cilët ato po takoheshin. Ata pastaj do të shkonin në një mbrëmje ku do të përdoreshin pije alkoolike dhe ku sjellja do të ishte në shkëlqje të plotë të atyre gjërave që kjo e re e dinte se ishin të drejta.

Mësuesja ishte lutur për frymëzim që t'i ndihmonte të gjitha vajzat e saj, por veçanërisht për këtë të re, që dukej kaq e pasigurt për zotimin e saj ndaj ungjillit. Mësuesja kishte marrë frymëzim atë natë që ta linte atë që kishte planifikuar paraprakisht dhe t'u fliste vajzave për të qëndruar të pastra moralisht. Kur ajo filloi të tregonte mendimet e ndjenjat e saj, e reja në fjalë e kontrollonte shpesh orën që të sigurohej se nuk po humbiste takimin me shoqet e saj. Megjithatë, ndërsa diskutimi vazhdoi, zemra e saj u prek, ndërgjegjja e saj u zgjua dhe vendosmëria e saj u përtëri. Kur tingulli i përsëritur i borisë së automjetit e thirri, ajo e shpërfilli atë. Ajo mbeti gjatë të gjithë mbrëmjes në klasë me mësuesen e saj dhe vajzat e tjera. Tundimi për të devijuar nga udha e miratuar e Perëndisë, ishte shmangur. Satani ishte zbrapsur. E reja qëndroi pasi të tjerat ishin larguar me qëllim që

ta falënderonte mësuesen e saj për mësimin dhe t'i tregonte se si e kishte ndihmuar që të shmangte atë që mund të kishte pasur një rezultat tragjik. Lutja e një mësueseje kishte marrë përgjigje.

Mësova më tej se, për shkak se kishte marrë vendim që të mos shkonte me shoqërinë e saj atë natë – disa nga vajzat e djemtë më të pëlqyer në shkollë – ata e kishin shmangur të renë dhe, për shumë muaj, ajo nuk kishte miq në shkollë. Ata nuk mund ta pranonin se ajo nuk ishte e gatshme të bënte gjërat që ata bënin. Qe një periudhë jashtëzakonisht e vështirë dhe e vetmuar për të, por ajo mbeti e palëkundur dhe, përfundimisht, fitoi shoqëri që kishte standardet e saj. Tani, disa vite më vonë, ajo ka bërë një martesë në tempull dhe katër fëmijë të mrekullueshëm. Sa e ndryshme mund të kishte qenë jeta e saj. Vendimet tona përcaktojnë fatin tonë.

Të reja të çmuara, bëni që çdo vendim që mendoni, të kalojë këtë testim: “Çfarë më bën kjo mua? Çfarë bën kjo për mua?” Dhe mos lejoni që kodi juaj i sjelljes të theksojë “Çfarë do të mendojnë të tjerët?” por përkundrazi “Çfarë do të mendoj unë për veten?” Ndikohuni nga ai zë i qetë dhe i ulët. Kujtoni se dikush me autoritet iu vuri duart mbi kokë në kohën e konfirmimit tuaj dhe tha: “Merre Frymën e Shenjtë”. Hapini zemrat, madje vetë shpirtrat tuaj, ndaj tingullit të atij zëri të veçantë që dëshmon për të vërtetën. Ashtu si premtoi profeti Isaia: “Veshët e tu do të dëgjojnë . . . një fjalë që do të thotë: ‘Kjo është rruga, ecni në të!’”³

Qëndrimi i zakonshëm i kohës sonë është lejueshmëria ndaj mëkatimit. Revistat dhe shfaqjet televizive portretizojnë yje të ekranit të filmave, heronj të fushës atletike – ata të cilët shumë të rinj janë të etur t’i kenë shembull – të cilët shpërfillin ligjet e Perëndisë dhe përfshihen haptas në praktika mëkatore, pa ndonjë pasojë në dukje. Mos e besoni këtë! Ka një kohë kur bëhen llogaritë – madje një bilanc të librit të llogarive. Çdo Hirushe ka mesnatën e saj – nëse jo në këtë jetë, atëherë në tjetrën. Dita e Gjykimit do të vijë për të gjithë. A jeni të përgatitura? A jeni të kënaqura me rezultatin tuaj?

Nëse ndokush është penguar në udhëtimin e saj, ju premtoj se ka një mënyrë kthimi pas. Procesi quhet pendim. Shpëtimtari ynë vdiq që të na siguronte juve dhe mua atë dhuratë të bekuar. Edhe pse shtegu është i vështirë, premtimi është i vërtetë. Tha

Zoti: “Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora”⁴. “Dhe nuk do [t’i] kujtoj më [ato].”⁵

Motrat e mia të reja e të dashura, ju keni dhuratën e çmuar të lirisë së zgjedhjes. Unë ju përgjerohem që të zgjidhni të bindeni.

Së fundi, qofshi të *duruara*. Çfarë do të thotë të durosh? Më pëlqen shumë ky përkufizim: të *rezistosh me kurajë*. Kuraja mund të jetë e nevojshme që ju të besoni; nganjëherë do të jetë e nevojshme ndërsa ju bindeni. Me sigurinë më të madhe do të kërkohet ndërsa ju duroni deri në atë ditë kur ta lini këtë ekzistencë në vdekshmëri.

Kam folur gjatë viteve me shumë njerëz që më kanë thënë: “Kam kaq shumë probleme, shqetësime kaq të rënda. Jam i trullësuar nga sfidat e jetës. Çfarë mund të bëj?” U kam ofruar atyre dhe tani ju ofroj juve, këtë sugjerim të veçantë: kërkoni udhëheqje qiellore çdo ditë një e nga një. Të jetosh duke u shqetësuar për të ardhmen është e vështirë, por të jetosh duke u kujdesur për çastin është e lehtë. Secili prej nesh mund të jetë i vërtetë për vetëm një ditë – dhe pastaj një tjetër dhe pastaj një tjetër pas asaj – derisa të kemi jetuar një jetë të udhëhequr nga Shpirti, një jetë pranë Zotit, një jetë me vepra të mira dhe drejtësi. Shpëtimtari premtoi: “Shikoni tek unë dhe duroni deri në fund, dhe do të jetoni; pasi atij që duron deri në fund, unë do t’i jap jetën e përjetshme”⁶.

Për këtë qëllim keni ardhur ju në vdekshmëri, miket e mia të reja. Nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa synimi që po përpiqeni fort të arrini – madje jeta e përjetshme në mbretërinë e Atit tuaj.

Ju jeni bija tepër të çmuara të Atit tonë Qiellor të dërguara në tokë në këtë ditë dhe kohë për një qëllim. Ju jeni rezervuar pikërisht deri në këtë orë. Gjëra të mrekullueshme e të lavdishme ju presin vetëm nëse besoni, bindeni dhe duroni. Qoftë ky bekimi juaj, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, amen.

Shënime

- | | |
|---|-------------------|
| 1. Julie de Azevedo Hanks, “Keeper of the Flame”, <i>Treasure the Truth</i> (kompakt disk, 1997). | 4. Isaia 1:18. |
| 2. Doktrina e Besëlidhje 64:34. | 5. Jeremia 31:34. |
| 3. Isaia 30:21. | 6. 3 Nefi 15:9. |